FLAMUR BUÇPAPAJ

HIJET E KRYEQYTETIT TË KUQ

PSIKOPATI

Botimet Nacional, Tiranë

Autor: Flamur Buçpapaj
Titulli: HIJET E KRYEQYTETIT TË KUQ, PSIKOPATI
Botues: Shtëpia Botuese Nacional
Redaktor: Dr. Mujë Buçpapaj
Lloji: Roman
Grafika: Arjan Milla
ISBN: 9789928396846
Email: bucpapaj@yahoo.com, nacionalalbania@yahoo.com
Tiranë, Shqipëri, 2025

Adresa: Botimet Nacional, rruga "Aleksander Moisiu",
Blloku i mediave, ish-Kinostudioja "Shqipëria e re",
Tiranë, Shqipëri
Tiranë, 2026

©Të gjitha të drejtat janë të autorit.

Vulnera infantiae diutius quam corpus vivunt.
Amabunt, sed amare nescient;
vivent, sed vitam non intellegent.
In mundo iniusto, amor fit somnium,et spes sola manet.

Asnjë qenie nuk jeton përgjithmonë, por plagët e fëmijërisë jetojnë më gjatë se trupi. Prandaj mendoni mirë kur sillni fëmijë në jetë: Mos i braktisni, mos i lini në mëshirë të kriminelëve, sepse ajo që u thyhet në shpirt nuk shërohet kurrë. Trauma bëhet shoqëruesja e tyre e përjetshme, deri në frymën e fundit.

Ata do të dashurojnë, por nuk do të dinë si të dashurojnë.
Do të jetojnë, por nuk do të dinë çfarë është jeta.
Makthi dhe e kaluara nuk harrohen — Ato flenë zgjuar brenda njeriut.
Dhe shpesh, në një botë të padrejtë, njeriu bindet se vetëm hakmarrja mund të shërojë plagët e hapura të shpirtit, sepse drejtësia ose vonon pafundësisht, ose humbet rrugës dhe nuk vjen kurrë. Kur e keqja mbetet pa ndëshkim dhe e vërteta pa zë, zemra helmohet nga ndjenja se vuajtja e përjetuar kërkon një kundërpeshë. Një akt që ta rikthejë ekuilibrin e humbur, sado i rremë apo i dhunshëm të jetë ai. Kështu, hakmarrja

shfaqet si një iluzion shprese, si një drejtësi e marrë në duart e njeriut, edhe pse shpesh ajo nuk shëron, por thellon plagën dhe e kthen dhimbjen në një rreth vicioz pa fund.
Ndërkohë, dashuria e vërtetë mbetet një mundësi e brishtë, pothuajse e paarritshme, sepse askush nuk e ka garantuar atë dhe askush nuk mund ta premtojë si një të drejtë. Ajo nuk imponohet, nuk blihet dhe nuk fitohet me forcë. Ekziston vetëm si shpresë e heshtur në zemrat e lodhura dhe si ëndërr që i reziston zhgënjimit. Dashuria jeton në hapësirën e pasigurt mes besimit dhe frikës, mes dëshirës për t'u dorëzuar dhe frikës për t'u lënduar sërish. Pikërisht për këtë arsye, ajo është e rrallë dhe e çmuar, sepse kërkon guxim në një botë që ushqen cinizmin dhe kërkon besim në një realitet që shpesh e tradhton…..

Hapat e parë në kryeqytetin e kuq .. Psikopati

Irritur mes dhunës dhe ftohtësisë, ai u bë psikopat, por arriti të jetë mjeku më i mirë në Evropë, i admiruar nga bota dhe i besuar nga shkenca. Por hija e fëmijërisë i ecte pas në çdo korridor suksesi, e padukshme për të tjerët, e pashmangshme për shpirtin, sepse ajo që na formon në errësirë nuk zhduket kurrë në dritë.

Hijet e së kaluarës nuk zhduken kurrë. Ato thjesht mësojnë të ecin pas nesh. Ne shërohemi, jo kur i harrojmë, por kur guxojmë ta kthejmë kokën dhe t'u themi: Nuk jeni më zotërit e shpirtit tonë.

Çmenduria nuk vjen papritur. Ajo është heshtja e gjatë e dhimbjes që askush nuk e dëgjoi.

"Kur njeriu humb realitetin, ai nuk sheh më njerëz — Sheh skena nga vetja e tij."……

Në spitalin "Nënë Tereza" sapo ishte shpallur fituesi i konkursit kombëtar për vendin e kirurgut të parë. Emri i tij do të përflitej gjatë në korridoret e spitalit: Arben Kodra, djalë nga Librazhdi, i gjatë, brun i çelët, me sy jeshil të thellë

dhe pamje që më shumë të kujtonte një top-model, sesa një mjek që kishte kaluar netë të tëra me libra nëpër duar
Në atë paradite të acartë dimri të vitit 1996, kur Shqipëria dridhej e tëra nga stuhia politike që po afrohej, Arbeni ngjiti shkallët e hyrjes kryesore të spitalit me hapa të ngadaltë e të sigurt. Palltoja e tij gri lëkundej lehtë mbi trupin e hollë. Pantallonat e zeza ishin aq mirë të hekurosura sa të jepnin përshtypjen e një disipline ushtarake. Këpucët italiane shkëlqenin në dyshemenë e mermerit sikur po lajmëronin ardhjen e dikujt të veçantë. Nga larg, dukej pak i përkulur përpara, me atë seriozitet të lindur që nuk e braktiste asnjëherë. Nuk kishte as muskuj të formuar, as shpatulla të gjera. Trupi i tij ishte i hollë, më shumë i ngjante një balerini sesa një kirurgu me dorë të fortë. Por eleganca ishte e tij prej natyre. Edhe kur nuk kishte pasur para, dinte të vishej me shije. Tani që ishte bërë kirurg i parë, kjo shije vetëm ishte rritur.
Korridori i gjatë i drejtorisë jehonte lehtë me zhurmën e hapave të tij. Ndërsa ecte, ndiente qartë se po e shikonin. Nga zyrat anësore, disa fytyra dilnin fshehtaz në derë. Jo nga kurioziteti i thjeshtë, por nga habia. Femrat e administratës e ndiqnin me sy të zbutur, disa me buzëqeshje të lehtë, disa me mendime të fshehta. Ishte hera e parë që para tyre kalonte një mjek me bukuri të tillë dhe me zërat që qarkullonin për të: Djaloshi që kishte mbaruar shkollën me të gjitha dhjeta dhe që kishte kryer kurse pasuniversitare, që kishte fituar gradën Doktor i Shkencave në Kirurgji….etj

"Nuk është thjesht i bukur, - pëshpëritën dy punonjëse, - është gjeni."
Arbeni e ndiqte këtë vëmendje me qetësi. Në hapin e katërt u ndal, nxori ngadalë dorën nga xhepi i djathtë i kostumit të zi dhe shikoi orën "Seiko" në kyçin e dorës. Akrepat tregonin 09:00.
Drejtori i përgjithshëm, Profesor pediatër, një nga mjekët më të mirë të vendit, duhej të ishte në zyrë. Arbeni kishte pyetur më parë te recepsioni dhe i kishin thënë se profesori kishte ardhur herët, si çdo ditë tjetër.
Para tij, në fund të atij korridori të gjatë e të ndriçuar fort, ndodhej dera me tabelën e artë:

"DREJTORI I PËRGJITHSHËM".
…Arbeni mori frymë thellë, sikur donte të mbante brenda vetes një qetësi që nuk ekzistonte më. Jashtë, acari dimëror të fuste therje në lëkurë. Ajri ishte i ashpër, i thatë dhe rrugët dukeshin si të ngrira jo vetëm nga bora, por edhe nga frika. Frymëmarrja dilte si avull i bardhë, një shenjë e vogël jete në një qytet që dukej i mpirë.
Brenda, atmosfera e vitit 1996 ishte edhe më e akullt. Thashethemet për përmbysje kushtetuese përhapeshin nga zyrat nëpër korridore, nga kafenetë e errëta te dhomat e pritjes së spitaleve. Askush nuk fliste hapur, por të gjithë e dinin. Fjalët qarkullonin me zë të ulët, të prera, sikur edhe muret kishin veshë.
Shteti dukej se po rrëshqiste nga duart e veta. Ligjet humbnin

peshë, institucionet lëkundeshin dhe besimi kishte filluar të thyhej si akulli i hollë nën këmbë. Nëpër spitale, mjekët punonin me turne të gjata, me paga që nuk mjaftonin as për dinjitet, ndërsa shpresat për stabilitet shuheshin çdo ditë nga një lajm i ri.

Ikjet masive të mjekëve drejt Gjermanisë nuk ishin më thjesht lajme; Iinin boshllëqe konkrete. Dhoma pa staf, pavione të heshtura, kolegë që nuk ktheheshin më nga pushimet "e përkohshme". Çdo largim ishte një plagë e re për sistemin dhe një pyetje e hidhur për ata që mbeteshin.

- A duhet të iki edhe unë? - e pyeti Arbeni veten, duke shtrënguar pallton rreth trupit. - Apo të qëndroj, edhe nëse gjithçka po shembet?

Askush nuk i jepte përgjigje. As koha. As shteti.

Në atë dimër, acari nuk ishte vetëm jashtë. Ai kishte hyrë thellë brenda njerëzve, duke ngrirë besimin, durimin dhe ëndrrën për një të nesërme më të sigurt.

Edhe Arbenit i kishin ofruar të ikte. Dy herë madje. Por ai kishte zgjedhur të qëndronte.

Të punonte aty, në spitalin më të mirë të vendit. Të niste karrierën e tij pikërisht këtu, në zemër të kryeqytetit të kuq. Ai ngriti dorën dhe e përgatiti për të trokitur.

Një kapitull i ri i jetës së tij po hapej, një kapitull që nuk do të ishte i thjeshtë. As i pafajshëm. As i zakonshëm.

Dhe hijet e korridorit dukej sikur e dinin këtë më mirë se kushdo. Ai trokiti dy herë. Pastaj pushoi pak, priti ndonjë zë, dhe kur s'u dëgjua asgjë, trokiti sërish. Prapë heshtje.

Atëherë shtyu ngadalë derën, pa pritur që dikush t'i thoshte "Hajde!" apo "Hyr brenda!".
Dera u hap dhe përballë tij, pas një xhami të pastër kristali, në tavolinën e punës ishte sekretarja.
- Përshëndetje, - tha ai me një gjysmë zëri.
- Si jeni? - pyeti përsëri, por pa marrë përgjigje shtoi: - Jam Arben Kodra,… kirurgu i ri…, doktor shkencash.
- E di, - ia ndërpreu fjalën sekretarja. - Të njoh nga fotografia e dosjes. Mirë se erdhe, zoti Arben!
Ajo e përshëndeti me një buzëqeshje të lehtë.
- Si jeni? Familja mirë? - e pyeti me ton të sjellshëm.
Arbeni uli kokën. U duk sikur u kap në faj. S'e kishte të lehtë t'i përmendnin familjen, ose më mirë, boshllëkun që ai e quante familje. Por nuk tha asgjë. Nuk tregoi as varfërinë, as historinë e zymtë që mbante brenda. Zgjodhi heshtjen.
Me lëvizje të shpejta instiktive, e fshiu me dorë pallton gri, sikur ajo ishte rrudhur, ose sikur po hiqte pluhurat që s'kishin qenë kurrë aty. Ishte një gjest që i përsëritej sa herë dikush i përmendte familjen. Ai kishte lexuar dikur se, ngrohtësia dhe siguria e përjetshme është familja. "Zoti është tek familja", shkruhej në një libër të vjetër që kishte lexuar në fëmijëri… Dhe fjalët i kujtonin gjithmonë atë boshllëk të tijin.- Po, zoti Arben, - tha sekretarja pas pak. - Cili është problemi juaj?
Ai nuk foli menjëherë. Mendoi, pastaj rregulloi përsëri jakën e palltos me ato lëvizjet e tij të pandryshueshme, dhe më në fund tha:

- Kam ardhur sepse më ka thirrur profesor Mentori,… drejtori.
- Ah, shumë mirë, - tha sekretarja. - Keni lënë takim me të?
- E… zotëri? - pyeti ajo sërish, kur pa që ai nuk po përgjigjej.
Mira - Ky ishte emri i saj. Ishte rreth të dyzetave, por ende ruante linja të bukura. Sytë jeshilë binin në sy në kombinim me flokët bionde dhe bustin e formuar. Trupi i saj ishte harmonik, pa celulit, ende i freskët për moshën që kishte.
Ajo u tërhoq paksa kur pa se Arbeni po e shikonte drejt, gjatë, dhe nuk po kthente përgjigje. Spitali "Nënë Tereza" në Tiranë ishte ende i zhurmshëm atë paradite dimri të acartë. Ishte viti 1996. Shqipëria po lëkundej si në prag të një stuhie, një llavë politike që pritej të shpërthente përmbysje kushtetuese. Mes kësaj trazire, Arben Kodra sapo kishte fituar konkursin e kirurgut të parë. Kishte mbaruar mjekësinë me gjithë dhjeta. Kursin dyvjeçar pasuniversitar për kirurgji me nota të shkëlqyera dhe madje kishte marrë edhe gradën "Doktor i Shkencave".
Ai dukej më shumë si top model sesa si kirurg: I gjatë, pak esmer, sy jeshilë të kthjellët, trup i hollë, pa muskuj të tepërt, si një balerin i formuar, si një figurë që s'e mban toka e zakonshme. Vishte një kostum të zi elegant, këpucë italiane të zeza, pallto gri të drejtë, të pastër. Arbeni vinte nga fshati, por dinte të vishej bukur edhe kur nuk kishte para, e aq më shumë tani. Ai kujtua që gjërat nuk janë si duken, sepse komunistët, s'do falin pushtetin e lënë.
Brendësisë së vitit 1996 i mungonte çdo ngrohtësi.

Thashethemet për përmbysje kushtetuese lëviznin nëpër zyra, kalonin nga kafenetë e errëta te korridoret e spitaleve, pa u thënë kurrë hapur. Askush nuk fliste, por të gjithë dinin. Fjalët qarkullonin me zë të ulët, të prerë, sikur muret vetë i dëgjonin dhe i raportonin.

Shteti dukej se po rrëshqiste nga duart e veta. Ligjet humbnin peshë, institucionet lëkundeshin, dhe besimi thyhej nën këmbë si akulli i hollë që paralajmëron rënien. Nëpër spitale, mjekët mbijetojnë me turne të gjata dhe paga që poshtëronin profesionin. Çdo ditë sillte një lajm të ri, dhe çdo lajm thërriste shpresat që kishin mbetur.

Ikjet drejt Gjermanisë nuk ishin më thjesht statistika, ishin boshllëqe të prekshme. Dhoma pa staf, pavione të heshtura, kolegë që iknin dhe nuk ktheheshin më. Çdo largim ishte një plagë e re në trupin e një sistemi që po shpërbëhej dhe një pyetje e hidhur për ata që mbeteshin.

- Po unë? - e pyeti veten, duke shtrënguar pallton rreth trupit.

- Të iki, apo të qëndroj, edhe kur gjithçka po shembet rreth meje?

Askush nuk i jepte përgjigje. As koha. As shteti.

Atë dimër, acari nuk ishte vetëm jashtë. Ai kishte depërtuar brenda njerëzve, duke ngrirë besimin, durimin dhe vetë idenë e së nesërmes.

Atëherë, zoti Arben iu drejtua sekretarja, me një zë të qetë, por të prerë:

- Tani, ju nuk keni caktuar një takim me shefin, - Joo, - tha

ai, duke e vështruar me kujdes. - Por mendoj se nuk ka problem. Do t'ju pres. Njerëzit që janë brenda tani,…besoj që do dalin, apo jo?
Ai ndaloi për një çast, duke u siguruar që ajo e kuptonte rëndësinë e momentit.
- S'ka gjë shefe, - tha ky përsëri, - pres kur të dalin.
- Do t'i them unë shefit, - tha sekretarja. - Kështu gjithçka do të shkojë qetë dhe pa keqkuptime.
Sekretarja, paksa e tensionuar, bëri shenjë me kokë, duke përtypur fjalët dhe duke kuptuar që çdo gjë në këtë zyrë ndodhte sipas një ritmi të caktuar. Arbeni mbajti sytë mbi derën, duke vlerësuar çdo lëvizje të mundshme dhe duke ndjerë peshën e vendimeve që mund të merrnin forma të papritura.
- Mirë, - tha ai më në fund, - Prisni pak dhe mos u shqetësoni. Çdo gjë do të shkojë sipas planit. Mbaroi së foluri ajo
Heshtja mbeti për disa çaste, ndërsa atmosfera e zyrës u mbush me atë tension të hollë që vetëm pritja e diçkaje të rëndësishme mund të sjellë. Drita e dobët e llambës mbi tryezë hidhte hije të gjata mbi mur, duke i dhënë çdo objekti një formë të pazakontë dhe një ndjesi të çuditshme pritjeje. Tani ai e ndjeu këtë tension në çdo qelizë të trupit. Qetësia që shfaqte ishte vetëm një maskë. Brenda, mendimet e tij fluturonin në të gjitha drejtimet, duke shqyrtuar skenarë të mundshëm, duke përpunuar çdo fjalë të thënë dhe çdo heshtje të shfaqur. Dëgjonte rrahjet e zemrës së vet si eko në hapësirën e vogël të zyrës. Çdo lëvizje e papritur

e sekretarës, çdo shfletim dokumenti, çdo tingull i lehtë i tastierës i dukej si paralajmërim për diçka që mund të ndryshonte gjithcka.

Ai mbajti frymën për një çast të gjatë, duke përpjekur të qetësohej, por mendimi se çdo vendim i tij mund të kishte pasoja të mëdha nuk e linte të qetësohej. Ishte një tension i brendshëm që nuk mund të shfaqej jashtë, një pritje që ngjante me një stuhi të fshehur, gati të shpërthente në çdo momenti. Aa se harrova fare. Jemi bërë si robotë.

- Si i keni nga shtëpia? - pyeti sekretarja në fund, si për t'i thënë diçka që kishte rëndësi.

Arbeni uli kokën menjëherë. Ai gjest, ajo përkulje e lehtë e qafës, vinte gjithmonë kur dikush i përmendte familjen. S'tha se nuk kishte familje. S'tha as se nuk e dinte çfarë quhej "familje" në fëmijërinë e tij. Heshti. Pastaj nisi të shkundte instinktivisht pallton, sikur të donte të largonte një pluhur të padukshëm, një shprehi që e kishte që fëmijë, sa herë i përmendej familja.

"Zoti është tek familja", kishte lexuar dikur në një libër të vjetër. Dhe pikërisht se nuk e kishte gjetur kurrë, atë zot. E ndiente sikur e ndiqte kudo.

- Po, zoti Arben, - tha ajo pas pak. - Më thuaj, si t'ia them drejtorit? Ju më keni thënë që nuk keni lënë takim me të, apo jo?

Ai heshti për një çast, duke ecur pak përpara, uli sytë dhe, me zë të ulët, iu përgjigj:

- Jo… nuk kam lënë. - Atëherë, duhet të presim derisa të

dalin ata që janë brenda përsëri, që të aprovojmë shansin për ty, - shtoi ajo, duke u përpjekur të mbante qetësinë dhe autoritetin. Arbeni nuk foli menjëherë. Heshtja e tij mbushte pak hapësirën e zyrës, ndërsa sytë e tij vështronin dyshemenë.

- E… zotëri, - tha ajo më në fund. - Mirë, e kam… Apo jo?

- Arbeni nuk foli përsëri. Vetëm uli sytë, sikur çdo fjalë e tepërt mund të shpërbënte një rend të brishtë. Heshtja e tij nuk ishte bosh. Ajo fliste më shumë se çdo fjalë. Çdo frymëmarrje, çdo lëvizje e vogël e trupit tregonte dyshime, kujtime dhe një përgjegjësi të rëndë që mbante mbi supe.

Sekretarja e vështronte, duke u përpjekur të kuptonte mendimet e tij, por çdo gjest i Arbenit ishte një mur i vogël heshtjeje që nuk mund ta thyente lehtë. Nën këtë heshtje, çdo gjë dukej e rëndësishme: Koha ngadalësohej, zyrën e mbushte tensioni i padukshëm i pritjes dhe vendimit të ardhshëm. Ai mbajti sytë poshtë, duke i dhënë hapësirë mendimeve të tij që të fluturonin në të gjitha drejtimet, ndërsa përgjigja e heshtur që lëvizi mes tyre mbeti e nënkuptuar, e pashprehur, por më e rëndësishme se çdo fjalë. Ajo e vuri re se Arbeni po e shikonte drejt, gjatë, pa lëvizur fare dhe pa kthyer përgjigje. U habit. Nuk ishte shikim si ai i burrave të tjerë. Ishte një shikim i ftohtë, i gjatë, gati klinik… Sikur donte të depërtonte përtej lëkurës së saj e ta shihte si funksiononte.

- Një minutë, doktor, - tha sekretarja, - po futem te profesori.

Ajo u ngrit në këmbë, rregulloi komcat e trikos dhe poshtë

këmishës së bardhë, i drejtoi jakat me dorë, sikur të fshinte jo vetëm rrudhat e stofit, por edhe ato të kohës. Ajo fshiu fustanin me kujdes dhe mori drejtim drejt derës së drejtorit. Dhoma mbeti pa të. Ndenjëset prej druri pishe, të lakuara me mjeshtëri dhe të mbuluara me lëkurë dhe sfungjer, krijonin një barrierë të qetë mes saj dhe botës së jashtme. Përtej tyre, zhurma e qytetit mbetej jashtë. Edhe pse zyra është në katin e parë, tingujt e automjeteve dhe bisedat e kalimtarëve nuk mund të depërtonin brenda, duke lënë dhomën të mbushur vetëm me heshtjen e rëndë dhe pritjen që i ngarkonte ajrin me një tension të hollë.

- Mos u mërzit, pak, doktor, - tha sekretarja dhe i tregoi me gishtin e madh vetëm një minutë.

Ai nuk foli; vetëm tundte kokën dhe buzëqeshja e lehtë që mbante në fytyrë dukej sikur thoshte: Po, gjithçka është në rregull.

Ajo ia ktheu shpinën dhe u drejtua përsëri drejt derës që e ndante nga zyra e drejtorit.

Dhoma e sekretarisë ishte e vogël, tre me dy metra, e mbushur me regjistra, shkresa dhe pesë telefona fiks kinezë. Stili ishte i njëjtë në të gjithë hierarkinë e kryeqytetit të kuq. Pas fitores së partisë komuniste, ngjyra blu ishte zhdukur. Të kuqtë, të ardhur nga çetat partizane të Jugut, kishin pushtuar çdo qoshe të qytetit. Ata që mbetën, nuk ndihen më. “Qytet i poshtër,” mendoi ai. “Gjithë racat inferiore partizane e kanë mbajtur këtë vend kaq gjatë. Koha e tyre ka kaluar, por e keqja ka mbetur.”

Ai vazhdoi të mendojë dhe në vete formuloi tezën që: Ku ka komunizëm, varfëria mbetet si një hije që nuk largohet dhe pas rënies së tij, gjithçka që duket se është zhdukur, në të vërtetë vazhdon të jetojë në heshtje. Ai foli me zë të ulët, duke buzëqeshur pak, sikur të thoshte me vete: "Komunistët janë si gungaçët. Vetëm vdekja ua drejton gungën." Sa kishte qeshur dikur me këtë thënie, e cila tani tingëllonte si një parashikim i trishtë.

Ai bëri dy hapa pas dhe pa një karrige ku të ulej, ndërsa sekretarja po vononte pak. Dhe për një çast, gjithçka rreth tij – zërat, druri, sfungjeri – U duk si një metaforë për botën: E jashtme, e fortë dhe e zhurmshme. E brendshme e izoluar dhe e heshtur, ku çdo lëvizje ka rëndësi dhe çdo heshtje është filozofi. Sekretarja vonoi pak, ndërsa Arbeni u ul në një karrige të vjetër, por e bukur, megjithëse e vjetëruar. Ai mbajti pallton pak çaste në duar, duke e shtrënguar rreth qafës që të mos e zinte i ftohti. Ora në mur tregonte nëntë e gjysmë; akrepat e kuq lëviznin si rrotullimi i tokës rreth boshtit të vet, pa e ditur që po matnin kohën.

Koha për të ishte një nocion abstrakt; në realitet ekzistonin vetëm hapësira dhe materia me antimaterien. Ai kishte një mendje të veçantë, mbante mend gjithçka: Shifra, fakte. Lëndët e matematikës dhe fizikës që kishte mësuar në fakultet, nuk i harronte fare. Ishte i aftë të shumëzonte dhe të pjesëtonte pa makinë llogaritëse dhe pa shkrim, vetëm me mend. Ai e kuptonte se marrëzia dhe çmenduria kishin lidhje me perceptimin e kohës dhe realitetin e saj. Jeta e

tij ishte kaluar në varfëri dhe i ftohti nuk e shqetësonte. Jashtë ishte janar dhe dhoma nuk kishte kondicioner, vetëm një furrnelë poshtë tavolinës së sekretares që nxinte pak sipërfaqen e dhomës. Ai mbështolli përsëri pallton rreth qafës dhe e ngushtoi pak, duke ruajtur ngrohtësinë, ndërsa humbi në mendime. Dera e drejtorit u hap dhe hyri sekretarja e bukur, që rrezatonte bukuri dhe shkëlqim. "Siç duket drejtori e priti mirë," tha më vete ai.

- Doktor, - tha ajo, - drejtori po ju pret.

- Po, - iu përgjigj ai. - Në rregull.

Ai u ngrit dhe hyri në zyrë. Arbeni e pa pak me habi profesorin. E kishte njohur nga librat dhe shkrimet në gazeta. Ishte pak më i vjetër se në fotot e botuara, por i dukej i ngrohtë dhe i mençur.

- Kam emocion, doktor, kur të shikoj, - tha Arbeni. - Je shumë i njohur dhe nuk di ç'të të them. Jam i lumtur që u takova me ty. Dhe që ti më prite.

Doktor Mentori nënqeshi pak, lëvizi kokën pak anash, sikur shikonte nga dritarja dhe pasi rregulloi jakën e këmishës së bardhë rreth qafës, tha: Faleminderit për fjalët e bukura, por koha jonë po mbaron. Ne shkruajtëm dhe bëmë shkencë në kohën tonë, kaq arritëm. Tani është radha juaj, brezit të ri, të ecni përpara. Në këtë spital nuk kemi trashëguar asgjë. Ka aparatura të vjetra, të shfrytëzuara në qindra operacione. Nuk kemi salla moderne operacioni, shtretër apo laboratorë studimi. Gjithçka është e viteve shtatëdhjetë, Ruso-Kineze. Të bësh operacion sot është sfidë e madhe. - shtoi ai përsëri.

Arbeni nuk foli, vetëm dëgjonte. Shikoi drejt profesor Mentorit….Lajmi është se ty, dr. Arbeni….. Praaaa. Shkurt fjala.

- Ne të kemi zgjedhur ty kryekirurg ose kirurg i parë, - tha Mentori dhe papritur u ngrit dhe e përqafoi.

Pastai shtoi:Ta gëzosh detyrën dhe shkosh sa më lart në profesionin tënd të bukur. Misioni ynë është të shpëtojmë jetë njerëzish. Jeta për ne është mbi të tëra gjërat që ekzistojnë në planet.

- Faleminderit i nderuar! - foli Arbeni me zërin që i dridhej. - Unë jam jetim, jam rritur në kushte që nuk mund t'ju tregoj. E di që varfëria është sëmundje shoqërore që ka shoqëruar njeriun që nga fillimi i jetës dhe lufta për ekzistencë ka qenë që në fillim. Më i forti fiton dhe në këtë jetë nuk ka vend për të dobët. Të dobët bien pre e vrasjeve, përdhunimeve dhe bëhen ushqim për të fortit. Kështu është edhe me kafshët: Fiton më i forti, tjetri bëhet pjesë e zinxhirit ushqimor. Prandaj nuk do lëshoj rrugë askujt që së bën detyrën. Rrini i qetë drejtor.

E di që do të sulmojnë dhe do të detyrojnë të reagosh keq.

- Jo, jo, - tha doktor Arbeni. - Do rri i qetë. Do zbatoj urdhërat tuaja dhe drejtësi. Do ma vështirësojnë jetën këtu. E di, por jam mësuar. Kudo ka tipa keqbërës dhe pa moral.

- Ashtu është, - tha doktor Mentori. - Jeta është e vështirë kudo. Por këtu kemi hequr shumë keq nën atë regjimin mesjetar. Të gjitha ishin gënjeshtra. Asgjë e vërtetë. Dhe, falë Zotit, kemi shpëtuar nga ai njeri i keq dhe pa asnjë

masë njerëzore, siç ishte njeriu socialist.
- Por është vështirë, - tha Mentori. - Komunizmi nuk ikën lehtë.
- Duket se jo,- iu përgjigj Arbeni, ndërsa u ul përsëri në karrige përballë profesor Mentorit.
- Atëherë, nesër do vij të prezantoj para ekipit të vjetër të kirurgjisë. Do të jetë pak e vështirë për ta të pranojnë që ti të jesh shefi i repartit në këtë moshë kaq të re, por do mësohen kur të shohin aftësitë e tua në operacion.
- Faleminderit, doktor! - tha Arbeni dhe uli kokën nga turpi i fjalëve të bukura të Mentorit.
- Kështu që unë të uroj suksese, doktor Arbeni. Për mua jeni rast i veçantë dhe krenari që një shqiptar, një student shqiptar, është bërë kaq i zoti dhe i përmendur edhe në revistat ndërkombëtare. Ne duhet të ndërtojmë këtë spital së bashku, ta pajisim me aparatura të fundit, të bëjmë rikonstruksion të repartit të kirurgjisë dhe të tjerëve që janë në gjendje të mjeruar.
- Po, doktor, - tha Arbeni. - Unë do zbatoj të gjitha detyrat dhe objektivat që keni për të ngritur spitalin në nivel me spitalet evropiane.
- Shumë mirë, - foli Mentori. - Shpresoj që këto ditë të na vinë edhe kompjuterat e porositur, Në mënyrë që dixhitalizimi të futet kudo, jo vetëm në repartin tënd. Jam shumë i kënaqur që po sillni modernizimin këtu.
- Ah, se harrova. Të porosis një kafe apo çaj? – kujtoi Mentori.

- Jo, jo, asgjë, - iu përgjigj Arbeni, duke lëvizur pak nga karrigia sepse deri tani kishte dëgjuar pa lëvizur, i shtangur nga biseda me Doktor Mentorin. Aq shumë rëndësi i kishte kushtuar fjalimit të tij prezantues.
- Epo, mirë, - ktheu fjalën Doktor Mentori dhe preku kokën, duke i dhënë një shenjë miratimi.
- Nesër do mbledh repartin tënd dhe do prezantohesh me ekipin e ri. Mbase aty do kesh edhe ata që të kanë dhënë mësim. Kjo është krenari për ty dhe vlerësim nga shoqëria. Prandaj puno mirë dhe ngrije repartin në nivel ndërkombëtar.
- Po, po, - e ndërpreu Arbeni.
- Do fus të gjitha metodat e reja, sidomos për operacionet. Do bëj të pamundurën që të zëvendësohen të gjitha mjetet e operacionit Dhe të bëhet rikonstruksioni i plotë i repartit të kirurgjisë. Këtë do ta bëjmë bashkë.- tha doktor Mentori.
- Shyqyr që erdhi kjo ditë, - shtoi ai e nuk foli më, u zhyt në detin e kujtimeve.
Ora kalonte. Një orë nga takimi dhe biseda mes tyre nuk mbaronte.
- Mirë, pra, po e mbyllim takimin për sot, - tha doktor Mentori. - Unë të uroj suksese dhe mbarësi.
Të dy u ngritën në këmbë për një nderim të shkurtër, shtrënguan duart dhe u përqafuan lehtë, duke takuar kokat me njëri-tjetrin. Në dhomë dëgjohej vetëm tik-taku i orës së kuqe në mur, që rrotullohej në heshtje, duke shënuar çdo çast për doktor Arbenin.

- Atëherë, mirupafshim nesër në orën tetë tek gjashtëkatëshja! - tha dr. Mentori dhe i dha dorën përsëri.

Arbeni hapi derën dhe shpejtoi pak hapin, duke u larguar me qetësi.

Pasi doli në paradhomë pa më ëmbëlsi sekretaren.

Sekretarja u ngrit në këmbë, mori një qëndrim korrekt dhe i tha: Ju uroj, doktor Arben, suksese! - ndërsa sytë i rrëshqitën pak në tokë, sepse Arbeni dukej shumë i bukur dhe sillte energji që hapte ndjeshmëri te të tjerët.

Ai hapi derën e drejtorisë dhe hyri në korridor, duke lënë pas takimin që i kishte dhënë një ndjesi të veçantë fillimi dhe besimi. Prezantimi para ekipit të kirurgjisë do të ishte hapi tjetër që ai vetë do të kryente.

Të nesërmen, në orën tetë fiks, ndërtesa gjashtëkatëshe e spitalit universitar ishte ende e zhytur në një heshtje që thyhej vetëm nga zhurma e aparateve të monitorimit dhe trokitja e shpejtë e hapave të infermiereve të turnit të natës. Mbi fasadën gri të godinës kishte rënë një mjegull e dendur, e cila dukej sikur ishte shtrirë aty që natën e kaluar për të mos u larguar lehtë.

Në sallën e madhe të mbledhjeve, poshtë pavijonit të kirurgjisë, ishin mbledhur të gjithë mjekët. Karriget metalike lëshonin një rrotullim të lehtë, ndërsa secili zinte vendin e vet, disi i përgjumur, disi i mpakur nga lodhja e turneve të natës.

Në fund të sallës, pranë dritares së madhe që shihte nga oborri, ishte ulur doktor Arbeni. Ai nuk po fliste me askënd. Thjesht rrinte i heshtur, i mbyllur në botën e vet,

sikur gjithë ky tubim, gjithë këta njerëz, gjithë ky spital, të mos kishin fare lidhje me të.
Ai shikonte jashtë dritares. Nga aty dukej një pemë e vetmuar, që nën mjegull dukej sikur ishte gdhendur prej guri. Dhe krejt papritur, Arbeni e gjeti veten të humbur në një varg mendimesh që vinin si dallgë të papritura.
Heshtja brenda kaosit.
- Çfarë është realiteti? - mendoi ai. - A është kjo që shohim çdo ditë? A janë këto duar që presin, që ngjisin, që shpëtojnë jetë, apo që ndonjëherë mbyllin sytë e një njeriu për herë të fundit? A është kjo dhimbja që shohim, apo lumturia e shkurtër e një pacienti kur i themi 'operacioni doli me sukses'? Apo realiteti është diçka që fshihet pas nesh, mbrapa kësaj perdeje materieje që e quajmë 'trup'?
Mjekët flisnin për raste, raporte, statistika. Ai s'i dëgjonte.
Në kokën e tij, fjalët fluturonin:
- Asgjë nuk i përket askujt. As jeta, as pasuria, as lavdia, as titujt. Gjithçka është e përkohshme. Vetëm fati, fati i verbër, mund të na ngrejë lart… Ose të na fundosë pa mëshirë.
Aty, në atë sallë të madhe, Arbeni e ndjeu veten si një pikë e vogël në një det të pamatë. E ndjeu se sa i brishtë ishte njeriu. Sa i pakuptimtë ishte çdokush para madhështisë së jetës.
Dhe sa e çuditshme ishte që ai – Një njeri që shpëtonte jetë – E kuptonte çdo ditë se njeriu është vetëm një shkëndijë e vogël që fiket shpejt. Salla u mbush plot. Kishte kirurgë me përvojë 30-vjeçare, Kishte të rinj të sapodalë nga specializimi, kishte infermiere që vinin thjesht për të

dëgjuar. Kishte anestezistë që fërkonin sytë akoma të lodhur nga operacionet e natës.

Doktoresha Mira hyri e para, me një dokument të trashë në dorë, që u përngjasua me një dosje çështjesh gjyqësore. Mjekët u kthyen nga ajo me respekt. Disa me drojë. Ajo dukej gjithmonë sikur di më shumë se çfarë thoshin gojët. "Prandaj i trembën…. ëë," - mendoi ky.

Pas saj, hyri drejtori i pavionit, Doktor Iliri, me ecje të shkurtër, por plot autoritet. Ai gjithmonë hynte i pari dhe dilte i fundit nga çdo mbledhje. Por sot kishte qenë ndryshe — Derisa dhe ai po vinte me pesë minuta vonesë në spital. Edhe kjo ishte shenjë tensioni. Ndërkohë dy kirurgë të rinj po diskutonin me zë të ulët: Sot do të flitet për rastin e vështirë që patëm dje. Po thonë që do të marrin vendim për ekipin e ri.

"Dhe Arbeni…"

"Po, Arbeni është në atë listë."

Fjalët përplaseshin në ajër, por Arbeni nuk i dëgjonte. Ai ishte i mbyllur në një hapësirë që askush në atë sallë nuk mund ta hynte. Mendimet e tij thellohen – Çfarë është njeriu?

Ai mbështeti bërrylat mbi tavolinë, vështroi duart e veta dhe mendoi: "Këto duar, një ditë, do jenë pluhur. Edhe pse sot presin, qepin, shpëtojnë… Nesër s'do të jenë asgjë. A ka kuptim gjithë ky mundim? Apo gjithçka është një lojë e madhe, e padukshme. Ku ne jemi vetëm figurina të lëvizura nga një fuqi që nuk mund ta shohim?"

Zihemi për një post. Absurde fare, por…..
Asnjë filozof nuk do t'i përgjigjej.
Asnjë shkrimtar nuk do t'i shpjegonte.
Asnjë profesor nuk do t'i jepte një formulë.
Sepse askush nuk e di.
Dhe pikërisht kjo e bën jetën kaq misterioze, kaq të rëndë, kaq të bukur. Lufta brenda llojit, më e keqja, qeshi ai.
Mbledhja nisi, ndërsa ai mbetet jashtë kohe.

Drejtori filloi të fliste, duke hapur zyrtarisht seancën: "Të nderuar kolegë! Sot do të diskutojmë mbi tri raste të vështira. Së pari ndryshimet në protokollet operative dhe… ekipin e ri të kirurgjisë së avancuar."…..u dëgjua si në humbëtirë….
Zëri i tij kumbonte në sallë. Për të tjerët, ai ishte real.
Për Arbenin, ishte si një jehonë e largët nga një botë tjetër.
Ai shikonte fytyrat: disa të qeta, disa të trembura, disa të lodhura. Dhe mendoi:
"Të gjithë këta njerëz mendojnë se e kanë fatin nën kontroll. Por nuk e kanë. Askush nuk e ka. Këtu jemi të gjithë vetëm udhëtarë të përkohshëm."
Ai mori frymë thellë. Ndjeu një qetësi të çuditshme.
Një qetësi që vetëm njerëzit e lodhur nga jeta, por të fortë në shpirt, mund ta kenë. Një moment, gjithë salla u kthye nga ai.
Drejtori pyeti: Doktor Arben, ju keni raportin e rastit të djeshëm. Mund të na e prezantoni?
Ai ngriti kokën ngadalë. Sikur u kthye nga një botë tjetër në

këtë botën tonë të përditshme. Iu deshën disa sekonda të rivendoste veten në realitet. Por para se të fliste, ai mendoi edhe një herë: "Ndoshta kjo është arsyeja pse jam këtu. Për të bërë diçka që ka kuptim vetëm për një çast, por që mund t'i ndryshojë jetën dikujt përgjithmonë."
Dhe pastaj u ngrit në këmbë me qetësinë e tij të zakonshme, gati të fliste.
Rasti i djeshëm ishte rast flagrant i mungesës së mjeteve dhe sallave te rregullta për operacione. Në disa vende ato edhe pikojnë shi. Ka raste që na ndërpritet edhe korenti i nderuar drejtor…. Ngriti kokën Arbeni dhe e shikoi atë në sy, prandaj duhen reforma të thella të modelit evropian. Dhe njëkohësisht aparatura të reja në gjithë sektorët e këtij spitali.
- Dakord, - e ndërpeu doktor Mentori. - Prandaj ju kam mbledhur sot për të sjell gjak të ri dhe mënyrë të re drejtimi.
Dr. Mentori u ngrit, rregulloi përparësen e bardhë dhe tha me zë të qetë, të prerë:
- Të nderuar kolegë! Sot jemi mbledhur të gjithë bashkë për një njoftim të rëndësishëm. Kam vendosur të liroj nga detyra shefin e kirurgjisë së mëparshme. Jo për arsye politike, por sepse spitali ynë ka nevojë për njerëz që mbartin ide të reja, që zotërojnë teknologjitë moderne: kompjuterin, robotikën dhe teknikat bashkëkohore kirurgjikale. Duhet njerëz që kanë sjellë rezultate të jashtëzakonshme. Pacientë që dikur vdisnin, sot jetojnë.
Dhe kjo falë një mjeku të ri… Një njeriu që mund ta quajmë

edhe "ufo", në kuptimin më të mirë të fjalës: dr. Arben Kodra.
- Ju lutem, një duartrokitje për të.
Gjysma e sallës u ngrit në këmbë. Brezi i ri duartrokiste fort, ndërsa mjekët e vjetër rrinin të ngrirë, duke parë njëri-tjetrin me buzë të shtrënguara.
Profesor Petriti, i ulur në mes, pëshpëriti me përçmim:
- Ky është një i çmendur…
E kam pasur student. Dhjetë ka marrë, nuk e diskutoj, por ky s'është normal. Flet me vete shpesh.
Një tjetër mjek i vjetër tundte kokën me ironi
- Epo…, kemi parë shumë "gjeni" të tillë…
Në atë moment, dr. Mentori ngriti dorën dhe tha:
- Dr. Arben, të lutem, afrohu!
Arbeni u ngrit ngadalë, me hap të sigurt. Salla u qetësua. Ai u përqafua me dr. Mentorin para se të merrte fjalën. U kthye nga salla, trokiti dy herë mbi tavolinë dhe tha:
- Të nderuar kolegë, ju lutem qetësi… Tani le të kalojmë te arsyeja pse jemi mbledhur. Zoti gjithmonë është i drejtë. Ai ndihmon të varfërit, por edhe mëkatarët. Ndërgjegja nuk ka peshë para mësimeve të Tij. Jeta, nga qeliza e parë e deri në formën që kemi sot, është formulë e krijuar dhe e lënë në dorën tonë nga Zoti. Ne jemi vdekatarë…Por jemi edhe bashkëpunëtorët e tij në shpëtimin e jetëve njerëzore.
Në sallë ra heshtje. Mjekët, të rinj e të vjetër, e dëgjonin me vëmendje.
- Prandaj më dëgjoni më vëmendje …Por dua të falënderoj për detyrën që më caktuat. Është nder të punoj me ju dhe me

drejtorin tonë profesor Mentorin. Salla se mori seriozisht dhe kishte akoma zhurmë.

Në tribunë ngrihet DR. MENTORI, drejtori i spitalit, i qetë, elegant, por me autoritet. Mikrofonin e tërheq pak drejt vetes. Zhurma bie ngadalë. Ai e ndërpreu doktor Arbenin. Për të vënë qetësi në sallë dhe për të treguar mbështetjen e tij për të.

DR. MENTORI

(ton i prerë, i qartë)

- Të nderuar kolegë... Kjo është arsye që… - e përsëriti prapë.

- Kam vendosur të liroj nga detyra shefin e kirurgjisë së mëparshme. Jo për arsye politike… Por sepse koha kërkon ide të reja, teknikë të re. Robotikë. Teknologji. Guxim. Praaa. Njerëz të rinj që njohin kompjuterin, dixhitalizimin dhe robotikën. Ju dhe tani s'e merrni seriozisht punën.

Në sallë, të rinjtë ngrenë vetullat me kureshtje. Të vjetrit tundin kokën me përbuzje.

DR. MENTORI vazhdoi me fjalimin:

- Dhe këto rezultate…Do i kemi falë një mjeku të ri. Një njeriu që, po, mund ta quajmë edhe një përsëri UFO, në kuptimin më të mirë të fjalës. Dr. Arben Kodra. Dua përsëri një duartrokitje për të.

Gjysma e sallës shpërthen në duartrokitje. Të rinjtë buzëqeshin krenarë. Të vjetrit qëndrojnë të ngrirë. Profesori Petriti shtyn syzet në hundë me nervozizëm.

PROF. PETRITI

(me zë të ulët, me kolegun)

- Ky është i çmendur. I kam dhënë dhjeta si student… Por njeri normal nuk është.
Flet me vete natën, në korridor, në banjo, rrugë e kudo.
MJEKU TJETËR
- Mirë, mirë… çmenduria paska filluar të bëhet kusht për poste, - dhe filloi të qeshte me ironi.
DR. MENTORI bën shenjë. ARBENI ngrihet përsëri për të folur. Hapi i tij i qetë, i sigurt. Manteli i bardhë pasqyron dritën. Sytë e tij, të thellë, të lodhur, dhe filozofikë. Ecën drejt tribunës. Çdo hap dëgjohet.
"TAK-TAK-TAK."
Ai ngjitet në podium. Përqafohet me Dr. Mentorin. Sallës i bie qetësia.
Arbeni afrohet te mikrofoni.
- Jam ARBEN KODRA, - foli ai (ngadalë, me zë të ulët)
- Të nderuar kolegë, … dëgjoni pak.
Ai ngriti kokën lart dhe duart i vëndosi mbi tavolinë.
"TAK. TAK." Heshtje absolute.
- Shikoni zotërinj profesorë dhe kolegë, - tha ARBENI. - Ju erdhi habi. E pashë, por përzgjedhja e drejtorit përgjithshëm nuk varet nga ju. Dhe jeni të detyruar ta aprovoni. Mos bëni zhurmë kot.
Tani… le të shkojmë te arsyeja pse jemi këtu. Po e përsëris. Mbajeni mend që Zoti është gjithmonë i drejtë. Ai ndihmon të varfrit…, por edhe mëkatarët. Ndergjegja? S'është asgjë para ligjeve të tij. Nga qeliza e parë… deri te trupi i njeriut që shpëtojmë në sallën e operacionit… Gjithçka është formulë

shkencore e vendosur nga ai. Pranojeni që gjithçka është kalimtare, siç jeni ju dhe unë më vonë. Brezat ndërrohen dhe vijnë breza të rinj. Prandaj Zoti e ka bërë ndryshimin dhe kohën e caktuar të jetës për secilin. Gjithçka në këtë jetë ka një fund. Unë s'po ju them që keni punar keq, ose mirë. Po ju them pranojeni të renë…….

Salla e dëgjon e stepur. Të rinjtë marrin frymë ngadalë. Të vjetrit mbajnë shënime me nervozizëm. Prandaj, po e përsëris meqë doni. S'e kisha në mendje t'ua thosha, por pranoni që s'keni bër detyrën mirë…

ARBENI: - Ne… jemi fajtorë për shumë vdekje, sepse s'kemi aparatura dhe staf të përgatitur mjekësor. Por kemi harruar edhe Zotin që ju vret. Ju s'jeni përgatitur më. Nuk lexoni më, nuk jeni abonuar me të rejat e fundit shkencore. Keni kapur këto poste dhe keni rënë rehat.

Uli pak kokën, pastaj e drejtoi, dhe tha:

- Të gjithë jemi fajtorë dhe po e fus edhe veten këtu. Që ju të ndjeheni mirë, por kam shumë kritika. Shumë paaftësi tuajat. Kanë sjellë humbje jete. Që ju nuk jeni mirë. E di kushdo këtu. Që ju njëkohësisht…Keni harrruar që jeni edhe ndihmësit e Zotit në shpëtimin e jetëve. E keni harruar edhe këtë. Praaa, me një fjalë, ose përmbledhje jemi shumë pas të tjerëve.. Në këtë shkencë në këtë spital, duhen reforma dhe bashkëpunim….

Ai po fliste me gjallëri dhe cinizëm së bashku. Sytë e tij reflektojnë një lodhje të thellë ekzistenciale. Dhe për këtë… nuk duhet thjeshtë shkencë. Duhet shpirt. Duhet frikë.

Duhet përgjegjësi hyjnore.
Në sallë… askush nuk lëvizi.
Edhe profesor Petriti ndalet, harron të shënojë diçka.
Po të shikoje fytyrat e mjekëve të rinj – Kishte sy që shkëlqejnë. Ndërsa po t'i shikosh fytyrat e mjekëve të vjetër. Kishte sy që errësohen nga inati dhe fyerja që iu bë.
ARBENI (ngre kokën): Dhe tani... të vazhdojmë diskutimin.
ARBENI (ton i drejtë, pa frikë): Të nderuar doktorë… profesorë…Sot para jush nuk jam thjesht shefi i ri i kirurgjisë. Sot jam ish-studenti juaj.
Ai buzëqesh me ironi të lehtë e thotë: Studenti që shpesh e keni tallur… E keni nënvlerësuar… Madje keni ironizuar edhe kur nuk isha në leksion. Ju kujtohet, apo jo? Më more shokë, zotërinj, që deri dje, madje dhe sot mund të flisni pas krahëve për mua, sepse në fund të fundit. Jeni dhe profesorë të pabesisë dhe mjeshtër të paskrahëve.
Fytyrat e profesorëve u nxinë, disa u skuqen, disa ulën shikimin.
Dr ARBENI: Ju thoshit dhe jam i sigurtë që e keni harruar ironinë me mua pas shpine, kur thoshit duke qeshur me sarkazëm. "Si qenka mjek ky njeri dhe gazetar. Ai më mirë të shkruajë poezi, reportazhe… Çfarë mjeku është ky? S'ka lidhje me mjekësinë dhe shkencën ekzakte. Të zgjedh njërin zanat, ose tjetrin,"
E kam dëgjuar nga shumë shokë të mite, por dhe vetë kam qëndruar pas dere për t'ju dëgjuar se sa bukur me shanit dhe më urrenit, sepse isha shumë ma i mirë se ju. Dhe më

kishit zili. Edhe s'më vinit dot nënta, sepse dija të gjitha tezat, si më shkrim, edhe me gojë. Madje disa prej jush ma keni thënë edhe pas shpine… Se qenkam i çmendur.
Nëpër sallë, disa mjekë të rinj buzëqeshin duke pritur shpërthimin.
(Dr ARBENI merr frymë thellë)
- Ju falënderoj! Po, ju falënderoj sinqerisht!
Ai ngrIti pak dorën, duke kërkuar vëmendje dhe jo zhurmë. Pastaj vazhdoi…..me të njëjtin ton dhe ironi: - Pra sulmet tuaja… Talljet tuaja… Më bënë pikërisht këtë që jam sot. Studimet e mia shkencore janë më të mirat. Të botuara në revista shkencore botërore. Më bëtë të dal në kopertina ndërkombëtare, si mjeku i ri më i mirë. Ju falënderoj që më quajtët i çmendur…Por të çmendurit nuk janë ata që e shtyjnë shkencën përpara, por ata që flenë mbi leksionet e vitit 1970.
Salla mban frymën. Disa profesorë shtrëngojnë nofullat.
- Shumë prej jush… profesorë të "nderuar"… jeni aty ku ishit që nga vitet e diktaturës. Me të njëjtat leksione, me të njëjtat fjalë, me të njëjtat skica të vjetra. Jeni vlerësuar si studentë dikur jo për dije,… por për biografi të mirë. Për këtë jam i sigurtë sepse leksionet tuaja nuk afrojnë asgjë shkencore dhe bashkohore. Ju u bëtë profesorë, sepse ishit me prindër në komitet, në byronë politike… Edhe notat i keni pasur gati në xhep. Po ashtu si profesorë e morët titullin nga biografia dhe jo nga shkenca juaj. Si pedagogë keni nxjerrë mjekë që nuk dinë të bëjnë diferencën mes

diagnozës dhe recetës. Dhe sot… i helmoni pacientët me paaftësinë tuaj.
Salla gjëmon nga pëshpëritjet.
Të rinjtë e mjekësisë fillojnë të duartrokasin, të vjetrit nervozohen.
Disa profesorë ngrihen nga karriget.
PROF. ASTRITI (i indinjuar): Këto janë fyerje! Nuk lejohet t'i thuash një salle me profesorë gjëra të tilla! Kush jeni ju? Askush nuk jeni. Një i përkëdhelur i dok. Mentorit.
DR. MENTORI (me ton të hekurt, pa ngritur zërin): Ulu, professor, ose dil jashtë.
Fjalët ranë njëra pas tjetrës, të ftohta, të pamëshirshme, si një vendim i marrë prej kohësh. Askush nuk guxoi të lëvizte. Frymëmarrjet u ndalën, shikimet u ulën, karriget mbetën të ngrira në vend. Një heshtje absolute pushtoi sallën. Jo ajo heshtje e zakonshme e respektit, por një qetësi e rëndë, kërcënuese, që shtypte çdo mendim dhe çdo kundërshtim. Në atë çast, u kuptua qartë se fjala e fundit ishte thënë dhe se çdo zë tjetër do të ishte thjesht një akt rebelimi pa shpresë.
Koha e komisarëve politikë ka mbaruar. Sot është koha e shkencëtarëve. Salla shpërthen në duartrokitje të forta. Vetëm brezi i ri duartrokiti. Të vjetrit ulin sytë, disa profesorë dolën nga salla të turpëruar dhe ikën në rrugë për t'u mbledhur më vonë dhe për të kundërshtuar reformën e re …. Situata u bë alarmante.
Dritat fillojnë të ndizen e fiken, sikur spitali vetë po e mban

mend këtë moment historik.
Arbeni qëndron në podium, i fortë, i qetë, si një njeri që sapo ka thënë të gjithë të vërtetën. Duartrokitjet vazhdojnë. Arbeni largohet ngadalë nga podiumi, me hap të sigurt, me fytyrë të qetë, por zemër që i rreh si daulle.
Prof. Petriti ka mbetur i ngrirë në vend, si një statujë e vjetër e harruar në një kënd të sallës. Fytyra i është mpirë, por sytë i shndrisin fort nga inati i përmbajtur, një zjarr i ftohtë që s'guxon ende të shpërthejë. Ai nuk flet. Heshtja e tij është kërcënim. Prof. Agroni tund lehtë kokën, ngadalë, sikur po përtyp çdo fjalë të Arbenit, jo për ta kuptuar, por për ta peshuar si rrezik. Në sytë e tij lexohet dilema: Frika për të humbur pushtetin dhe lodhja e një kohe që po perëndon.
Prof. Alma, e vetmja që nuk e urren Arbenin, rri e menduar. Duart i ka të kryqëzuara, shikimin e mban diku mes tavolinës dhe dritares. Ajo e ndjen se diçka ka ndryshuar përfundimisht. Nuk është thjesht një mbledhje — Është një çarje në murin e vjetër.
Në fund të sallës, dr. Mentori e preti Arbenin me një buzëqeshje të lehtë, thuajse të padukshme, por plot kuptim. Një buzëqeshje që nuk është triumf, por miratim.
ARBENI (me zë të prerë): - Nuk jam këtu vetëm për t'u folur. Jam për të thënë të vërtetën. Jam këtu për ta ndryshuar këtë spital.
Dr. Mentori i afrohet ngadalë Arbenit. Nuk flet menjëherë. E vështron drejt e në sy, sikur po mat peshën e çastit. Pastaj e prek lehtë në shpatull — Një gjest i thjeshtë, njerëzor, por

i mbushur me besim dhe përkrahje, si një stafetë e heshtur që kalon nga një brez te tjetri.

DR. MENTORI (qetë, me zë të ulët, por të palëkundur): Kështu të dua. Të drejtë. Të patrembur. Të pathyeshëm. Luftëtar, nëse duhet.

Dera e sallës hapet me zhurmë të thatë. Pas mbledhjes, profesorët e vjetër dalin në korridor si një tufë e shpërndarë, pa bosht, pa udhërrëfyes. Kostumet e tyre të errëta humbasin mes mureve të bardha të spitalit. Zërat e tensionuar përplasen në korridor, copë-copë, kthehen në jehona nervoze, plot ankth, mllef dhe mospranim të realitetit të ri.

PROF. PETRITI (duke ngritur zërin, me inat të hapur): Kjo nuk mbaron këtu! Këtë do ta paguani!

Heshtje. Hapat e tyre largohen, por hija e tyre mbetet pezull në ajër. Dr. Mentori ndalet pranë Arbenit. Nuk e ndjek turmën me sy, përkundrazi, shikon pas vetëm për një çast, drejt korridorit të mbushur me hijet e së shkuarës: Fytyra të vjetra, frikë të vjetra, pushtete që po shemben ngadalë. Pastaj kthen sytë nga Arbeni.

DR. MENTORI: Tani fillon lufta, Arben.

(Një pauzë e rëndë) - Jo ajo me armë. Ajo do të ishte më e lehtë. Fillon lufta më e egër. Lufta e fjalës, e kujtesës, e frikës.

Sot, pa e kuptuar plotësisht, Arbeni i kishte dhënë zë brezit të ri. Jo një zë të lartë e të zhurmshëm, por një zë që lind nga nevoja për të mos gënjyer më veten. Një zë që nuk

kërkon leje për të ekzistuar, sepse e di se leja është forma më e sofistikuar e nënshtrimit. Një zë që nuk përkulet para titujve, para diplomave të varura në mure, para autoritetit që ushqehet me frikë dhe heshtje.

Ishte një zë që nuk fshihej më pas qetësisë së rreme, pas kompromisit të vogël të përditshëm, pas frazës së njohur "nuk është koha e duhur". Një zë që mbante mbi vete kujtesën e dhimbjes, por edhe peshën e përgjegjësisë — Sepse të flasësh nuk është vetëm guxim, është edhe barrë.

Ai zë nuk do të pranohej. Do të përpiqeshin ta thyenin me ironi, me procedura, me fjalë të buta që fshihnin kërcënime. Do të përpiqeshin ta njollosnin, ta paraqisnin si ambicie personale, si rebelim të papjekur, si gabim profesional. Dhe kur kjo të mos mjaftonte, do të përpiqeshin ta heshtnin, ngadalë, pa zhurmë, ashtu siç heshten gjërat më të rrezikshme.

Dr. Mentori e dinte këtë. Në fytyrën e tij u shfaq një buzëqeshje e lehtë, pa asnjë grimë gëzimi, por me atë vendosmëri të qetë që lind vetëm tek ata që kanë parë shumë humbje dhe nuk besojnë më në mrekulli. Ai e kuptonte se ajo që kishte nisur. Nuk ishte një fitore, por një rrugë pa kthim. "Por tani," mendoi, duke e parë Arbenin drejt e në sy, "tani nuk je më vetëm." Dhe kjo, në fund të fundit, ishte e vetmja mbrojtje që mund t'i ofrohej. Por të vjetrit, ata që jetojnë nga heshtja dhe mbijetojnë nga harresa, nuk e falin kurrë të vërtetën. Ata e presin, e shtrembërojnë, e quajnë rrezik, sepse u rrënon themelet.

Arbeni e dëgjoi pa e ndërprerë. Ai tund kokën lehtë, jo si shenjë dorëzimi, por si pranim i peshës së asaj që e priste. Fytyra i mbeti e qetë, sytë të kthjellët, sikur prej kohësh ta kishte bërë paqe me pasojat.

Në atë qetësi nuk kishte naivitet, por vendosmëri. Ai e dinte se fjala e thënë nuk tërhiqet më, dhe se rruga që kishte zgjedhur nuk kishte kthim prapa. Heshtja e tij ishte përgjigjja më e fortë.

- Ky djalë është rrezik.

Fjala ra rëndë në ajër, si një diagnozë e pashënuar në kartelë. Prof. Petriti nuk bërtiti. Nuk kishte nevojë. Zemërimi i tij ishte i ftohtë, i përpunuar prej vitesh pushteti.

- Na poshtëroi para të gjithëve, - vazhdoi ai. - Jo me zë, por me guxim. Dhe kjo është më e keqja. Duhet ta ulim menjëherë. Duhet ta ndalim… Para se të marrë hov.

Prof. Agroni shtrëngoi buzët. E dinte se ku po shkonte kjo bisedë. I rregulloi syzet me një lëvizje nervoze.

- S'e heq dot Mentori, - tha më në fund. - Ai e ka futur me firmën e tij. Me përgjegjësi personale.

Një hije e hollë kaloi në fytyrën e Prof. Petritit. Ai u kthye ngadalë, me atë qetësinë që paralajmëronte gjithmonë diçka më të keqe se shpërthimi.

- Atëherë do t'i gjejmë një rrugë tjetër, - tha. - Sistemi ka më shumë se një derë daljeje.

Ai ndaloi për një çast, pastaj shtoi me një zë të ulët, thuajse për vete: Një njeri që flet kështu,… nuk i mban dot gjatë këto poste. Jo këtu. Jo mes nesh.

Sytë i ngushtoi dhe hodhi vështrimin rreth e rrotull, instinktivisht, si një gjarpër që kontrollon territorin përpara se të godasë. Ai kërkonte aleatë, heshtje, frikë. Dhe i gjeti. Në krah të tij, Prof. Alma u afrua. Zëri i saj ishte i ulët, por i dridhur nga shqetësimi.

- Petrit… Mos bëj marrëzira, - i tha. - Djali është i aftë, i ndershëm. Spitali ka nevojë për njerëz si ai.

Për një moment të shkurtër, Prof. Petriti u ndal. Pastaj buzëqeshi lehtë, një buzëqeshje që nuk arrinte në sy. U afrua edhe ai, duke ulur zërin, sikur po ndante një sekret, pikërisht sepse është i aftë,… është rrezik.

Fjalët i dolën të ftohta, pa asnjë ngarkesë emocionale. Ishin përfundim.

Ata u kthyen dhe u larguan në drejtim të korridorit të errët. Dritat fluoreshente ndizeshin e shuheshin mbi kokat e tyre. Hapat kumbuan gjatë, të matur, si një marrëveshje e pashkruar. Jo thirrje. Jo urdhra. Vetëm heshtje që fillonte të organizohej. Një komplot nuk lind kurrë me zhurmë. Ai ecën. Dhe pret ditën kur do të godasë.

OBORRI I SPITALIT – PAK MINUTA MË VONË

Sirenat e një ambulance çajnë ajrin, duke thyer qetësinë e rrugës si thikë të nxehtë mbi akull. Drita e kuqe pulson mbi fasadat e ndërtesave, reflekton mbi xhamat e trotuarit dhe krijon hijet e zbehta të kalimtarëve që ndalen të shikojnë, të alarmuar. Infermierët zbresin me ngut nga automjeti

i urgjencës. Dyert përplasen pas tyre dhe sirena shuhet papritur, si të ishte prerë me thikë. Ata bartin me shpejtësi një barelë, rrotat e saj kërcasin mbi asfaltin e lagur. Mbi të shtrihet një pacient i ri, i përgjakur. Këmisha i është njomur nga gjaku, fytyra e zbehtë dhe e shtrembëruar nga dhimbja, sytë hapen e mbyllen me vështirësi, si të kërkonin ajër. Një plagë e thellë i çan barkun. Ajo ishte e freskët, ende e hapur, dhe çdo frymëmarrje duket si një përpjekje e fundit për jetë. Çdo sekondë është një çmim i lartë për jetën e tij.
Pas barelës vrapon shoku i tij, i panikuar, me duar të përgjakura dhe sy të çmendur nga frika. Ai ulëret me zë të lartë. Një britmë e çjerrë ku përzihen dëshpërimi dhe lutja:
SHOKU I PACIENTIT
Ju lutem! Ai po vdes! E ka prerë një xham i madh! Po humbet gjak!
Infermierët shpërndahen të shqetësuar, njëri kontrollon pulsin, tjetri stabilizon pacientin, ndërsa lëngjet e kuqe ngjiten mbi lëkurën e zbuluar dhe uniformat e tyre. Prof. Petriti tenton të afrohet, por ngrihet një tension i padukshëm midis stafit dhe profesorëve të tjerë.
INFERMIERI: Ku është shefi i kirurgjisë?! Urgjente! Duhet operacion brenda 5 minutash!
Profesorët e vjetër ngurojnë, të mpirë nga rutina e përjetshme e rreziqeve dhe pasigurisë së jetës së pacientëve. Çdo sekondë duket se zgjat për një jetë të tërë dhe heshtja e tyre është si një barrierë që pengon shpejtësinë e nevojshme për të shpëtuar jetën. Drita e sirenës vazhdon të pulsojë, duke

e bërë çdo moment më të rëndësishëm, çdo frymëmarrje më të vështirë, duke e shndërruar urgjencën në një teatër tragjik që luhet mes jetës dhe vdekjes. Atëherë dera në fund të korridorit hapet. Arbeni del me përparësen e bardhë, i kthjellët, si i lindur për atë moment.

ARBENI (ton komandues): Salla 3, përgatitje të menjëhershme. Grupi A – me mua. E futim në operacion tani!

Infermierët marrin frymë me lehtësim.

Profesorët e vjetër e shikojnë me sy të ngrirë.

– Ai po i merr pacientët, po merr autoritetin, po merr spitalin.

Arbeni shikon Petritin në sy:

ARBENI (me zë të ulët, i vendosur): Fjalët mbaruan, profesor. Tani flasin duart.

Ai nxiton drejt sallës së operacionit.

PARASALLA E OPERACIONIT

Të rinjtë e ndjekin me entuziazëm, syri i tyre i ndezur nga kurioziteti dhe një përzierje frike me respekt. Atmosfera është e ngarkuar, një përzierje adrenalinë dhe pritjeje, ku çdo lëvizje duket se mund të ndryshojë rrjedhën e ngjarjeve. Njëri prej tyre, doktori i ri Erisi, i afrohet Arbenit, ende i turbulluar nga forca e fjalëve që dëgjoi më parë.

ERISI

Doktor Arben… Si ia dole t'u flisje ashtu?

Arbeni e sheh për pak, pa nxituar, dhe më pas vesh dorezat kirurgjikale ngadalë. Një rit i matshëm, me një qetësi që të shtyn të ndalesh dhe të mendosh. Ka diçka të frikshme në atë qetësi: Një siguri që nuk lind nga fjalët, por nga përvoja. Nga netët pa gjumë, nga gabimet e paguara shtrenjtë, nga rastet kur gjithçka varej nga një vendim i vetëm. Një siguri e heshtur, e ngulitur thellë, që nuk ka nevojë të shfaqet me zë të lartë. Ajo buron nga vendosmëria për të mos u tërhequr, edhe kur frika është aty, e pranishme, por e kontrolluar.
Është ajo lloj sigurie që ndjehet në mënyrën si lëviz duart, si përqendrohet shikimi, si koha ngushtohet rreth një qëllimi të vetëm. Një siguri që nuk premton mrekulli, por veprim.
Arbeni: Kur një e vërtetë hesht…, dikush duhet ta thotë me zë.
Ai ngrihet drejt derës së sallës operacionit dhe me një lëvizje të qetë, por të vendosur, e hap atë. Dritat e bardha shpërthejnë menjëherë mbi të, duke i kthyer hijet e trupit të tij në skica të forta, të ndritshme, ku çdo detaj duket i padiskutueshëm.
ARBENI (me një vendosmëri dhe qetësi): Tani të shpëtojmë një jetë.
Dera mbyllet pas tij me një klik të prerë. Një heshtje e shkurtër përshkon sallën, ndërsa të gjithë e kuptojnë se çdo moment ka rëndësinë e vet.

MOMENTET E PARA TË OPERACIONIT

Dritat e bardha digjen si yje mbi tryezën e operacionit,

duke ndriçuar çdo plagë, çdo gjilpërë, çdo lëvizje të dorës kirurgjikale. Pajisjet elektronike bipojnë ritmikisht, monitorimi i pulsit dhe tensionit i pacientit shfaqet në ekrane që shkëlqejnë, duke krijuar një simfoni teknologjie dhe përqendrimi. Infermierët dhe kirurgët e rinj janë të tensionuar, por Arbeni udhëheq çdo veprim me një siguri që i bën ata të ndihen të mbrojtur, edhe pse në thellësi dinë se çdo gabim mund të kushtojë një jetë. Çdo prerje, çdo lëvizje, çdo vendim duket se ka peshën e një universi të tërë, dhe në atë qetësi të tensionuar, Arbeni është qendra e gjithçkaje.

Dritat pulsojnë mbi fytyrat e të rinjve, duke i bërë ata të ndihen pjesë e një misteri të madh, ku jeta dhe vdekja janë vetëm disa centimetra larg njëri-tjetrit.

Pacienti është i zbehtë, gjaku i rrjedh i ngrohtë mbi çarçafët blu.

Ekipi i ri i kirurgjisë, rreth e rrotull Arbenit, mezi merr frymë.

Të rinj, të frikësuar, por me sytë tek ai.

ARBENI (qetë, i sigurt): Mpiksjen e gjakut e keni? Adrenalina gati? Clamp-ët e vegjël sillini më afër.

Të rinjtë nxitojnë. Askush nuk mendon. Gjithçka lëviz sipas ritmit të tij.

Pacienti dridhet. Gjaku shpërthen paksa nga plaga.

INFERMIERJA: Doktor… po e humbasim…

Arbeni ngrit kokën. Sytë i shkëlqejnë me qetësi të akullt.

ARBENI: S'po humbasim askënd. Qetësohuni… Jam unë

këtu. Kam parë edhe më rëndë.
Fjalët e tij bien si një premtim, të mbushura me siguri dhe vendosmëri. Të gjithë në sallë ndihen të qetësuar, sikur frika e tyre të ishte një valë që ai e përmbysi me praninë e tij.
ARBENI: Vetëm përqëndrim. Ky është momenti kur mjekësia nuk lejon frikë.
Ai fut duart brenda plagës me një ritëm të matur, çdo lëvizje e tij është e qartë, e llogaritur, pa asnjë dridhje. Gjaku ngjyros dorezat deri në bërryla, por Arbeni nuk e ndjen – Përqendrimi i tij është total, i përqendruar te çdo arterie, te çdo ind, te çdo frymëmarrje e pacientit që po lufton për jetën.
Ekipi i rinjve e shikon me admirim dhe pak frikë, por me respekt. Secili prej tyre ndjen se po mëson jo vetëm teknika kirurgjikale, por edhe artin e vendosmërisë, të qetësisë në krizë dhe fuqinë që vjen nga kontrolli i plotë mbi situatën. Në atë heshtje të mbushur me tension, çdo bipo e monitorit duket si një rrahje e përbashkët me zemrën e pacientit. Dhe ndërsa Arbeni punon, duket sikur koha ndalet — Çdo sekondë është një fitore, çdo lëvizje e dorës së tij një akt shpëtimi që mban të gjithë ekipin të fokusuar dhe të frymëzuar.
Ai është jo vetëm kirurg, por lider dhe mburojë. Një pikë referimi në mes të kaosit dhe jetës që lufton për të vazhduar.

KORRIDORI JASHTË SALLËS

Profesorët e vjetër qëndrojnë të mbledhur. Tension, urrejtje, ego.

PROF. PETRITI (me zë të ulët,): Shikoni, ja ku e ka shou-n. Ai po bën spektakël brenda.

PROF. AGRONI: Po nëse e shpëton?

PROF. PETRITI (një buzëqeshje e ftohtë): Atëherë do e shkatërrojmë ndryshe.

OPERACIONI HIPNOTIZUES

Brenda sallës së operacionit Arbeni ka gjetur burimin e gjakderdhjes: një arterie e çarë thellë.

ARBENI: Kjo është. Po ta humbnim këtë arterie,… morëm fund.

Gishtat e tij lëvizin me shpejtësi të pabesueshme.

Bën një lëvizje të saktë, që duket më shumë art sesa mjekësi.

Monitori: bip… bip… BIP… BIP…

Ritmi i zemrës stabilizohet. Ekipit i shpëton një psherëtimë lehtësimi.

ERISI (doktori i ri): Doktor… Kjo ishte… e pamundur.

ARBENI: Nuk ekzistojnë gjëra të pamundura. Vetëm momente ku njeriu dorëzohet dhe humb. Ne… nuk dorëzohemi kurrë. S'jemi nga ata tipa dhe qeshi pak me ironi.

Në atë moment, dritat e sallës fillojnë të dridhen.

INFERMIERJA: Çfarë po ndodh?! Një heshtje e frikshme.

Pastaj "puf!". Dritat fiken për dy sekonda. Errësirë totale.

ERISI (dëgjohet në errësirë): Profesorët… kanë fikur rrymën! Por dritat ndezen sërish nga gjeneratori.
Arbeni ngre kokën ngadalë, plot mllef të heshtur.
ARBENI: Vazhdojmë. Nuk ka kush të na ndalë.

KORRIDORI, PAS OPERACIONIT

Të gjithë të rinjtë dalin pas tij.
FUND I OPERACIONIT
Pas 50 minutash pune të palodhur, me gjakderdhje të ndalur, plagët të mbyllura dhe zemrën e pacientit të stabilizuar, sallën mbush një heshtje e lehtë, e ngarkuar me lodhje dhe lehtësim. Çdo frymëmarrje e stafit duket se ka ritmin e një fitoreje të vogël, por të jashtëzakonshme.
ARBENI: Mbaroi. Ekip. E shpëtuam.
Disa infermierë shikojnë njëri-tjetrin, të emocionuar, disa me sy të lagur nga lotët e fshehtë, të tjerët me buzëqeshje që nuk mund të fshihen.
Një infermiere e re ndalon për një çast dhe e thotë me zë të ulët, akoma e tronditur nga përvoja:
INFERMIERJA E RE: Doktor… Asnjëherë s'kam parë një operacion të tillë.
ARBENI (shikon gjithë ekipin me sytë e qetë, por të fortë): Mos harroni këtë natë. Jo për mua… Por për veten tuaj, sepse mjekësia nuk është thjesht një profesion,… është luftë. Luftë ndaj kohës, ndaj frikës, ndaj humbjes dhe sonte fituam një betejë.
Ai largohet nga salla me hap të vendosur, duart e gjakosura ende nga operacioni, duke lënë pas një heshtje të thellë

dhe respekt të pamasë. Çdo anëtar i ekipit ndjen peshën e mësimit që mori fuqinë e qetësisë së Arbenit dhe kuptimin e vërtetë të profesionit: Se shpëtimi i jetës nuk është vetëm teknikë, por edhe guxim, vendosmëri dhe besim në vetvete dhe në kolegët.

Dritat e sallës tërhiqen gradualisht mbi tryezën e operacionit, ndërsa gjaku i thatë shkëlqen nën dritën e pulsuar, duke lënë pas jo vetëm një pacient të shpëtuar, por edhe një ekip të transformuar nga përvoja e përbashkët. Ai nuk është më thjesht një kirurg. Është udhërrëfyes dhe frymëzim për të gjithë që ndodhen pas tij.

Disa duartrokasin lehtë. Të vjetrit heshtin, të turpëruar.

Dr. Mentori afrohet duke buzëqeshur.

DR. MENTORI: Bravo, Arben… Nuk shpëtove vetëm një pacient. Sot shpëtove moralin e një spitali.

Dok. Arbeni qëndronte në këmbë, me duart në xhepa, duke parë diku larg, në një pikë të padukshme midis murit dhe mendimeve të tij.

Ai mori frymë thellë. E hapi gojën ngadalë, si dikush që ka mbajtur shumë brenda për shumë vite.

"Jeta ime ka qenë e vështirë… shumë më e vështirë se ç'mund ta kuptoni ju. Këto nuk janë asgjë për mua Doktor, - tha ai.- U munduan të më prishin operacionin, por dështuan."

Zëri i tij ishte i ulët, por i mprehtë. Një zë që vinte nga thellësia e shpirtit dhe plagëve.

"E di mirë çfarë janë njerëzit. Ju i shihni ndryshe ndoshta. Ju mendoni se janë të mirë, se kanë zemër, se duan njëri-

tjetrin. Por kjo është një gënjeshtër, një iluzion i bukur që e vënë për të mos u çmendur. Njerëzit nuk janë miqësorë. Nuk janë të butë. Nuk janë të ndershëm. Janë maska. Ata janë ujqër që nuk durojnë asgjë mbi ta. Mbrapa tyre fshihet ferri."

Ai qeshi hidhur, një buzëqeshje që nuk kishte asnjë grimcë gëzimi.

"Të fortët sundojnë. Të dobëtit përkulen. Kështu janë mësuar këta. Kjo është natyra. Kaq. Ata nuk falin….."

Shkenca? Ligji? Morali? Si kudo. Vetëm fjalë boshe, për të mbajtur turmën nën kontroll. Këta janë mësuar se si.

Udhëheqësi sundon popullin, dhe populli…, populli është skllav. Skllav modern. Skllav që nuk ka zinxhirë në duar por ka zinxhirë në mendje.

"Por tani mfjaft ….Sapo i mundëm."

Ai bëri dy hapa përpara, sikur donte t'i afrohej një të vërtetë të hidhur.

"Njeriu është i lig nga natyra. - mendoi ai, - I lindur me mllef, me zili, me lakmi. I lindur me dëshirë për të shkatërruar, për të marrë, për të zhdukur. Pas buzëqeshjes së çdo njeriu ka një thikë. Pas çdo fjalë të butë, një gropë që ta hapin sapo t'u kthesh shpinën. Dhe mos më bëni të flas për moralin e doktorëve…"

Ai uli kokën, pastaj ngriti sytë duke i fiksuar si dritë lazeri. E tha: Ju profesorët… me bluzat e bardha. Jeni të zinj nga brenda.

Zëri ngrihet i ngadaltë, i prerë, si një akuzë që nuk kërkon përgjigje, por ndërgjegje.

A- mendoni se nuk iu shoh? Ju dhe të tjerët?
Një pauzë e shkurtër, mjaftueshëm e gjatë për t'i bërë fjalët të rëndojnë. Jeni të bardhë nga përparësja dhe të zi nga brenda.
Plot dashnore të reja, të fshehura pas titujve akademikë dhe korridoreve të errëta. Plot premtime të rreme, të thëna me të njëjtën gojë që predikon etikë dhe betime profesionale. Plot mëkate që i fshini me dorashka sterile, duke menduar se pastërtia e latex-it pastron gjithçka.
Por jo.
Ato nuk fshihen.
Ato mëkate ju njollosin shpirtin më shumë se gjaku në sallën e operacionit, sepse gjaku shpëtohet, ndërsa hipokrizia vret ngadalë. Vret besimin, vret dinjitetin, vret shembullin që duhet t'u jepni atyre që ju shikojnë si autoritet.
Bluzat tuaja janë të bardha, por brenda tyre ka heshtje të kalbura, frikë nga e vërteta dhe një moral që vishet e zhvishet sipas interesit. Dhe pikërisht kjo, më shumë se çdo gabim mjekësor, është sëmundja që po e shkatërron këtë sistem nga brenda. Ju fshiheni pas etikës. Por etikën e keni vrarë vetë herën e parë që shitët ndërgjegjen për një rrogë më të mirë, një pozicion më të lartë, për një femër më të re. Grabitqarë me kollare. Hiena të rrethit të bardhë.
Frymëmarrja e tij u bë më e thellë, zëri më i rëndë. "Jeni më keq se kafshët e egra."
Të paktën kafshët vrasin për të ngrënë, për të mbijetuar. Ju vrisni shpirtërisht për luks, për pushtet, për ego.

Ju pretendoni se shpëtoni jetë, por sa jetë keni shkatërruar me një firmë, me një vendim, me një thashethem?
Sa njerëz keni futur në varfëri? Sa të rinj keni përdorur?
Sa gra keni prekur me duar që ndoshta kanë shpëtuar jetë, por kanë ndotur dinjitet?
Ai ngriti duart, duke i parë sikur kërkonte të kuptonte nëse ishin të tijat apo të dikujt tjetër.
"Ju jeni vrasës me gjak të ftohtë. Por jo me thikë. Jo me pistoletë. Jo me helm. Vrisni me fjalë. Me heshtje. Me pushtet. Me indiferencë. Jeni të rrezikshëm sepse pretendoni të jeni të pastër. Por e vërteta është kjo: Njeriu është armiku më i madh i njeriut. Dhe ju, në këtë sallë të bardhë, jeni prova e gjallë."
Në sallë ra qetësi e frikshme. Vetëm zhurma e kondicionerit dëgjohej, si një frymë e ftohtë që i mbulonte të gjithë. Arbeni u ul më në fund, i lodhur, sikur nga supet i ishte hequr një mal i tërë. Arbeni ishte i lodhur dhe i këputur, por njëkohësisht krenar për operacionin e tij të parë si shef kirurgjie. Ai bëri atë që askush nuk e kishte bërë deri më sot. Solli në jetë një njeri të cilit i ishte çarë barku plotësisht, i ishin këputur shumë organe jetësore, thuajse ishte ndarë në mes. Ai e rindërtoi trupin dhe tani pacienti jetonte të gjithë u hutuan dhe heshtën. Ndërsa disa prej mjekëve të vjetër e quajtën rastësi. Dr. Mentori ishte shumë i gëzuar dhe krenar për zgjedhjen e tij. Lajmi u përhap si era. I gjithë qyteti e mësoi menjëherë, sepse në sistemet diktatoriale dhe pasdiktatoriale lajmi ecën me shpejtësi drite.

Arbeni shkoi në dhomën e mjekëve, lau duart dhe fytyrën, hoqi kostumin kirurgjikal dhe vështroi edhe një herë nga korridori i spitalit të gjashtëkatëshit, i cili dergjej nga vjetërsia, pisllëku dhe shtretërit me susta që kërcisnin në mënyrë sistematike; Zhurma e tyre dëgjohej nga larg.

"Çfarë spitali është ky? - mendoi me vete. - As në Afrikë s'ka spital të tillë. Ky është socializmi, more njerëz…- nënqeshi hidhur. - Por po të shkosh te Onkologjiku, është akoma më tmerr. Aty hyn i shëndoshë dhe del i vdekur. Kushte mjerane. Asnjë aparaturë. Mjekë që vetëm vjedhin gjithçka. Ky është turpi ynë si shoqëri, - mendoi përsëri. - Prandaj duhen reforma. Duhen ambiente të reja dhe aparatura të fundit, si kudo tjetër në Evropë. Spitali qëndror në Shqipëri ishte si një parking varrezash. Ky ishte investimi i socializmit dhe i Byrosë Politike, që e ka mbajtur dhe vazhdon ta mbajë peng vendin."

Ai veshi kostumin e tij të zi, u kreh para pasqyrës dhe pas pak vendosi edhe kollaren blu. Më pas doli në oborr dhe shikoi nga rruga për të gjetur ndonjë taksi. Deri atë ditë kishte marrë rrogën e kursantit në spital, si çdo specializant tjetër. Sot ishte dita e tij e parë e punës dhe nga sot ai quhej mjek i punësuar. Kishte kursyer dhjetë mijë lekë të vjetra, të cilat i mbante në portofol.

Jetonte në një dhomë në Qytetin Studenti, në godinën 18, bashkë me një pedagog të ri të lëndës së matematikës. Nuk kishte autobus direkt. Vetëm deri në qendër, sepse linja e vetme ishte Kombinat–Kinostudio. Tek spitali kishte një

stacion ku mblidheshin dhjetëra njerëz dhe të hipje në autobus ishte sakrificë e madhe. Po ashtu duhej të ruheshe nga xhepistët e shumtë që vidhnin pothuajse çdo njeri me kostum, e aq më keq të moshuarit.

"Shqipëri e pleqëruar…, - mendoi përsëri. - Kur në kryeqytet ndodh kështu, s'keni ide si është në rrethin tim. Unë jam rritur në konviktet e qytetit të Librazhdit, ku varfëria s'ka kufi."

Ai ngriti kokën lart dhe shikoi majtas për të parë nëse po kalonte ndonjë taksi, ose nëse duhej të dilte në rrugë për të ndaluar njërën prej tyre. Ai qëndroi edhe pak në cep të oborrit, duke dëgjuar zhurmën e largët të ambulancave dhe britmat e mjekëve që vraponin mes korridoreve. E dinte mirë se ky spital, edhe pse i rrënuar, ishte vendi ku ai duhej të luftonte për jetët e të tjerëve. Por ndonjëherë i dukej se duhej të luftonte edhe kundër vetë sistemit, kundër pluhurit që s'dilte kurrë, kundër pajisjeve të prishura dhe kundër mentalitetit të mjekëve të vjetër që prisnin vetëm ditën e pensionit. Pikërisht atë çast, një taksi e vjetër, me ngjyrë të verdhë të shuar, u shfaq në skaj të rrugës. Shoferi, një burrë rreth të gjashtëdhjetave me fytyrë të rrudhur dhe me një cigare të pashuar mes gishtave, ndaloi para tij.

– Hë, doktor, ku do të shkojmë? – e pyeti ai, me një buzëqeshje të shtrembër, sikur e njihte prej kohësh.

Arbeni hapi derën, u ul në sediljen e pasme dhe ndjeu aromën e rëndë të duhanit të vjetër e të gomës së djegur. Ulësi kërciti nën peshën e tij.

– Në Qytetin Studenti, te godina 18, – tha me zë të qetë.
Taksisti ndezi makinën që u drodh sikur po zgjohej nga gjumi pas një jave. Dritat e dobëta të mbrëmjes ndriçonin trotuaret e plasaritura, fasadat e pallateve gri të periudhës komuniste dhe fytyrat e lodhura të njerëzve që prisnin autobusa të tejmbushur.
– Kam dëgjuar për operacionin, – tha shoferi, duke parë Arbenin nga pasqyra. – Thuhet se keni bërë mrekulli sot.
Arbeni nuk foli për një moment. Pastaj tha:
– Nuk ishte mrekulli. Ishte hesap i vështirë… Por i bërë siç duhet.
– Po njerëzit thonë që kanë parë Zotin të zbresë në sallë operacioni, – qeshi shoferi, duke u përpjekur ta zbuste atmosferën. – Eh, doktor, këtu te ne njerëzit flasin shumë.
Arbeni buzëqeshi lehtë, por sytë i qëndruan të zymtë. Mendja i shkoi te pacienti që kishte lënë pas, te barku i shqyer, te suturat e pafundme, te momenti kur monitori gati u ndal.
– Njerëzit flasin, – pëshpëriti ai. – Por spitalet nuk flasin. Ato tregojnë të vërtetën. Dhe e vërteta është e hidhur.
Shoferi nuk foli më. Rruga e heshtur vazhdoi mes ndërtesave të betonit të vjetër. Dritat e rrugës dridheshin sikur ishin lodhur edhe ato nga jeta e kryeqytetit. Kur mbërritën te Qyteti Studenti, Arbeni zbriti ngadalë. Freskia e mbrëmjes i preku fytyrën. Para tij shtrihej godina e gjatë, me dritare të mëdha, ku studentët e varfër jetonin mes librave të vjetër dhe shpresave të mëdha. Ai u ndal disa sekonda para

hyrjes, vështroi qiellin gri të Tiranës dhe mendoi: "Dita e parë mbaroi. Nesër fillon lufta e dytë." Pastaj hapi derën e godinës dhe hyri brenda. Ai u ngjit ngadalë në katin e dytë të godinës, duke dëgjuar trokitjen e këpucëve të tij mbi shkallët e betonit të vjetër që kërcisnin nën peshën e çdo njeriu. Në korridor mbizotëronte aroma e lagështisë, e bojës së vjetër dhe e sobave elektrike që studentët ndiznin fshehurazi.

Dhoma e tij ishte numër 112.

Ai shtyu derën e lehtë prej druri të hollë dhe hyri brenda. Pamja ishte e njëjtë si çdo ditë dhe njësoj e trishtë.

Një krevat me susta, që kërciste sapo i afroheshe. Dysheku i vjetër, i hollë, i konsumuar në mes, ku trupi humbiste si në një gropë të butë. Sipër tij, disa batanije ushtarake, ngjyrë gri, prej leshi të rëndë që mbante erë magazinë e lagësht.

Në qoshe ndodhej një furrnelë e dikurshme, që ngrohte vetëm ajrin rreth vetes dhe kërciste si t'ishte gati të shpërthente. Dritaret ishin të vjetra, xhamat e tyre të plasaritur. Në njërin kënd mungonte një copë xhami dhe ai e kishte mbuluar me karton dhe me ngjitës.

Banjo? S'kishte.

Në fund të korridorit, një e përbashkët, ku vinte era klor, myk dhe rrëmujë. Uji vinte me orar; Ndonjëherë fare. Dushet? Pothuajse kurrë nuk funksiononin. Të lahesh ishte luks. Të lahesh "siç duhet" – Science fiction. Ai buzëqeshi hidhur me vete.

"Konvikt i qelbet… Por është shtëpia ime për tani,"- mendoi.

Hoqi kostumin me kujdes, e palosi dhe e vendosi sipër karriges së vetme. Hapi dollapin e vogël të drurit, në fund të dhomës, që gjithashtu gërvishte si macet e errësirës dhe mori rrobat sportive. I veshi ngadalë, duke ndier lodhjen që i rëndonte në çdo muskul.

Më pas u ul në krevatin me susta që lëshoi një kërcitje të gjatë, sikur po protestonte.

Ai vështroi dhomën e vogël, dritaren e plasaritur, batanijet e rënda, tavolinën e vogël ku mbante edhe librat e fakultetit e mendoi: "Kjo është jeta e një mjeku në Shqipëri. Kjo është jeta ime tani."

Arbeni u shtri pak në krevatin me susta. Dëgjoi një krrr-cing të gjatë që iu ngjit nervave, por nuk reagoi më. Ishte aq i lodhur sa edhe hekuri i shtrembër i krevatit i dukej si muzikë.

Në tavan, mbi kokën e tij, kishte një njollë të madhe lagështie që formonte figurën e një harte. Ai e kishte vëzhguar shpesh dhe çdo ditë zgjerohej pak nga pak, sikur lagështia po gërryente edhe vetë frymën e studentëve.

Ai mori frymë thellë. Mbushi hundët me aromën e dhomës. Një përzierje pluhuri, djersë, rrobash të lagura dhe ajër të ftohtë që hynte nga dritarja e prishur. Dhe megjithatë…, aty ndjehej "në shtëpi".

Mjerimi, kur zgjat, kthehet në normalitet.

E hodhi sytë te tavolina e vogël. Aty ishin librat e vjetër të mjekësisë, të zverdhur dhe të përdorur nga katër breza para tij. Disa ishin të çarë, të tjerë mungonin faqe. Pjesa më

e madhe e diturive që ai kishte, nuk dilnin nga këta libra, por nga netë të panumërta në sallën e operacionit dhe nga ndjekjet e pafundta pas profesorëve që rrallë flisnin.
Pikërisht atë çast, u dëgjua një trokitje e lehtë në derë.
Trak… trak… Arbeni ngriti kokën. – Hyr! – tha me zë të lodhur. Dera u hap ngadalë dhe brenda hyri pedagogu i matematikës, shoku i tij i dhomës, një djalë i ri, me flokë të zinj dhe sy të lodhur, që mbante në dorë disa fletë të llogaritjeve.
– O Arben… – tha ai duke e parë – Të dëgjova sot te lajmet. E paskan bërë lajm të madh operacionin tënd.
Arbeni u ngrit pak, mbështeti shpinën në mur.
– Po… – tha shkurt. – Punë, jo lajm.
Pedagogu qeshi me hidhërim.
– Këtu çdo gjë bëhet lajm,… për një ditë. Pastaj harrohet. Vetëm mjerimi mbetet.
Ai u ul në karrigen e vet dhe nisi të paloste fletët. Dhoma u mbush me heshtjen e zakonshme të konviktit. Nga korridori dëgjoheshin zhurma hapash, fishkëllima sobash elektrike dhe dikush që grinte diçka për drekë në një tavolinë të vogël.
– Arben… – tha shoku i dhomës, duke ngritur sytë. – Do ia dalësh. Unë e di. Kjo dhomë,… ky varfërim… Kjo s'është fundi. Kjo është vetëm stacioni i parë.
Arbeni uli sytë. E ndjeu që fjalët e shokut i shkuan thellë, por nuk deshi ta tregonte.
– Shpresoj… – tha ai qetë.

Pastaj, duke parë rrobat e tij të varfra, batanijet ushtarake, sobën e vjetër, dritaren e plasur, shtoi me zë të ulët:
– Veç të mos më thyejë shpirtin ky vend…
Shoku i hodhi një vështrim të sinqertë, pa keqardhje, por me respekt.
– Nuk ka vend që e thyen shpirtin tënd, Arben. Ti je i fortë. E ke treguar sot.
Arbeni psherëtiu ngadalë. Qafa i rëndonte nga lodhja, trupi i dridhej pak prej tensionit të ditës. Ai u shtri përsëri, mbuloi sytë me parakrahun e tij dhe mendoi: "Një ditë kjo do të jetë vetëm kujtim. Një ditë do të kem mundësinë të ndryshoj diçka… Në këtë vend të izoluar, të plasaritur… të braktisur."
Krevatit iu dëgjua prapë kërcitja karakteristike, por këtë herë ai qeshi lehtë.
– E pra… Edhe muri na ka dëshmitarë të përditshëm këtu…
Mbylli sytë për disa sekonda. E kishin thirrur kantinat e lodhjes, por më shumë e kishin thirrur përgjegjësitë e së nesërmes.
Dhe në heshtjen e dhomës 112, mes lagështisë së konviktit dhe rënkimeve të hekurit, Arbeni e ndjeu qartë se jeta e tij sapo kishte filluar. Lufta e tij gjithashtu. Në këtë dhomë ku dritaret ishin të vjetra, me xhama të çarë, në një cep të mbuluar me një copë kartoni. Muret ishin të zverdhura nga koha dhe lagështia, ndërsa dyshemeja e ftohtë prej parketi të vjetër qante në çdo hap që hidhje.
Dhoma nuk kishte banjo. Ajo ndodhej në fund të korridorit,

e përbashkët, e vjetër. Gjithmonë me radhë. Ujin që vinte me orar, ose nuk vinte fare. Dushet pothuajse nuk funksiononin kurrë. Të lahesh "normalisht" ishte luks. Të prisje ujin ishte pjesë e ditës, pastaj mos harro proçeset tjera si ngrënia apo gjumi.

Arbeni qeshi lehtë me vete, një buzëqeshje e hidhur që i doli pa zë, më shumë si një reagim instinktiv sesa si shenjë humori.

"Konvikt i qelbur… Dhe këtu do jetoj unë, si mjek i sapo punësuar?" - mendoi, ndërsa hunda i mbushej me erën e lagështisë, bojës së vjetër dhe lodhjes së grumbulluar të viteve. "Nuk mundem. Duhet të gjej një shtëpi më qera patjetër." - Edhe qeshi me skenën që kishte përpara. Ai hodhi sytë rreth e rrotull. Muret ishin të zverdhura, të mbushura me njolla që askush nuk kishte mundur t'i fshinte. Dritarja mezi hapej dhe fëshfërima e erës hynte si një psherëtimë e gjatë. Gjithçka dukej e përkohshme, sikur edhe vetë jeta e tij aty ishte vetëm një ndalesë e padëshiruar, por që do ikte shumë shpejt përgjithmonë e do ngelej vetëm në kujtesë.

Arbeni pa përsëri tavolinën. Një copë mobilie e vjetër, me këmbë të çara dhe sipërfaqe të gërryer nga koha. E shikoi gjatë, sikur po e shihte për herë të parë. Në atë tavolinë kishte ngrënë, kishte lexuar, kishte fjetur me kokën mbi libra mjekësie, kishte shkruar shënime dhe ëndrra që ende nuk guxonte t'i quante plane. Tani tavolina i dukej si një pasqyrë e heshtur, e konsumuar, por ende në këmbë. Si ai vetë. Në atë çast e kuptoi se nuk ishte thjesht një vend ku

jetonte, por një provë durimi, një fillim i ashpër që do ta formësonte. Dhe për herë të parë, mes neverisë dhe lodhjes, ndjeu edhe një grimë krenarie që kishte mbijetuar deri aty. Në tavolinë ndodheshin disa libra të vjetër të fakultetit, një fletore dhe një stilolaps i lodhur. Asgjë më shumë. Dhoma ishte bosh, e varfër, por e qetë. Dhe qetësia i duhej.

Arbeni mori frymë thellë. Lodhej trupi, por edhe mendja. Kishte pasur ditën e parë të punës si shef i sallës së kirurgjisë. Kishte kryer atë operacion të pamundur që ndoshta askush tjetër nuk do ta merrte përsipër. Kishte shpëtuar një njeri që ishte thuajse i prerë në mes.

Tani ishte vetëm në dhomën e tij të vogël.

Sytë i shkuan tek dritarja me xhamat e çarë. Jashtë, dielli i pasdites hynte si një vijë e hollë drite që prekte dyshemenë e ftohtë.

"Edhe kjo ditë mbaroi," mendoi. U shtri pa forcë dhe mbuloi fytyrën me parakrah. Tavanin e kishte parë mijëra herë, njollën e lagështisë që çdo ditë që zgjerohej pak nga pak. Por sot, ndryshe nga ditët e tjera, ai nuk mendoi për lagështinë. Mendoi për të nesërmen.

Të nesërmen, Arbeni u zgjua me një ndjesi të çuditshme presioni në gjoks. Nuk ishte frikë, as ankth i hapur. Ishte si një barrë e padukshme që i rrinte mbi shpatulla. E dinte se kjo ditë nuk do të ishte e zakonshme. Mbrëmja e kaluar i kishte lënë mendimet të hapura, të paketuara keq, dhe tani çdo gjë kërkonte rend e disiplinë.

Ai e dinte se duhej të punonte më shumë se kurrë. Projekti

i tij shkencor po hynte në fazën më delicate. Edhe stafi i ri, ende i papërdorur plotësisht, priste drejtimin e tij. Ishin të rinj, ambiciozë, por të paformuar. Kishin nevojë për një dorë të fortë, për orientim dhe vizion të qartë edhe Arbeni e dinte, se vetëm ai mund ta vendoste këtë ritëm.

Ndërsa pinte kafen e parë të ditës, mendja e tij rrëshqiste midis pyetjeve që e gërryenin prej kohësh: "Po sikur të mos mjaftojë? Po sikur ekipi të mos e kuptojë drejtimin tim? Po sikur presioni t'i shtyjë drejt gabimeve që nuk mund t'i korrigjoj më pas?"

Por ai nuk ishte njeri që dorëzohej. E njihte mirë veten. Kur ndjente peshën më të rëndë, atëherë punonte më fort. Aty fillonte forca e tij e vërtetë.

Vendosi të ndërtonte një plan të qartë.

Së pari një mbledhje me stafin e ri shkencor. Jo thjesht për t'u dhënë detyra, por për të vendosur standardet: punë të disiplinuar, analiza të thella, shënime të sakta dhe mbi të gjitha përgjegjësi. Secili duhej të kuptonte se projekti nuk ishte thjesht një detyrë pune, por një sfidë intelektuale që kërkonte përqendrim absolut.

Së dyti ai vetë do të merrej me pjesën më të ndërlikuar të kërkimit. Do ta shtynte veten deri aty ku pak të tjerë arrinin. Duhej të punonte dyfish, të humbiste orë gjumi, të kalonte netë pa zhurmë. Ishte i gatshëm.

Së treti krijimi i një metodologjie të re pune. Një rregull i brendshëm që do të përshpejtonte proçedurat dhe do t'i jepte ekipit ndjesinë se po lëviznin shpejt, por në mënyrë të kontrolluar.

Këto mendime, edhe pse të rënda, i dhanë një qetësi të ftohtë. Ishte qetësia e dikujt që e di se rruga është e vështirë, por që ecën me kokën lart.

Arbeni u ngrit, veshi këmishën e tij të zakonshme të errët dhe për një çast pa veten në pasqyrë: Sytë i kishte pak të lodhur, por të vendosur. Ishte gati. Sot nuk do të lejonte asgjë ta shpërqendronte.

Dera u mbyll ngadalë pas tij dhe ai doli përpara stafit të tij të ri. Ditë e re, sfidë e re, dhe vetëm një rrugë përpara: punë, punë dhe sërish punë.

Koha kaloi shpejt. Ai u bë gati dhe shkruajti disa gjëra themelore, se e dinte që e nesërmja do të ishte edhe më e vështirë.

Të nesërmen, Arbeni u zgjua me një tringëllimë të lehtë brenda kokës. Jo dhimbje, por një shenjë e qartë lodhjeje të akumuluar. Ndërsa hapi perden, drita gri e mëngjesit i ra në sy. Ishte ai lloji i mëngjesit që të shtyn të mendosh më shumë sesa duhet.

Në tavolinë, filxhani i kafesë nxirrte avull, por mendja e tij rrinte pezull mbi problemet e ditës. Stafi i ri,… projekti…, pritshmëritë,… përgjegjësia. Ai murmuriti me vete: "Sot duhet t'i vendos në vijë. Nuk kam më kohë për gjysmë-masa."

Pas pak, u nis drejt spitalit. Korridoret e ftohta e përshëndetën me heshtjen e zakonshme. Në sallën e mbledhjeve, stafi i ri shkencor ishte ulur në pritje. Pesë njerëz, të gjithë të rinj, me fytyra që përzien padurim, ambicie dhe pak frikë.

Arbeni hyri pa zhurmë, hodhi dosjet mbi tavolinë dhe i pa një nga një.
- Mirëmëngjes! - tha ai.
- Mirëmëngjes profesor! - u kthyen ata pothuaj në kor.
Arbeni qëndroi pak sekonda në këmbë, duke matur secilin prej tyre. Pastaj foli:
- Dëgjoni. Projekti ynë po hyn në një fazë të re. Më të vështirë. Dhe unë dua vetëm një gjë nga secili prej jush: Përqendrim absolut. Gabimet nuk i toleroj dhe as vonesat.
Një nga vajzat në ekip, Nora, ngriti dorën.
- Profesor, mund të dimë saktësisht çfarë faze fillojmë sot? Materialet që na dërguat ishin të pjesshme…
Arbeni e ndërpreu butë, por prerë:
- Po, prandaj jemi këtu. Sot nis analiza e të dhënave që kemi grumbulluar tre muajt e fundit. Dua që secili prej jush të punojë mbi segmentin që kam caktuar. Nuk dua improvizime.
Nga ana tjetër, Arjani, djali më i ri në ekip u ngrit e foli me zë paksa të pasigurt:
- Profesor…, të gjitha të dhënat janë shumë të shpërndara. Na duhet një metodologji e re, ose… do na marrë shumë kohë.
Arbeni uli dosjen në tavolinë me një të shtyrë të lehtë që tërhoqi vëmendjen e të gjithëve.
- Pikërisht për këtë jam zgjuar në orën pesë të mëngjesit, Arjan. - tha ai. - Kam përgatitur një metodologji të re pune. Do ta ndiqni pikë për pikë, pa devijime. Ai hapi dosjen dhe

nisi të shpjegonte, me një ton të ulët, por autoritar. - Nora, ti do të merresh me analizën e terrenit. Dua raport të plotë deri nesër në mëngjes.
- Po profesor. - tha ajo, duke shënuar me shpejtësi.
- Arjan, ti merresh me segmentin eksperimental. Dua rezultatet paraprake deri në darkë.
- Po mundohem… - foli ai ngadalë.
Arbeni ngriti vetullën.
- Nuk dua "do mundohem". S'ka. Dua të përfundohet.
Arjani ngriti sytë dhe u drejtua nga ai. Pas një heshtjeje të vogël tha:
- Po, profesor. Do ta përfundoj. S'e përsëris më fjalën tuaj.
Në fund, Arbeni i pa të gjithë me një qetësi të ftohtë.
- E di që jeni të rinj. E di që jeni ambiciozë. Por unë kam nevojë për punë serioze, të saktë dhe të pakontestueshme. Nëse punojmë si duhet, ky projekt do të na çojë shumë larg. Nëse jo… Nuk ia vlen as të humbasim dy orë të tjera.
Në sallë ra heshtje. Pastaj, Arbeni shtoi me një ton më të butë, që doli nga thellësia e lodhjes së tij:
- Unë do jem këtu gjithë ditën. Çdo pyetje, çdo paqartësi ma sillni direkt. Mos prisni. Mos e lini për më vonë. Sot do të punojmë fort. Sa më fort që të mundemi.
Nora buzëqeshi lehtë.
- Do ia dalim, profesor.
Ai e pa shkurt, pa buzëqeshur.
- Shpresoj.
Pastaj u kthye nga tabela dhe filloi t'u shpjegonte fazën e re të kërkimit. Zëri i tij mbushi sallën, ndërsa ekipi shënonte

çdo fjalë.
Dhe brenda vetes, Arbeni ndjeu se, për herë të parë pas shumë ditësh, gjithçka po merrte formë. Të nesërmen, Arbeni u zgjua herët. Në dritaren e dhomës së tij të vogël në konvikt, qielli kishte ngjyrën e pluhurit të mëngjesit. Ai ndjeu një ngërç të lehtë të qafës, lodhje nga operacioni madhor i një dite më parë. Por sot ishte ndryshe. Sot, mendja e tij punonte më shpejt se trupi.
"Duhet ta filloj sot,- mendoi ai, teksa veshi përseri kostumin e zi dhe mori çantën e punës. - Duhet t'i drejtoj vetë."
Në QSUT "Nënë Tereza", korridoret e gjata e pritën me erën e dezinfektantit dhe zhurmën e karrocave metalike. Si çdo mëngjes, kishte një lloj kaosi të heshtur, që vetëm mjekët e dinin ta lexonin.
- Doktor, - tha Nora, doktoresha e re. - Më dukeni i shqetësuar nuk më dukeni në formë. S'e di si jeni sot? Nëse keni nevojë për pushim ik, se punojmë ne.
Arbeni fërkoi ballin, pastaj u mbështet në karrige.
- A më shqetëson? Më shqetëson fakti që spitali punon me aparate të viteve '80. Më shqetëson stafi i lodhur. Më shqetëson mungesa e protokolleve moderne. Dhe më shqetëson që dikush dje gati vdiq,… vetëm pse jetojmë në një vend ku reforma nuk vijnë kurrë.
Nora uli kokën.
- Keni të drejtë… Por ne jemi këtu. Mund të fillojmë diçka.
Arbeni ngriti sytë drejt saj, këtë herë me pak më shumë butësi.

- Po. Prandaj ju kam mbledhur. Nga sot, ne fillojmë fazën e parë të projektit të ri shkencor. Dua rezultate, jo fjalë.
Ai hapi dosjen e madhe blu mbi tavolinë.
- Nora, ti do të merresh me analizën e rasteve të traumës abdominale. Dua raport të shtjelluar deri nesër.
- U krye, doktor. - tha ajo.
- Arjan, ti merresh me statistikat e ndërhyrjeve të dekadës së fundit në QSUT. Gjej çfarë ka funksionuar dhe çfarë jo.
Arjani u ngurtësua. Nuk foli për momentin, pastaj tha:
- Puna është shumë e madhe… Por do ta bëj.
- Gjeni nuk të kërkova të bëhesh e nuk dua të jesh, - ia ktheu Arbeni me një buzëqeshje të lehtë. - Dua të jesh i saktë…. Kaq bëj.
Ai u ngrit në këmbë dhe hodhi një vështrim drejt dritares së sallës. Jashtë, ambulancat hynin e dilnin pa pushim.
- Ky është spitali ynë. S'është perfekt. As modern. Por është i yni. Dhe unë dua ta çoj përpara, me ju ose pa ju. Nëse punojmë fort, do ia dalim. Nëse jo… ky vend do na hajë të gjallë.
U krijua një heshtje e rëndë. Derisa Nora mori guximin dhe tha:
- Jemi me ju, doktor Arben.
Ai u kthye nga ata, mori frymë thellë dhe e mbylli mbledhjen:
- Mirë atëherë. Fillojmë sot. Pa humbur asnjë minutë.
Dhe ndërsa dilnin nga salla, Arbeni ndjeu një lloj peshe në kraharor, jo nga frika, por nga përgjegjësia.

Dita sapo kishte filluar. Ai sot kishte një operacion jashtëzakonisht të vështirë në zemër, te një pacient i cili nuk kishte mundësi të shkonte jashtë shtetit për arsye vizash dhe mungesë fondesh. Një ndërhyrje e tillë jashtë vendit do t'i kushtonte rreth pesëdhjetë mijë dollarë, prandaj pacienti vendosi ta kryente operimin në spitalin shtetëror.

Në të gjitha bisedat, konsultat dhe diskutimet paraprake, emri i doktor Arben Kodrës ishte përmendur shpesh, derisa u bë i famshëm si kirurgu i vetëm që mund ta realizonte me sukses një operacion kaq të ndërlikuar. Ai ishte shpresa e fundit e pacientit. Pacienti, një burrë rreth të pesëdhjetave, kishte ardhur në spital që një javë më parë. Rrinte i heshtur, i lodhur nga dhimbjet dhe ankthi, por me një shpresë të vetme që e mbante gjallë: Emrin e Arben Kodrës. Familjarët e tij kishin dëgjuar histori të pabesueshme për të, për operacionet ku ai rikthente zemra që të tjerët i kishin hequr dorë i quanin të vdekura, për preçizionin e tij të frikshëm, për duart që punonin me një qetësi të çuditshme.

Disa thoshin se ai operonte si makinë, të tjerët se ishte i çmendur. Por askush nuk e mohonte një gjë: Arbeni ishte më i miri.

Në mëngjes herët, infermierja lajmëroi:

- Doktor, pacienti është gati. Analizat përfundimtare janë miratuar. Presim vetëm ju.

Arbeni qëndroi përpara pasqyrës së sallës së veshjes, duke parë reflektimin e tij: sytë e qetë, por të ngarkuar me diçka të padukshme. Fytyra formale e kirurgut perfekt dhe diku

në prapaskenë një hije e zgjatur që nuk largohesh kurrë.
"Ky është rasti që do të flasin të gjithë… Ose që do të të fundosë," - i pëshpëriti zëri i brendshëm.
Ai mbylli sytë për një çast. Pastaj mori frymë thellë, veshi përparësen kirurgjikale dhe u nis drejt sallës së operacionit, duke e ditur se këtë herë nuk do të luftonte vetëm kundër sëmundjes së pacientit, por edhe kundër hijeve që i ngatërronin mendjen gjithnjë e më shumë.
Kur hyri në sallën e operacionit, ekipi u ngrit menjëherë në këmbë, pothuajse në mënyrë instinktive, sikur prania e tij të kishte një peshë të padukshme, por të pakundërshtueshme. Lëvizjet ndalën për një çast, zhurmat u shuan, dhe vëmendja u përqendrua vetëm tek ai. Nuk ishte frikë ajo që i ngriti në këmbë, por respekti dhe besimi që kishte ndërtuar pa fjalë, por me vepra. Të gjithë e dinin se sot ishte një ditë kritike. Jo një ndërhyrje e zakonshme, jo një rutinë spitalore që harrohej sapo mbyllej dosja. Ishte një nga ato operacione që mbartin peshën e fatit ku çdo vendim, çdo sekondë dhe çdo lëvizje e dorës mund të bëhej histori, për mirë ose për keq.
Monitorët ndiznin dritat e tyre të ftohta, instrumentet kirurgjikale shkëlqenin nën ndriçimin e fortë dhe ajri ishte i mbushur me një tension të pastër, profesional. Secili anëtar i ekipit e ndiente se nuk ishte thjesht një ditë pune, por një provë, një kufi mes asaj që dinin dhe asaj që do t'u kërkohej të jepnin.
Në atë sallë, përpara një trupi të shtrirë dhe një jete që varej nga duart e tyre. U bë e qartë se sot nuk kishte vend

për gabime, justifikime apo frikë. Vetëm për përqendrim absolut dhe për guxim.
Narkozisti Iliri kontrollonte parametrat, ndihmësja Dora përgatiste veglat, ndërsa Dr. Rinjasi lexonte kartelën e pacientit për herë të fundit. Por sapo Arbeni u afrua, një heshtje e pazakontë mbuloi gjithë sallën. Sikur të gjithë prisnin që ai t'i udhëhiqte dhe njëkohësisht frikësoheshin nga mënyra se si ai punonte.
Pacienti u soll në tavolinë. Lëkura e tij ishte e zbehtë, frymëmarrja e dobësuar. Kur e panë, Arbeni pa se sytë e tij kërkonin diçka,… ndoshta siguri.
- Doktor… - pëshpëriti pacienti para se t'i vendosnin maskën e anestezisë. - Ju… vetëm ju,… mund të ma shpëtoni jetën…
Arbeni nuk foli. U afrua dhe vendosi dorën mbi supin e tij, një gjest që askush s'e kishte parë më parë nga ai. Ishte e vetmja shenjë njerëzore që i kishte mbetur mes gjithë paranojave.
Por menjëherë pas këtij momenti, një hije e zezë u duk në qoshen e majtë të sallës, e gjatë, e heshtur, sikur vështronte me ankth operacionin që do të fillonte. Vetëm Arbeni e pa. Askush tjetër nuk e vuri re. Zëri i brendshëm filloi të fliste qartë, si një mik i vjetër:
"Nëse gabon, do të humbasësh gjithçka. Ata mezi presin që ti të gabosh. Ata duan të të shembin."
Arbeni shtrëngoi nofullën. Mori bisturinë dhe e vendosi sipër lëkurës së pacientit.

- Fillojmë. Kontaktoni bypass-in. Përgatitni retraktorët. Askush nuk do flas pa urdhrin tim.
Dora u drodh. Iliri uli kokën. Rinjasi mbeti pa frymë nga autoriteti i ftohtë i Arbenit.
Drita e bardhë ndriçonte ashpër mbi tavolinën e operacionit. Hija e zezë, megjithëse pa trup, dukej sikur afrohej gjithnjë e më shumë.
Dhe Arbeni e dinte se këtë herë… Nuk ishte vetëm ai që luftonte për jetën e pacientit. Ishte ai kundër gjithë botës.
Dhe kundër hijeve që po i shtoheshin brenda.
"Nëse gabon, do të humbasësh gjithçka. Ata mezi presin. Ata duan të të shembin." Lëvizjet e stafit u pezulluan për një çast, zhurmat u shuan dhe sytë u kthyen drejt tij, sikur prania e Arbenit të vendoste menjëherë rendin dhe qartësinë për të gjitha gjërat
Të gjithë e ndienin se kjo nuk ishte një ditë si të tjerat. Ishte një ditë kufiri, një nga ato ndërhyrje ku fati vendoset mbi tehun e një sekonde. Një operacion që mund të mbetej gjatë në kujtesë, ose si shembull suksesi, ose si barrë që nuk harrohet kurrë.
Monitorët pulsonin me ritëm të ftohtë, instrumentet shkëlqenin nën dritat e forta dhe ajri mbante një tension të dendur, pothuajse të prekshëm. Secili në ekip e kuptonte se sot nuk mjaftonte vetëm dijenia; kërkohej përqendrim absolut, disiplinë dhe guxim i heshtur. Në atë sallë, përballë një jete të varur nga duart e tyre, u bë e qartë se nuk kishte vend për hezitim. Vetëm për vendime të sakta dhe për përgjegjësi.

Drita e bardhë ndriçonte ashpër mbi tavolinën e operacionit. Hija e zezë, megjithëse pa trup, dukej sikur afrohej gjithnjë e më shumë. Arbeni e dinte që po gaboi ishte fundi, por "s'do të gaboj, - tha më vete ai, - do të qëndroj i fortë kundër të gjithëve."

Në fakt ishte e vërtetë. Ishte ai kundër gjithë botës. Dhe kundër hijeve që po i shtoheshin brenda. Para se të hynte në sallë, Arbeni u ndal në dhomën e sterilizimit. Uji i nxehtë i rridhte mbi duar, por ai nuk e ndiente më. Shikimi i kishte mbetur i ngulur në një pikë të vogël në mur. Një pikë e errët që lëvizte lehtë, sikur të ishte një sy që e vëzhgonte.

Ai mbylli dhe hapi sytë disa herë, ngadalë, me shpresën se gjithçka do të zhdukej si një iluzion i lodhjes. Por pika ishte ende aty. E palëvizshme. Një njollë e padukshme për të tjerët, por e mprehtë për të, si një shenjë paralajmëruese që nuk pranonte të fshihej.

"Po të shikojnë, Arben. Jo vetëm kolegët. Edhe ata që s'i sheh njeri."

Zëri brenda tij nuk ishte më thjesht një mendim i shpërndarë. Kishte marrë formë, ton, madje edhe autoritetin e dikujt që e kishte shoqëruar prej vitesh, një dëshmitar i heshtur i dyshimeve, frikërave dhe fitoreve të tij. Ishte zëri i përvojës së dhimbshme, i presionit të grumbulluar, i një sistemi që rrallë falte.

"Mjaft!" - pëshpëriti Arbeni me zë të ulët, duke fshirë duart me pecetë sterile, sikur të donte të pastronte jo vetëm gjakun, por edhe mendimet që po i turbulloheshin. Por

zëri nuk u tërhoq, përkundrazi, u bë më këmbëngulës, më i ftohtë: "Pacienti është vetëm një provë. Të kanë kurdisur. Duan të shohin si gabon, si rrëshqet për një çast, si bëhesh shembull. Jo për ta shpëtuar jetën, por për të vërtetuar frikën e tyre."

Arbeni mori frymë thellë. Për një moment, salla u duk sikur u ngushtua rreth tij. Dritat i rëndonin mbi sy, monitorët rrihnin më fort se zakonisht dhe çdo zhurmë e vogël merrte peshë të tepruar. Megjithatë, pas atij çasti të brishtë, ai e ndjeu sërish qendrën e vet.

Duart iu ndalën së dridhuri. Shikimi iu kthjellua. Ai e dinte: Në këtë betejë, frika ishte armiku i vetëm, që nuk duhej lejuar të fitonte.

Ai ngriti kokën vrullshëm dhe pa veten në pasqyrë. Sytë i dukeshin më të lodhur, më të thellë. Edhe më të errët. Në reflektim, pas shpatullave të tij, u duk qartë për një çast figura e një hijeje nga lartë, pothuaj njerëzore, e cila lëvizte ngadalë si të merrte frymë.

Arbeni u kthye me shpejtësi, sikur dikush ta kishte thirrur në emër. Zemra i rrahu fort për një çast të shkurtër, ndërsa sytë përshkuan hapësirën përreth me një ankth të përmbajtur.

Askush.

Vetëm një raft metalik në cep të dhomës, i mbushur me doreza sterile, të rreshtuara me një rregull të ftohtë, gati klinik. Drita e zbehtë reflektohej mbi to, duke i bërë të dukeshin më shumë si dëshmitarë të heshtur sesa si mjete

pune. Heshtja u rëndua edhe më shumë dhe Arbeni e kuptoi se ajo që e kishte shtyrë të kthehej nuk vinte nga jashtë, por nga një zë i brendshëm që nuk po e linte rehat.
Ai u përkul për të marrë kapuçin kirurgjikal, por duart i dridheshin lehtë, pothuajse të padukshme për syrin e tjetrit, por jo për të vetin, jo nga frika e operacionit. Zemra njerëzore ishte një territor i njohur për të, një hartë që e kishte lexuar qindra herë nën dritat e forta të sallës. Ajo që e trembte ishte zemra e tij. Ritmi i saj i çrregullt. Ajo rrahje e paarsyeshme që shpërthente sa herë hijet dukeshin se lëviznin në qoshet e shikimit, sikur dhoma të kishte sy të padukshëm. Nuk ishte imagjinatë, i thoshte vetes, por trupi nuk e dëgjonte arsyen.
U drejtua ngadalë dhe mori frymë gjatë, thellë, si për të bindur mushkëritë dhe gjakun të ktheheshin në disiplinë. Për një çast, gjithçka u ndal. Por ai e dinte: Qetësia ishte vetëm një pushim i shkurtër, jo një shpëtim.
Në korridor dëgjoheshin hapat e stafit, që shushurinin duke vrapuar, rrotat e barelave që kalonin. Një botë e tërë e zhurmshme jashtë, ndërsa brenda tij sundonte një heshtje e ftohtë.
Dr. Arbeni bëri qepjen e fundit me një lëvizje të saktë, thuajse ceremoniale. Monitorët ruanin një ritëm të qëndrueshëm, një gjuhë e qartë që ai e kuptonte më mirë se fjalët. Gjithçka ishte aty ku duhej të ishte. Zemra përballë tij rrihte e qetë, e bindur.
Ai u ndal për një çast, vështroi fushën kirurgjikale dhe hoqi

dorezat me kujdes, sikur të mos donte të prishte ekuilibrin e arritur. Një operacion i pastër. I suksesshëm. Asnjë gabim.
- Mbylleni, - tha me zë të ulët, por të prerë.
Ndërsa infermierët nisën proçedurat e fundit, Arbeni u tërhoq një hap prapa. Për herë të parë atë natë, zemra e tij iu përgjigj heshtjes me një rrahje të rregullt. Jo sepse frika ishte zhdukur, por sepse, edhe këtë herë, ai kishte fituar mbi të. Operacioni po ecte drejt fundit. Zemra në monitor rrihte e qëndrueshme, pa devijime, pa alarm. Vijat e gjelbra vazhdonin marshimin e tyre të rregullt, si një provë e padiskutueshme, se dora e Arbenit kishte qenë më e saktë se zërat.
Ai bëri qepjen e fundit dhe ndaloi për një çast.
- Ritmi është perfekt, - tha infermierja, duke hedhur një sy nga monitori.
- Po, - u përgjigj Arbeni shkurt. - Ta mbyllim.
Ndërsa instrumentet filluan të hiqeshin një nga një, hijet që kishin qëndruar në qoshet e sallës u trashën. Nuk ishin më vetëm errësirë. Morën konture njerëzore. Profesorë. Kolegë të vjetër. Ata që kishin pritur një gabim të vogël, një çarje në dorë, një moment pasigurie. - E pati fatin sot, - pëshpëriti njëri prej tyre, pa e ngritur zërin.
- Jo, - iu përgjigj tjetri me buzë të shtrënguara. - E kishte përgatitur. Më mirë se ç'prisja.
Fjalët e tyre rrëshqitën në ajër si gjilpëra të vogla, por nuk e prekën më. Arbeni hoqi dorezat ngadalë, me një qetësi që nuk ishte krenari, por kontroll. Suksesi i tij nuk kishte nevojë për duartrokitje.

- Pacienti stabil. Mund të transferohet, - tha ai, me zë të qartë.
Dr. Arbeni pa edhe një herë veglat e punës. Të vjetra, të mjeruara, të konsumuara nga duar të gabuara. Nuk ishin vetëm mjete metalike, ishin dëshmi të një neglizhence të gjatë. Dikur kishin qenë precize, të besueshme. Tani mbanin mbi vete shenjat e pakujdesisë dhe të një sistemi që i kishte lënë në harresë. Në mendjen e tij, ato vegla nuk ishin fajtore. Ishin thjesht pasojë. Pasojë e njerëzve që nuk dinin ku të ankoheshin për abuzimet e pronarëve të tyre, të shtypur dhe të heshtur, të shndërruar në mjeranë, nga një hierarki që i përdorte dhe i hidhte tutje kur nuk shërbenin më.
Ai u ul dhe bëri një inventar të dytë, këtë herë jo mbi letër, por në mendje. Çdo bisturi, çdo pincë, çdo instrument u kalua nëpër kujtesën e tij me saktësi kirurgjikale. Vendosi t'i riparonte të gjitha. Jo vetëm për operacionet që do të vinin, por si një akt i vogël kundërshtimi ndaj rrëmujës dhe dorëzimit.
Në atë qetësi pas operacionit, mes erës së antiseptikut dhe metalit të ftohtë, Arbeni ndjeu se rregullimi i veglave ishte një mënyrë për të rregulluar diçka edhe brenda vetes. Nuk mund ta ndreqte systemin, por mund të ndreqte mjetet. Dhe për të, kjo mjaftonte, për momentin. Duke i rishikuar.
A bëjnë më për operacione apo jo?
Ai thirri ndihmësen, infermieren.
- Dua një rreshtim të të gjitha veglave që përdorim në

operacion çdo ditë, - tha ai.
Ajo filloi t'i shfletojë dhe të numërojë me kujdes, një nga një, duke u siguruar që asnjë të mos mungonte.

VEGLAT

Mbi tavolinën e instrumenteve ndodhen të rreshtuara si ushtarë: bisturia nr. 10 dhe nr. 15 për prejen e parë; klamerët vaskularë DeBakey; retraktorët sternalë; finochietto, të mëdhenj, të rëndë, të ftohtë; gërshërët Metzenbaum të harkuara; pinzeta Kocher dhe Adson; klamerët hemostatikë Kelly dhe Halstead; tubat e aspirimit Yankauer; makina e bypass-it kardiopulmonar, një kullë e madhe me zhurmë të lehtë motori; monitori 3D i navigimit kirurgjik, kompjuteri që Arbeni e përdor me obsesion.
Ndihmësja e re, Dora, një vajzë rreth të tridhjetave, i prek instrumentet me kujdes. Ajo hedh një sy tek Arbeni me ndrojtje: E kanë paralajmëruar se është gjeni, por dhe i çuditshëm. Ai e rindërtoi operacionin në mendjen e tij nga fillimi. Çdo hap, çdo prerje, çdo lëvizje e bisturisë u rikrijua me kujdes të jashtëzakonshëm. Duhej të dinte saktësisht si të vepronte dhe ku mund të përmirësohej. Asgjë nuk mund të lihej rastësisht; çdo detaj, çdo vegël, çdo lëvizje duhej të ishte e kontrolluar, e parashikueshme. Në mendjen e tij, operacioni ishte tashmë i kryer, por përsëri, kishte ende vend për përmirësime.
Fillimi i operacionit
Narkozisti, Dr. Iliri, i hodhi një vështrim të fundit monitorit

dhe foli me zë të qetë, pothuaj mekanik:
- Parametrat janë stabilë. Pacienti ndodhet në 1.8 MAC. Mund të filloni kur të dëshironi, doktor Kodra.
Arbeni afrohet me një hap të matur. Dora e tij e djathtë u shtri drejt bisturisë, por përpara se ta prekte metalin e ftohtë, një zë i njohur, i padukshëm, i ngjiti mendjes si një jehonë e vjetër që nuk vdes kurrë.
Mos i beso narkozistit…E ka ndryshuar dozën qëllimisht… Kontrolloje vetë.
Ai ndaloi. Bëri një hap mbrapa. Për një çast, trupi iu drodh lehtë, sikur nervat të kishin marrë një urdhër të kundërt nga vullneti. Duart i dridheshin, por jo aq sa të humbnin kontrollin. Ishte dridhja e një njeriu që e di se po hyn në territor ku gabimi nuk falet.
Me një përqendrim të sforcuar, Arbeni e ktheu vështrimin nga monitori. Pulsi: i rregullt. Saturimi: I qëndrueshëm. Presioni: Brenda normës. Gjithçka ishte perfekte. Tepër perfekte.
Mori frymë thellë. Ajri i ftohtë i sallës së operacionit i pastroi mendjen për një sekondë të vetme.
- Fillojmë, - tha më në fund.
Zëri i tij ra në heshtjen sterile të sallës dhe u ngulit në të me prerje të saktë, si një urdhër që nuk kthehet më pas.
E pastaj tha: Dora. Duhet bisturia numër dhjetë.
Infermierja ia zgjati mjetin me kujdes ritual. Metali i ftohtë preku pëllëmbën e tij dhe në atë çast, koha sikur u ndal. Salla e operacionit, dritat e forta, monitorët që pulsonin,

instrumentet e rreshtuara me disiplinë ushtarake. Gjithçka ishte gati.

- Nuk ka vend për dyshim, - i tha vetes, duke i hapur sytë nga kujtesa, por brenda tij, beteja e vërtetë sapo kishte filluar. Çdo lëvizje duhej të ishte më e saktë se zëri i brendshëm që nuk pushonte së akuzuari. Çdo prerje, një provë besimi — Jo vetëm ndaj kolegëve, por ndaj vetvetes.

- Po, doktor, - tha Dora me zë të ulët, ndërsa ia lëshonte bisturinë.

Sytë e saj, megjithatë, nuk u shkëputën nga fytyra e Arbenit. Ajo pa diçka që nuk ishte në protokoll: Një hije të padukshme që i lëvizi për një çast pas shpatullës së tij të djathtë, si një parandjenjë që kalon pa u thënë.

Operacioni kishte filluar.

Prerja.

Një vijë e kthjellët e gjatë në sternum. Arbeni e bën me një precizion obsesiv, pothuaj matematik. Ai nuk lë asnjë devijim, sikur një algoritëm të drejtonte dorën.

- Retraktorët, - urdhëroi ai.

Metali i rëndë futet në pjesën e hapur dhe kraharori përhapet me një kërcitje të heshtur. Një aromë e lehtë gjaku përhapet në ajrin steril.

Ndihmësi i dytë, Dr. Rinjasi, mbetet i habitur:

- Doktor,… qepjet anësore janë,… perfekte. S'kam parë ndonjëherë të jenë kaq të pastra.

Arbeni nuk përgjigjet. Sytë i ka ngulur në trupin e ekspozuar. Pastaj drejtohet tek kompjuteri, për të parë të gjitha të dhënat e tij.

Navigimi me Kompjuter
Monitori 3D ndriçohet me ngjyrë blu. Zemra shfaqet si një hologram që rrotullohet ngadalë.
- Kjo është diagnoza e pacientit: Defekt septal ventrikular i komplikuar me stenozë të arteries descendente anteriore,
- thotë Rinjasi.
- Unë e kam parë tashmë, - përgjigjet Arbeni ftohtë.
- Kompjuteri jep modelin e saktë. Do të përdorim bypass total për 27 minuta. Jo më shumë. Dora, paralajmëro perfuzionistin.
Dora nxiton, paksa e trembur nga mënyra autoritare e tij.

Z E M R A
Zemra del në fushën e operacionit si një objekt i kuq që lëviz ritmikisht. Arbeni e shikon sikur të ishte një libër i hapur. Zëri i brendshëm përsërit: "Kujdes… Rinjasi të vëzhgon… Ai pret gabimin tënd… Ai shtrëngon nofullën, merr frymë thellë dhe fillon."
- Klamer arterial. Bypass. Fillojmë arrestin kardiak.
Makineria e bypass-it lëshon një zhurmë të ulët "vum-vum-vum". Zemra ngadalëson, pastaj ndalon plotësisht. Një qetësi e ftohtë mbush sallën.
Arbeni bën një insizion të vogël në septum.
- Gërshërët Metzenbaum.
- Ja, doktor.
Dora ia jep. Ai fut instrumentin me një delikatesë që të bën të harrosh egërsinë e çarjes së sternumit.

- Aspiratorin, - thotë në një ton që s'toleron vonesë.
Gjaku thithet menjëherë dhe fusha pastrohet. Dr. Rinjasi tund kokën:
- Kjo është jashtëzakonisht e saktë… Po hapni zonën e defektit pa prekur asnjë strukturë anësore…
Arbeni nuk e dëgjon. Ai dëgjon vetëm zërin:
"Ata po të spiunojnë, po studiojnë teknikat e tua që t'i marrin…" Ai fut një patch sintetik për mbylljen e defektit, vendos qepje tepër të imta, perfekte, simetrike. Si një rikujtim i momentit të operacionit. Dora vështronte duart e tij dhe pështpëriti, pothuajse me admirim: "Ato janë të sakta."
- Sikur të ishin makinë… Aq të sakta dhe të shpejta.
- Jo s'jam makinë, - iu përgjigj Arbeni pa e kthyer kokën. - Njeriu thjesht duhet të mos lejojë askënd t'i prishë qetësinë, që të punojë saktë.
Fjalët i dolën me nerv, si një sulm i fshehtë, një mburojë që e mbronte nga dyshimet dhe presionet e jashtme. Në atë çast, duart e tij nuk ishin thjesht mjete pune. Ato ishin zëri i disiplinës dhe kontrollit që mbante çdo hap të operacionit nën urdhër.
Ripërtëritja e Zemrës. Hiqni klamerët. Rifillojmë ritmin.
Narkozisti shton pak adrenalinë. Makina e bypass-it ngadalësohet.
Zemra fillon të dridhet,… pastaj rreh. Të gjithë marrin frymë.
- Operacion i mrekullueshëm, doktor, - thotë Rinjasi.

Arbeni ngrin. Zëri i brendshëm i tha: "Mos e beso. Të tall. Ai do të raportojë diçka."
Ai i afrohet Rinjësit dhe i thotë me një qetësi të frikshme:
- Nuk dua komente. Vetëm punë. Vetëm heshtje.
Ashtu u bë. Salla mbetet në heshtje të plotë, vetëm me zhurmën ritmike të monitorëve.
Ai qep sternumin, vendos drenat, kontrollon gjithçka dy herë, pastaj tri herë. Obsesioni i tij e shndërron mbylljen në një ritual.
Kur largohet nga salla, Dora i thotë narkozistit me zë të ulët:
- A e patë si fliste me hijet? Kur s'e shihnim ne…
- Po, - i ia kthen Iliri, - por askush nuk operon zemrën si ai. Edhe nëse ecën mes hijeve… Ai e bën magjinë e tij.
Arbeni doli nga salla e operacionit me hap të ngurtë. Në korridorin e gjatë, drita e bardhë spitalore duket më e ftohtë se zakonisht, sikur të ishte një tunel pa fund.
Ai ndalon, vendos duart në xhepa dhe mbyll sytë për një sekondë.
Zëri i brendshëm vjen menjëherë: "Ata të panë. E panë mënyrën si e mbylle defektin. Do ta kopjojnë teknikën tënde. Kjo s'duhet të ndodhë."
Ai hap sytë me vrull, kthen kokën djathtas dhe për një çast sheh një hije të gjatë që lëviz pas qoshes. Zemra i rreh fort, më e fortë se zemra që sapo rregulloi.
- Kush? Kush është atje? - pëshpëriti.

Nuk përgjigjet askush. Vetëm shkëlqimi i dyshemesë së spitalit.

Në kujtesën e tij, Arbeni rindërtoi çdo moment të operacionit. Çdo prerje, çdo lëvizje e bisturisë, çdo qepje, nuk gjeti asnjë gabim. Çdo gjë kishte shkuar sipas planit, më mirë se sa mund të kishte imagjinuar, por hijet brenda tij nuk pushonin. Për një çast i dukeshin si duar të padukshme që përpiqeshin ta bindnin të dyshonte: "A e ke bërë si duhet? A nuk ke harruar diçka?"

Ai i hodhi pas këto mendime, duke u fokusuar te realiteti: Pacienti po shfaqte shenja të qëndrueshme. Zemra rrihte e qetë, parametrat ishin të stabilizuar. Operacioni kishte përfunduar me sukses.

- Pacienti doli mirë, - tha Arbeni, duke nxjerrë një frymë të gjatë.

Duart e tij, të lëmuara nga përqendrimi dhe lodhja, u ngritën në një lëvizje të vogël mirënjohjeje dhe vetëdijes. Në sallë u dëgjua heshtja e ekuilibruar dhe pastaj duartrokitje të heshtura. Respekt dhe vlerësim i fshehtë nga ata që e kuptonin madhështinë e çdo veprimi të tij. Hijet brenda tij u tërhoqën paksa, pa u zhdukur, por më të heshtura. Ishin dëshmitarë, jo pengesa.

Arbeni buzëqeshi lehtë. Për një moment, qetësia kishte fituar mbi dyshimin

Paranoja e parë: Dosja sekrete

Arbeni ecën drejt dhomës së stafit, hapat e tij të ngadaltë duke tingëlluar më shumë në mendjen e tij sesa në dysheme. Kur hyn, sheh dy kolegë të përqendruar mbi një

dosje. I afrohet ngadalë. Çdo lëvizje e tij ishte e matur, sikur të matë reagimet e tyre sekondë pas sekonde.
- Ç'po shihni? - pyet me një ton të ftohtë, pak kërcënues, që ia lëshon rrugën paranojës së tij.
- Uu… , asgjë, doktor…, vetëm protokollin e sotëm… - thotë njëri prej tyre, i hutuar, duke u përpjekur të fshehë diçka që ndoshta as ata vetë nuk e kuptonin.
Zëri i brendshëm i Arbenit pëshpërit, i ftohtë dhe i prerë:
- Mos e besoni askënd.,… çdo dokument mund të jetë një kurth. Çdo shenjë, çdo heshtje, mund t'ju tregojë më shumë se sa duan ata që të shihni.
Ai shikon dosjen dhe pastaj kolegët, duke ndjerë një dridhje të hollë në duar. Çdo veprim duket i dyshimtë, çdo heshtje ngjall pyetje. Por ai e di: Duhet të qëndrojë i qetë, për të zbuluar të fshehtën pa humbur kontrollin. "Gënjeshtarë. Po hetojnë operacionin tënd. Po mbledhin prova." Ai afrohet aq shumë sa kolegu mbrapa shtyhet paksa.
- Më jepni dosjen. Dua ta shoh.
- Po…, po, sigurisht… - ia zgjatin ata me duar të dridhura.
Arbeni e hap vrullshëm. Faqet janë bosh, vetëm formularë standardë: emër pacienti, data, diagnoza. Asgjë sekret. Ai i përplas faqet pa zhurmë. Ata të trembur largohen pa e parë asnjë sekondë në sy. Ikën jashtë dhe nuk i dolën më doktorit përpara.
Paranoja e dytë: Kamera që lëviz vetë
Kur futet në dhomën e veshjes, ai ndjen një të ftohtë të çuditshëm në qafë. Ngrihet drejt e lart dhe sheh kamerën e sigurisë në tavan.

Ajo lëviz paksa majtas, sikur të ndiqte pikërisht atë.
"Jo… jo, s'është normale. Nuk lëviz kurrë kaq ngadalë…" - murmurit ai më vete.
Zëri i brendshëm: "Të survejojnë. Duan të dinë ç'ke në mendje. Po pret një gabim tëndin."
Ai afrohet drejt kamerës, si i marrë, dhe ngre gishtin:
- Hej! Kushdo që po më ndjek, e di ç'po bëni. Nuk më kapni dot. Nuk kopjoni dot duart e mia!
Salla hesht. Vetëm një pikë uji nga klima bie mbi pllakat e bardha.
Paranoja e tretë: Hija që i flet.
Merr rrobat civile dhe afrohet te dollapi i tij. Kur e hap, ndjen sikur dikush qëndron mbrapa tij. I duket sikur dëgjon frymën e dikujt, shumë e lehtë.
Ai kthen kokën me shpejtësi.
Asgjë. Nuk kishte vetëm ambjenti i spitalit bosh. Por pastaj, te këndi i dhomës, aty ku drita nuk mbërrin plotësisht, shfaqet një hije njerëzore, e paqartë. Qëndron e ngrirë, si të priste urdhër.
- Kush je? - i thotë Arbeni me zë të ulët, pa guxuar të lëvizë.
Hija nuk përgjigjet. Vetëm lëkundet paksa, sikur të merrte frymë. Zëri i brendshëm fillon të flasë, jo si mendim, por si dikush tjetër: "Ata duan të ta marrin gjithçka. Emrin. Duart. Të vërtetën. Por unë jam këtu. Vetëm unë të mbroj. Mos i beso askujt tjetër."
Zëri nuk ishte më një pëshpëritje. Ishte bërë i ngjeshur, i sigurt, autoritar. Si një mjek tjetër brenda tij, më i ftohtë, më i pamëshirshëm.

Arbeni u mbështet te maja e dollapit metalik. Gishtat iu shtrënguan fort, gati sa nuk u çanë nga presioni. Gjunjët iu dobësuan për një çast dhe trupi i kërkoi për t'u dorëzuar. Shtrëngimi vazhdoi. Derisa i rrëshqiti ngadalë përgjatë qafës, i ftohtë, si një gjarpër paralajmërues.
Ai mbylli sytë për një sekondë. Jo për t'u qetësuar, por për të mbijetuar.
Paranoja e katërt: Komploti i stafit.
Kur doli nga dhoma, korridori i gjatë i spitalit iu duk më i ngushtë se zakonisht, sikur muret ishin afruar për ta dëgjuar. Në fund të tij, Dora dhe Rinjasi qëndronin pranë një dritareje, duke folur me zë të ulët.
Arbeni pa buzët e tyre që lëviznin. Pa shikimet e shpejta pas shpatullave. Pa ndalesat e vogla, sikur fjalët të priteshin me thikë.
Zëri i brendshëm shpërtheu:"Po flasin për ty. Po e planifikojnë. Duan të të nxjerrin të çmendur.
Të të heqin nga kirurgjia. Të të zhdukin pa lënë gjurmë."
Hapat e Arbenit u përshpejtuan. Zhurma e këpucëve të tij mbi dyshemenë sterile ishte e thatë, kërcënuese.
- Çfarë po diskutoni? - pyeti me një ton të ftohtë, pa asnjë përshëndetje.
Dora u shtang. Fytyra i humbi ngjyrë.
- Asgjë, doktor… Po flisnim për orarin e turnit… - tha, por zëri i saj u thye në fund.
- Për mua po flisnit? - shpërtheu Arbeni.
Zëri i tij përplasi korridorin si një alarm.

Rinjasi hapi sytë, i hutuar.
- Doktor! Kurrsesi! Ishte vetëm një diskutim rutinë, ju betohem.
Por Arbeni nuk dëgjonte më fjalë. Fjalët ishin bërë të kota. Ai pa përtej tyre. Pas shpinave të Dorës dhe Rinjësit, qëndronte hija. Më e gjatë se herët e tjera. Më e errët. E palëvizshme. Nuk kishte fytyrë, por kishte peshë. Një siluetë që nuk kërkonte dritë për t'u parë, vetëm frikë. Askush tjetër nuk e vuri re. Vetëm ai. Një prani që nuk kishte nevojë për sy për t'u parë, sepse qëndronte mbi supet e tij, brenda frymëmarrjes së tij. Zëri u kthye përsëri, i qetë tani: "E sheh? Unë të paralajmërova."
Paranoja e pestë: Dosja që zhduket vetë.
(dhe këtu fillon rrëshqitja e pakthyeshme…)
Ai hyn në zyrën e tij për të marrë një dosje pacienti. Zgjat dorën te tavolina,… por dosja nuk është aty. Një boshllëk i papritur që e paralizon për një çast.
"Jo… Jo…!" - pëshpërit, zëri i tij i ulët duke u humbur në ajrin e ngushtë të zyrës.
Ai kontrollon sirtarët një nga një, por gjithçka është bosh. Zemra i rreh më shpejt, çdo instinkt i thotë se nuk është thjesht harrim.
Pastaj zëri i brendshëm flet, i prerë dhe i ftohtë, duke i rrëmbyer çdo dyshim: "E morën. Tani e kanë. E dinë sekretin tënd. Një dridhje e lehtë i përshkon duart. Ai e di që kjo nuk është thjesht një humbje materiali. Është një paralajmërim. Çdo vend që mendon se është i sigurt

mund të jetë një kurth. Hijet rreth tij nuk janë më vetëm pasqyrime të frikës, por dëshmitare të veprimeve që nuk mund t'i parashikojë dot."

Arbeni kap kokën me duar. E ndjen sikur spitali i bardhë është mbushur me sy të padukshëm, që e ndjekin nga çdo qoshe.

Një spital i bardhë. Me hije të zeza që po afrohen gjithnjë e më shumë.

Doktor Arbeni u qetësua më në fund, pasi kreu me sukses operacionin e parë të tij si shef i kardiologjisë. Ai doli ngadalë nëpër katet e spitalit kardiologjik të gjashtëkatëshit, në qendrën spitalore "Nënë Tereza". Diku në fund të korridorit, sekretarja e ish-shefit e priti dhe i dorëzoi çelësat e zyrës së re. Arbeni i mori me dorë të sigurt, buzëqeshi lehtë dhe u nis drejt zyrës. Ndërsa në mendje i shpërthenin kujtimet që nuk e kishin lënë kurrë rehat.

Traumat e hershme… Braktisja nga babai i tij i papërgjegjshëm, i cili kurrë nuk interesohej për të. Nëna, një grua e thjeshtë fshati, pa shkollë, që nuk guxonte t'i kundërvihej sjelljeve arbitrare e të dhunshme të burrit. Ajo e shkreta bënte aq sa mundej, sepse babai nuk punonte dhe çdo ditë sillte probleme. "Ka bërë mjaft ajo," mendonte shpesh doktor Arbeni në heshtje.

Ai u detyrua ta bënte shkollën tetëvjeçare duke jetuar në konviktin e qytetit të Librazhdit. Aty u torturua dhe u abuzua, jo vetëm nga djemtë më të mëdhenj e të fortë, por edhe nga disa drejtues, sepse Arbeni vinte nga një

familje me "biografi të keqe". Për këtë arsye, sapo mbaroi tetëvjeçaren, e përjashtuan nga konvikti. Të mesmen e bëri duke ecur çdo ditë me këmbë nga fshati i tij i thellë malor Gurakuq, deri në qytet. Rruga i merrte rreth dy orë për të shkuar dhe më shumë se tre për t'u kthyer. Në dimër ecte në shi, në baltë, në acarin e pyllit. Çdo ditë ndeshej me babain e tij dembel dhe të dhunshëm, që nuk kursente fyerjet. Shpesh, Arbeni qante vetëm përgjatë shtigjeve të pyllit, duke mbajtur hallet brenda vetes, pa pasur me kë të fliste.

Megjithatë, ai nuk u dorëzua. Në çdo hap që bënte drejt qytetit, edhe pse këmbët i dhembnin dhe duart i ngrinin nga acari. Një zë brenda vetes i thoshte: "Mos u ndal. Mos u përkul." Shpesh ndalonte buzë lumit dhe shikonte ujin që rridhte me vrull. I dukej se ai lumë ishte jeta e tij: E ashpër, e turbullt, por gjithmonë duke vazhduar përpara. Në shkollën e mesme, ndonëse shumë shokë e tallnin ose e shikonin me mëshirë. Arbeni nuk u shpërqendrua asnjëherë. Zgjidhte bankën e fundit, vendoste librat para vetes dhe humbiste në leksione. I pëlqenin biologjia dhe kimia. I pëlqente mënyra si funksionon te zemra, si rrihte, si tundej në gjoksin e njeriut si një farkëtar i lodhur që s'mund të ndalet.

Ai e dinte që fati i tij ishte i lidhur pikërisht me këto ushtri të vogla qelizash që luftonin brenda trupit të njeriut.

Në shtëpi ishte ferr. Babai kthehej çdo natë i dehur, i dhunshëm. Ndonjëherë i fliste Arbenit me përçmim: "Ti s'ke për t'u bërë kurrë njeri!"

Nëna rrinte në qoshe, me duar të çara nga puna dhe sy të lodhur që mbusheshin me lot, por nuk guxonte të hapej. E vetmja gjë që bënte ishte t'i linte një copë bukë të ngrohtë djalit të saj, kur ai kthehej në darkë nga shkolla.

Dhe kështu, ditë pas dite, vit pas viti, Arbeni u ngjit me mund në majën që ëndërronte. Në maturë doli i pari në rreth — Një goditje e fortë kundër gjithë paragjykimeve, Një shuplakë e heshtur mbi të gjitha fyerjet, abuzimet dhe padrejtësitë që e kishin ndjekur. Më pas erdhi dega e mjekësisë. Filloi një jetë e re në qytetin e madh, por as aty s'kishte askënd. Jetoi në një dhomë të vogël studenti, që shpesh ngjante më shumë me një magazinë sesa me dhomë. Punonte gjatë netëve në një furrë buke, ndërsa ditën ndiqte leksionet me përkushtim të verbër. Flinte pak, hante pak, por mësonte shumë.

Në një moment, gjatë vitit të tretë, një profesor i njohur i fakultetit e vuri re. E thirri pas leksionit dhe i tha: Ti ke diçka që të tjerët nuk e kanë. Ke luftuar më shumë se çdokush për të ardhur deri këtu. Këta libra nuk t'i mëson mendja, por jeta. Vazhdoni, Arben. Ti do bëhesh mjek i madh.

Ato fjalë i ngulur thellë në zemër i dhanë krahë.

Vitet kaluan dhe me mundim të jashtëzakonshëm. Ai fitoi specializimin në kardiologji. Punoi në sallë operacioni gjatë, hekur, i palodhur. Mjekët e mëdhenj nisën ta respektonin, pacientët nisën ta donin. Dhe ja ku ishte tani: Në korridorin e spitalit "Nënë Tereza", duke mbajtur në dorë çelësat e zyrës së tij të re, si shef kardiologjie. Një arritje që në fëmijëri dukej e pamundur.

Hyri brenda, vështroi tavolinën e tij të pastër, dritaren ku hynte një rreze dielli dhe u mbështet pak në karrigen e re. Frymëmarrja iu lehtësua. Sytë iu lagën, por këtë herë jo nga dhimbja triumfi. Por sapo u ul në karrigen e tij të re, një rrymë e ftohtë i përshkoi shtyllën kurrizore. Drita e diellit që hynte nga dritarja u duk sikur u zbeh. Ishte ai moment i njohur… Kur kujtimet, si hije të gjalla, i ngriheshin para syve pa e pyetur.

Dhuna. Fyerjet. Britmat.

Bullizmi i pafund. Sytë iu mjegulluan dhe realiteti u tret. Papritur ai nuk ishte më shef kardiologjie, por një djalosh i vogël, i frikësuar, në korridorin e konviktit të Librazhdit.

- Ej, hajde këtu, fshatar! - dëgjoi zërin e trashë të njërin prej djemve të mëdhenj.

Arbeni, i dobët dhe i trembur, zgjati hapin për t'iu shmangur, por nuk arriti. Një dorë e fortë e kapi nga jaka dhe e përplasi pas murit.

- Kush të ka thënë të hash ushqimin para të tjerëve? Apo s'të kanë mësuar rregullat e qytetit, në atë fshatin tënd të mjerë?

Ai dridhej, por nuk fliste. Kur hapi gojën, të tjerët qeshën.

- Shiko se si i dridhen këmbët si lepur! - klithi një tjetër. Pastaj erdhën shqelmat.

Goditjet e ashpra i binin në brinjë, në shpinë, në këmbë. Në fund, e lanë rrëzë murit, duke qeshur. Arbeni i vogël mblidhej si një top i vogël, me duart në kokë, duke u përpjekur të mos qante. Por lotët i rridhnin vetë, kundër

vullnetit të tij. - Mos e qaj, se do ta marrin vesh që je i dobët! - i pëshpëriti një ditë nëna në shtëpi, pa e ditur se ai tashmë e kishte humbur aftësinë për të mos qarë.
Dhe kujtimet nuk ndaleshin. Ai pa veten në pyll, me çantën e grisur në shpinë, duke qarë rrugës së gjatë për në shkollë. Dëgjoi ofshamat e natës kur babai i dehur godiste derën dhe ai fshihej poshtë shtratit. Pa fytyrën e nënës që lutej me sy, pa fjalë.
DHUNA nuk të lë kurrë në paqe. Ajo qëndron. Rri aty. Pret. Doktor Arbeni u rikthye në realitet, i mbuluar në djersë të ftohtë. Thonjtë i ishin ngulur në pëllëmbë, aq fort sa lëkura i ishte skuqur. Zemra i rrihte shpejt, shumë shpejt. Ironia e hidhur e një kardiologu që s'dinte si t'ia qetësonte rrahjet vetes. Ai e dinte shumë mirë se çfarë ishte kjo. Trauma. Ataku i panikut. Gjurma e asaj dhune të vjetër që nuk shlyhej kurrë.
U ngrit në këmbë, mbështeti duart mbi tavolinë dhe mori frymë me zor.
"Je i sigurt tani. Je i rritur. Je shef klinike," - i pëshpëriti vetes. Por zëri i fëmijës së brendshëm, i atij fëmije që dikur dridhej në konvikt, përsëri i thoshte: "Ata s'mbaruan me ty. Ata jetojnë ende në mendjen tënde."
Kjo ishte beteja e tij më e vështirë. Jo salla e operacionit. Jo pacientët. Por ai vetë.
Ajo plagë e vjetër mendore që nuk mbyllej dot me bisturi.
Dhe në atë moment, ai e ndjeu pavarësisht arritjeve, pavarësisht titujve, dhuna e dikurshme ishte ende brenda

tij, si një kafshë e fshehur që mund të zgjohej në çdo çast.
Por këtë herë, ai vendosi të mos ikte. Të mos fshihej. Jo më. Ai mbylli sytë dhe u betua se do ta luftonte këtë plagë, një herë e mirë. Pas atij momenti të rëndë në zyrë, Arbeni mendoi se do ta kalonte shpejt. U mundua të përqendrohej në punë, të analizonte kartelat e pacientëve, të kontrollonte listat e ndërhyrjeve ditore. Por çdo hapje dosjesh, çdo fletë, çdo rrahje zemre që dëgjonte në stetoskop i rikthente një fije ankthi.
Në sallën e operacionit ai ishte i njohur për qetësinë e tij. Ishte i ftohtë, i saktë, i palëkundur. Por atë ditë, ndërsa po përgatiteshin për një bypass urgjent të një pacienti në moshë, diçka u thye brenda tij.
- Doktor, jemi gati, - tha infermierja.
Arbeni veshi përparësen sterile, vendosi maskën dhe hyri në sallë. Dritat kirurgjikale, të forta dhe të bardha, i goditën sytë. Një moment, vetëm një çast… Dhe ai pa veten të ri në korridorin e konviktit, duke u shtyrë e goditur nga shokët e tij. Një kujtim i papritur që e bëri zemrën t'i rrahnte më shpejt.
Kur mbajti bisturinë në dorë, gishtat filluan t'i dridheshin paksa, dridhje të gjata që nuk mund t'i fshihte.
- Doktor, gjithçka në rregull? - pyeti një kirurg i ri, duke hedhur një sy të shqetësuar.
Arbeni nuk foli. Përpiqej të merrte frymë. Vetëm frymë. Por salla iu duk e vogël, shumë e vogël; Muret dukeshin sikur i afroheshin, duke e mbytur në një hapësirë të

ngushtë. Zhurma e aparaturave iu shndërrua në jehonën e të qeshurave të djemve që dikur e përqeshnin. Errësohej…, errësohej…

- Doktor! - thirri sërish infermierja, me zë të qetë por të prerë, duke e tërhequr Arbenin përsëri në realitet.

Ai mori një frymë të thellë, vendosi bisturinë me vendosmëri dhe iu kthye pacientit. Salla ishte e tij tani dhe çdo hije e së kaluarës nuk kishte më fuqi mbi të. Ai bëri një hap mbrapa. Maska iu mbush me avull nga frymëmarrja e shpejtë. U përkul dhe mbështeti duart te tavolina metalike.

U ndje sikur po mbytej.

- Dilni të gjithë jashtë! - urdhëroi shefi i anestezisë, i cili e kuptoi menjëherë se diçka nuk ishte në rregull. - Dërgojeni një kirurg tjetër!

Arbeni doli nga salla, i lodhur, i mpirë. Eci deri në dhomën e pushimit dhe u ul në një karrige të ngurtë, duke mbajtur kokën me duar. Ai e dinte çfarë ishte ajo: Një sulm akut ankthi, i shkaktuar nga trauma e thellë që nuk kishte marrë kurrë ndihmë.

Për herë të parë në jetë, ai e kuptoi se nuk mund t'i shmangej më.

Duhej të përballej. Të nesërmen, ai trokit në derën e qetë të një zyre psikologjie brenda spitalit. Një grua rreth të pesëdhjetave, me sy të butë dhe zë të qetë, e priti.

- Ulu, doktor Arben, - i tha. - Më kanë njoftuar se ke pasur një episod të rëndë. Si ndihesh?

Ai heshti gjatë,… shumë gjatë. Pastaj, papritur, thonjtë

iu ngulën në pëllëmbë, ndërsa lotët filluan t'i rridhnin në heshtje mbi duar.

- Unë… kam luftuar gjithë jetën, - pëshpëriti më në fund. - Por mendoj se e shkuara nuk ka ikur Nuk më ka lënë kurrë. Jam duke u thyer… Dhe nuk dua të thyhem. Jo tani… Jo kur kam ardhur deri këtu.

Psikologia e dëgjoi me vëmendje, pa ndërprerë, pa gjykuar.

- Arben, - tha ajo me qetësi, - Dhuna që ke përjetuar s'ka mbaruar thjesht sepse je rritur. Ajo është brenda teje. Dhe është koha ta nxjerrim nga errësira. Jo me forcë, por me hap pas hapi.

Ai ngriti kokën pak. Për herë të parë ndjeu një grimë lehtësim. Kishte gjetur dikë që e dëgjonte, dikë që nuk e poshtëronte, dikë që nuk e godiste, dikë që mund t'i shihte plagët e padukshme. Dhe kështu filloi rruga e tij e dytë: Emancipimi i shpirtit.

Terapia nuk ishte e lehtë. Në fakt, ishte gjëja më e vështirë që doktor Arbeni kishte bërë ndonjëherë. Më e vështirë se provimet e mjekësisë, se specializimi, se çdo operacion që kishte kryer.

Në seancën e parë psikologia i tha qetësisht:

- Ne do të hyjmë në dhoma që ti i ke mbyllur me vite. Disa janë të errëta, disa të dhimbshme. Por pa i hapur, ato do të vazhdojnë të të trazojnë. Ai u drodh. Por pranoi.

Seanca e dytë - Psikologia nisi me një ushtrim të ngadaltë frymëmarrjeje.

- Zemra jote po të flet, Arben. Le ta dëgjojmë pa u trembur, -

tha me një qetësi që sfidonte zërin e brendshëm të dyshimit. Ai mbylli sytë dhe iu përkushtua udhëtimit të brendshëm. U kthye sërish në pyllin e lagësht që ndante fshatin nga qyteti. Erërat e freskëta të mëngjesit dhe aromat e dheut të lagur e mbështetën, por ndjenja e frikës mbeti e paprekshme. E pa veten të vogël, me çantën e grisur mbi shpinë, duke vrapuar i frikësuar nga britmat e babait që jehonin nëpër pemë dhe rrugica. Çdo hap i asaj rruge ishte plagë; çdo hap i kthente kujtime që dhembnin, por që nuk mund të shmangeshin.

Zemra i rrihte me ritëm të shpejtë, dhe fryma e tij u bë një ndërthurje e kujtimit dhe realitetit. Ai ndjeu frikën e një fëmije të vetmuar, por edhe forcën e dikujt që kishte mësuar të mbijetonte. Çdo kujtim i hidhur ishte një gur mbi të cilin mund të ndërtonte vetëdijen dhe qetësinë e së tashmes.

Psikologia e vëzhgonte heshturazi, duke e lënë të përballet me errësirën e së kaluarës, duke ditur se vetëm përballimi i saj mund ta çlironte. Sytë i lotuan. Nuk fliste dot.

- Arben, - tha psikologia butë, duke e parë drejt në sy, - Ti nuk je më ai fëmijë. Tani ke të drejtë t'i japësh zë atij djali që dikur heshti nga frika.

Ai mori frymë thellë, ndjeu një lëvizje të brendshme që e mbushte me ngrohtësi dhe dhimbje njëkohësisht, dhe pëshpëriti:

- Kam dashur të bërtas… Por nuk kam guxuar kurrë.

Një qetësi e çuditshme pushtoi dhomën. Ishte si një derë që hapej nga brenda. Ky ishte çelësi i parë që u hap: Njohja e frikës dhe pranimi i saj.

Seanca e pestë

Psikologia i dha një fletë dhe një laps dhe i kërkoi të shkruante për djalin e vogël që kishte qenë dikur.

- Si do t'i flisje atij sot? - pyeti, zëri i saj i ngrohtë dhe i qetë, një udhërrëfyes mes kujtimeve dhe realitetit. Arbeni rrëshqiti penën mbi letër, duke ndjerë se çdo fjalë ishte një hap drejt çlirimit të vetvetes. Çdo fjali, çdo rresht, ishte si një bisht i lidhur me atë frikë të fshehur prej dekadash. Për herë të parë, nuk ishte më viktimë e kujtimeve, por një dëshmitar i tyre dhe njëkohësisht, një mjeshtër i zërit të brendshëm që dikur nuk kishte guxuar të shprehte.

Arbenit iu drodh dora, por më në fund shkroi:

"Më vjen keq që nuk të mbrojti askush. Më vjen keq që u mundove vetëm. Ti nuk kishe faj. Ti nuk ishe i dobët. Ti ishe fëmijë."

Kur e lexoi me zë të lartë, zëri i thyhej dhe ai u detyrua të ndalej disa herë për të mbledhur frymën. Fjalët e tij dolën me një ngarkesë që kishte qëndruar e ngulitur brenda për vite me radhë.

Psikologia e pa drejt në sy dhe tha me një qetësi të fuqishme:

- Për herë të parë, ti po i jep atij fëmije dashurinë që nuk e mori kurrë.

Arbeni u mbështet pas karriges dhe mbylli sytë. Ishte sikur dikush po i hiqte një barrë të rëndë, që e kishte mbajtur mbi supe gjithë jetën. Fryma iu qetësua, por ndjenja e plagëve të vjetra ende ecte nëpër trupin e tij, si hije të padukshme që nuk donin të largoheshin.

Seanca e dhjetë: Prishja e murit të heshtjes

Në një moment të vështirë, psikologia e pyeti me butësi, por edhe me vendosmëri:

- Pse mendon se rrahjet, fyerjet dhe talljet të kanë ndjekur kaq shumë?

Arbeni u ngri. Një heshtje e rëndë mbuloi dhomën, duke lënë vetëm tingujt e frymëmarrjes së tyre të përbashkët dhe dritën e butë që binte mbi tavolinë. Kujtimet e dhimbshme të fëmijërisë dolën një nga një, të pazakonta dhe të pashlyera, duke e goditur nga brenda. Çdo goditje, çdo fyerje, çdo tallje kishte formuar një hije mbi trupin dhe mendjen e tij, Një mburojë që dikur e mbronte, por tani dukej e rëndë dhe e panevojshme. Ai pa përpara veten një tjetër herë të vogël, duke u përpjekur të shkojë në shkollë me çantën e grisur mbi shpinë, duke u ndjerë i vetmuar dhe i pafuqishëm. Dritat e korridorit ishin të zbehta dhe britmat e babait që jehonin në kujtesën e tij e shoqëronin çdo hap. Ishin çaste që nuk mund t'i harronte, sepse çdo goditje e jashtme kishte lënë një vulë të përhershme mbi shpirtin e tij.

Ai ndjeu një dridhje të hollë në duar dhe një tension që i shtrihej në shpinë. Nuk ishte më vetëm rikujtim; Ishte një sfidë e vërtetë për të pranuar, dhe për të çliruar plagët që kishin formuar çdo lëvizje, çdo frymë, çdo ndjesi të tij deri në këtë moment i kujtonin të kaluarën e tij të errët. Zëri i tij i brendshëm iu shfaq si një hije e heshtur, duke i thënë: "Ke mbijetuar. Ke mbijetuar mbi gjithçka deri tani."

Arbeni mori frymë thellë. Një lot i heshtur rrëshqiti mbi

faqen e tij pa e kuptuar. Nuk ishte vetëm dhimbje; Ishte lehtësim, Një hap drejt pranimit të vetes dhe fuqisë që kishte fituar duke u përballur me të kaluarën. Psikologia e pa duke e lënë të qëndronte në heshtje. Një vështrim i qetë dhe i kuptueshëm që e nxiste të përballej me çdo kujtim.
Në atë heshtje të gjatë, ai filloi të ndiente një transformim të brendshëm. Çdo plagë që kishte fshehur, çdo frikë që kishte mbajtur të fshehur brenda vetes, po fillonte të zbehej, duke u shndërruar në njohje dhe forcë. Në mendjen e tij, ai mund të shihte për herë të parë një lidhje mes të kaluarës dhe të tashmes, një mundësi për të shëruar dhe për të ecur përpara. Pas një minute të gjatë heshtjeje, ai foli më në fund: "Sepse unë mendoja se i meritoja… Se isha i padëshiruar."
Fjalët i ranë rëndë në ajër, si një e vërtetë e vjetër që më në fund kishte gjetur guximin të dilte. Psikologia nuk e ndërpreu. E la të qëndronte aty, në atë hapësirë të zhveshur nga mbrojtjet.
- Dhe tani, çfarë mendon? - pyeti ajo butë.
Arbeni ngriti sytë për herë të parë pa lëkundje. Vështrimi i tij ishte i lodhur, por i qartë.
- Tani mendoj se ata ishin të gabuar. Jo unë.
Kjo fjali nuk ishte thjesht përgjigje. Ishte një ngadhënjim i heshtur. Një mur i rrëzuar pas dekadash faji të gabuar. Për herë të parë, ai e hoqi peshën e turpit nga vetja dhe ia ktheu atyre që ia kishin ngarkuar.
Seanca e pesëmbëdhjetë: Katarsisi
Psikologia vendosi ta çonte edhe më thellë.

- Dua të mbyllësh sytë dhe t'ua thuash atyre që të dhunuan atë që nuk the dot në atë kohë. Pa frikë. Pa ndalesa.
Arbeni mbylli sytë. Trupi iu tendos për një çast, sikur po përballej me një stuhi të vjetër. Kur foli, zëri i tij ishte i dridhur, thuajse i thyer:
- Pse ma bëtë këtë? Një frymë e rëndë i doli nga kraharori. Heshtja u mbush me kujtime. Pastaj zëri iu forcua, sikur diçka brenda tij po zgjohej:
- Unë nuk kisha faj!
Lotët nisën t'i rridhnin lirshëm, pa turp, pa përmbajtje. Fjalët e fundit dolën të forta, të pastra, çliruese:
- Unë kam vlerë! Ju s'mund të ma zhduknit! Në atë çast, nuk ishte më fëmija i frikësuar. Ishte burri që i kishte mbijetuar dhunës. Dhe po ia kthente dinjitetin vetes. Dhoma dukej më e qetë, fryma më e lehtë. Katarsisi nuk erdhi si shpërthim, por si një çlirim i thellë, i vonuar, por i pakthyeshëm.
Kur i hapi sytë, frymëmarrja i ishte qetësuar. Duart i ishin ngrohur. Balli nuk i ishte djersitur. Për herë të parë, nuk ndjeu turp, por çlirim. Pas çdo séance ai dilte nga zyra i lodhur, por më i lehtësuar. Filloi të flinte më mirë. Të merrte frymë më thellë. Të ecte më drejt. Sallat e operacionit nuk i dukej më aq të ngushta.
Trauma nuk ishte zhdukur, por ai po mësonte ta zbusë. Ta vë në vendin e saj. Të mos e lejojë të komandojë jetën. Dhe kështu, pak nga pak, doktor Arben po rilindte, jo vetëm si mjek — por si njeri.
Ngjarja në spital – Shpërthimi

Në sallën e kirurgjisë mbretëronte qetësia e zakonshme e mëngjesit, ajo qetësi e ftohtë që ndjen vetëm para se bisturia të preki mishin e gjallë. Arbeni ishte i përqendruar te pacienti. Një ndërhyrje delikate që kërkonte dorë të sigurt dhe mendje të kthjellët. Asistentët po përgatitnin instrumentet, ndërsa ai kontrollonte edhe një herë analizat dhe skanerin.

Por në prapaskenë, dy kolegë – të njëjtët që e kishin parë gjithmonë me zili – po i hidhnin tension ditës. Njëri prej tyre kishte ndryshuar qëllimisht renditjen e instrumenteve, tjetri kishte hequr një pjesë të vogël nga raporti i analizave, duke e bërë të dukej sikur Arbeni i kishte harruar në një kontroll rutinë. Qëllimi i tyre ishte i qartë: Një gabim i vogël mjaftonte që ai të dukej i paaftë. Kur Arbeni vuri re mungesën e një materiali, fytyra iu zbeh. Një shqetësim i brendshëm i goditi si rrufe. Për një sekondë sallën e mbushi një zhurmë e largët, si të hapej një derë e padukshme në kujtesën e tij.

- Ku është garza? Kush e ka hequr? – zëri i tij filloi të dridhej lehtë.

Asnjë përgjigje. Pastaj… ndodhi.

Diçka brenda tij u këput. Ai nisi të marrë frymë shpejt, sytë iu errësuan në skaje dhe papritur nuk ishte më në sallën e kirurgjisë. Ishte përsëri fëmijë. Ishte në korridorin e shkollës ku tre djem e kishin shtyrë pas dere dhe e kishin goditur me shqelma. Ishte në dhomën e errët ku ia kishin marrë ushqimin dhe e kishin lënë pa ngrënë vetëm për t'u tallur.

Ishte në rrugicën pas shkollës ku ai kërkonte mëshirë, ndërsa një grusht i fortë i binte në bark. Salla u zhduk. Dritat, monitorët, të gjithë rregullimi i saktë kirurgjikal u shkrinë në një mjegull të bardhë. U kthyen hijet. Tani nuk ishin thjesht kujtime të largëta. Ato qëndronin përpara tij, gjallë dhe kërcënuese, duke e ndjekur çdo hap dhe çdo frymë. Ai nisi të fliste me zë të ngjirur, të thyer, me sytë e ngulur në dysheme sikur po shikonte një realitet tjetër, një botë ku frika nuk ishte thjesht kujtim, por pranë tij në çdo moment: "Ju lutem,… mos më rrihni…, mos ma merrni bukën… Ju lutem, jo prapë… Mos më mbyllni aty…"
Fjalët dilnin nga një burim brenda që nuk mund ta ndalte. Dorën e tij e dridhte aq shumë sa instrumentet ranë në dysheme, duke bërë një tingull të fortë metalik. Asistentët u ngritën të alarmuar, me fytyra të tensionuara. Njëri nga kirurgët u largua me nxitim, duke murmuritur diçka të pakuptueshme.
Arbeni qëndroi i ngrirë për një moment, duke parë hijet që lëviznin rreth tij, duke i përsëritur fjalët e tmerrshme të së kaluarës. Zemra i rrihte e shpejtë, fryma e ngadaltë por e pashmangshme. Ai e kuptoi se për të përballuar këtë vizion, duhet të rikthehej në vetvete. Duart iu shtrënguan rreth një bisturie të imagjinuar, sikur të ishte lidhja e vetme me realitetin.
- Nuk do më bëni dëm… - tha me një zë më të qetë, duke luftuar me hije që po përpiqeshin të merrnin kontrollin.
Një heshtje e rëndë mbuloi sallën. Ndërsa fryma e tij

u stabilizua paksa, Arbeni filloi të ndiente fuqinë e tij të brendshme, fuqinë për të qëndruar në realitet, për të mos lejuar që frika e së kaluarës të pushtonte gjithçka.

– E kemi thënë, nuk është i qëndrueshëm… Nuk duhet të jetë këtu…

Tjetri e shikonte me kënaqësi të fshehtë: Skena e shkatërrimit të tjetrit ishte për të triumf.

Arbeni nisi të tundej, duart i dridheshin, duke përplasur krahët sikur po largohej nga dikush që e kërcënonte:

– Mos më mbyll! Mos më mbyll! Jo prapë! Jo!

Dikush thirri urgjent psikiatrisen e spitalit.

Ajo hyri me hap të shpejtë dhe urdhëroi:

– Ndizni dritat! Largoni instrumentet! Jepini hapësirë!

U afrua ngadalë te Arbeni, me një qetësi që dukej e mbinatyrshme.

– Arben… – tha me ton të butë. – Je në spital. Nuk ka askush që të prek. Askush nuk po të ndjek. Je i sigurt.

Por ai vazhdonte të shihte hijet.

– Joo… Janë këtu…, po më rrahin… Mos i lër të më marrin ushqimin…

Ajo u ul në gjunjë përballë tij, i vuri dorën në sup dhe i foli duke e ulur ritmin e frymëmarrjes:

– Dëgjoje zërin tim… Vetëm zërin tim. Merr frymë. Jam këtu. Nuk po të ndodh asgjë. Ato janë kujtime, Jo tani… Asnjë prej tyre nuk mund të të prekë më.

Ngadalë-ngadalë, frymëmarrja e tij nisi të stabilizohej. Sytë iu kthyen në fokus. Sikur një perde e trashë u ngrit nga

mendja e tij dhe ai pa sërish realitetin. Ai u drodh, pastaj uli kokën dhe nisi të qante në heshtje.

– Më falni…, – murmuriti. – Nuk doja…

Psikologia i vuri dorën në shpatull.

– S'ke pse kërkon falje. Trauma nuk zgjedh kohën. Ti ke luftuar i vetëm shumë vite. Tani nuk je më vetëm. Ndërsa jashtë sallës, dy doktorët që donin sabotimin e tij u panë mes tyre me shqetësim: Ky nuk ishte thjesht një shpërthim. Ishte diçka që mund t'u kthehej kundër, sepse askush nuk e kishte pritur që Arbeni, njeriu që gjithmonë heshti dhe duroi, të fillonte më në fund,… të kujtohej, për të kaluarën

Përplasja me fëmijërinë – Rikthimi i plotë i kujtimeve

Në dhomën e qetësimit, pas shpërthimit në sallën e operacionit, Arbeni ishte ulur në krevatin e bardhë, ende me duart që i dridheshin lehtë. Psikologia i rrinte pranë, pa bërë asnjë lëvizje të tepruar. Vetëm një dritë e dobët hynte nga dritarja, duke krijuar një hijë në dysheme që për të ishte e tmerrshme, sepse ai e dinte çfarë po vinte.

– Arben…, dua që të marrësh frymë me mua. Je i sigurt. Je këtu.

Por nuk mjaftonte. Diçka brenda tij po hapej, një derë e rëndë që ai e kishte mbyllur me vite të tëra heshtjeje dhe turpi. Dhe tashmë ajo derë u ça vetë. Pa lejen e tij.

Papritur sytë iu mjegulluan dhe dhoma u zhduk.

Ai nuk ishte më burrë. Nuk ishte doktor. Nuk ishte njeri i rritur.

Ishte përsëri 8 vjeç. Korridori i shkollës - Fillimi i ferrit

Ai vraponte nëpër korridorin e errët të shkollës së vjetër. Dëgjonte zërat e tyre pas vetes, të qeshurat e poshtra.
– Ej, kthehu këtu, qen i vogël!
Këmbët e tij të vogla rrëshqisnin në pllakat e lagura. Ndjeu dorën e njërit prej tyre te bluza, e cila e tërhoqi me forcë pas derës së një klase të boshatisur.
E mbyllën brenda. Errësirë. Fryma e tij e vogël po i merrej. U ul në dysheme, duke shtrënguar gjunjët.
– Pse po ma bëni? – pyeti me zë fëmije.
Ata qeshën. Dritarja e derës u hap dhe njëri prej djemve i tha:
– Se je i dobët. Se nuk flet. Se nuk kundërshton.
Ata e lanë atje një orë të tërë, derisa mësuesit as që vunë re. Rruga e kthimit në shtëpi — Grabitja e ushqimit……Pastaj kujtimi ndryshoi.
Ishte dimër. Një ditë e ftohtë. Ai mbante në çantën e vogël një sanduiç që i kishte bërë nëna, i vetmi ushqim që hante shpesh gjatë ditës.
Tre djem e ndoqën në rrugicën pas shtëpisë së kulturës.
- Ç'ke aty? – tha njëri.
- Vetëm bukën… – u përgjigj ai duke e mbajtur çantën fort.
- Jepja! - bërtiti tjetri.
Ata ia shkulën nga duart, e rrëzuan në tokë dhe nisën të hanë sanduiçin para syve të tij, ndërsa ai qante pa zë.
- Më lini,… më lini pak…,, Është e imja,… Ju lutem…
Por ata qeshën, duke i hedhur copat në baltë. Ai e mori atë që mbeti dhe e fshiu me mëngë. E hëngri duke qarë, sepse ishte i uritur.

Dhe askush, askush nuk e dëgjoi.
Dhoma e errët – Tortura më e rëndë, por rikthimi nuk mbaroi aty. E shtynë në një depo të braktisur pas shkollës. E mbyllën brenda dhe fikën dritën.
– Rri aty derisa të të mësohesh! – thirri njëri.
Ai bërtiste…..
– Kam frikë! Mos më lini këtu! Ju lutem! Ju lutem!
Goditje në derë. Qeshje. Pastaj heshtje. Ai mbante barkun, sepse më parë e kishin goditur fort. Dhimbja e shpuante ngadalë. Ajri ishte i rëndë. Ai filloi t'i fliste vetes:
– Do dal…, do dal… Vetëm po të rri i qetë… Nuk dua t'i zemëroj… , do rri i qetë…
Por askush nuk erdhi. Erdhi vetëm nata. Dhe aty u krijua trauma. Trauma që e ndoqi gjithë jetën.
Trauma që sot shpërtheu në sallën e operacionit.
Kthimi në spital
Zëri i psikologes depërtoi më në fund në errësirën e kujtesës.
– Arben… Je këtu. Mbaroi. Mbaroi. Askush s'të prek.
Ai hapi sytë. Loti i kishte mbuluar fytyrën. Pëshpëriti:
– E mbaj mend…,, çdo gjë… çdo britmë…, çdo goditje…
Psikologia i fshiu lotët me letër.
– Këto nuk janë më armiqtë e tu. Janë kujtime që kërkojnë shërim. Dhe ti nuk je më fëmijë. Nuk je më vetëm.
Ai për herë të parë ndjeu me besim në fjalët të saj. Dhe kuptoi se përballja me të shkuarën sapo kishte nisur. Dhe se për t'u shëruar, ai duhej të rikthente edhe kujtimet që kishte mbuluar prej vitesh.

Përplasja me kolegët – Spitali përballet me hijet e tij

Pas episodit të rëndë në sallën e operacionit, lajmi u përhap shpejt nëpër pavijone. Disa mjekë e panë me shqetësim, disa me dyshim, por disa, sidomos ata që nuk e duronin ngritjen e tij të shpejtë si shef i kardiokirurgjisë, panë një mundësi për ta rrëzuar.

Njëri prej tyre, doktori L.K., i njohur për zili dhe arrogancë, u fut në dhomën e stafit ku Arbeni po pinte një gotë ujë. Ai akoma ishte i lodhur, duart i dridheshin pak.

- Na e prure turpin sot, shef, – tha L.K. me një buzëqeshje të ngrirë. – Të iku truri në sallë. Për pak na e vdiqe pacientin në duar.

Arbeni ngriti kokën, pa folur.

- Po s'qenke mirë akoma, - ndërhyri një kirurg tjetër me zë tallës. - Si shef, duhet të jesh i fortë… Ose ndoshta ky post është shumë i madh për ty.

Të tjerët nisën të murmuritnin. Ishin tre, të gjithë dhe atmosfera bëhej e rëndë.

- Sot na e vërtetove që s'je i aftë, - shtoi një tjetër, me sy të ngulur te ai.

Diçka e ftohtë u çua në shpinën e Arbenit. Zërat, fjalët, qëndrimet, nuk ishin të kolegëve, ishin të djemve të konviktit.

"Je i dobët! S'vlen për asgjë! S'ke vend këtu!"

Dhe truri i tij nisi t'i ngatërrojë kohët. Dhoma nisi të zvogëlohej, ashtu si depoja ku e mbyllnin dikur. Zërat e kolegëve filluan të tingëllonin si ato të fëmijëve që qeshnin me të.

- Lëreni bukëzën, mos e qitni në vaj! - dëgjoi një zë të vjetër, të fëmijërisë.
Arbeni u ngrit në këmbë me vështirësi, i mbërthyer nga një ndjenjë paniku. Sytë i errësoheshin, fryma i shkurtohej. Ai pa fytyrën e kolegut që po e shikonte me ironi… Por ai nuk e shihte më kolegun. Ai shihte një nga torturuesit e rinisë.
- Ju lutem… mos më rrihni sot… – murmuriti ai pa e kuptuar, me zë të dridhur.
Kolegu ngriti vetullat.
- Ç'po thua, more Arben?
- Mos… mos më merrni bukën,… ju lutem,… Sot jo… — pëshpëriti Arbeni duke shtyrë karrigen, duke u tërhequr mbrapa sikur priste goditje. Zërat u ngritën.
- Ky ka humbur fare!
- Kush e ka emëruar këtë shef?!
Në atë moment dera u hap me forcë.
Psikologia hyri.
Ajo iu afrua Arbenit me kujdes.
- Arben.,… është e vërtetë ajo që po sheh? A po i shikon ata tani? Ai po dridhej. Sytë e tij ishin të mbushur me lot.
- Po… janë këtu…., janë tre… më kanë zënë… Do më rrahin…
Zëri i tij u thye. Psikologia u kthye nga kolegët me një shikim të ftohtë.
- A e shikoni? Ai po përjeton një episod disociativ. Kjo është traumë e rëndë, jo dobësi. Asnjë nga ju nuk ka të drejtë ta sulmojë për këtë! Ata u hutuan. Nuk e prisnin. Ajo u kthye

sërish tek Arbeni.
- Arben, je me mua. Nuk janë ata. Këtu jemi në spital. Këtu je i sigurt. Asnjë nuk do të prekë.
Ai po merrte frymë me vështirësi, por filloi ta shihte pak nga pak fytyrën e saj, jo më hijet.
- A janë larguar? – pyeti si fëmijë.
- Po, - tha ajo me zë të butë. - Nuk janë më dhe nuk do të vijnë prapë sot.
Ai uli kokën dhe qau në heshtje, si dikur në depo.
Pasojat – Spitali përballet me të vërtetën
Drejtori i pavijonit u thirr menjëherë.
Psikologia raportoi: "Ky episod nuk është një çrregullim i rastësishëm. Është rezultat i traumës së rëndë të fëmijërisë. Ai ka nevojë për mbështetje, jo sulme."
Ndërsa kolegët, të turpëruar dhe të kapur në befasi, rinin pa fjalë, duke kuptuar se e kishin shtyrë Arbenin drejt një krize të rrezikshme.
Drejtori tha:
- Që nga sot, askush nuk ka të drejtë ta provokojë, ta nënçmojë apo ta sfidojë. Do të fillojnë masa disiplinore.
Psikologia e mori Arbenin nga krahu.
- Arben, do të vazhdojmë terapinë. Ky ishte një hap i vështirë, por i rëndësishëm, sepse tani trauma nuk fshihet më. Tani ajo mund të shërohet. Ai e ndoqi në heshtje, me lot ende pa u tharë, por për herë të parë,…nuk ndihej vetëm.
Sabotimi – hija e njeriut që do ta rrëzojë
Pas incidentit, spitali dukej i qetë në sipërfaqe, por brenda

mureve kishte fërkime, nervozizëm dhe zëra që s'donin të ndalonin. Disa nga mjekët filluan të distancoheshin nga Arbeni, disa e shikonin me dyshim, por një prej tyre,… kishte vendosur ta përdorte dobësinë e tij si armë.

Ai quhej Doktor L.K. Një kirurg i talentuar, por i njohur për ambicie të verbër. Njeriu që besonte se vendin e shefit duhej ta kishte ai, Jo "djali i ardhur nga rruga". Pas episodit, ai iu afrua disa kolegëve dhe tha me një ton të ftohtë:

- Nuk mund të drejtojë pavionin një njeri që sheh fantazma.

Dhe qeshi. Por ai nuk u mjaftua me fjalë. Ai kishte një plan.

Nata e sabotimit

Ishte ora 22:30. Arbeni atë natë kishte roje. Psikologia i kishte rekomanduar pushim, por për arsye mungesash ai duhej të qëndronte. Në tavolinë kishte çajin e tij bimor që e qetësonte, një bllok, dhe disa dosje pacientësh. Doktor L.K. e dinte këtë.

Ai ishte fshehur në dhomën e materialeve disa minuta më parë, duke pritur momentin e duhur. Në monitorin e kirurgjisë u shfaq një thirrje emergjence: Pacient me arrest kardiak në urgjencë. Arbeni u ngrit menjëherë dhe vrapoi drejt sallës. Ndërkohë, L.K. hyri në zyrën e tij.

Ai hapi kompjuterin dhe krijoi një raport të rremë: "Doktor Arbeni, gjatë episodit disociativ, ka vendosur gabim protokollin për pacientin X, duke rrezikuar jetën…" L.K. e vuri draftin në dosjen e brendshme të spitalit me datë retroaktive. Pastaj mori dy fletë të tjera dhe falsifikoi nënshkrimin e Arbenit me një aftësi të frikshme. Pastaj

doli me qetësi, sikur s'kishte ndodhur asgjë. Në sallën e urgjencës, Arbeni hyri i tëri me vrull profesional. Pacienti ishte një djalë i ri, 27 vjeç, me puls shumë të ulët. Ai nisi proçedurat me përpikmëri, vendosi defibrilatorin, kërkoi adrenalinën, monitoroi ritmin. Puna shkonte perfekt, por në një moment, ndërsa po jepte udhëzimet, ai dëgjoi një zë imagjinar, një britmë e fëmijërisë: "Ooo, na erdhi i çmenduri!"

Arbeni ngriti kokën për një sekondë, i hutuar. Zemra i rrahu fort.

Infermierja e vuri re.

- Doktor? Jeni mirë?

Ai mori frymë thellë, e përzuri hijen e fëmijërisë dhe u përqendrua sërish.

- Jam mirë. Vazhdojmë. Pacienti u stabilizua në minutën e 14-të. Një sukses i shkëlqyer mjekësor, por Arbeni nuk e dinte se ndërkohë, në kompjuterin e tij, një faj i rremë po e priste si thikë pas shpine.

Mëngjesi i akuzës

Në mëngjes, drejtori e thirri urgjent në zyrë.

Arbeni hyri, pa kuptuar asgjë. Në tavolinë ishin të shtrira fletët e falsifikuara.

- Doktor Arben… Çfarë është kjo?

Ai i pa. Zëri i tij u drodh.

- Këto nuk i kam shkruar unë, … është… e rremë…

Doktori L.K. qëndronte në kënd të zyrës, me duart e kryqëzuara dhe një buzëqeshje të lehtë, të neveritshme.

- Po nënshkrimi? - tha ai.
- Është falsifikuar! - protestoi Arbeni, por sytë e tij nisën të errësoheshin.
Truri filloi ta tradhtonte. Drejtori e shikonte me dyshim.
- Ky është problem shumë i rëndë, doktor. Nëse keni bërë gabim protokolli dhe po përpiqeni ta mbuloni, do të ketë pasoja të rënda…
Zërat filluan të përzihen. Dhoma nisi të rrotullohej. Ai pa sërish tre djem të konviktit. Pa derën e hekurit që mbyllej. Pa duart që e kapnin. Pa qeshjet, goditjet, heshtjen. Nuk pa asnjë zhurmë tjetër, që ta zbulonte realitetin e të kujohej që ishte në spital.
- Jo.… jo… mos, … mos më mbyllni… Mos më rrihni… Ju lutem… Nuk kam bërë asgjë… -pështpëriti ai, duke lëkundur kokën dhe duke u përpjekur të mbante frymën nën kontroll.
Zëri i tij dridhej, i çarë nga frika dhe kujtimet e tmerrshme që e ndjeknin.
Drejtori u tërhoq pak, i trembur nga intensiteti i papritur.
- Doktor, çfarë po thoni?! - tha ai, duke u përpjekur të mbante qetësinë, por një shenjë shqetësimi dukshëm i prekte fjalët.
Doktor L.K. u afrua me një shikim të ftohtë, të ngulitur dhe cinik.
- Po e shihni? - tha me zë të prerë, duke lëshuar një pathirrmë pa ekuivok. - Nuk është i qëndrueshëm për këtë post.
Arbeni dridhej, duart i ishin shtrënguar në grushta të

vogla, por zemra i rrihte fort, si të donte të shpërthente jashtë kraharorit. Frika dhe tmerri i kujtimeve të fëmijërisë përplasnin çdo mendim racional. Ai ndjeu se çdo akuzë, çdo dyshim i jashtëm, ngjallte brenda tij hijet e së kaluarës, të cilat tashmë nuk i vinte dot nën kontroll.

Megjithatë, ndërsa dridhja vazhdonte, një pjesë e tij — E vogël, por e vendosur dhe një zë i brendshëm i tha: "Ky nuk je ti. Kjo është frika që ata duan të shohin. Ti je më shumë se sa kujtimet e tua."

Ai mori një frymë të thellë dhe ngriti pak kokën, duke u përpjekur të rikthehej në realitet, të qëndronte në hapësirën ku mund të kontrollonte çdo veprim dhe çdo fjalë. Por tensioni mbetej i rëndë dhe dhoma dukej sikur ngushtohej me çdo frymë, me çdo hap dhe me çdo shikim të kritikëve rreth tij.

- Nuk kam bërë asgjë…, mos ma merrni,… mos ma merrni bukën… Ju lutem… - tha përsërisi, me lutjen e një fëmije.

Drejtori thirri psikologen me urgjencë. Ajo hyri menjëherë dhe shkoi drejt Arbenit.

- Arben. Shiko tek unë. Vetëm tek unë. Nuk është e vërtetë ajo që po shikon. Je në spital. S'ke bërë asgjë të keqe.

Ajo e mori nga krahu, ndërsa ai dridhej, derisa ngadalë, shumë ngadalë u qetësua. Por kjo herë ishte ndryshe… Psikologia u kthye nga drejtori.

- Këto dokumente janë të fabrikuara. Unë dua që IT të kontrollojë hyrjet në kompjuter. Dhe dua hetim të plotë.

Drejtori, i turpëruar nga reagimi i tij i nxituar, pranoi.

L.K. ngriti vetullat.
- S'kemi nevojë për dramë…Qenkam gabuar. E lëmë kështu këtë temë.
- Po, kemi nevojë për sqarim drame - i tha psikologia ftohtë. - Dhe ti je pjesë e kësaj drame.
Në atë moment, për herë të parë:
Sabotimi u zbulua dhe lufta e vërtetë sapo kishte filluar.

Hetimi – zbardhja e së vërtetës
Drejtori i spitalit, i tronditur nga episodet e ditëve të fundit, u ul pas tavolinës dhe kërkoi një takim emergjent me IT-në dhe psikologen. Ai e dinte se nuk mund të lejonte që një incident i tillë të mbetej i pazgjidhur.
- Duhet të dimë çfarë ka ndodhur me dosjet e Arbenit. Nuk mund të mbetemi me dyshime, - tha ai.
Psikologia, që kishte qenë gjithmonë mbështetësja më e fortë e Arbenit, mori një vendim:
- Unë do të qëndroj pranë tij gjatë gjithë proçesit. Ai nuk ka bërë asgjë të gabuar. Por truri i tij është ende i lënduar nga traumat e së kaluarës. Duhet të jemi të kujdesshëm.
Arbeni u ul pranë tyre, me dorën e tij të dridhur mbi tavolinë. Zemra i rrihte fort, por kjo nuk ishte frika e zakonshme: Ishte tensioni i pritjes të së vërtetës. Hyrja në IT – Gjurmimi i dokumenteve. IT-ja filloi të analizonte kompjuterin e Arbenit, log-et e hyrjes, ndryshimet në dokumente dhe çdo aktivitet të dyshimtë. Pas rreth dy orësh, doli një e dhënë tronditëse:

- Shikoni këtë, - tha IT-ja, duke e treguar monitorin. - Dokumenti është krijuar nga një përdorues tjetër, me hyrje nga makina e doktor L.K. Ai ka aksesuar folderin e Arbenit në orën 22:45, Kohë kur Arbeni ishte në sallën e urgjencës. Drejtori ngriti vetullat.

- Kjo është e papranueshme! - tha ai. - L.K., Nuk ka shpjegim. Psikologia përpiqej të qetësonte Arbenin, që ndihej i tensionuar dhe i emocionuar.

- Shiko… Kjo është e drejtë, - i tha ajo butë. - E vërteta po del. Tani është momenti yt, por nuk duhet të humbasesh qetësinë.

Thirrja e doktor L.K.

Drejtori thirri menjëherë L.K. në zyrë. Ai hyri me një buzëqeshje të lehtë, që iu zhduk kur pa të gjithë ekipin përballë tij: Drejtori, psikologia dhe Arbeni.

- Doktor L.K., - tha drejtori ftohtë. - Ka prova që ju keni falsifikuar dokumente dhe jeni përpjekur ta sabotoni shefin tuaj. Si e shpjegoni këtë?

L. K. heshti. Zëri i tij i sigurt u shua.

- Unë… nuk e… - Ai u ndal.

Psikologia iu afrua pak:

- Nuk ka "nuk e kam bërë". Log-et janë aty. Kompjuteri nuk gënjen. Arbeni mori frymë thellë. Zëri i tij ishte i qetë, por i fuqishëm:

- Nuk kam bërë asgjë të gabuar. Dhe nuk mund të toleroj që dikush të rrezikojë pacientët për ambicie personale.

Drejtori shikoi L.K.

- Do të nisim proçedurat disiplinore. Përjashtim i menjëhershëm nga pavioni i kirurgjisë. Do të bëjmë një raport të plotë tek bordi i spitalit.
L.K. e dinte se nuk kishte rrugë shpëtimi. Ai u tërhoq, i mërzitur dhe i shkatërruar.
Çlirimi dhe reflektimi
Arbeni u ul. Frymëmarrja e tij u qetësua. Truri i tij, që sapo kishte përjetuar rikthimin e kujtimeve të tmerrshme të fëmijërisë. Tani ndjeu një lehtësim të papritur.
- Faleminderit! - tha ai vetëm psikologes. - Faleminderit që qëndrove pranë meje.
- Ti e meriton këtë çlirim, - tha ajo.
- Por kujto, kjo është vetëm një betejë. Të tjerat janë ende për t'u përballuar, brenda jush.
Arbeni e kuptoi atë që kishte ndodhur: Jo çdo luftë fitohet me forcë fizike. Disa fitore kërkojnë qetësi, durim dhe drejtësi.
Hijet e fëmijërisë nuk ishin zhdukur, por tani ai ndjeu se kishte një armë të re: Fuqinë për t'u përballur me to pa u fundosur.
Hijet e së kaluarës nuk zhduken kurrë; ato thjesht mësojnë të ecin pas nesh. Ne shërohemi jo kur i harrojmë, por kur guxojmë t'i kthejmë kokën dhe t'u themi: Nuk jeni më zotërit e shpirtit tim.
Rikthimi i hijes – provë e fuqisë së brendshme
Natën e parë në shtëpinë e re, heshtja mbështolli gjithçka. Dritat e rrugës depërtuan butësisht në dhomë, por Arbeni ndjeu se diçka nuk ishte qetësisht e zakonshme. Papritmas,

kujtimet e fëmijërisë, të dhunës dhe poshtërimit, filluan të shfaqeshin me forcë të pazakontë.

- Babai,,… britmat,… dhuna… - murmuriti mendja e tij. Fillimisht, trupi i tij dridhej dhe frymëmarrja u bë e shpejtë. Ishte sikur tërë dhimbja e dekadave po rikthehej për t'ia mbushur shtëpinë e re me terrorin e së kaluarës. Por Arbeni, i mësuar nga çdo sfidë, ndaloi për një çast. Mbylli sytë dhe e përqafoi ndjesinë. Çdo dridhje, çdo kujtim i dhimbshëm, e pranoi, pa u larguar apo fshehur. Ai filloi të fliste me hijet në mendjen e tij, si një njeri që mësonte të bënte paqe me të shkuarën:

- E di që keni qenë pjesë e jetës sime. E kuptoj dhimbjen dhe frikën. Por nuk më kontrolloni më. Jam këtu, dhe jam i fortë.

Në atë çast, hijet filluan të zbehen, por nuk u zhdukën plotësisht. Ato shfaqeshin herë pas here, si kujtesa që e testonin vazhdimisht, por Arbeni nuk u tremb. Çdo frymëmarrje, çdo mendim i qetë, i jepte forcë. Ai kuptoi se fuqia e brendshme nuk është mungesa e frikës, por aftësia për të vepruar me qetësi dhe vendosmëri, pavarësisht saj.

Për herë të parë, ai e ndjeu shtëpinë jo vetëm si vend për jetën fizike, por si qendër të mendjes dhe shpirtit të tij. Vendi ku mund të ndërtonte vetveten dhe të menaxhonte çdo kujtim të dhimbshëm. Hijet ishin aty, por tashmë ishin të pafuqishme: Nuk mund të ndërhynin në vendimet, në qetësinë ose në lumturinë e tij të brendshme.

Në mëngjes, Arbeni u zgjua me një ndjesi të re energjie.

Shtëpia pranë spitalit nuk ishte më vetëm strehë; Ishte një laborator i forcës së brendshme, vendi ku çdo kujtim i errët mund të përballohej dhe kthyer në mësim, durim dhe stabilitet. "Çdo hijë që kthehet, - mendoi për vete, - më mëson të jem më i fortë. Nuk jam më viktimë. Nuk do të jem kurrë më."

Dhe me këtë vetëdije, Dr. Arbeni përjetoi për herë të parë qetësinë absolute, ndonëse hijet vazhdonin të shfaqeshin herë pas here. Ai kishte provuar fuqinë e tij brenda vetes dhe tani dinte se asgjë nuk mund ta thyente më.

Arbeni e kuptoi shpejt se suksesi në kirurgji ishte një bekim, por edhe një mallkim që e vinte shpesh në provë. Dita e tij fillonte herët, shumë herët, kur ende askush nuk kishte hyrë në spital. Ai ecte gjatë korridoreve të heshtura, duke dëgjuar vetëm trokitjen e këpucëve të veta dhe zërin e brendshëm që i thoshte vazhdimisht se diku, në një qoshe të errët, hijet e së kaluarës po e prisnin përsëri.

Por tani nuk ishte më ai i dikurshmi. Ai i kishte mbijetuar vetes dhe kjo e bënte më të fortë se çdo armik të jashtëm. Ai vazhdoi punën me qetësi. Çdo prerje kirurgjikale ishte e matur, çdo vendim i shpejtë, çdo rrahje e zemrës së pacientit në monitor dukej sikur harmonizohej me frymëmarrjen e tij. Personeli mjekësor e shikonte me admirim, disa me zili, disa me frikë. Kishte diçka te Arbeni që nuk ishte thjesht talent - Ishte prania, përqendrimi, mendimi i thellë që nuk e tradhtonte kurrë.

Shkrimet në gazetat ndërkombëtare filluan ta përmendnin

shpesh: "Kirurgu i ri shqiptar që po sfidon statistikat e vdekshmërisë." Revista shkencore e cilësonin si "fenomen", ndërsa disa kolegë thoshin se fati i kishte dhuruar një dhunti që pak njerëz në Europë e zotëronin, por fama kishte një çmim.

Sa më shumë njerëz e vlerësonin, aq më shumë riktheheshin hijet e dikurshme—Ato që e kishin ndjekur që nga fëmijëria, nga një dhunë që askush s'e pa. Nga padrejtësi që askush s'i dëgjoi, nga netët kur flinte në heshtje të frikshme në konvikt. Duke dëgjuar vetëm rrahjen e zemrës dhe shpresën se e nesërmja do të ishte më e lehtë.

Tani ai kishte marrë një shtëpi të vogël, pranë spitalit. Një banesë e qetë, me dritare të gjera nga ku binte drita e hënës drejt në dysheme. Atje, mes asaj qetësie të ngrirë, ai ndihej i sigurt. Ishte një distancë e vogël fizike nga spitali, por një hap i madh psikologjik, larg varfërisë së dikurshme dhe zhurmës së konviktit.

Në mbrëmje, pas një dite të gjatë me operacione të vështira, ai rrinte në dritare dhe shikonte qytetin poshtë. Dritat dukej sikur notonin në errësirë, ndërsa njerëzit e vegjël lëviznin si hije të padukshme.

"Sa e çuditshme," mendonte shpesh. "Drita i bën njerëzit të duken të sigurt, por brenda tyre gjithmonë fshehin një errësirë të vogël."

Dhe pikërisht atë natë, kur ai mendonte se më në fund po fitonte kontrollin mbi mendjen e vet, hijet iu rikthyen. Jo aq të dhunshme sa më parë, por tinëzare. Zëra që i kujtonin gabimet që s'i kishte bërë, frikërat që s'i përkasin më, fytyrat

e njerëzve që i kishte humbur, fjalët që s'u thanë kurrë.
Ai u ul në divan, mbajti kokën me duar dhe mbylli sytë. Por në vend të qetësisë, para syve i shfaqeshin skena nga e shkuara, të çrregullta, të mjegullta, si të ishin copëza filmi të gjetura në errësirë.
Pastaj… asgjë. Një frymëmarrje e thellë. Një ngritje. Ai u çua menjëherë dhe ndezi dritat e të gjitha dhomave.
Ky ishte instinkti i tij: Dritë ndaj errësirës, veprim ndaj frikës, kurajo ndaj heshtjes. Nuk do t'i lejonte hijet të fitonin.
Të nesërmen, ai u kthye në spital si çdo ditë tjetër. Kolegët e panë që kishte diçka ndryshe në sytë e tij—Një vendosmëri e re. Disa pyetën, por ai nuk dha përgjigje. Nuk kishte nevojë. Sallat e operacionit u mbushën sërish me dritë të fortë të projektorëve, me erën e sterilizuesve, me tingujt e aparaturave që punonin si orë zvicerane. Arbeni hyri në operacionin e parë me po atë qetësi të hekurt. Atje, brenda atyre mureve të bardha, ai ndjehej i pathyeshëm. Pacientët shpëtonin radhazi. Vendimet e tij u bënë objekt studimi. Fotot e tij nisën të qarkullojnë nëpër revista mjekësore. Spitale gjermane, austriake, zvicerane filluan të dërgonin ftesa zyrtare.
Ai i lexonte dhe thjesht buzëqeshte.
Fama rritej. Emri i tij tashmë ishte një pikë reference për kirurgët e rinj. Por brenda tij, shumë më e rëndësishme se lavdia, ishte qetësia që pofitonte ngadalë. Ai e kuptoi se çdo jetë që shpëtonte ishte një goditje e fortë kundër hijeve të së kaluarës.
Ai nuk i shmangej traumave—Por i dominonte. Në fund të

asaj dite të gjatë, ndërsa dilte nga spitali dhe i afrohej rrugës drejt shtëpisë së tij të re, Arbeni e ndjeu për herë të parë se ndoshta, ndoshta… ishte duke fituar jetën e vet. Dhe me një zë të ulët, aq të ulët sa vetëm ai vetë mund ta dëgjonte, pëshpëriti: "Hijes i iket vetëm duke ndezur dritën brenda vetes."

Intervista që ndryshoi gjithçka

Doktor Arbeni u qetësua më në fund, pasi kreu me sukses operacionin e parë të tij si shef i kardiologjisë. Ai doli ngadalë nëpër katet e spitalit kardiologjik të gjashtëkatëshit, në qendrën spitalore "Nënë Tereza". Diku në fund të korridorit, sekretarja e ish-shefit e priti dhe i dorëzoi çelësat e zyrës së re. Arbeni i mori me dorë dhe i vuri në xhep të sigurt. Buzëqeshi lehtë dhe u nis drejt zyrës, ndërsa në mendje i shpërthenin kujtimet që nuk e kishin lënë kurrë rehat. Traumat e hershme… Braktisja nga babai i tij i papërgjegjshëm, i cili kurrë nuk interesohej për të. Nëna, një grua e thjeshtë fshati, pa shkollë, që nuk guxonte t'i kundërvihej sjelljeve arbitrare e të dhunshme të burrit. Ajo e shkreta bënte aq sa mundej, sepse babai nuk punonte, dhe çdo ditë sillte probleme. "Ka bërë mjaft ajo," Mendonte shpesh doktor Arbeni në heshtje. E kaluara i vinte gjithmonë në mendje. Ai kujtonte gjithmonë nënën me respekt dhe dashuri. Si e ndihmoi ajo e vetme.

Ai u detyrua ta bënte shkollën tetëvjeçare duke jetuar në konviktin e qytetit të Librazhdit. Aty u torturua dhe u abuzua, jo vetëm nga djemtë më të mëdhenj e të fortë,

por edhe nga disa drejtues, sepse Arbeni vinte nga një familje me "biografi të keqe". Për këtë arsye, sapo mbaroi tetëvjeçaren, e përjashtuan nga konvikti.
Shpesh, Arbeni qante vetëm përgjatë shtigjeve të pyllit, duke mbajtur hallet brenda vetes, pa pasur me kë të fliste. Megjithatë, ai nuk u dorëzua. Në çdo hap që bënte drejt qytetit, edhe pse këmbët i dhembnin dhe duart i ngrinin nga acari. Një zë brenda vetes i thoshte: "Mos u ndal. Mos u përkul." Shpesh ndalonte buzë lumit dhe shikonte ujin që rridhte me vrull. I dukej se ai lumë ishte jeta e tij: E ashpër, e turbullt, por gjithmonë duke vazhduar përpara.
Në shkollën e mesme, ndonëse shumë shokë e tallnin ose e shikonin me mëshirë, Arbeni nuk u shpërqendrua asnjëherë. Zgjidhte bankën e fundit, vendoste librat para vetes dhe humbiste në leksione. I pëlqenin biologjia dhe kimia; I pëlqente mënyra si funksiononte zemra, si rrihte, si tundej në gjoksin e njeriut si një farkëtar i lodhur që s'mund të ndalet. Ai e dinte që fati i tij ishte i lidhur pikërisht me këto ushtri të vogla qelizash që luftonin brenda trupit të njeriut.
- Ti s'ke për t'u bërë kurrë njeri! - i thoshte babai. Çdo fjalë binte mbi shpirtin tënd si një gur i rëndë. Në atë moment, ndihej se bota të kishte mbyllur dyert para, se vlera jote nuk ekzistonte dhe ëndrrat e tua nuk kishin kuptim. Por, kjo është vetëm një hije e mendimeve të dikujt tjetër, e një pasqyre të shqyer të frikës dhe dobësive të tij.
Filozofikisht, fjala e tillë të mëson një të vërtetë të hidhur:

Vlera jonë nuk përcaktohet nga fjalët e të tjerëve, qofshin ato prindër, shokë apo shoqëri. Ajo që e bën njeriun të vërtetë nuk është miratimi i të tjerëve, por aftësia për të ngritur veten mbi talljen, për të kuptuar dhe pranuar gabimet dhe për të ndërtuar identitetin tënd të pavarur.

Shkencërisht, psikologët thonë se përvoja të tilla mund të lënë gjurmë në vetëbesimin dhe ndjenjën e vetëvlerësimit, por nuk janë të pakthyeshme. Çdo individ ka forcën për të rimarrë kontrollin mbi historinë e vet dhe për të krijuar një version më të fortë dhe më të plotë të vetes. Dhe në fund, mund të thuhet: "Fjalët që plagosin shpirtin nuk përcaktojnë vlerën tënde. Ajo që je dhe ajo që mund të bëhesh nuk varet nga tallja e të tjerëve, por nga guximi yt për të ecur përpara dhe për të krijuar veten nga hiri i përbuzjes."

Nëna rrinte në qoshe, me duar të çara nga puna dhe sy të lodhur që mbusheshin me lot, por nuk guxonte të hapej. E vetmja gjë që bënte ishte t'i linte një copë bukë të ngrohtë djalit të saj, kur ai kthehej në darkë nga shkolla, që ëndërronte. Në maturë doli i pari në rreth — Një goditje e fortë kundër gjithë paragjykimeve. Një shuplakë e heshtur mbi të gjitha fyerjet, abuzimet dhe padrejtësitë që e kishin ndjekur.

Më pas erdhi dega e mjekësisë. Filloi një jetë e re në qytetin e madh, por as aty s'kishte askënd. Jetoi në një dhomë të vogël në qytet studenti, që shpesh ngjante më shumë me një magazinë sesa me dhomë. Punonte gjatë netëve në një furrë buke, ndërsa ditën ndiqte leksionet me përkushtim të

verbër. Flinte pak, hante pak, por mësonte shumë.
Në një moment, gjatë vitit të tretë, një profesor i njohur i fakultetit e vuri re. E thirri pas leksionit dhe i tha:
- Ti ke diçka që të tjerët nuk e kanë. Ke luftuar më shumë se çdokush për të ardhur deri këtu. Këta libra nuk t'i mëson mendja, por jeta. Vazhdoni, Arben. Ti do bëhesh mjek i madh.
Ato fjalë i ngulur thellë në zemër, i dhanë krahë.
Vitet kaluan dhe me mundim të jashtëzakonshëm. Ai fitoi specializimin në kardiologji. Punoi në sallë operacioni gjatë, i fortë si hekur e i palodhur. Mjekët e mëdhenj nisën ta respektonin; Pacientët nisën ta donin. Dhe ja ku ishte tani: Në korridorin e spitalit "Nënë Tereza", duke mbajtur në dorë çelësat e zyrës së tij të re si shef kardiologjie. Një arritje që në fëmijëri dukej e pamundur.
Hyri brenda, vështroi tavolinën e tij të pastër, dritaren ku hynte një rreze dielli dhe u mbështet pak në karrigen e re.
E ndjeu se jeta më në fund i kishte dhënë atë që meritonte. Frymëmarrja iu lehtësua. Sytë iu lagën, por këtë herë jo nga dhimbja por nga triumfi. Sapo u ul në karrigen e tij të re, një rrymë e ftohtë i përshkoi shtyllën kurrizore. Drita e diellit që hynte nga dritarja u duk sikur u zbeh. Ishte ai moment i njohur… Kur kujtimet, si hije të gjalla, i ngriheshin para syve pa e pyetur.
Dhuna. Fyerjet. Britmat.
Bullizmi i pafund. Sytë iu mjegulluan dhe realiteti u tret. Papritur ai nuk ishte më shef kardiologjie, por një djalosh

i vogël, i frikësuar, në korridorin e konviktit të Librazhdit. Hijet u kthyen…..

- Ej, hajde këtu, fshatar! - dëgjoi zërin e trashë të njërin prej djemve të mëdhenj.

Arbeni, i dobët dhe i trembur, zgjati hapin për t'iu shmangur, por nuk arriti. Një dorë e fortë e kapi nga jaka dhe e përplasi pas murit.

- Kush të ka thënë të hash ushqimin para të tjerëve? Apo s'të kanë mësuar rregullat e qytetit në atë fshatin tënd të mjerë?

Ai dridhej, por nuk fliste. Kur hapi gojën, të tjerët qeshën.

- Shiko se si i dridhen këmbët si lepur! - klithi një tjetër.

Pastaj erdhën shqelmat.

Goditjet e ashpra i binin në brinjë, në shpinë, në këmbë. Në fund, e lanë rrëzë murit, duke qeshur. Arbeni i vogël mblidhej si një top i vogël, me duart në kokë, duke u përpjekur të mos qante. Por lotët i rridhnin vetë, kundër vullnetit të tij.

- Mos e qaj, se do ta marrin vesh që je i dobët! - i pëshpëriti një ditë nëna në shtëpi, pa e ditur se ai tashmë e kishte humbur aftësinë për të mos qarë.

Dhe kujtimet nuk ndaleshin. Ai pa veten në pyll, me çantën e grisur në shpinë, duke qarë rrugës së gjatë për në shkollë. Dëgjoi ofshamat e natës kur babai i dehur godiste derën dhe ai fshihej poshtë shtratit. Pa fytyrën e nënës që lutej me sy, pa fjalë.

DHUNA nuk të lë kurrë në paqe. Ajo qëndron. Rri aty. Pret…….Pastaj jashtë u dëgjua një zë.

Doktor Arbeni u rikthye në realitet, i mbuluar në djersë të ftohtë. Thonjtë i ishin ngulur në pëllëmbë, aq fort sa lëkura i ishte skuqur. Zemra i rrihte shpejt, shumë shpejt — Ironia e hidhur e një kardiologu që s'dinte si t'ia qetësonte rrahjet vetes.

Ai e dinte shumë mirë se çfarë ishte kjo.

Trauma. Ataku i panikut.

Gjurma e asaj dhune të vjetër që nuk shlyhej kurrë.

U ngrit në këmbë, mbështeti duart mbi tavolinë dhe mori frymë me zor.

"Je i sigurt tani. Je i rritur. Je shef klinike," - pëshpëriti vetes. Por zëri i fëmijës së brendshëm, i atij fëmije që dikur dridhej në konvikt, përsëri i thoshte:

"Ata s'mbaruan me ty. Ata jetojnë ende në mendjen tënde."

Kjo ishte beteja e tij më e vështirë. Jo salla e operacionit. Jo pacientët. Por ai vetë.

Ajo plagë e vjetër mendore që nuk mbyllej dot me bisturi.

Dhe në atë moment, ai e ndjeu: Pavarësisht arritjeve, pavarësisht titujve. Dhuna e dikurshme ishte ende brenda tij, si një kafshë e fshehur që mund të zgjohej në çdo çast. Por këtë herë, ai vendosi të mos ikte. Të mos fshihej. Jo më. Ai mbylli sytë dhe u betua se do ta luftonte këtë plagë — Një herë e mirë. Pas atij momenti të rëndë në zyrë, Arbeni mendoi se do ta kalonte shpejt. U mundua të përqendrohej në punë, të analizonte kartelat e pacientëve, të kontrollonte listat e ndërhyrjeve ditore. Por çdo hapje dosjesh, çdo fletë dhe rrahje zemre që dëgjonte në stetoskop, i rikthente një fije ankthi.

Në sallën e operacionit ai ishte i njohur për qetësinë e tij. Ishte i ftohtë, i saktë, i palëkundur. Por atë ditë, ndërsa po përgatiteshin për një bypas urgjent të një pacienti në moshë, diçka u thye brenda tij.

- Doktor, jemi gati, - tha infermierja.

Arbeni veshi përparësen sterile, vendosi maskën dhe hyri në sallë. Dritat e forta kirurgjikale i goditën sytë. Një moment, vetëm një çast… dhe ai pa veten në korridorin e konviktit, duke u shtyrë e goditur.

Kur mbajti bisturinë në dorë, gishtat filluan t'i dridheshin.

- Doktor, gjithçka në rregull? - e pyeti një kirurg i ri. Arbeni nuk foli. Përpiqej të merrte frymë. Vetëm frymë. Por salla u bë e vogël, shumë e vogël, sikur muret i afroheshin. Zhurma e aparaturave iu shndërrua në jehonën e të qeshurave të djemve që e përqeshnin dikur. Errësohej… errësohej…

Për herë të parë në jetë, ai e kuptoi se nuk mund t'i shmangej më.

Duhej të përballej.

- Doktor! - thirri sërish infermierja.

Ai bëri një hap mbrapa. Maska iu mbush me avull nga frymëmarrja e shpejtë e çrregullt. U përkul dhe mbështeti duart mbi tavolinën metalike, sikur kërkonte diçka ku të mbahej.

Një ndjesi mbytjeje e pushtoi papritur.

- Dilni të gjithë jashtë! - urdhëroi shefi i anestezisë, i cili e kuptoi menjëherë se diçka nuk shkonte. - thirrni një kirurg tjetër! Arbeni doli nga salla i rraskapitur, i mpirë. Hapat i

kishte të rëndë, sikur dyshemeja po e thithte. Eci deri në dhomën e pushimit dhe u ul në një karrige të fortë, duke e mbajtur kokën mes duarve.
Ai e dinte çfarë po i ndodhte: Një sulm akut ankthi, i lindur nga një traumë e thellë, e vjetër, që kurrë nuk kishte gjetur trajtim.
Të nesërmen, ai trokiti në derën e psikologes brenda spitalit. Ajo ishte dashamirëse e tij e kishte ndihmuar gjithmonë. Ishte një grua rreth të pesëdhjetave, me sy të butë dhe zë të qetë. E priti si përherë me dashuri
- Ulu, doktor Arben, - i tha. - Më kanë njoftuar se ke pasur përsëri një episod të rëndë. Si ndihesh? Ai heshti gjatë,… shumë gjatë. Pastaj, papritur, thonjtë iu ngulën në pëllëmbë ndërsa lotët filluan t'i rridhnin në heshtje mbi duar.
- Unë… kam luftuar gjithë jetën, - pëshpëriti më në fund. - Por mendoj se e shkuara nuk më ka lënë kurrë. Jam duke u thyer…, dhe nuk dua të thyhem. Jo tani…, jo kur kam ardhur deri këtu.
Psikologia e dëgjoi me vëmendje, pa ndërprerë, pa gjykuar.
- Arben, - tha ajo me qetësi. - Që në fillim unë isha dhe jam me ty.. Dhe do të shëroj. Dhuna që ke përjetuar s'ka mbaruar thjesht sepse je rritur. Ajo është brenda teje. Dhe është koha ta nxjerrim nga errësira. Jo me forcë, por me hap pas hapi.
Ai ngriti kokën pak. Për herë të parë ndjeu një grimë lehtësim.
Kishte gjetur dikë që e dëgjonte. Dikë që nuk e poshtëronte.

Dikë që nuk e godiste. Dikë që mund t'i shihte plagët e padukshme. Dhe kështu filloi rruga e tij e dytë: Emancipimi i shpirtit. Terapia nuk ishte e lehtë. Në fakt, ishte gjëja më e vështirë që doktor Arbeni kishte bërë ndonjëherë. Më e vështirë se provimet e mjekësisë, se specializimi. Qetësisht tha ajo:

- Ne do të hyjmë në dhoma që ti i ke mbyllur me vite. Disa janë të errëta, disa të dhimbshme. Por pa i hapur, ato do të vazhdojnë të të trazojnë. Ai u drodh. Por pranoi.

Seanca e dytë

Psikologia e nisi me një ushtrim frymëmarrjeje.

- Zemra jote po të flet, Arben. Le ta dëgjojmë pa u trembur. Ai mbylli sytë. U kthye sërish në pyllin e lagësht mes fshatit dhe qytetit. E pa veten fëmijë, me çantën e grisur, duke vrapuar i frikësuar nga britmat e babait. Çdo hap i asaj rruge ishte plagë.

Sytë i lotuan. Nuk fliste dot.

- Arben, - tha psikologia butë, - Ti nuk je më ai fëmijë. Tani ke të drejtë t'i japësh zë atij djali që dikur heshti nga frika.

Ai mori frymë thellë dhe pëshpëriti:

- Kam dashur të bërtas… Por nuk kam guxuar kurrë. Ky ishte çelësi i parë që u hap.

Seanca e tjetër

Psikologia i kërkoi të shkruante për djalin e vogël që ishte dikur.

- Si do t'i flisje atij sot? Arbeni u mendua thelllë, nguli sytë në një vend, dora iu drodh, por më në fund shkroi:

"Më vjen keq që nuk të mbrojti askush. Më vjen keq që u mundove vetëm. Ti nuk kishe faj. Ti nuk ishe i dobët. Ti ishe fëmijë."
Kur e lexoi me zë të lartë, zëri i u thye. Më vjen keq që s'të dëgjoi askush. Ti ishe vetëm. Ai nuk shkruante dot më tej, sepse po dridhej.
Iu desh të ndalej disa herë. Psikologia e pa drejt e në sy dhe tha:
- Për herë të parë, ti po i jep atij fëmije dashurinë që nuk e mori kurrë. Arbeni u mbështet pas karriges dhe mbylli sytë. I dukej sikur dikush po i hiqte një barrë që e kishte mbajtur mbi supe gjithë jetën. Sot është dita e së vërtetës.
- Mos ndalo, mos mbaj asgjë brenda, se kështu do shërohesh.
Seanca tjetër – Prishja e murit të heshtjes
Në një moment të vështirë, psikologia e pyeti:
- Pse mendon se rrahjet, fyerjet dhe talljet të kanë ndjekur kaq shumë?
Ai u ngri komplet nuk foli e pas një minute tha:
- Sepse unë mendoja se i meritoja…, se isha i padëshiruar.
- Dhe tani, çfarë mendon, - tha ajo duke e shikuar në sy pa rrahur qerpik fare. - Fol mos u mendo dhe futi dorën në xhepin e përparmë të përparëses së bardhë.
Ai ngriti sytë për herë të parë pa lëkundje:
- Tani mendoj se ata ishin të gabuar. Jo unë. - tha ai.
Kjo fjali ishte një ngadhënjim
Seanca e fundit– Katarsisi
Psikologia vendosi ta çonte më thellë.

- Dua të mbyllësh sytë dhe t'ua thuash atyre që të dhunuan atë që nuk the dot në atë kohë. Zëri i tij fillimisht ishte i dridhur. Filloi të flasë:
- Pse ma bëtë këtë?
Pastaj më fort.
- Unë nuk kisha faj!
Dhe në fund, me lot që i rridhnin lirshëm tha:
- Unë kam vlerë! Ju s'mund të ma zhduknit jetën! Ju s'më bëni dot gjë. Tani jam unë ai që iu bëj që ju fus frikën.
Kur i hapi sytë, frymëmarrja i ishte qetësuar. Duart i ishin ngrohur. Balli nuk i ishte djersitur.
Për herë të parë, nuk ndjeu turp, por çlirim…….
Pas çdo seance
Ai dilte nga zyra i lodhur, por më i lehtësuar. Filloi të flinte më mirë. Të merrte frymë më thellë. Të ecte më drejt. Pacientët nisën të vinin re ndryshimin. Infermierët e shihnin më të qetë. Sallat e operacionit nuk i dukej më aq të ngushta. Trauma nuk ishte zhdukur — Por ai po mësonte ta zbuste. Ta vë në vendin e saj. Të mos e lejojë të më komandojë jetën.
Ngjarja në spital – shpërthimi
Në sallën e kirurgjisë mbretëronte qetësia e zakonshme e mëngjesit, ajo qetësi e ftohtë që ndjen vetëm para se bisturia të preki mishin e gjallë. Arbeni i ishte i përqendruar te pacienti – Një ndërhyrje delikate që kërkonte dorë të sigurt dhe mendje të kthjellët. Asistentët po përgatitnin instrumentet, ndërsa ai kontrollonte edhe një herë analizat dhe skanerin.

Por në prapaskenë, dy kolegë – Të njëjtët që e kishin parë gjithmonë me zili – Po i hidhnin tension ditës. Njëri prej tyre kishte ndryshuar qëllimisht renditjen e instrumenteve, tjetri kishte hequr një pjesë të vogël nga raporti i analizave, duke e bërë të dukej sikur Arbeni kishte harruar një kontroll rutinë. Qëllimi i tyre ishte i qartë: Një gabim i vogël mjaftonte që ai të dukej i paaftë.
Kur Arbeni vuri re mungesën e një materiali, fytyra iu zbeh. Një shqetësim i brendshëm i goditi si rrufe. Për një sekondë sallën e mbushi një zhurmë e largët, si të hapej një derë e padukshme në kujtesën e tij.
- Ku është garza? Kush e ka hequr?
Zëri i tij filloi të dridhej lehtë. Asnjë përgjigje. Pastaj… ndodhi. Diçka brenda tij u këput. Ai nisi të marrë frymë shpejt, sytë iu errësuan në skaje dhe papritur nuk ishte më në sallën e kirurgjisë. Ishte përsëri fëmijë. Ishte në korridorin e shkollës ku tre djem e kishin shtyrë pas dere dhe e kishin goditur me shqelma. Ishte në dhomën e errët ku ia kishin marrë ushqimin dhe e kishin lënë pa ngrënë vetëm për t'u tallur. Ishte në rrugicën pas shkollës ku ai kërkonte mëshirë, ndërsa një grusht i fortë i binte në bark. Salla u zhduk. U kthyen hijet. Ai nisi të fliste me zë të ngjirur, me sytë e ngulur në dysheme, sikur shikonte një realitet tjetër:
– Ju lutem,… mos më rrihni… Mos ma merrni bukën… Ju lutem, jo prapë… Mos më mbyllni aty…
Instrumentet ranë nga duart e tij. Asistentët u trembën.

Njëri nga kirurgët u largua me nxitim duke mërmëritur:
- E kemi thënë, nuk është i qëndrueshëm… Nuk duhet të jetë këtu…
Tjetri e shikonte me kënaqësi të fshehtë: Skena e shkatërrimit të tjetrit ishte për të triumf. Arbeni nisi të tundej, duart i dridheshin, duke përplasur krahët sikur po largohej nga dikush që e kërcënonte:
- Mos më mbyll! Mos më mbyll! Jo prapë! Jo!
Dikush thirri urgjent psikiatren e spitalit. Ajo hyri me hap të shpejtë dhe urdhëroi:
- Ndizni dritat! Largoni instrumentet! Jepini hapësirë!
U afrua ngadalë te Arbeni, me një qetësi që dukej e mbinatyrshme.
- Arben… - tha me ton të butë. - Je në spital. Nuk ka askush që të prek. Askush nuk po të ndjek. Je i sigurt.
Por ai vazhdonte të shihte hijet.
- Jo,… janë këtu,… po më rrahin… Mos i lër të më marrin ushqimin…
Ajo u ul në gjunjë përballë tij, i vuri dorën në sup dhe i foli duke e ulur ritmin e frymëmarrjes:
- Dëgjoje zërin tim… Vetëm zërin tim. Merr frymë. Jam këtu. Nuk po të ndodh asgjë. Ato janë kujtime, jo tani… asnjë prej tyre nuk mund të të prekë më. Ngadalë-ngadalë, frymëmarrja e tij nisi të stabilizohej. Sytë iu kthyen në fokus. Sikur një perde e trashë u ngrit nga mendja e tij dhe ai pa sërish realitetin. Ai u drodh, pastaj uli kokën dhe nisi të qante në heshtje.

- Më falni… - murmuriti. - Nuk doja…Psikologia i vuri dorën në shpatull.
- S'ke pse kërkon falje. Trauma nuk zgjedh kohën. Ti ke luftuar i vetëm shumë vite. Tani nuk je më vetëm.
Ndërsa jashtë sallës, dy doktorët që donin sabotimin e tij u panë mes tyre me shqetësim: Ky nuk ishte thjesht një shpërthim. Ishte diçka që mund t'u kthehej kundër.
Sepse askush nuk e kishte pritur që Arbeni. Njeriu që gjithmonë heshti dhe duroi, të fillonte më në fund,… të kujtohej.
Përplasja me fëmijërinë – rikthimi i plotë i kujtimeve
Në dhomën e qetësimit, pas shpërthimit në sallën e operacionit, Arbeni ishte ulur në krevatin e bardhë, ende me duart që i dridheshin lehtë. Psikologia i rrinte pranë, pa bërë asnjë lëvizje të tepruar. Vetëm një dritë e dobët hynte nga dritarja, duke krijuar një hije në dysheme që për të ishte e tmerrshme. Sepse ai e dinte çfarë po vinte.
– Arben,… dua që të marrësh frymë me mua. Je i sigurt. Je këtu.
Por nuk mjaftonte. Diçka brenda tij po hapej. Një derë e rëndë që ai e kishte mbyllur me vite të tëra heshtjeje dhe turpi. Dhe tashmë ajo derë u hap vetë. Pa lejen e tij. ….Papritur sytë iu mjegulluan dhe dhoma u zhduk. Ai nuk ishte më burrë. Nuk ishte doktor. Nuk ishte njeri i rritur.
Ishte përsëri 8 vjeç. Korridori i shkollës - Fillimi i ferrit
Ai vraponte nëpër korridorin e errët të shkollës së vjetër. Dëgjonte zërat e tyre pas vetes, të qeshurat e poshtra.

- Ej, kthehu këtu, qen i vogël! Këmbët e tij të vogla rrëshqisnin në pllakat e lagura. Ndjeu dorën e njërit prej tyre te bluza, e cila e tërhoqi me forcë pas derës së një klase të boshatisur.
E mbyllën brenda.
Errësirë.
Fryma e tij e vogël po i merrej. U ul në dysheme, duke shtrënguar gjunjët.
- Pse po ma bëni? - pyeti me zë fëmije.
Ata qeshën. Dritarja e derës u hap dhe njëri prej djemve i tha:
- Se je i dobët. Se nuk flet. Se nuk kundërshton.
Ata e lanë atje një orë të tërë, derisa mësuesit as që vunë re.
Rruga e kthimit në shtëpi - Grabitja e ushqimit
Pastaj kujtimi ndryshoi. Ishte dimër. Një ditë e ftohtë. Ai mbante në çantën e vogël një sanduiç që i kishte bërë nëna, i vetmi ushqim që hante shpesh gjatë ditës. Tre djem e ndoqën në rrugicën pas shtëpisë së kulturës.
- Ç'ke aty? - tha njëri.
- Vetëm bukën… - u përgjigj ai duke e mbajtur çantën fort.
- Jepja! - bërtiti tjetri.
Ata ia shkulën nga duart, e rrëzuan në tokë dhe nisën të hanë sanduiçin para syve të tij, ndërsa ai qante pa zë.
- Më lëreni, … më lëreni pak… është e imja, … ju lutem…
Por ata qeshën, duke i hedhur copat në baltë.
Ai e mori atë që mbeti dhe e fshiu me mëngë. E hëngri duke qarë, sepse ishte i uritur. Dhe askush, askush nuk e

dëgjoi. Dhoma e errët - Tortura më e rëndë. Por rikthimi nuk mbaroi aty.
E shtynë në një depo të braktisur pas shkollës. E mbyllën brenda dhe mbyllën derën.
- Rri aty derisa të të mësohesh! - thirri njëri.
Ai bërtiste.
- Kam frikë! Mos më lini këtu! Ju lutem! Ju lutem!
Goditje në derë. Qeshje. Pastaj heshtje. Ai mbante barkun, sepse më parë e kishin goditur fort. Dhimbja e shponte ngadalë. Ajri ishte i rëndë. Ai filloi t'i fliste vetes:
- Do dal… do dal… Vetëm po të rri i qetë… Nuk dua t'i zemëroj… Do rri i qetë…
Por askush nuk erdhi. Erdhi vetëm nata. Dhe aty u krijua trauma. Trauma që e ndoqi gjithë jetën. Trauma që sot shpërtheu në sallën e operacionit.
Kthimi në spital
Zëri i psikologes depërtoi më në fund në errësirën e kujtesës.
- Arben… Je këtu. Mbaroi. Mbaroi. Askush s'të prek.
Ai hapi sytë. Loti i kishte mbuluar fytyrën. Pëshpëriti:
- E mbaj mend… çdo gjë… çdo britmë… çdo goditje…
Psikologia i fshiu lotët me letër.
Këto nuk janë më armiqtë e tu. Janë kujtime që kërkojnë shërim. Dhe ti nuk je më fëmijë. Nuk je më vetëm. Ai për herë të parë ndjeu fjalët e saj. Dhe kuptoi se përballja me të shkuarën sapo kishte nisur.
Dhe se për t'u shëruar, ai duhej të rikthente edhe kujtimet që kishte mbuluar prej vitesh.

Përplasja me kolegët – Spitali Përballet me hijet e tij që ia vështirësuan jetën. Pas episodit të rëndë në sallën e operacionit, lajmi u përhap shpejt nëpër pavijone. Disa mjekë e panë me shqetësim, disa me dyshim, por disa, sidomos ata që nuk e duronin ngritjen e tij të shpejtë si shef i kardiokirurgjisë, panë një mundësi për ta rrëzuar.

Njëri prej tyre, doktori L.K., i njohur për zili dhe arrogancë, u fut në dhomën e stafit ku Arbeni po pinte një gotë ujë. Ai akoma ishte i lodhur, duart i dridheshin pak.

- Na e prure turpin sot, shef, - tha L.K. me një buzëqeshje të ngrirë. - Të iku truri në sallë. Për pak na e le pacientin në duar.

Arbeni ngriti kokën, pa folur.

- Po s'qenke mirë akoma, - ndërhyri një kirurg tjetër me zë tallës. - Si shef, duhet të jesh i fortë… Ose ndoshta ky post është shumë i madh për ty.

Të tjerët nisën të mërmëritnin. Ishin tre të gjithë dhe atmosfera bëhej e rëndë.

- Sot na e vërtetove që s'je i aftë, - shtoi një tjetër, me sy të ngulur te ai.

Diçka e ftohtë kaloj në shpinën e Arbenit. Zërat, fjalët, qëndrimet, nuk ishin të kolegëve. Ishin të djemve të konviktit.

"Je i dobët!"

"S'vlen për asgjë!"

"S'ke vend këtu!"

Dhe truri i tij nisi t'i ngatërrojë kohët. Dhoma nisi të zvogëlohej, ashtu si depoja ku e mbyllnin dikur. Zërat e

kolegëve filluan të tingëllonin si ato të fëmijëve që qeshnin me të.
- Lëreni bukëzën, mos e qitni në tokë! - dëgjoi një zë të vjetër, të fëmijërisë.
Arbeni u ngrit në këmbë me vështirësi, i mbërthyer nga një ndjenjë paniku. Sytë i errësoheshin, fryma i shkurtohej. Ai pa fytyrën e kolegut që po e shikonte me ironi… Por ai nuk e shihte më kolegun. Ai shihte një nga torturuesit e rinisë.
- Ju lutem…, mos më rrihni sot… – murmuriti ai pa e kuptuar, me zë të dridhur.
Kolegu ngriti vetullat.
- Ç'po thua, mor Arben?
- Mos… mos më merrni bukën… Ju lutem… Sot jo… - pëshpëriti Arbeni, duke shtyrë karrigen, duke u tërhequr mbrapa sikur priste goditje. Zërat në veshin e tij u rritën.
- Ky ka humbur fare! - tha njëri nga doktorët.
- Kush e ka emëruar këtë shef?!
Në atë moment dera u hap me forcë. Psikologia ndërhyri.
- Mjaft! - tha ajo me një autoritet që askush në dhomë nuk e priste.
Ajo iu afrua Arbenit me kujdes.
- Arben… Është e vërtetë ajo që po sheh? A po i shikon ata tani?
Ai po dridhej. Sytë e tij ishin të mbushur me lot.
- Po… janë këtu… Janë tre… Më kanë zënë…, do më rrahin… - Zëri i tij u thye.
Psikologia u kthye nga kolegët me një shikim të ftohtë.
- A e shikoni? Ai po përjeton një episod disociativ. Kjo është

traumë e rëndë, jo dobësi. Asnjë nga ju nuk ka të drejtë ta sulmojë për këtë!
Ata u hutuan. Nuk e prisnin. Ajo u kthye sërish tek Arbeni.
- Arben, je me mua. Nuk janë ata. Këtu jemi në spital. Këtu je i sigurt. Asnjë nuk do të prekë.
Ai po merrte frymë me vështirësi, por filloi ta shihte pak nga pak fytyrën e saj, jo më hijet.
- A janë larguar? - pyeti si fëmijë.
- Po, - tha ajo me zë të butë. - Nuk janë më. Dhe nuk do të vijnë prapë sot.
Ai uli kokën dhe qau në heshtje, si dikur në depo. Pasojat
Spitali përballet me të vërtetën. Drejtori i pavijonit u thirr menjëherë. Psikologia raportoi:
- Ky episod nuk është një çrregullim i rastësishëm. Është rezultat i traumës së rëndë të fëmijërisë. Ai ka nevojë për mbështetje, jo sulme.
Ndërsa kolegët, të turpëruar dhe të kapur krejt në befasi, rinin pa fjalë, sy më sy dhe trup të ngrirë nga dëshmia e papritur e Arbenit. Dallimi mes heshtjes së tyre dhe tensionit që mbushte dhomën ishte i dukshëm; Tani kuptuan se mënyrat e tyre të nënçmimit e kishin shtyrë Arbenin drejt një krize të rrezikshme. Një moment ku nervat dhe kufijtë e tij ishin kërcënuar seriozisht. Disa shikonin njëri-tjetrin me faj dhe frikë, ndërsa të tjerë përpiqeshin të fshihnin turpin që u mbulonte fytyrat.
Drejtori, i ftohtë dhe i vendosur, e ndërpreu heshtjen me një ton që nuk linte vend për diskutim:

— Që nga sot, askush nuk ka të drejtë ta provokojë, ta nënçmojë apo ta sfidojë. Çdo shkelje do të ndjekë masa disiplinore të menjëhershme.

Fjalët e tij zbritën mbi dhomën si një urdhër i prerë, duke krijuar një ekuilibër të ri forcash. Heshtja u thellua, ndërsa ndjenja e përgjegjësisë dhe frikës u përhap mes kolegëve. Ata kuptuan se nuk ishte thjesht një paralajmërim formal. Tani çdo veprim do të kishte pasoja dhe se fuqia e Arbenit për t'u mbrojtur nuk mund të injorohej më.

Psikologia e afrohet me kujdes dhe e mori Arbenin nga krahu. Ai ndjeu ngrohtësinë dhe mbështetjen e saj. Një kontrast i qartë me tensionin e papërballueshëm që sapo kishte përjetuar. Frymëmarrja e tij u qetësua ngadalë, ndërsa ajo e udhëhoqi jashtë dhomës, duke i ofruar një ndjenjë sigurie dhe kujdesi, duke e ndihmuar të rikthehet gradualisht nga kufiri i krizës drejt stabilitetit dhe vetëkontrollit.

- Arben, do të vazhdojmë terapinë. Ky ishte një hap i vështirë, por i rëndësishëm, sepse tani trauma nuk fshihet më. Tani ajo mund të shërohet.

Ai e ndoqi në heshtje, me lot ende pa u tharë.

Por për herë të parë…nuk ndihej vetëm.

Sabotimi – Hija e njeriut që do ta rrëzojë

Pas incidentit, spitali dukej i qetë në sipërfaqe, por brenda mureve kishte fërkime, nervozizëm dhe zëra që s'donin të ndalonin. Disa nga mjekët filluan të distancoheshin nga Arbeni, disa e shikonin me dyshim, por një prej tyre… Kishte vendosur ta përdorte dobësinë e tij si armë.

Ai quhej Doktor L.K. Një kirurg i talentuar, por i njohur për ambicie të verbër. Njeriu që besonte se vendin e shefit duhej ta kishte ai, jo "djali i ardhur nga rruga".
Pas episodit, ai iu afrua disa kolegëve dhe tha me një ton të ftohtë:
- Nuk mund të drejtojë pavionin një njeri që sheh fantazma.
Por ai nuk u mjaftua me fjalë. Ai kishte një plan.
Nata e sabotimit
Ishte ora 22:30. Arbeni atë natë kishte roje. Psikologia i kishte rekomanduar pushim, por për arsye mungesash ai duhej të qëndronte. Në tavolinë kishte çajin e tij bimor që e qetësonte, një bllok, dhe disa dosje pacientësh.
Doktor L.K. e dinte këtë.
Ai ishte fshehur në dhomën e materialeve disa minuta më parë, duke pritur momentin e duhur.
Në monitorin e kirurgjisë u shfaq një thirrje emergjence: Pacient me arrest kardiak në urgjencë. Arbeni u ngrit menjëherë dhe vrapoi drejt sallës. Ndërkohë, L.K. hyri në zyrën e tij. Ai hapi kompjuterin dhe krijoi një raport të rremë:
"Doktor Arbeni, gjatë episodit disociativ, ka vendosur gabim protokollin për pacientin X, duke rrezikuar jetën…"
L. K. e dërgoi draftin në dosjen e brendshme të spitalit me datë retroaktive. Pastaj mori dy fletë të tjera dhe falsifikoi nënshkrimin e Arbenit me një aftësi të frikshme.
Pastaj doli me qetësi, sikur s'kishte ndodhur asgjë.
Në sallën e urgjencës
Arbeni hyri i tëri me vrull profesional. Pacienti ishte një

djalë i ri, 27 vjeç, me puls shumë të ulët. Ai nisi proçedurat me përpikmëri, vendosi defibrilatorin, kërkoi adrenalinën, monitoroi ritmin.
Puna shkonte perfekt.
Por në një moment, ndërsa po jepte udhëzimet. Ai dëgjoi një zë imagjinar, një britmë e fëmijërisë:
"Ooo, na erdhi i çmenduri!"
Arbeni ngriti kokën për një sekondë, i hutuar. Zemra i rrahu fort. Infermierja e vuri re.
- Doktor? Jeni mirë? – pyeti ajo.
Ai mori frymë thellë, e përzuri hijen e fëmijërisë dhe u përqendrua sërish.
- Jam mirë. Vazhdojmë.
Pacienti u stabilizua në minutën e 14-të. Një sukses i shkëlqyer mjekësor. Por Arbeni nuk e dinte se ndërkohë, në kompjuterin e tij, një faj i rremë, po e priste si thikë pas shpine.
Mëngjesi i akuzës
Në mëngjes, drejtori e thirri urgjent në zyrë. Arbeni hyri, pa kuptuar asgjë. Në tavolinë ishin të shtrira fletët e falsifikuara.
- Doktor Arben… çfarë është kjo?
Ai i pa. Zëri i tij u drodh.
- Këto nuk i kam shkruar unë…, është…, e rremë…
Doktori L.K. qëndronte në kënd të zyrës, me duart e kryqëzuara dhe një buzëqeshje të lehtë, të neveritshme.
- Po nënshkrimi? - tha ai.

- Është falsifikuar! - protestoi Arbeni, por sytë e tij nisën të errësoheshin.
Truri filloi ta tradhtonte. Drejtori e shikonte me dyshim.
- Ky është problem shumë i rëndë, doktor. Nëse keni bërë gabim protokolli dhe po përpiqeni ta mbuloni, do të ketë pasoja të rënda…
Zërat filluan të përzihen. Dhoma nisi të rrotullohej. Ai pa sërish tre djem të konviktit. Pa derën e hekurit që mbyllej. Pa duart që e kapnin. Pa qeshjet.
- Jo… jo…, mos…, mos më mbyllni…, mos më rrihni…, ju lutem…, nuk kam bërë asgjë…- pëshpëriti ai duke lëkundur kokën.
Drejtori u tremb.
- Doktor, çfarë po thoni?!
Doktor L.K. u afrua me cinizëm:
- Po e shihni? Nuk është i qëndrueshëm për këtë post.
Arbeni po dridhej.
- Nuk kam bërë asgjë…, mos ma merrni,… mos ma merrni bukën…, ju lutem… — tha përsëri ai i shndërruar në fëmijë.
Kjo ishte ajo gjë reale që hyri në trurin e tij …Drejtori thirri psikologen me urgjencë. Ajo hyri menjëherë dhe shkoi drejt Arbenit.
- Arben. Shiko tek unë. Vetëm tek unë. Nuk është e vërtetë ajo që po shikon. Je në spital. S'ke bërë asgjë të keqe.
Ajo e mori nga krahu, ndërsa ai dridhej, derisa ngadalë, shumë ngadalë, u qetësua. Por kjo herë ishte ndryshe…
Psikologia u kthye nga drejtori.

- Këto dokumente janë të fabrikuara. Unë dua që IT të kontrollojë hyrjet në kompjuter. Dhe dua hetim të plotë.
Drejtori, i turpëruar nga reagimi i tij i nxituar, pranoi.L.K. ngriti vetullat.
- S'kemi nevojë për dramë…dhe më shumë hetime, - tha ai.
- Po, kemi, - i tha psikologia ftohtë. - Dhe ti je pjesë e kësaj drame.
Në atë moment, për herë të parë, diçka po ndryshonte në mënyrë të prekshme. Ishte si një dritë e vogël që depërtonte përmes mjegullës së padrejtësisë së përditshme. Për herë të parë, ndjenja e drejtësisë po vihej në veprim dhe jo si një koncept i largët apo fjalë boshe që dëgjohej në leksione dhe ligjërata.
Veprimet që deri më tani kishin kaluar pa u ndëshkuar po përballeshin menjëherë. Çdo provokim, çdo poshtërim që kishte mbushur dhomën me tension, tani po shihte një reagim të shpejtë dhe të prerë. Ishte një moment kur fjalët e drejtuesit nuk ishin thjesht paralajmërim: Ato ishin ligj në veprim, një masë që shpejt korrigjonte pabarazinë dhe mbante nën kontroll rrezikun për dhunë ose poshtërim të mëtejshëm. Në ajrin e mbushur me tension dhe frikë, Arbeni ndjeu për herë të parë se kishte mbështetje dhe mbrojtje. Nuk ishte më vetëm përballë talljes dhe injorancës. Tani, drejtësia po ndërhynte shpejt dhe në mënyrë konkrete. Ishte një çast i çuditshëm, një kombinim force, lehtësimi dhe respekti, ku gjithçka që deri më tani kishte dukur e padrejtë po transformohej në një ekuilibër të ri të fuqishëm.

Sabotimi u zbulua.
Dhe lufta e vërtetë sapo kishte filluar. Hetimi – zbardhja e së vërtetës
Drejtori i spitalit, i tronditur nga episodet e ditëve të fundit, u ul pas tavolinës, dhe kërkoi një takim emergjent me IT-në dhe psikologen. Ai e dinte se nuk mund të lejonte që një incident i tillë të mbetej i pazgjidhur.
- Duhet të dimë çfarë ka ndodhur me dosjet e Arbenit. Nuk mund të mbetemi me dyshime, - tha ai.
Psikologia, që kishte qenë gjithmonë mbështetësja më e fortë e Arbenit, mori një vendim:
- Unë do të qëndroj pranë tij gjatë gjithë procesit. Ai nuk ka bërë asgjë të gabuar. Por truri i tij është ende i lënduar nga traumat e së kaluarës. Duhet të jemi të kujdesshëm. Arbeni u ul pranë tyre, me dorën e tij të dridhur mbi tavolinë. Zemra i rrihte fort, por kjo nuk ishte frika e zakonshme: Ishte tensioni i pritjes së së vërtetës.
Hyrja në IT – gjurmimi i dokumenteve
IT-ja filloi të analizonte kompjuterin e Arbenit, log-et e hyrjes, ndryshimet në dokumente dhe çdo aktivitet të dyshimtë. Pas rreth dy orësh, doli një e dhënë tronditëse:
- Shikoni këtë, - tha IT-ja duke e treguar monitorin. - Dokumenti është krijuar nga një përdorues tjetër, me hyrje nga makina e doktor L.K. Ai ka aksesuar folderin e Arbenit në orën 22:45, kohë kur Ardiani ishte në sallën e urgjencës.
Drejtori ngriti vetullat.
- Kjo është e papranueshme! - tha ai. - L.K. nuk ka shpjegim.

Psikologia përpiqej të qetësonte Arbenin, që ndihej i tensionuar dhe i emocionuar.
- Shiko… kjo qe zbuluam është e drejtë, - i tha ajo butë. - E vërteta po del. Tani është momenti yt, por nuk duhet të humbasësh qetësinë.
Thirrja e doktor L.K.
Drejtori thirri menjëherë L.K. në zyrë. Ai hyri me një buzëqeshje të lehtë, që u zhduk kur pa të gjithë ekipin përballë tij: Drejtori, psikologia dhe Arbeni.
- Doktor L.K., - tha drejtori ftohtë. - Ka prova që ju keni falsifikuar dokumente dhe keni përpjekur ta sabotoni shefin tuaj. Si e shpjegoni këtë?
L.K. heshti. Zëri i tij dhe pamja e sigurt u shua.
- Unë… nuk e…kam bërë.
Ai u ndal, vetëm shikoi si i habitur. Psikologia iu afrua pak:
- Nuk e ke, "nuk e ke bërë". Log-et janë aty. Kompjuteri nuk gënjen. Mashtrues i pabesë, - tha ajo dhe përplasi dokumentet në tokë
Arbeni mori frymë thellë. Zëri i tij ishte i qetë, por i fuqishëm:
- Nuk kam bërë asgjë të gabuar. Dhe nuk mund të toleroj që dikush të rrezikojë pacientët për ambicie personale.
Drejtori shikoi L.K.:
- Do të nisim proçedurat disiplinore. Përjashtim i menjëhershëm nga pavioni i kirurgjisë, raport i plotë tek bordi i spitalit. L.K. e dinte se nuk kishte rrugë shpëtimi. Ai

u tërhoq, i mërzitur dhe i shkatërruar. Doli jashtë më kokën ulur dhe hap të ngadaltë. Askujt s'i foli më,…..

Çlirimi dhe reflektimi

Arbeni u ul. Frymëmarrja e tij u qetësua. Truri i tij, që sapo kishte përjetuar rikthimin e kujtimeve të tmerrshme të fëmijërisë, tani ndjeu një lehtësim të papritur.

- Faleminderit! - i tha ai vetëm psikologes. - Faleminderit që qëndrove pranë meje!

- Ti e meriton këtë çlirim, - tha ajo.

- Por kujto, kjo është vetëm një betejë. Të tjerat janë ende për t'u përballuar, brenda jush.

Arbeni e kuptoi atë që kishte ndodhur: Jo çdo luftë fitohet me forcë fizike. Disa fitore kërkojnë qetësi, durim dhe drejtësi. Hijet e fëmijërisë nuk ishin zhdukur, por tani ai ndjeu se kishte një armë të re: Fuqinë për t'u përballur me to pa u fundosur.

Nata e hijes – rikthimi i së shkuarës

Ishte ora tre e mëngjesit. Pavijoni i kirurgjisë ishte i qetë. Vetëm orët e makinës së monitorimit tingëllonin të vazhdueshme, një ritëm mekanik që dukshëm nuk i qetësonte Arbenin. Ai qëndronte në zyrën e tij, duke shfletuar dosjet e pacientëve për ditën e nesërme, por mendja e tij nuk ishte tek puna. Fryma e natës dhe heshtja e pazakontë e spitalit i hapën portat e kujtimeve që kishte mundur t'i shtypte.

Papritur, një dridhje e brendshme e pushtoi. Një tingull i largët i qeshjes së fëmijëve, qepallat e vogla që e godisnin

dhe britmat e dhunës, iu duk sikur po dilnin nga muret.
Ai u ngrit nga karrigia, me duart e dridhura mbi tavolinë. Dritat e zbehta krijuan hijet e ngjashme me ato që i kishte parë në konviktin e qytetit të Librazhdit.
- Jo… mos më rrihni… Mos më merrni bukën… Ju lutem…
- pëshpëriti ai, zëri i tij i dridhur dhe i ulët, duke u kthyer përsëri fëmijë.
Salla u errësua në perceptimin e tij. Për një moment, nuk ishte më zyrë spitali. Ishte korridori i shkollës, derës së hekurit dhe depoja e braktisur. Djemtë e mëdhenj e tallnin përsëri. Ai qëndroi i fortë këtë herë, nuk e humbi toruan dhe u kthye në realitet. Psikologia po bënte punën e saj. Ai po përmisohej.
Përplasja finale – L.K. përballet me të vërtetën
Dita ishte e ngrohtë dhe drita e mëngjesit depërtonte në korridoret e spitalit. Pas zbulimit të falsifikimit të dokumenteve, L.K. po qëndronte në dhomën e pushimit me kolegët e tij, duke përpiqur të ruante vetëbesimin. Por ai e dinte se tani gjithçka po i shkonte kundër: Hetimi kishte zbuluar provat e qarta, dhe drejtori kishte marrë vendim për masat disiplinore. Arbeni u fut në dhomë, pa zhurmë, por me sytë e vendosur. Nuk ishte më i dridhur nga frika. Nuk kishte më hijet e fëmijërisë që ta pengonin. Tani ai ishte shef, profesionist dhe njeri i vendosur.
- Doktor L.K., - tha ai me zë të qetë, por të prerë. - Duhet të flasim.
L.K. ngriti kokën, me një buzëqeshje të përulur, përpjekje

për arrogancë: Nxori duart nga xhepat dhe e shikoi në sy.
- Arbeni… Nuk e kuptoj pse po më sulmon. Ishte një keqkuptim, thjesht një,… gabim teknik. - tha dok. L.K.
- Nuk është gabim teknik.
Arbeni iu afrua pak më shumë, duke e mbajtur shikimin në sytë e tij.
- Ky ishte sabotim i qëllimshëm. Falsifikuat dokumente për të më rrëzuar nga pozita dhe për të rrezikuar pacientët.
L.K. u përpoq të buzëqeshte, por zëri i tij dridhej pak:
- Nuk është e vërtetë…, s'ka prova,…- tha ai Arbeni u hutua koka filloj ti dridhet nga dialogu me L.K.
Shfryu shumë dhe gati u rrëzua në tokë.
Zërat e së shkuarës jehonin fort në mendjen e tij, të gjallë e të pamëshirshëm. Për çaste nuk arrinte të fliste. Trupi i tij po e ripërjetonte çdo goditje, çdo poshtërim, sikur gjithçka po ndodhte tani. Papritur, dera u çel dhe një dritë e zbehur u derdh në dhomë. Ishte psikologia. Ajo hyri qetë, pa nxituar dhe iu afrua me hapa të kujdesshëm. Ajo nuk kishte ikur, pasi e dinte që sëmundja do t'i përsëritej.
- Arben…Ti je këtu. Ata nuk janë këtu. Nuk mund të të bëjnë asgjë. Merr frymë me mua…Ti po përmirësohesh — tha ajo, duke i vendosur lehtë dorën mbi sup. Ai ngriti sytë, por ajo që shihte ende nuk ishin fytyra reale; Ishin hijet e fëmijërisë që nuk e linin. Zëri i tij doli sërish, i dridhur, si një lutje e dëshpëruar. Zëri i psikologes depërtoi me këmbëngulje në kaosin e mendjes së tij, i qartë dhe i qëndrueshëm:
- Kujtimet janë këtu, por ti nuk je më ai fëmijë. Këtu nuk ka

dhunë. Je i sigurt. Askush nuk mund të të prekë.
Ngadalë, hijet nisën të treten. Trupi i tij, i mbledhur dhe i tendosur, filloi të çlirohej. Zemra i rrihte ende fort, por frymëmarrja u bë më e thellë, më e rregullt.
- Mbaroi… - pëshpëriti ai, i lodhur, pothuajse i zbrazët, duke mbetur vetëm me veten.
- Po, mbaroi… - i tha psikologia, duke ia fshirë lotët. - Por tani ke parë çfarë ke qenë i mbyllur aty brenda. Do të m'i tregosh të gjitha. Dhe që nga ky çast, mund të fillojmë t'i shërojmë këto plagë.
Ai e kuptoi: Hijet nuk zhduken kurrë plotësisht, por forca për t'u përballur me to mund të mësohet. Për herë të parë pas shumë vitesh, ndjeu një çlirim të lehtë. Një hap të vogël drejt qetësisë që kishte kërkuar gjithë jetën.
- Po, mundem, - tha Arbeni dhe e ndërpreu. - sepse tani e di të vërtetën. Ti do të më shërosh. E di…Tani nuk ka më hije që të më trembin. Nuk ka më frikë që të më ndalojë.
Drejtori u shfaq në derë, me fytyrë të prerë:
- Doktor L.K., këto këtu janë proçedura disiplinore. Do të fillojnë menjëherë. Përjashtim nga pavioni, raport tek bordi i spitalit dhe paralajmërim i shkruar.
L.K. u ngrys. Tani nuk kishte mënyrë shpëtimi. Ai e kuptoi se çdo lojë dhe manipulim kishte përfunduar.
- Ti… nuk do të fitosh, - tha ai, por zëri i tij nuk kishte më forcë. - Je një psikopat me veshje doktori.
- Pusho, - tha Arbeni. - Unë…….
- Nuk bëj lojëra. Nuk përpiqem të zë vendin askujt në

mënyrë të pandershme. Unë mjekoj, nuk sabotoj. Dhe ky spital nuk ka vend për egoizëm dhe dhunë profesionale.
Arbeni u kthye me shpinë nga ai dhe u largua nga dhoma. Pas tij, L.K. qëndronte i shokuar, duke kuptuar se jo vetëm profesionisht, por edhe psikologjikisht. Arbeni kishte fituar betejën.
Psikologia, që ishte e pranishme, iu afrua Arbenit tek zyra e tij dhe i tha me një buzëqeshje të butë:
- Ja ku je. Jo vetëm se i mbijetove hijes së së kaluarës, por tani bëre edhe drejtësi. E vendosëm përpara syve të të gjithëve.
- Kisha mbledhje me redaksinë. Të kam shkruar disa herë, por nuk më përgjigje. Ai ngriti telefonin. Ishte i fikur. Një ndjenjë e thellë paniku e pushtoi. Mendimi se ajo mund të kishte harruar, ose më keq, mos të donte të fliste me të, i rrëzoi zemrën.
Heshtja e dhomës u bë më e rëndë dhe hijet në mur dukeshin sikur e pyesnin gjithashtu:
- A mund të kontrollosh atë që nuk ekziston, Arben?
- Mos e bëj këtë më, të lutem. Mos dysho për gjithçka. Po më ngufat, - i tha ajo butë, duke i prekur faqen. Por ai u tërhoq.
- Ti je e imja…, dhe unë jam i yti, apo jo? Mos më detyro të mendoj gjëra të tjera.

- Arben, dashuria nuk është pronësi, - foli prerë ajo duke e shikuar në sy.
Ai buzëqeshi rrezikshëm.
- Epo unë kështu e kam mësuar: dashuria, xhelozia, psikopatia.
- E kemi diskutuar një mijë herë: psikopatia shërohet me ujë të ftohtë! - tha ai me një sarkazëm të hidhur, duke cituar kolegun e tij të vjetër.
Elira u step.— Këto nuk janë më shaka… Ai iu afrua shumë pranë, aq sa mund t'i ndiente frymëmarrjen e tha:
- Unë e di çfarë është dashuria. Dashuria është luftë. Është fiksim. Është zjarr. Po ta mora unë këtë zjarr, të gjithë të tjerët do të digjen nga ai. Kush të prek ty, prek mua.
Ajo u tërhoq një hap pas.
- Arben…frikësohem nga ajo që po bëhesh.
Ai qeshi lehtë.
- Unë jam gjithmonë unë. Thjesht… Tani jam më i sinqertë se më parë.
Dialog të tjerë të brendshëm
Dr Arbeni filloi të dridhej dhe të humbistë në erresirën e mendimeve të tij paranojake. Zërat i erdhën në vesh: "Ajo të do…, mos u çmend. Jo, ajo të tradhton. Ti je budalla që i beson. Po pse atëherë je kaq i frikësuar?"
- Nuk jam i frikësuar! Jam i sigurt! Ajo ka dikë tjetër! - Kush? Kush e ka? Kush e prek? Kush e sheh? Kush guxon? - Do ta zbuloj. Do ta zbuloj gjithçka. Në këtë moment, sytë e tij merrnin një shkëlqim të ftohtë.

Ai ishte duke rrëshqitur. Dhe askush nuk e dinte.
Rrëshqitja në errësirë
Dr. Arbeni nuk e përmbante më veten. Dyshimi, që më parë ishte një zë i heshtur brenda mendjes, tani e kishte pushtuar tërësisht. Tashmë nuk mjaftonte vetëm të mendonte. Duhej të shihte, të kontrollonte, të ndiqte çdo hap të saj. Një lloj zjarrvënie brenda tij po e shtynte përtej kufijve të arsyes. Ai u ngrit nga kolltuku, hapi dritaren dhe u përkul për të shikuar rrugën e zbrazët. Një ndjenjë e çuditshme eksitimi përzihej me frikën që i dridhte zemrën. Çdo hapa të saj, çdo ndalesë, dhe telefonatë që ajo bënte, për Arbenin ishte një mesazh i fshehtë, një provë që duhej deshifruar. Dhe filloi të ndjekë Elirën vetë. Në fillim me kujdes, duke qëndruar në hije, duke u fshehur pas mureve dhe makinave të parkuara. Çdo lëvizje e saj ishte një histori që ai po përpiqej të lexonte, një kod që vetëm ai mund ta kuptonte. Por çdo minutë që kalonte, zjarri i dyshimit rritej, duke e bërë më të vështirë të ndalonte.
Në errësirë, qyteti dukej i paqartë, hijet bashkoheshin me mendimet e tij të sëmura dhe çdo dritë e largët dukeshin si sinjale që vetëm ai mund t'i lexonte. Tingujt e rrugës, hapa të huaj, makina që kalonin, gjithçka ndërthurej me paranojën e tij: Një botë ku realiteti dhe fantazia nuk njihnin më kufij. Ai nuk po e bënte këtë nga dashuria, mendoi me një zë të brendshëm që i dridhej: Po e bënte për të shpëtuar atë, për ta mbajtur pranë vetes. Por nën sipërfaqe, ai e dinte se po rrëshqiste në një errësirë, ku asgjë nuk kishte kthim. Një

rrugë pa dalje, e mbushur me hijet e fantazmave të mendjes së tij

Fillimi i ndjekjes

Një mëngjes, kur Elira doli nga shtëpia për të shkuar në punë, ai priti pesë minuta. Mjaftueshëm sa të mos binte në sy. Mjaftueshëm sa të ndihej "strategjik" dhe survejues…

Pastaj doli pas saj, me kapuç dhe syze të errëta. Eci disa metra prapa, duke imituar ritmin e saj, duke u fshehur sa herë që ajo kthehej kokën.

Në rrugën e Dibrës, ajo ndaloi për të blerë një kafe. Ai u fsheh pas një makine të parkuar, me frymëmarrjen e çrregullt, me duart e mbërthyera fort në xhepa. Zemra po i rrifte me të fortë.

- A thua? Me kë po flet? - pëshpëriti ai.

Edhe pse ajo nuk po fliste me askënd. Pastaj e pa duke qeshur me shitësen e kafesë.

- Pse qesh? Çfarë i the? Po ia jep zemrën dikujt tjetër? - murmuriti, ndërsa sytë i dridheshin. Në imagjinatën e tij, çdo buzëqeshje ishte provë. Çdo ndalesë ishte takim i fshehtë. Çdo fjalë ishte tradhti. Mjegulla e tradhëtisë dhe pabesisë së femrave. Ia kaploi trurin dhe trupin. Ai tashmë nuk besonte më, sepse kishte lexuar dikur që femrat e bukura janë pronë e tjerëve dhe burrin e mbajnë sa për firmë.

Mbase po më ndodh dhe mua kështu mendoi ai. Edhe humbi në shkretëtirën e mendimeve të thella.

Rrjeti i spiunëve

Në mbrëmje, ai telefonoi tre njerëz që i njihte nga koha kur ata punonin në institucione të shtetit. Ishin të papunë, të braktisur, të mësuar me survejim. Kishin nevojë për para dhe Arbeni kishte shumë punë për ta.
Ai nuk humbi kohë i thirri, iu bleu rroba kapele të kuqe dhe dy biçikleta të mëdha si të SHIK-ut. Shkurt iu tha hapni sytë dhe veshët do ju punësoj. Unë s'dua pyetje. Hidhni këto rroba të vjetra. Vishuni me të zeza dhe kapelet e kuqe. Ata hapën sytë, por nuk folën. Ai ua ndërpreu hamendjet dhe tha:
- Dua të më ndiqni një person.
- Kush është? - thanë ata njëherësh.
- Gruaja ime, - përgjigji ai ftohtë.
Ata u panë mes tyre.
- Doktor… Nuk jemi mësuar të spiunojmë familjarët e njerëzve…Arbeni u ngrit në këmbë, i kuq në fytyrë. Ju jeni spiunë sigurimi të poshtër. Keni survejuar familjet dhe këdo …Jeni mashtues. Doni punë apo jo?.....E vazhdoi pa pritur përgjigjen e tyre.
- Ajo nuk është familjare. Ajo është rreziku im! Kush ta prek jetën, ta vjedh edhe frymën! Do paguheni trefish! Vetëm ndiqeni! Do të më sillni çdo detaj! ÇDO GJË! …….
Ata nuk folën më dhe…
Nuk guxuan ta kundërshtonin. Të nesërmen, ai pagoi edhe dy njerëz të tjerë: Një djalë të ri nga rrugica e ish-tregut elektrik dhe një burrë të heshtur që dikur kishte punuar në hetimet sekrete pas '91-shit. - Do të më raportoni për çdo

mik të saj, çdo koleg, çdo njeri që i afrohet, - urdhëroi ai. - Dua emrat, numrat, vendet ku takohen, çfarë flasin. Ajo nuk duhet të më fshihet më.

Fillon spiunimi i miqve të Elirës

Në redaksi, Elira u pa duke folur disa herë me kolegun Arlindin. Ishte normalitet pune, por normaliteti nuk ekzistonte më për Arbenin.

Një nga njerëzit e tij, Shkëlqimi, i dërgoi fotografi.

"Ja ku po pinë kafe. Janë vetëm. Po qeshin."

Arbeni i pa fotot me duar që i dridheshin.

- Me kë po qesh kështu? Kush je ti, Arlind? Kush mendon se je?

E mori numrin e tij dhe e ruajti në telefon. Në mbrëmje, i telefonoi fshehtazi.

- Alo? Kush jeni?

Arbeni nuk foli. Vetëm dëgjonte frymën e tij të rëndë në receptor.

- Alo? Kush është?

Arbeni mbylli telefonin.

- Do ta shohim… Do ta shohim se kush është ai, - tha me zë të ulët, me një qetësi të frikshme.

Observimi i miqve të saj të ngushtë

Një ditë tjetër, Elira u takua me shoqen e saj të ngushtë, Albën. Po diskutonin për një reportazh.

Një burrë me kapuç po rrinte në një tavolinë më tutje. Ishte njeri i Arbenit. Po i fotografonte. Ai ishte profesionit dhe bënte sikur nuk i shikonte, por raportoi direkt…

Raportimi i erdhi shkurt: “Me një shoqe. Po flasin për punë. Nuk ka burrë me ta.”
Por Arbeni nuk besoi. Ai nuk beson më informacion, as prova, as logjikë— Po ai djali në tavolinën tjetër? Po kamerieri që i shikoi dy herë? Po ai që kaloi në trotuar dhe kthente kokën? Nuk më gënjeni dot! Ajo është e rrethuar! Njeriu i tij që po e vëzhgonte nuk foli më. Ishte më mirë të mos fliste.
Katandisja e brendshme
Në shtëpi, një mbrëmje të zymtë, Elira iu afrua me zë të butë, sikur po i fliste një fëmije që kishte humbur rrugën.
- Arben… çfarë ke? - i tha me kujdes. - Po më dukesh shumë i lodhur. Nuk po fle mirë. Sytë t’i kam parë gjithë natën hapur. Mos po të mbyt puna?
Ai qeshi shkurt, një e qeshur pa gëzim, që u shua shpejt në ajër.
- Puna…? - përsëriti me ironi. - Po, puna më mbyt. Puna për të ruajtur dashurinë tonë… Atë që ti po ma vjedh ngadalë.
Elira u step.
- Unë? - tha me zë të dridhur.
- Unë po ta vjedh dashurinë?
- Po, - tha ai pa hezitim. - Me buzëqeshjen tënde që nuk ma jep më. Me heshtjen që më përjashton. Me telefonatat që i fsheh. Me sekondat që kalojnë pa m’u përgjigjur. Me çdo hap që bën pa mua, sikur unë të mos ekzistoja. Ajo ngriti sytë, e tmerruar. Në fytyrën e tij nuk pa më njeriun që kishte dashur, por një hije të tensionuar, të ftohtë.

- Arben,… kjo që po thua është xhelozi e sëmurë.
Ai lëvizi kokën ngadalë, si dikush që refuzon të dëgjojë.
- Jo. Kjo është dashuria në gradën e fundit. Dashuria që nuk duron mungesën. Dashuria që nuk pranon ndarje.. - U ndal për një çast dhe e shikoi drejt në sy. - A nuk të pëlqen të dish që dikush i ka sytë vetëm tek ti? Që jeton vetëm për ty? Ai jam unë.
- Kështu nuk do askush, Arben… - tha ajo, duke u tërhequr një hap pas. - Kjo nuk është dashuri. Kjo është kontroll.
Ai u afrua. Një hap i vetëm, por i mjaftueshëm për ta mbushur dhomën me ankth. Fryma e tij u bë më e rëndë, zëri më i ulët.
- Kontrolli është mënyra e vetme për të mos humbur atë që do, - tha. - Dhe unë nuk kam ndërmend të humbas asgjë.
Elira ndjeu se diçka e padukshme po mbyllej rreth saj, si një kafaz që nuk bënte zhurmë kur mbyllej.
- Po, është kontroll. Kontrolli e shpëton dashurinë. Pa kontroll, dashuria vdes. Unë po e mbaj gjallë.
Ajo u tërhoq. Ai e pa këtë si provë.. Ishte më mirë të heshte sesa të hynte në një dialog të pakuptimtë me tjetrin, — burrin e saj.
Zërat e brendshëm
Atë natë, ai foli përsëri me veten.
- Ajo po më tradhton.
- Jo, Arben, ndoshta s'po të tradhton.
- Po. Po e bën. Ti e di. Ti gjithmonë ke pasur ndjesi të fortë.

- Duhet ta ndjekësh. Vetë. Nuk mund t'i besosh më askujt tjetër.
- Po miqtë e saj? Ata të qeshin mbrapa shpine.
- Do t'i vëzhgoj të gjithë. Do t'i zbuloj një nga një. - Dhe kur ta gjej kush është ai burrë…
- Po, çfarë do bësh, Arben?
- Do t'ia mbyll gojën. Përgjithmonë…….

Ai qeshi i vetëm në dhomë dhe drita e llampës dridhej sikur vetë dhoma të kishte frikë prej tij. Dhe nga fijet e padukshme të kontrollit

Arbeni nuk mjaftohej më duke ndjekur. Tani duhej të ndërhynte. Të kontrollonte. Të manipulonte gjithçka rreth Elirës - Punën, kohën, njerëzit. Ai besonte se "dashuria ka të drejtë mbi gjithçka".

Mesazhet e fshehta

Një natë, Elira ishte duke fjetur. Arbeni mori telefonin e saj nga komodina, me kujdes që të mos e zgjonte. Gishtat i lëviznin me shpejtësi, të drejtuar nga një paranojë që nuk e kontrollonte më. Dërgoi mesazh te redaktori i saj: Ai u kënaq që ajo ishte në gjumë dhe se dëgjoi mirë, pastaj skërmiti dhëmbët e shkruajti.

"Nesër s'do vij dot në intervistë. Jam sëmurë. E shtyjmë për të hënën." Pastaj fshiu gjurmët. Dërgoi një tjetër te kolegu Arlind: Nuk kam ndërmend të dal më me ty për kafe. Të lutem mos më shkruaj."

Pastaj fshiu edhe këtë dhe një të tretë te shoqja e saj Alba:

"Po dua pak hapësirë, të rri vetëm. Mos më telefono për disa ditë."

Pastaj e vendosi telefonin në vend dhe u kthye në shtrat. Elira në gjumë murmuriste diçka të butë. Ai e shikoi me një lloj ngrohtësie të sëmurë.

"Po të mbroj… po të shpëtoj nga njerëzit që të tërheqin drejt gabimit," - pëshpëriti e pastaj.

Ai e puthi lehtë në ballë dhe përsëriti:

- Dashuria është kapuçi që të mbron nga bota. Unë jam kapuçi yt.

- Takimi i prishur

Të nesërmen, Elira u drejtua për një intervistë të rëndësishme me një biznesmen të madh. Një punë e madhe, një hap profesional.

Arbeni e kishte mësuar vendin e takimit. Kishte mbërritur një orë më parë. U afrua te recepsioni.

- Përshëndetje. Jam nga RTSH… - tha, duke përmendur emrin e Elirës. - Takimi i saj është anuluar. Ka një urgjencë familjare.

Recepsionistja u hutua. - A jeni i sigurt? Ai shfaqi një kartë identiteti të vjetër, të skaduar, por që dukej zyrtare.

- Patjetër. Më njoftuan mua direkt. Ju lutem, anuloni gjithçka.

Kur Elira mbërriti, biznesmeni nuk ishte më. Takimi ishte fshirë. Ajo telefonoi redaktorin.

- Pse s'më the që e shtymë takimin?

- Unë? Unë nuk të kam thënë gjë të tillë. Ti vetë më the që ishe sëmurë!

Elira u mpak.

- Jo… jo, unë nuk kam thënë asgjë.
Për disa sekonda, heshti. Një hije dyshimi i kaloi në mendje, por jo për punën për veten e saj.
- Mos po harroj gjëra? Mos jam e lodhur?
Arbeni, nga larg, e pa duke u kthyer me hap të rëndë. Dhe buzëqeshi.
- Sa e brishtë është…, sa lehtë thyhet…Ajo është bukuria e tokës dhe hënës. Ajo është planeti që ekzisto vetëm për mua.
Filozofia e errësirës
Në mbrëmje, Elira i tregoi gjithçka.
- Sot më ndodhi diçka shumë e çuditshme. Dukeshin sikur gjërat ishin manipuluar. Dikush i ka prishur…
Arbeni uli kokën, me ton të butë, gati poetik.
- Ndonjëherë universi na mbron nga takime që nuk na duhen. E ke menduar këtë?
- Nuk ishte universi, Arben. Ishte dikush që po ndërhynte në jetën time.
Ai mori një gotë verë dhe tha me zë filozofik:
- Njeriu nuk humbet në rrugën e vet. Humb kur njerëzit i hapin dyer që s'duhet t'i hapë. Dashuria është mbyllja e këtyre dyerve Elira ngriti vetullat.
- Dashuria nuk është burg.
- Jo, - tha ai me zë të qetë, - Dashuria është udhëheqje. Nëse dikush të do, të udhëheq. Po s'të udhëhoqi, të humbi. Po të la të lirë…, të braktisi.
Ajo e pa, e hutuar.

- Këto nuk janë fjalë të shëndetshme…
Ai buzëqeshi.
- Janë fjalë të sinqerta. Bota është e rrezikshme, Elirë. Xhelozia nuk është sëmundje. Xhelozia është syri i tretë i dashurisë. Ajo sheh atë që zemra nuk e sheh.
- Nuk dua të jem pjesë e një dashurie të tillë… - tha ajo me zë të dridhur.
Ai iu afrua pranë veshit dhe i pëshpëriti:
- Dashuria, kur të gjen, nuk të lë rrugë shpëtimi.
- Të gjithë largohen, të gjithë kthehen. Askush nuk i shpëton zemrës së vet.
Pastaj u largua drejt kuzhinës, duke qeshur me vete.

Një mesazh i frikshëm
Pak më vonë, telefoni i Elirës vibroi. Ishte një mesazh nga një numër i panjohur:
"Mos u tako më me Arlindin. Ai nuk është ai që mendon."
Ajo ngriti sytë nga ekrani dhe hodhi vështrimin drejt Arbenit, i cili po hante darkë. Fytyra e tij ishte e qetë, pothuaj e lumtur, sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Ajo u drodh.
- Arben… A ma dërgove ti këtë mesazh?
Ai e pa me një buzëqeshje të butë.
- Çfarë mesazhi?
Ajo ia zgjati telefonin. Arbeni ngriti supet.
- Duhet të jetë ndonjë i çmendur që të ndjek në Instagram. Je e bukur, Elirë. Të ndjekin shumë sy…

Ajo nuk foli më. Por zemra i rrihte fort.
Diçka po thyhej brenda saj.
Mbyllja e rrjetit
Gjatë ditëve në vijim, mesazhet u shtuan në inbox-in e saj:
"Miqtë e tu po qeshin me ty. Kujdes nga ai që të sheh te redaksia."
"Mos i beso shoqes tënde."
"Dikush po të prek zemrën."
Ajo filloi të dyshonte për të gjithë. Ndërkohë, Arbeni i thoshte me ton të qetë:
- Njeriu duhet të dyshojë, Elirë. Dyshimi e mban të gjallë. Dashuria e vërtetë të bën paranojak dhe paranoja është mënyra më e sigurt për të ruajtur atë që ke.
- Ti po e çmend këtë dashuri, - tha ajo.
Arbeni buzëqeshi lehtë, i qetë si deti para stuhisë.
- Jo, unë po e ngjall. Po e ruaj, - tha Arbeni. - Dashuria do luftë mbrojtje dhe sulm. Dashuria vdes vetëm kur qetësohet. Dashuria e fortë është gjithmonë e sëmurë pak. A nuk është kështu?
Ajo e kuptoi për herë të parë. Nuk ishte më i njëjti njeri.
Dhe ai nuk kishte ndërmend të kthehej. Ajo kuptoi që ky njeri po ikën në erresirë. Sëmundja e tij është bërë e pashërueshme. Ajo tashmë e ka mbuluar komplet atë njeri të mirë, - tha ajo.
Survejimi i Tiranës
Në ditët kur fama e quante veten "bekim", Dr. Arbeni e kuptoi se ajo ishte helm, i ëmbël në fillim dhe i hidhur deri në kockë në fund.

Sa më shumë e përmendnin në media, aq më shumë zgjoheshin brenda tij zërat e dikurshëm. Zërat e asaj kohe të errët të fëmijërisë, kur Tirana dukej një qytet i vjetër ushtarakësh, survejimesh dhe dyshimesh pa fund. Dhe tani… Gjithçka po kthehej. Dashuria e tij për Elirën, gazetarja e bukur dhe ambicioze, ishte bërë fillimisht shpëtim. Por shpejt, shumë shpejt, shpëtimi u kthye në rrënim.

Dashuria kaloi në xhelozi. Xhelozia në dyshim. Dhe dyshimi… në psikopati.

Zërat që s'u ndanë më heshtjen.

Arbeni ecte në dhomë me hapa të shkurtër, trupin pak të përkulur, duart e futura në xhepa. Fliste ngadalë, duke përsëritur fjalë që askush s'i dëgjonte.

- Më gënjeu,… po, më gënjeu… Jo, nuk mund të jetë rastësi…

- A e pe si më pa mbrëmë? Si dikë që s'ka më nevojë… Hapat e tij ndaluan. Ai ktheu kokën majtas, sikur dikush i fliste nga hija e murit.

- Ju? Po ju? Tani ju flisni, apo jo? Ju keni përfunduar në plehra… sepse ishit plehra!

Ai ngriti zërin dhe hija u shtrembërua në mur, por askush nuk ishte aty. Vetëm mendja e tij që thyhej me ngadalësi. Ai komunikonte me hijet. Sëmundja iu kthye.

Mesazhet e fshehta

Elira fillimisht nuk e kuptoi ç'po ndodhte. Në telefonin e saj nisën të vinin mesazhe që nuk mbanin emër: "Mos dil sot." "Rri në shtëpi. Dikush të ndjek." "Nuk është e sigurt

të takosh njerëzit që takon." "Ata s'të duan siç të dua unë." Në fillim ajo mendoi se ishte dikush i bezdisshëm. Ajo u frikësua shumë shpesh kujtoi që dikush po e ndiqte, pastaj e kuptoi ritmin. Orën. Mënyrën si përshkruhej çdo lëvizje e saj. Vetëm një njeri mund t'i dinte, Arbeni.

Takimi me Bac Dhelprën

Që prej asaj dite, Arbeni mori vendimin fatal: Të takonte kryetarin e ShIK-ut të vjetër, njeriun e njohur vetëm me një nofkë: Bac Dhelpra. Zyra e tij ishte ngjitur me spitalin "Nënë Tereza". Një dhomë me mure të vjetra, me erë dosjesh të djegura dhe duhani shtetëror. Kur Arbeni hyri, ai e priti me ceremoni.

Ashtu siç priten njerëzit e famshëm dhe njëkohësisht njerëzit e dobët.

- Doktor Arben! Më në fund na erdhe. Je bërë i madh. Të njeh e gjithë Tirana.

Kryetari buzëqeshi me një qetësi që të fuste të ftohtin deri në palcë.

- Për çfarë ke ardhur?

Arbeni nuk foli menjëherë. Heshti, sikur po e matëte peshën e fjalëve. Pastaj pëshpëriti:

- Ajo… më tradhëton. Kam nevojë të ndiqet. Dua survejim të pastër. Dua… metoda si dikur. Të njëjta, por më shkencore.

Bac Dhelpra ngriti vetullën.

- Si dikur?

- Po. Pikërisht si dikur. Fizik. Psikologjik. Total. Një qeshje e ngadaltë, e thatë, mbushi zyrën.

- Atëherë,… do t'ju rikthejmë historinë. Disa nga njerëzit tanë po na presin…

Ai thirri menjëherë specialistin e kësaj fushe i cili vinte nga errësira sigurimit. Ai tha thirreni atë. Ymer Calamani — Monstrën që bënte të gjitha pislliqet e kryetarit.

U hap dera. Brenda hyri duke çaluar një burrë rreth të gjashtëdhjetave, me këmishë të bardhë dhe një buzëqeshje të ftohtë, të thatë. Emri i tij ishte i frikshëm në korridoret e vjetra të sigurimit:

Ymer Calamani. Ish-pedagog. Ish-survejues. Thuhej se dinte 47 mënyra për t'i thyer psikologjikisht njerëzit. Asnjë prej tyre nuk përfshinte dhunë fizike. Ishin më të këqija.

Ai përshëndeti me servilizëm:

- Doktor,… është nder për ne. Çfarë të duhet? Survejim i thjeshtë? Apo… ai i vjetri?

Bac Dhelpra ndërhyri:

- Zbato detyrën. Mos fol pa të thënë unë. Ai mbylli gojën e uli shikimin poshtë. Ishte veshur me kostum blu dhe këpucë të zeza llustrafin.

- Ngrije kokën, - urdhëroi kryetari, - Dhe dëgjo: Doktori është mik i yni. Jo pyetje. Merr shënim se çfarë të thotë ai. Kaq bëj dhe vepro.

Calamani buzëqeshi edhe më shumë – Dhe sa herë buzëqeshte, dukej sikur fytyra e tij po vishej me një maskë njeriu, por nën të kishte diçka tjetër.

Uniformat e zeza dhe kokat e kuqe

U vendos që survejimi të kryhej nga një skuadër e vogël prej tetë vetash — ish-agjentë të mbetur në hije, të papunë,

të shpërndarë në periferi të qytetit, që prisnin vetëm një shans për t'u rikthyer në zanatin e vjetër.
Arbeni pagoi njëzet mijë dollarë aty për aty.
Kryetari dhe Ymeri buzëqeshën me një ironi të përmbajtur, pothuaj të gëzuar. Nuk ishin pak para.
Arbeni e theu heshtjen. Zëri i tij ishte i ulët, por prerë:
- Dëgjoni këtu, njerëz të ligj…Pastaj dha urdhrin absurd, me një qetësi që të shqetësonte:
- Dua t'i vishni me xhaketa të zeza. Dhe,… me koka të kuqe. Ligësia juaj po na hyn në punë. Ai e nguli shikimin te Kryetari.
Bac Dhelpra e vështroi me dyshim.
- Pse të kuqe?
- Sepse Tirana duhet pastruar nga e keqja. Hija duhet të ketë ngjyrën e luftës. U morëm vesh, apo jo? - tha Arbeni.
Calamani u përkul lehtë, si në një rit të vjetër miratimi.
- Si të urdhëroni, doktor. Hija do të ketë ngjyrën që doni.
Dhe kështu lindi skuadra e re e Tiranës:
Hijet e Kuqe
Fillon ndjekja e Elirës. Ata e ndoqën Elirën kudo.
Në kafe.
Në takime pune.
Në intervista.
Edhe kur dilte vetëm për të marrë ajër.
Arbeni nuk iu besonte njerëzve të vet. Shpesh dilte edhe vetë pas saj, me sy të kuq, me hap të shpejtë. Shkruante shpejt në një bllok të vjetër:

"Ora 18:03, flet në telefon. Me kë? Pse buzëqesh?
18:47, takon mikeshën… ose e thotë se është mike…
20:10, dikush e përshëndet. Mendja më thotë: Është ai?"
Shpesh zëri i tij ndryshonte nga butësia në shpërthim.
- Pse bën kështu? Pse nuk më thua të vërtetën? Unë dua vetëm të të mbroj…Dhe prapë i dërgonte mesazhe anonime:
"Mos e tako atë burrë sot. Ai është i keq."
"Ai po të shfrytëzon. Shiko po nuk të kërkoi seks."
"Unë vetëm të dua. Vetëm kaq."
Pastaj i lutej me mëshirë, dhe ironi
"Më thuaj të vërtetën ose do të humbasim të dy. Të gjitha këto parulla i shkruante dhe në mure ku kalonte ajo…."
Filozofia e errët e dashurisë së tij.
Në ditarin e tij, ai shkroi një fjali që më vonë do ta tmerronte këdo që do ta gjente.
"Dashuria është një luftë. Xhelozia është uniforma. Psikopatia është arma."
Dhe poshtë saj shënoi: "Elira duhet të shpëtohet. Edhe nëse HIJET E KUQE HYJNË NË JETËN E ELIRËS."
Në ditët që pasuan, Tirana u mbush me lëvizje të padukshme.
Shfaqeshin si hije në cepat e syrit dhe zhdukeshin kur ktheje kokën. Ishin të heshtur, të shpejtë, të bindur. Të veshur me xhaketa të zeza dhe maska të kuqe që shkëlqenin në dritën e dobët të natës.
Ishin njerëzit e Dr. Arbenit. Ish-agjentët e rikthyer në Hijet e Kuqe.

Ditët e para të survejimit
Elira nuk e ndjeu menjëherë.
Në mëngjeset e para thjesht i dukej sikur dikush e shikonte në trotuar. Kur dilte nga shtëpia e saj në Rrugën e Dibrës, një makinë gri ndalonte diku më larg, por motori nuk fikej. Dritat e brendshme mbeteshin të zbehta, si sy të fshehur pas velave. Në një varkë që udhëtonte mes detit.
Një nga Hijet e Kuqe raportonte: "Objekti po lëviz. 07:53. Po niset drejt redaksisë."
Tjetri përgjigjej: "Qëndroni pas saj. Mos u afroni. Duhet ta mendojë se jeta vazhdon normalisht."
Por jeta e saj nuk do të vazhdonte më normalisht. Ajo tashmë është objekt i një qënieje të sëmurë dhe paranojake. Elira ndjen ftohtësinë.
Në redaksi, Elira filloi të vinte re se dikush e priste gjithmonë te hyrja. Jo çdo ditë në të njëjtën orë, por gjithmonë në të njëjtin vend. Një burrë i gjatë, i veshur thjesht, me një pamje aq të zakonshme sa bëhej e padukshme. I jepte përshtypjen e një punonjësi të zyrës tatimore, të legalizimeve, ose të ndonjë departamenti anonim — Atyre që askush nuk guxon t'i pyesë pse janë aty. Ai i hapte derën me një buzëqeshje neutrale, të saktë, të stërvitur.
- Mirëmëngjes, zonja Elira!
Zëri i tij nuk mbante as miqësi, as kërcënim. Ishte thjesht zyrtar.
Një mëngjes, Elira e ktheu kokën nga kolegia e saj, Monda.
- A e njeh atë burrin?

Monda ngriti supet, pa u shqetësuar shumë.

— Jo. Vetëm shoh që është shpesh këtu. Ndoshta ndonjë kontroll institucional… Kështu janë tani. Vijnë gjithmonë pa paralajmërim.

Elira pohoi me kokë, por stomaku iu shtrëngua. Ishte një ndjesi që nuk kishte të bënte me frikën e zakonshme. Ishte diçka më e vjetër, më e thellë. Instinkti i një gazetareje që e njeh rrezikun përpara se ai të marrë formë. Ajo kishte mësuar ta nuhaste presionin, heshtjen e imponuar, sytë që shohin pa u dukur. Dhe tani, ai instinkt po i thoshte qartë: Dikush po e ndiqte jo hap pas hapi, por mendim pas mendimi.

Shënimet e fshehta të Arbenit

Ndërkohë, Arbeni përditë bëhej më i saktë dhe më i rrezikshëm.

Në bllokun e tij, ai shënonte çdo detaj: "08:12 – Dikush i buzëqeshi. Kush ishte Miku i asaj dite në konferencë shtypi?" Përse ka lidhje me Elirën ky?

"14:45 – Vendosi buzëkuq të ri. Për kë?"

"18:22 – Hëngri me dikë. Kamera e kalimit të rrugës s'e pa mirë."

Mbi faqe vihen edhe komente që i flasin vetes: "Të dua… Dhe ti më gënjen… pse? Pse duhet të gjej përgjigje te njerëz të tjerë, dhe jo tek ti?"

Zëri i tij përplasej në muret e dhomës, i vetëm, pa dëshmitarë: "Zoti më ruajt nga dashuria që më tradhton."

U ndal për një çast. Fryma iu rëndua. Pastaj shtoi, më zë më

të ulët, si një rrëfim që s'guxonte ta thoshte me zë të plotë: "Zoti më ruajt nga mendja ime…, që s'po e kontrolloj dot." Dritat ishin të fikura. Vetëm ekrani i laptopit ndriçonte fytyrën e tij, të zbehtë, të tendosur. Raportet vinin çdo ditë, në orare të sakta, të ftohta si dokumente morgu. Hijet e Kuqe nuk harronin asgjë: Hyrje, dalje, ndalesa, biseda pa zë, shikime të shkurtra, heshtje të gjata.

Ai i lexonte me një përqendrim të sëmurë. Çdo fjali i dukej një shenjë. Çdo boshllëk, një provë e fshehur. Edhe kur raporti thoshte "asgjë e dyshimtë", ai ndalej më gjatë. Sepse për të, asgjëja ishte forma më e rrezikshme e fajit. Një kafe e pirë vetëm, një telefonatë e humbur, një vonesë prej pesë minutash. Në mendjen e tij, gjithçka lidhej. Çdo detaj ndërtonte një narrativë që vetëm ai e shihte. Dhe sa më shumë raporte grumbulloheshin, aq më i sigurt bëhej: Jo për të vërtetën, por për dyshimin.

Hijet e Kuqe raportonin.

Ai gjykonte. Dhe realiteti, pak nga pak, po humbiste të drejtën e fjalës.

Takimi i parë i Elirës me Hijet e Kuqe

Një mbrëmje, kur Elira po dilte nga redaksia, një dritë e kuqe reflektoi tek xhami i derës. Ajo u ndal. Zemra i rrahu më shpejt. Nuk ishte dritë makine – Ishte një maskë, një fytyrë e kuqe që u zhduk sapo ajo u kthye. Uaa tha ajo mos vallë po më bëjnë sytë kështu?

- Kush… ishte ky? - tha nën zë ajo.

Dhe atë natë, për herë të parë, ajo vrapoi drejt shtëpisë. Ishte e tmerruar dhe e trembur Akoma se besonte si po

ndodh e gjithë kjo.
Hija e Kuqe raportoi:
- Objekti u shqetësua. Nuk qëndroi gjatë. Nuk mori kontakt me askënd. Misioni vazhdon.
Kjo fjali shkoi drejtpërdrejt te telefoni i Arbenit.
Arbeni buzëqeshi.
- Mirë. Mirë…, po e kupton që dikush e sheh. Ndoshta tani nuk do ta takojë atë… atë…Zëri i tij u drodh.- Atë tradhtarin……
Biseda e natës – Paranoja bëhet filozofi
Një natë ai u ul në ballkonin e shtëpisë, ndezi një cigare dhe filloi të fliste me zërin që vetëm ai e dëgjonte:- E do. Po. E do me zemër. Por dashuria, kur nuk kontrollohet… Është sëmundje.
Ai mori bllokun dhe shkroi: "Dashuria e pastër ka vetëm dy armiq: Frikën dhe fantazinë. Të dyja i kam. Prandaj vuaj."
Pastaj shtoi: "Kur dyshon, njeriu nuk dashuron më. Ai survejon."
Dhe poshtë: "Xhelozia është prova më e madhe e dashurisë. Por edhe dënimi i saj."
Iu duk se një hije i tha:
- Dhe ti po e ndëshkon, apo jo?
Arbeni u përgjigj:
- Unë po e mbroj…
Por zëri i errët brenda tij qeshi:
- E mbron nga kush? Nga ajo vetë?
Kur survejimi bëhet ndërhyrje.

Hijet e Kuqe nuk mjaftoheshin më me ndjekje. Filluan të futeshin mes njerëzve të saj. Njëri u bë kamerier te kafeja ku Elira pinte çdo mëngjes.
Tjetri u punësua përkohësisht te redaksia për "punë teknike".
Një tjetër u ul në seminarin ku ajo mbajti një prezantim për etikën e medias. Dhe i mori shënim të gjitha pyetjet që ajo bëri.
Ata i përcillnin Arbenit çdo fjalë që ajo thoshte. Një ditë i çuan këtë raport:
Objekti tha: "Nuk kam pasur kurrë ndonjë lidhje me ndonjë politikan apo funksionar. Liria e gazetarit është jeta e tij."
Arbeni lexoi me zë të dridhur: "Liria e gazetarit…, jeta e tij…"
Pastaj zëri i tij ra në tone të ulëta, të frikshme: "Pse duhet ta theksojë kaq fort këtë? Kush e pyeti? Kush e angazhon? Pse duhet të mbrohet… Nga kush?"
Ai u tmerrua, gërvishti fytyrën dhe gati sa nuk qau. Dhe aty, për herë të parë, ai e shkroi fjalinë që e çoi drejt çmendurisë: "Njerëzit mbrohen vetëm kur fshehin diçka."
Shfaqja e Arbenit në vendet ku ajo nuk e priste.
Një mbrëmje, në një event mediatik, Elira po dilte nga hoteli kur papritur dëgjoi:
- Elira.
Ajo u kthye dhe e pa Arbenin. Ishte shumë e habitur dhe hapi sytë e tha me veten, ky më ndjek. Fshiu me dorën e djathtë djersën që po i dilte papritur nga ajo që pa…..Si doli

aty? Ai nuk kishte ftesë. Nuk ishte në listë. Nuk e kishte njoftuar ajo…….
- Arben? Ç'bën këtu?
Ai buzëqeshi me një ëmbëlsi të sforcuar.
- E dija që do ishe. Më dukej e çuditshme të mos isha… pranë teje.
- Po unë nuk, … nuk ta thashë fare që do vija këtu.
Arbeni uli kokën pak.
- Po, nuk ma the. Por unë duhet ta dija. Është detyra ime,… të di.
Ajo u shtang.
- Detyra jote? Ç'do të thotë kjo?
Zëri i tij u bë i qetë. Shumë i qetë.
Aq i qetë sa ishte e frikshme.
- Të mbroj. Nga kush?
Ai afroi fytyrën pranë saj: Nga njerëzit që ti s'i sheh,… por unë i shoh.
Elira u largua një hap, duke mos ditur më nëse po i fliste i njëjti njeri që ajo kishte dashur.

Fillimi i tmerrit

Atë natë, kur ajo u kthye në shtëpi, gjeti në derë një pusullë të shkurtër:
"Mos e tako më Bac Dhelprën. Nuk është njeri i pastër."
Elira ngriti sytë." Si e dinte Arbeni, që ajo kishte intervistë me Bac Dhelprën nesër?
Pse i vinte kjo pusullë në derën e saj? Si e dinte?"
Ajo mori frymë thellë. Dhe për herë të parë, ajo protokolloi

veten me të njëjtën pyetje që i bënte shpesh të tjerëve si gazetare: "A jam duke u survejuar?"
Por ajo nuk e dinte se survejimi kishte kaluar në fazën tjetër. Në fazën kur dashuria e një njeriu mund të shndërrohet në fatkeqësinë më të madhe të dikujt tjetër. Ai i dërgon Elirës mesazhe të fshehta. Jo mesazhe të zakonshme—Por fjali të çuditshme, të shkëputura, të mbështjella me filozofi të rreme, me citime të shpikura nga libra që s'ekzistojnë. Mesazhe që vetëm një njeri në prag të humbjes së arsyes mund t'i shkruajë:
"Rruga ka sy. Ti nuk i sheh, por ata shohin atë që fsheh."
"Mos harro, e vërteta është një dritë që të djeg, jo që të ngroh."
"Nuk ka tradhti më të madhe sesa heshtja. Ai i niste të flinte natën, gjithmonë pas orës dy, sepse atëherë "qyteti fle dhe të vërtetat lëvizin lirshëm".
Fillon t'ia prishë takimet. Ndodh gjithmonë në mënyra të çuditshme: Dikush e thërret Elirën për një urgjencë të rreme. Një telefonatë anonime njofton për "probleme me makinën", për "dikë që ka rënë në tokë tek po blinte në dyqan". Dikush që e thërret për "punë të rëndësishme" etj. Arbeni nuk shfaqet kurrë personalisht.
Ai vetëm lë gjurmë. Të ftohta. Të padukshme.
Të frikshme. Ai i njeh të gjithë miqtë e saj, sheh oraret e tyre, vendet ku darkojnë, madje edhe mënyrën si qeshin. Dhe çdo detaj e përdor kundër saj. "Sa herë të qeshësh me të tjerët," i shkruan një natë, "kujtohu se diku dikush po të

vëzhgon tek e qeshura."
Miqtë e Elirës shndërrohen në objektiva.
Arbeni e bind veten se secili prej tyre është "lidhja e dobët", "shkaku i prishjes së pastërtisë morale".
Një nga shokët e saj të ngushtë fillon të shikojë makina që e ndjekin.
Një tjetër sheh në derë një letër pa emër: "Ti e di pse."
Një shoqe e Elirës merr një thirrje: Një burrë i panjohur i thotë të qëndrojë larg saj, "për të mirën e qytetit".
Në fakt, gjithçka është vetëm pasqyra e një paranoje që po i gërryen trurin.
Në sytë e tij, dashuria është shndërruar në një luftë të heshtur. Një betejë morale ku ai është ushtari i vetëm, i vetmi që "sheh të vërtetën"
Por në realitet, ai është thjesht një njeri që po fundoset, dalëngadalë, në territoret e errëta të vetes.

MËNYRAT E SURVEJIMIT NDAJ ELIRËS

Vëzhgim i përditshëm nga "hijet e qytetit"
Ish-agjentët ndjekin rutinën e saj: Rrugët nga shtëpia në punë, kafet ku ndalet, orët kur del në ballkon, njerëzit me të cilët flet edhe për pak sekonda.
Raportet i dorëzohen Arbenit çdo mbrëmje, të shkruara me dorë, si dikur në vitet e tranzicionit.
Informatorë të infiltruar në ambientet e saj
Arbeni paguan kamarierin e kafes ku ajo shkon çdo mëngjes, recepsionisten e qendrës ku punon, një shitëse libri që e përshëndet shpesh. Të gjithë i raportojnë atij lëvizjet dhe

humorin e Elirës, duke mos ditur as përse e bëjnë.
Kontroll i telefonatave dhe numrave të panjohur
Arbeni përdor njohuritë e ish-oficerëve: Identifikojnë çdo numër që i telefonon Elirës, zbulojnë profesionin dhe adresën e secilit kontakt të saj, madje regjistrojnë oraret si "model sjelljeje".
Ai e bind veten se nga këto mund të zbulojë "tradhtinë".
Fotografi të fshehta në distancë
Njëri prej njerëzve të tij përdor një aparat të vjetër me teleobjektiv:
Foto teksa ajo pret autobusin, foto kur ajo qesh me një shoqe. Foto kur ajo ndalet për të lidhur flokët.
Arbeni i mban në një dosje të quajtur "Projekt Tirana".
Ai përdor. Makina që e ndjekin me distancë të sigurt. Asnjëherë e njëjta makinë. Asnjëherë i njëjti shofer. E lënë të mendojë se rastësisht ndodhet gjithmonë pranë tyre. Një makinë, por në çdo kthesë, dikush e shikon, dikush shënon kohën, vendin, fytyrën.
Vëzhgim i miqve të saj
Për secilin mik të Elirës hapet një dosje e vogël, pothuajse si një regjistër sekret: Oraret e aktivitetit të tyre ditor, profesionet, lidhjet familjare, vendet ku shkojnë me Elirën, zakonet e përbashkëta dhe gjestet e vogla që i zbulojnë brenda marrëdhënieve të tyre. Çdo detaj është një copëz e një mozaiku që Arbeni përpiqet të kuptojë. Ai kërkon të zbulojë "cilin prej tyre ajo e ka të dashur", si një hetues që nuk ndalon para asnjë detaji të vogël. Sa më shumë

të gërmojë, aq më shumë çmendet. Mendimet i shkojnë nga një skaj në tjetrin: Ndonjë mesazh i fshirë, një 'like' i dyshimtë, një koment që duket i zakonshëm, por që ai e sheh si një shenjë të fshehtë. Çdo vështrim që ajo ia hedh dikujt tjetër kthehet në dyshim, çdo buzëqeshje bëhet një provë e fshehtë. Ai fillon të ndjejë një paranojë që i shndërron kujtimet e përbashkëta në skena të rrezikshme, ku çdo mik mund të jetë një rival, çdo bisedë një komplot.

Kontroll i rrjeteve sociale

Një ish-informativ i SHISH-it do të ishte i lumtur me pasionin e tij për detajet: Arbeni analizon të gjitha lëvizjet e saj online. Oraret kur ajo hyn në platforma sociale, fotot ku është tagguar pa dijeninë e saj. Njerëzit që pëlqejnë postimet më shpesh, mesazhet që fshihen menjëherë sapo shfaqen. Çdo reagim i Elirës kthehet në një provë imagjinare në librin e tij të supozimeve: Një 'like' i vonuar, një koment i thjeshtë, apo mungesa e reagimit në një postim, për Arbenin është një mesazh i koduar. Ai ndonjëherë rri deri vonë, duke krahasuar imazhet, duke numëruar herët e fundit kur ajo ka ndryshuar statusin. Duke regjistruar çdo detaj në një tabelë që vetëm ai e kupton. Çdo informacion i vogël ngrihet në një histori të plotë. Edhe çdo histori e plotë e shndërron Arbenin në një hulumtues të obsesionuar, që e humb kufirin mes realitetit dhe imagjinatës. Ai survejon të gjithë ata që kanë të bëjë me të.

Mes tyre është edhe një person që punon si teknik. Ai është ai që Arbeni e sheh si më të parrezikshmin: Gjithnjë afër,

gjithnjë i disponueshëm, i ditur për detajet që Arbeni i kërkon me pasion. Çdo fjalë e tij, çdo gjest i zakonshëm, për Arbenin merr një kuptim tjetër – Ndonjëherë të pafajshëm, ndonjëherë të rrezikshëm. Ai përpiqet të dallojë mes të zakonshmes dhe të fshehtës, të dallojë të vërtetën nga një shenjë e krijuar rastësisht.

Ndërsa ditët kalojnë, Arbeni zhytet më thellë në rrjetin e saj social, duke harruar shpesh realitetin, duke humbur kontakt me miqtë e tjerë edhe duke krijuar një univers të tijin, ku çdo mik është pjesë e një plani të fshehtë, çdo mesazh fshehur është një provë dhe çdo moment i heshtur i Elirës bëhet një skenë dramatike në teatrin e mendjes së tij. Ai futet në shtëpinë e Elirës si "riparues antene" dhe vendos një mikrofon të vogël në shkallë, që kap vetëm zhurma të përgjithshme — por për Arbenin mjafton. Çdo hije, çdo hap në korridor, për të është "provë e lëvizjeve të saj të fshehta".

Vëzhgim natën

Dy prej tyre qëndrojnë në errësirë, duke ruajtur nga larg dritaren e saj. Çdo lëvizje e Elirës bëhet një mesazh: Kur fik dritën, kur hap perden, kur shfleton diçka në letër para se të shtrihet për të fjetur. Arbeni i lexon këto si "kode", si shenja të fshehta të një bote që vetëm ai mund ta deshifrojë. Ai beson se edhe mënyra si fik dritën, ritmi i veprimeve të saj, apo zvarritja e duarve mbi tavolinë para se të shtrihet, flasin për gjëra të fshehta që askush tjetër nuk i sheh. Çdo gjest i zakonshëm kthehet për të në një mesazh të koduar.

Raport psikologjik i rremë për Elirën

Një ish-oficer, i njohur për aftësitë e tij në analizën e sjelljes, i ka bërë Arbenit një raport të përgatitur me kujdes, por të rremë:

"Ekziston prirja që ajo të fshehë gjëra. Nuk qëndron gjatë në një vend. Shmang kontaktin me sy. Ka ndryshuar mënyrën e veshjes."

Arbeni e merr këtë raport si të vërtetë absolute, si një manual për të kuptuar çdo veprim të saj. Çdo fjalë e raportit shndërrohet në një udhëzim për veprime edhe më të rrezikshme dhe paranoja e tij nis të rritet. Ai fillon të kontrollojë çdo detaj, të regjistrojë çdo moment dhe të interpretojë çdo heshtje si një kërcënim të mundshëm.

Hijet në aksion

Rrjeta e zezë ngrihet, duke lëvizur në heshtje dhe duke mbushur natën me tension. Që nga ajo natë gjithçka ndryshon. Çdo dritë që shfaqet në dhomën e saj, çdo hap i përgjumur, çdo tingull i vogël kthehet në pjesë të një puzzle të frikshme. Arbeni ndjen se po hyn në një lojë të madhe, ku realiteti dhe imagjinata përplasen dhe ku çdo veprim i tij mund të ketë pasoja të paparashikueshme.

Nata kur gjithçka filloi, mbetet e gjallë në mendjen e tij: hijet lëvizin, sytë mbajnë çdo detaj dhe errësira bëhet një partner heshtak në çdo lëvizje. Arbeni është tashmë i kapur nga rrjeti i tij i paranojës, duke jetuar mes dy botëve: Asaj reale dhe asaj të krijuar nga frika dhe dëshira për kontroll. Ishte nata kur Tirana dukej e zbrazët, si një qytet i braktisur

nga koha. Rrugët ishin të gjata dhe të heshtura, dritat e rrugëve dridheshin si qirinj të lodhur, ndërsa era sillte një pluhur të imët që ndizej si shkëndijë nën llampat e verdha. Qyteti merrte frymë ngadalë, sikur e ndiente se diçka po afrohej. Dhe pikërisht atë natë, hijet morën urdhrin e parë. Në një zyrë të mbyllur, larg syve dhe zhurmës, Bac Dhelpra — Kryetari i vjetër, cinik, i stërvitur në survejimet e dikurshme të Sigurimit — Mblodhi njerëzit e tij. Fytyra i ishte bërë gur, pa shprehje, si dikujt që kishte parë shumë dhe nuk besonte më në asgjë.

- Qyteti duhet parë me sytë tanë, - tha ngadalë. - Çdo lëvizje. Çdo frymëmarrje. Gjithçka të kontrollohet. Zëri i tij ishte i ftohtë, pothuajse i zhveshur nga njerëzillëku, një zë që nuk pyeste dhe nuk dyshonte, vetëm urdhëronte. Rreth tavolinës qëndronin tetë burra, të veshur me xhaketa të zeza. Trupat e tyre ishin të palëvizshëm, si statuja të gdhendura nga errësira dhe sytë u lëviznin ngadalë, të mësuar të shihnin pa u vënë re, të regjistronin pa lënë gjurmë. Maskat e kuqe u vareshin te qafa. Ende jo të vëna. Prisnin momentin e tyre. Ishin simbol, urdhër dhe mallkim njëkohësisht.

Në qendër të tavolinës ndodhej dosja e Elirës. Fletë të radhitura me përpikmëri, fotografi të marra nga larg, shënime me shkrim të thatë, orare hyrjesh e daljesh, fragmente jete të copëzuara e të reduktuara në dokumente. Një emër i vetëm, i vendosur në zemër të një mekanizmi të vjetër frike, që vazhdonte të funksiononte edhe pse koha kishte ndërruar fytyrë.

Natyrshëm, ajo ishte e vetmja grua brenda atij rrjeti burrash të errët, të formuar në kohë kur kontrolli quhej virtyt dhe dyshimi ishte ligj i pashkruar. Bac Dhelpra u përkul pak mbi tavolinë. Me majat e gishtave preku dosjen, si të ishte një objekt i brishtë, por i rrezikshëm.

Askush nuk foli. Dera u mbyll ngadalë pas tyre. Kërcitja e bravës tingëlloi si një vulë e rëndë, që nuk hapet lehtë. Ndjekja filloi. Tre hijet e para u shkëputën nga errësira e qytetit. Lëvizën pa zhurmë. Pa gjurmë. Pa emra. Vetëm funksione brenda një urdhri. Tirana nuk i pa, por që nga ajo natë, ajo nuk ishte më vetëm.

Hija 1: "Qeni" Një burrë i gjatë, me shikim bosh, ish-operativ i terrenit. Në trup mbante gjithmonë një radio të vjetër. Detyra e tij ishte këmbësorja: Ndjekja e Elirës pas çdo kthese, pas çdo dere, pas çdo dyqani.

Ai mori pozicion në zonën pranë shtëpisë së saj.

Kur Elira doli për në punë, ai nisi pas saj me hap të heshtur. Asnjëherë afër. Asnjëherë larg. Gjithmonë në distancën perfekte të një hijeje.

Hija 2: "Kasaforta" i heshtur, i trashë, me duar të mëdha. Ishte specialist për dyert, drynat, dhe futjet sekrete.

Ai mori detyrën e kontrollit të ambienteve ku ajo lëvizte.

Natën, kur pallati i Elirës heshte, ai hapte portën e poshtme pa dëmtuar asgjë. Shikonte shkallët, dëgjonte tubat, shihte gjurmët e këpucëve dhe i raportonte Arbenit:

"Ka pasur dy vizitorë shtesë këtë javë. Njëri mashkull."

Arbeni u zverdh…Shko kontrollo direkt bërtiti. Ai u nis

direkt për kontroll edhe pse ishte thjesht fantazi profesionale e "Kasafortës".

Hija 3: "Kujdestari"

Një ish-lexues i interceptimeve.

Nuk punonte më me kabuj, tani punonte me njerëz. Detyra e tij ishte të vëzhgonte fytyrën e Elirës, mimikën, shqetësimin.

Ai merrte vend në kafe, bibliotekë, në qendër të qytetit.

Nuk e hiqte vështrimin nga ajo për 2–3 orë rresht.

Në raportin e parë shkroi:

"Tregon nervozizëm. Prek shpesh qafën. Kjo është shenjë e fajit."

Arbeni qeshi i çmendur: "E dija! Ajo ka një të fshehtë!"

Maska të kuqe në lëvizje

Pas dy javësh vëzhgimesh, Bac Dhelpra dha urdhrin:

"Vishni maskat."

Maskat e kuqe, ngjyrë gjaku. Shenjë për Arbenin se "operacioni ka filluar". Hijet u nisën gjatë natës, në lagjet e qytetit. Silleshin pranë ndërtesave, dilnin nga errësira, qëndronin në pozicione ku nuk i shihte askush. Vetëm qentë e rrugës i ndiqnin me sy të frikësuar.

Në vendin poshtë-dritares së Elirës, dy prej tyre qëndruan të fshehur mes pemëve. Hidhnin sy drejt dritares së saj të fjetur. "Ajo lëviz shumë në gjumë," raportuan. Arbeni e lexoi raportin pesë herë.

Aksioni i parë i madh – Ndjekja e natës

Në një mbrëmje të ftohtë, Elira doli për të takuar një kolege.

Asgjë e dyshimtë. Vetëm një shëtitje e zakonshme në Bllok, dritat e kalldrëmit ndriçonin butësisht rrugën dhe tingujt e qytetit përziheshin me zhurmën e këmbëve të, që ecnin shpejt për diku.

Por për Arbenin, çdo lëvizje ishte alarm. Ai nuk e duronte pa ditur çdo detaj. Telefonoi Bacin me zë të ftohtë: Startojeni operacionin. Dua çdo hap të saj sot.

Tri makina të ndryshme u shpërndanë në zona të ndryshme të qytetit. Brenda tyre ishin njerëzit e tij, të gjithë duke monitoruar çdo lëvizje, çdo fytyrë që mund të afrohej pranë saj. Të gjitha automjetet raportonin çdo informacion në kohë reale. Ndërkohë, Elira ndjeu një të ftohtë në shpinë. U kthye menjëherë, por nuk pa asgjë. Vetëm dritat e zbehta të rrugës, hije që shtriheshin mbi trotuar dhe rruga e boshatisur para saj. Por një hijë ishte aty, në distancë, duke e ndjekur me një qetësi të frikshme, si të shënjonte çdo hap të saj.

Mesazhi i parë i fshehtë natën e asaj dite, ndërsa Elira u shtrua në krevat, telefonit i saj i erdhi një mesazh anonim:

"Dikush që ti e njeh shumë mirë nuk të tregon të vërtetën."

Ajo u dridh. Iu duk sikur fjalët i hynin brenda, duke e shqetësuar në mënyrë të padukshme. Një ndjenjë e çuditshme: Dikush e ndiqte, dikush dinte më shumë se ajo dhe ajo nuk mund të kuptonte se kush ishte. Zemra i rrihte më shpejt dhe mendimi i parë shkoi tek çdo person që e njihte.

Natën e asaj dite, heshtja e qytetit nuk ishte më e zakonshme. Ajo ishte mbushur me tension të padukshëm,

me sy që shikonin nga errësira dhe hije që lëviznin mes dritave të zbehta. Mesazhi ishte vetëm fillimi, një provokim që do ta çonte Arbenin dhe Elirën në një lojë të rrezikshme të ndjekjes dhe frikës, ku çdo gjest i vogël mund të kishte pasoja. Dikush po e shikonte nga dritarja Iu duk sikur një hije qëndronte poshtë rrugës. Iu duk sikur Tirana ishte bërë një qytet i kuq, i rrethuar nga sy që nuk flenë.Por ajo nuk e dinte…Se hija ishte reale. Dhe hija kishte fytyrën e atij që ajo e donte.

Paranoja e doktor Arbenit që nga ai takim i shkurtër, i ngrirë dhe i dyshimtë me Kryetarin e SHIK-ut. Diçka brenda doktor Arbenit ishte çarë, si një fije e tendosur në buzë të shkëputjes.

Ai e kishte ndier që nuk po e kontrollonte më vetveten, por në vend që të trembej, ndjeu një ngazëllim të çuditshëm, një lloj ndriçimi të errët brenda gjoksit. Në ditët pas takimit, ai pagoi disa ish-shikas të tjerë, ish-sigurimsa dhe ish-funksionarë që kishin mbetur pa punë. U dha urdhër të visheshin me kapele të kuqe, të lëviznin natën nëpër Tiranë, të shfaqeshin në qoshe pallatesh, të largoheshin sapo të shiheshin. Jo për nevojë operative, por për paranojën e tij. Ai donte që hijet të ishin reale. Qyteti u mbush me figura të heshtura me koka të kuqe, që shfaqeshin papritur në rrugicat e Lanës, në hyrje të tregut të vjetër, në oborret e pallateve të rrënuara. Njerëzit filluan të flisnin:

- Kush janë këta?
- Ç'janë këto kapele të kuqe?

- Po na kthehet komunizmi?
Tirana lëvizi nën një puls frike të përmbajtur e askush nuk e dinte që burimi i kësaj frike ishte një njeri i vetëm… Një njeri që po humbiste mendjen.
Mbrëmja e Parë e Çarjes së Madhe
Në dhomën e tij të gjumit, ndriçuar vetëm nga një llambë e dobët me ngjyrë të verdhë, Arbeni fliste me veten. Jo thjesht me veten… Fliste me hijet që imagjinonte. Ai ndiente praninë e tyre.
- Po më dëgjoni, apo jo? - i tha murit.
- Po ma dredh gruaja? Më tradhton? Më ndjek, mos ik në heshtje? Ju ma thoni… Ju e dini!
Hija e dritës së dritares lëvizi lehtë nga era, dhe ai u ngrit me vrull.
- Ajo ma dredh! Ajo më tradhton! - bërtiti.
Në dhomë nuk kishte njeri, por ai pyeste, priste përgjigje, madje hidhte kërcënime ndaj boshllëkut. Gruaja e tij, që nuk ishte kurrë martuar zyrtarisht me të – qëndronte në dhomën tjetër. Ajo e njihte këtë gjendje. E kishte parë atë të fundoset në paranojë ngadalë, vit pas viti, Derisa SHIK-u i vuri vulën e çmendurimit të tij. Ajo nuk guxonte më t'i fliste. Edhe frymëmarrja e saj i dukej e rrezikshme.
Partneriteti me "Bac Dhelprën"
Në këtë errësirë mendore, doktor Arbeni gjeti një aleat:
Njeriun më negativ, më të poshtër, më të fryrë nga egoja – Bac Dhelprën. Bac Dhelpra ishte një figurë e errët e viteve '80, ish pedagog, një manipulues i lindur, një artist

i intrigës dhe mashtrimit politik. Kishte kaluar qetë e pa shumë zhurmë tranzicionin, por kur pa gjendjen e Arbenit, pa paranojën e tij,… buzëqeshi.
Ai i tha Arbenit:
- Tani është koha jonë. Njerëzit janë të frikësuar, o doktor. Kaosi është toka më pjellore për ideologjitë e vjetra. Ne do t'i shtyjmë vetë të votojnë për socializmin. Do ta kërkojnë vetë,… nga frika. Do e krijojmë një realitet ku komunizmi nuk kthehet me pushkë… por me panik.
Arbeni e dëgjoi i magjepsur.
- Do të jenë hijet e mia që do ta bëjnë… — pëshpëriti me sy të zgurdulluar. Bac Dhelpra i dha një goditje të lehtë në shpatull:
- Jo, doktor. Jo hijet e tua. Hijet tona.
Prej atij momenti, dyshja u bë e pandashme, një bashkim toksik midis paranojës dhe ligësisë së pastër.
Viti i Zi – 1997
Kur shpërtheu kaosi i vitit '97, Arbeni për pak sa nuk u çmend nga gëzimi. Piramidat ranë, njerëzit humbën kursimet, rrugët u mbushën me dhimbje, thirrje, djegie, dhe… armë. Armë që dilnin nga depot e ushtrisë, që hapeshin si kasaforta pa kod. Kishte njerëz që merrnin armë për të mbrojtur familjet, të tjerë nga paniku, të tjerë nga dëshpërimi, por kishte edhe nga ata që merrnin armë vetëm që të ndiheshin dikush.
Kjo ishte festa e doktor Arbenit.
- Më në fund! Më në fund kaos! - klithi ai ndërsa shikonte

lajmet në një televizor të vjetër.
- Tani jam mbret… Mbreti i këtij qyteti të kuq!
Ai vizatoi në një hartë të Tiranës, një qark të madh të kuq, duke e quajtur Qarku i Hijeve. Në atë hartë shënoi vendet ku do të shfaqeshin njerëzit me kapele të kuqe. Vendet ku do të krijoheshin panikë të rremë, zjarre të kontrolluara, thirrje të rreme për grusht shteti, lajme konspirative të shpërndara në tregje e deri te dëgjimet e rreme të natës.
- Kjo Tirana do të bëhet laborator i frikës - i tha Bac Dhelprës.
- Laborator, ore doktor, laborator! - ia ktheu tjetri me entuziazëm tinëzar. - Pastaj, populli, i lodhur, i trembur,… do të kërkojë vetë kthimin e "rendit të vjetër".
- Dhe unë… unë do të kem kontrollin, - tha Arbeni me një zë që nuk ishte më i tij.
Në ditët që pasuan, kryeqyteti filloi të ndiente një dridhje të pashpjegueshme nën lëkurë. Njerëzit shikonin kapele të kuqe në errësirë, dëgjonin thashetheme të frikshme, flitej për hijet e vjetra të Sigurimit që po ktheheshin, për komunistë që donin të rimerrnin pushtetin. Askush nuk e dinte që shumë nga këto skena ishin të sajuara nga Arbeni dhe Bac Dhelpra. Qyteti po shndërrohej, ngadalë, në një teatër të çmendurisë dhe Arbeni ishte regjisori i tij.
Gruaja që Nuk Fliste
Gruaja e doktor Arbenit, Elira kishte jetuar në heshtje pranë tij për shumë vite, pa e ditur nëse ishte bashkëshorte, shërbëtore, apo thjesht një element i padukshëm në jetën e tij. Ata nuk ishin martuar kurrë me dokumente. Në sytë e

Arbenit ajo ishte "pronë e padëshmuar", Një hije shtëpiake që duhej të qëndronte në kornizën e tij të kontrollit.
Në netët e kaosit të 1997-s, Elira filloi të kishte frikë se mos ai do ta vriste.
E ndiente energjinë e tij të çakorduar. Sytë e skuqur nga pagjumësia, lëvizjet e çuditshme, murmuritjet, të qeshurat e pakuptueshme. Një natë, ai hyri në dhomë pa zhurmë. Ajo po rrinte ulur, me duart e mbledhura, duke dëgjuar zhurmat e qytetit. Qentë lehën. Njerëz vraponin poshtë pallatit dhe diku larg dëgjoheshin krisma.
- Pse u dridhe sot? - i tha me një zë të ulët që i tërhoqi gjakun drejt kokës….
- Nuk jam dridhur, Arben… - tha ajo me frikë.
Ai iu afrua fytyrës së saj aq afër sa ajo ndjeu erën e frymës së tij të rëndë.
- E pashë hijen tënde si u tund. Po jep sinjale? Apo je me ta?
- Me kë? - belbëzoi ajo.
- Me hijet e kuqe! - bërtiti.
Ajo u zgjat për ta prekur në krah, e ai u largua sikur e kishte goditur me thikë.
- Mos më prek! - bërtiti. - Trupi yt është burimi i informacionit! Ju nuk e kuptoni…, çdo qelizë e jotja i përket dikujt tjetër.
Gruaja që nuk duhej të ekzistonte
Elira jetonte me doktor Arbenin si një hije që lëvizte ngadalë nëpër muret e shtëpisë. Ai nuk e kishte martuar kurrë, nuk e kishte pranuar zyrtarisht, por megjithatë e kontrollonte

më shumë se një bashkëshorte të ligjshme. Ajo ishte e bukur në mënyrë të fikur, me sy të mëdhenj, të rraskapitur, që dukeshin sikur kishin parë shumë më tepër se ç'duhej në këtë jetë. Shpesh sillej nëpër shtëpi pa zhurmë, që ai të mos nervozohej. Ecja e saj ishte si ajo e një maceje të plagosur. E heshtur, e kujdesshme, e frikshme.
Që nga nata kur u hapën depot e armëve dhe Tirana u kthye në një skenë lufte. Arbeni u çmend përfundimisht. Elira e pa transformimin e tij me sy. Ai nuk ishte më një burrë që thjesht kishte paranojë. Ishte një njeri që e kishte përqafuar çmendurinë si identitet të ri.

Nata e Përplasjes

Një natë, kur krismat mbushnin ajrin dhe qyteti dukej sikur merrte frymë në vapë e gjak, ai hyri papritur në dhomën ku Elira rrinte ulur. Dera u mbyll pas tij me një zhurmë të thatë, që e preu ajrin. Ajo ishte mbledhur në karrigen pranë dritares, me duart e kryqëzuara në prehër, duke dëgjuar britmat e rrugës, thyerjet e xhamave, motorët që kalonin me shpejtësi, si hije të arratisura. Ai e pa gjatë, me një vështrim që kërkonte shenja, prova, kuptime të fshehura. Heshtja u zgjat, e rëndë, gati kërcënuese.
- U mbylle në vetvete, - tha ai më në fund, me zë të ulët, por të ngarkuar. - Sytë nuk t'i kam parë kurrë kaq larg.
- Po dëgjoj ç'po ndodh jashtë, Arben… - u përgjigj ajo qetë, pa e kthyer kokën, sikur fjala e saj të mos kishte nevojë për dëshmi. Ai iu afrua. Aq pranë sa hija e tij i ra mbi fytyrë

dhe ia zuri dritën e dritares. Prania e tij ishte e ftohtë, e kontrolluar, si një pyetje pa përgjigje.
- Hija jote lëvizi, - tha ai ngadalë.
- Jo nga frika. Nga qëllimi. A po jep sinjale? Apo po luan lojë me ta?
- Me kë? - pyeti ajo, duke ngritur më në fund sytë drejt tij, me një qetësi që e sfidonte. Ai ngriti gishtin lart, sikur po shënonte një faj të padukshëm në ajër, një sekret që s'thuhej me emër, por që rëndonte mbi ta më shumë se zhurma e qytetit jashtë.
- Me hijet e kuqe! Ato flasin. Edhe ti iu flet… Por nëpërmjet dridhjeve të trupit. Ti iu jep sinjale. E kupton sa e rrezikshme është? Për ty kjooo?
Elira e preku lehtë në krah për ta qetësuar. Ai u tërhoq mbrapa sikur e kishte goditur me thikë.
- Mos më prek! - ulëriti. - Qelizat e tua mbajnë informacione! Ti je valë, Elira! Valë që dikush tjetër i kontrollon!
Ajo u ngrit ngadalë.
- Unë jam vetëm Elira… Nuk jam valë, nuk jam hije…
Arbeni qeshi, një të qeshur që nuk kishte më asgjë njerëzore.
- Po, je Elira… Elira e Hijeve. Tani më përket mua vetëm, aq sa do ti. Por unë kam hijet e mia. Dhe në qytet… Ato janë më të shumta se kurrë.
Në rrugë u dëgjua një shpërthim.
Elira u drodh. Arbeni e pa.
Fytyra e tij u ndriçua nga një çmenduri triumfuese.
- E pe?! E pashë! U dridhe! Dikush të aktivizoi! Hija jote

është pjesë e projektit tim… Dhe unë do ta zbuloj çdo gjë! Ajo nuk foli…Në sytë e saj kishte vetëm një gjë: Frikë e pastër.

Dhoma e Kuqe e Doktor Arbenit

Dhoma ku flinte Doktor Arbeni nuk ishte më dhomë gjumi. Dukej si një bunker i çuditshëm, me perde të trasha që nuk linin të hynte asnjë dritë, me tri llamba të kuqe të vendosura në qoshe dhe me letra plot shifra, lapsa, hartime të çrregullta të ngjitura nëpër mure. Në qendër kishte një tryezë të madhe druri, ku ai rrinte ulur si gjykatës, si komandant… apo si i çmendur. Elira ishte në dhomën tjetër, por dera ishte hapur. Ajo dëgjonte gjithçka. Ai kishte vënë përgjues kudo, në shtëpinë e tyre e cila mund të që quhej lirisht qendër vëzhgimi.

Fillimi i Ritit të Çmendurisë

Arbeni u ngrit nga karrigia dhe vëzhgoi murin sikur aty kishte dikush.

- Mirëmbrëma… - i tha murit.

Zëri i tij ishte i butë, i qeshur, i sëmurë.

- Ju prisja. Jeni vonuar. Pse u vonuat?

Ai priti. Sikur priste përgjigje. Pastaj përplasi dorën mbi tryezë.

- Mos më gënjeni! - ulëriti. - Ju jeni gjithmonë këtu! Ju shoh edhe kur jeni pas shpinës sime!

Elira ngriti dorën mbi gojë. Zëri i tij po bëhej gjithnjë e më i rrezikshëm.

Arbeni u afrua te një qoshe e dhomës ku hija e llambës

lëvizte lehtë.
- Po ti? — - foli hijes me një zë të ulët. - Ti e spiunove Elirën, apo jo? Ti e pe si u dridhe mbrëmë… Mos u fshih! FOL!
Ai ngriti dorën sikur donte ta qëllonte hijen.
Por hija, ishte vetëm hije. - Ja ku je! - bërtiti papritmas. - Tani do të jap urdhërat. Duhet të lëvizim shpejt. Tirana është në duart tona. Kaosi është mbreti im, e unë jam babai i tij. Tani… Rreshtohu!
Ai ngriti të dyja duart lart, sikur komandonte një ushtri të padukshme.
- Hije e parë, shko te Lana! Hap panik, bëj që njerëzit të mendojnë se do shpërthejë një depo tjetër.
Hije e dytë, futu mes pallateve te Komuna e Parisit! Dëgjo bisedat, dua të di çdo fjalë. Hije e tretë… - Ai u afrua te muri dhe i pëshpëriti: Ndiqe Elirën. Nuk i besoj më. Lëviz si një valë e dyshimtë. Dua raport deri në mëngjes! Ai bëri një hap mbrapa, i frymëzuar nga vetvetja.
Tani ikni! Disiplinë! Urdhrat e mia s'kanë kthim!
Momenti i Frikës së Pastër
Në atë çast, një copë letre ra nga tavolina.
Një zhurmë e vogël, vetëm një fëshfërimë e thatë, si frymëmarrja e fundit e një sekreti.
Por për Arbenin ishte sinjal i madh. Një alarm i padukshëm që i shpërtheu në tru. Ai ngriti kokën me një hov të egër. Sytë iu ndezën, jo nga drita, por nga frika që ishte shndërruar në dyshim, e dyshimi në çmenduri.
- Kush lëvizi? Kush prej jush preku letrën time?! - bërtiti,

me një zë që nuk pyeste, por dënonte.veprimin imagjinar të tij.

Ajri u drodh. Muret dukeshin sikur u afruan edhe më shumë. Pastaj ai u kthye nga dera dhe e pa Elirën.

Ajo qëndronte e ngrirë në prag, si një figurë e harruar në një fotografi të vjetër. Duart i kishte të trazuara, gishtat i dridheshin pa e kuptuar pse, ndërsa fytyra i ishte zbehur sikur dikush t'i kishte fshirë ngjyrat me një leckë të lagur. Nuk kishte guxim të fliste, as të largohej. Ai e pa. Ajo e pa. Heshtja u bë më e rëndë se ulërimat e tij, një heshtje që shtypte kraharorin dhe nuk linte vend për frymë. Në atë boshllëk, çdo mendim bëhej akuzë. Akuza shtoheshin. Përgjigje nuk kishte Elira… - tha ai më në fund, ngadalë, duke shqiptuar emrin sikur ta shijonte ose ta vriste me të njëjtën kohë.

- Po më ndjek? Po më spiunon? Po flet me hijet e mia pa lejen time?

Zëri i tij ishte i ulët tani, por më i rrezikshëm. Nuk kishte më nevojë për britma. Dyshimi kishte marrë formë, kishte marrë emër. Elira hapi gojën për të folur, por fjalët iu ngatërruan në fyt. Ajo e kuptoi se çfarë do që të thoshte, ai nuk do të besonte më dhe ajo, e pafajshme në pamje, qëndronte aty poshtë e ulur, si dëshmitare e heshtur e një shpërthimi që sapo kishte filluar.

- Jo… - tha ajo me një zë të thyer. - Unë thjesht… kam frikë. Po më tremb.

Ai qeshi me një të qeshur të çakorduar.

- Frikë? Frika është ilaçi im, Elira. Ti jeton falë frikës time. Pa frikë, ti s'do ekzistoje. Ti, po më përgjon… sepse do të dish urdhrat. Edhe ti je një hije, Elira. Një hije që nuk e kupton akoma rolin e vet.
Ajo u tërhoq një hap mbrapa. Ishte e shastisur e lodhur dhe në panik.
Dhe aty, Elira kuptoi.
Doktor Arbeni nuk ishte më thjesht paranojak. Ai kishte kaluar kufirin. I kishte shpallur luftë realitetit. Ai ishte bërë udhëheqësi i një ushtrie që nuk ekzistonte.
E kuptoi se ai po fundosej në një botë ku hijet kishin emra, role, misione… Dhe ajo vetë ishte një prej tyre.
Elira e braktisi dhomën në heshtje. Me zemrën që i rrihte fort.
Me një ndjenjë të ftohtë në stomak. Ai ishte i humbur plotësisht. Ai tashmë është psikopat. Këtë konfirmoj ajo atë natë.
Bac Dhelpra – Arkitekti i Errësirës
Në bodrumet e Tiranës së 1997-ës, ku lagështia e betonit përzihej me aromën e barutit dhe frikës, lëvizte një njeri që të gjithë e quanin Bac Dhelpra. Nuk kishte asnjë dosje zyrtare për të, asnjë fotografi të qartë, as një vijë identiteti. Ishte njeri me shumë emra, shumë fytyra, shumë jetë. Ishte fantazmë e regjimeve, shpirt i errët i sistemeve të shembura, dhe mjeshtër i manipulimit. Ishte ai që i kishte çuar fjalë Doktor Arbenit se "hijet e kuqe" ishin reale.
Ishte ai që e kishte gjetur mendjen e dobët të Arbenit,

e kishte pickuar dhe e kishte futur ngadalë në labirinte paranojash.
Ishte ai që po ushqente çmendurinë e tij. Natën e asaj dite, Bac Dhelpra hyri në shtëpinë e Arbenit pa trokitur. Derën e kishte lënë hapur ai Elira bërtiti nga tmerri. Kur pa një tip të tillë që iu duk si kriminel nga ata të filmave aksion dhe njëkohësisht si një paranojak tjetër. Ishte veshur më te zeza dhe kapele e zezë që shkonte më errësirën e tij.
Dhelpra nuk e njihte nga binte frika. Ai e nuhaste atë si ujku gjahun.
Ai hyri ngadalë, duke fërkuar duart, me një buzëqeshje të ashpër.
- Ku je, doktor? - thirri ai me një ton të ëmbël e cinik.
Takimi i dy çmendurive.
Arbeni doli nga dhoma e tij, me flokë të çrregullt dhe sy të zgurdulluar.
- Më erdhe? - i tha. - Hija ime e parë tha që do të vije.
Bac Dhelpra qeshi.
- Po, po, hijet… i ke rritur shumë, doktor. Tani ato punojnë më mirë se sigurimsat e dikurshëm.
Arbeni ngriti kokën krenar.
- Janë të trajnuara. U jap detyra. Më raportojnë. Po formojnë rrjetin.
- Rrjetin e çfarë? - pyeti Dhelpra, me një zë që e nxitej të fliste më shumë.
- Rrjetin e mbyllur pra: "Shiko, njofto, hesht!"
Arbeni ngriti duart sikur po predikonte. Dhe po e shikonte drejt ne sy.

- Atë rrjetin që të kam thënë që në fillim kryetar, - tha Arbeni.
- Rrjetin e rikthimit!
- Poo, - tha Baci - Sigurimi nuk është zhdukur kurrë, thjesht fjeti.
- Ne do t'i kthejmë strukturat në gjithë vendin.
- Njerëzit kanë nevojë për frikë. Frika krijon rend. Tashi ne po vijmë në pushtet doktor. Dhe s'e lëshojmë më atë. Njerëzit na duan, edhe pse ne s'u japim asgjë. Japim vetëm dogma. Ata prapë na votojnë ne.

Dhelpra po e shikonte me sy gjysmë të mbyllur, duke buzëqeshur me një kënaqësi të fshehtë. Ai e shtynte, e ushqente, e ndiqte me fjalë.

- Dhe populli? - e pyeti butë. - Çfarë bëhet me popullin? Asgjë nuk bëhet.

Haha qeshi në fund ai.

Arbeni u afrua.

- Populli është turmë. Turma është e manipulueshme. Sidomos tani… - Ai buzëqeshi me dhëmbët e ngrirë. - Sidomos tani që kanë armë, që janë të trembur, që nuk dinë ku t'ia mbajnë. Kaosi është koha jonë. Ata do votojnë çdo gjë që u jep siguri. Edhe nëse ajo siguri është e kuqe. Unë jam mbreti i kaosit. Ti je njeriu që e ndezi fitilin. Ne të dy… jemi historia e re.

Bac Dhelpra uli kokën si mjeshtër që po aprovonte nxënësin.

- Të lumtë, doktor. Po piqesh. Dhe tani… Duhet hapi tjetër.
- Cili? - pyeti Arbeni.
- Rruga e Kombinatit.

Aty do përhapet fjala se po vijnë "armiqtë e popullit".
Ti do dalësh mes njerëzve, i shoqëruar nga hijet e tua të kuqe.
Do flasësh. Do shpallësh se qeveria ka rënë.
Dhe se vetëm një dorë e fortë mund të shpëtojë Tiranën.
Arbeni u ndez.
- Do flas!
- Do flas për socializmin! Do flas për kërcënimin! Do flas për rikthimin!
- Po - tha Bac Dhelpra. - Do flasësh për frikën. Dhe për shpresën. Këto dy gjëra janë armët më të mëdha të regjimeve.
Elira dëgjon gjithçka.
Në korridor, Elira qëndronte e ngjitur pas murit, duke mbajtur frymën. Ajo i dëgjoi të gjitha. Fjalët e Arbenit. Nxitjen e Bac Dhelprës. Planet. Skenarët. Çmendurinë që po merrte krahë. Ajo kuptoi se nuk ishte më e rrezikuar vetëm ajo, por i gjithë qyteti.
Arbeni nuk ishte më thjesht i çmendur.
Tani ai ishte armë në duart e një njeriu të poshtër, manipulues, që donte të ringjallte një epokë të vdekur.
Dhe Elira, me zemër të ngrirë, e kuptoi: Nëse nuk bënte asgjë, Tirana do të digjej.
Dhe Arbeni do ishte ai që do ndizte shkëndijën.
Nata e Kuqe në Kombinat
Tirana kishte hyrë në një natë që nuk do harrohej kurrë. Një natë ku qielli dukej sikur shkulte vetullat e veta nga

dhimbja, E rrugët përqeshnin frikën e njerëzve me krisma të shpeshta, Britma, lëvizje të çakorduara dhe një mjegull të kuqe që lindte nga flakët e gomave të djegura.
Në skajin e Kombinatit, në një shesh të errët mes fabrikave të braktisura, po mblidhej një turmë njerëzish. Turmë e lodhur, e frikësuar, e armatosur. I shtynte paniku, thashethemet dhe lajmet e përhapura enkas nga njerëzit e Bac Dhelprës.
"Po vijnë armiqtë!"
"Qeveria ka rënë!"
"Vetëm një dorë e fortë mund të vendosë rend!"
Turma mërmëriste. Frynte si një bishë e gjerë, e padukshme. Në qendër të sheshit ishte ngritur një platformë e improvizuar. Dy reflektorë të vjetër fabrikash hidhnin dritë të kuqe, duke krijuar hijet e famshme që Doktor Arbeni i quante "ushtria e tij".
Dhe hijet po dukeshin sikur vallëzonin.
Mbërritja e Doktor Arbenit
Arbeni u shfaq si një profet i errësirës. I ulur në sediljen e pasme të një makine të vjetër të blinduar, i shoqëruar nga tre burra të veshur me rroba të zeza e kapele të kuqe. Ishin ish-sigurimsa të mbetur pa punë, të blerë me lekë dhe frikë. Elira nuk ishte me të. Ajo e ndoqi nga larg, e kamufluar mes turmës, me një shall të hedhur në kokë dhe me duart që i dridheshin. Zemra i rrihte aq fort sa mendonte se mund të dëgjohej.
Makina ndaloi. Derën ia hapi vetë Bac Dhelpra, si shërbëtor i djallit.

- Koha jote erdhi, doktor, - tha ai dhe e udhëhoqi drejt platformës.
"Erdhi profeti errësirës," - tha më vete doktori. Ai kopsiti pullat e xhaktes se zezë dhe pasi bëri disa hapa nën shoqërimin e rojeve. Ia hodhi shikimin turmës, disa gati e adhuronin këtë figurë të çmendur që po ecte drejt podiumit si mesia i errësirës. Sytë e Arbenit ishin të ndezur, jo nga besimi, por nga një zjarr i brendshëm që ushqehej me frikë dhe madhështi të rreme. Ai nuk shihte më njerëz. Shihte armiq, komplotistë, fytyra që ndryshonin formë sipas dyshimeve të tij. Paranoja e udhëhiqte si një dorë e padukshme, ndërsa mendja e tij ishte e mbushur me bindjen se ishte i zgjedhuri, i vetmi që "dinte të vërtetën".
Pas tij, si në një haluçinacion kolektiv, hijet e kuqe i rrinin ngjitur, të shtrira mbi mure, mbi tokë, mbi ndërgjegjen e turmës. Nuk ishin njerëz, por ide të verbra, simbole dhune dhe bindjeje, të gatshme për komandë, për urdhër, për sakrificë. Arbenit i dukej se ato prisnin vetëm një shenjë të tij, një lëvizje të dorës, një fjalë të hedhur si shkrepëse.

Fjalimi i Çmendurisë
Ai u ngjit sipër në platformë me hapa të matur, pothuaj ceremonialë. Çdo hap dukej sikur e ngrinte mbi tokën e zakonshme, duke e afruar më shumë me mitin që kishte ndërtuar për veten. Turma heshti. Jo nga respekti, por nga frika e përzier me kureshtje. Heshtja u shtri si një pëlhurë e trashë mbi shesh.

Arbeni ndaloi në mes të platformës.
Ngriti duart drejt qiellit, sikur po kërkonte bekim, ose sikur po thërriste dëshmitarë të padukshëm. Gishtat iu shtrënguan, dhe për një çast dukej sikur po mbante në duar fatin e të gjithëve.
- Unë e di! - tha me zë të lartë, dhe fjala u përplas në ajër si një goditje. - E di kush jeni. Edhe e di kush jeni kundër nesh!
Turma nuk lëvizi. Disa fytyra u ngurtësuan, të tjera u përkulën. Arbeni vazhdoi, zëri i tij tani i mbushur me pathos dhe kërcënim. Ata që fshihen mes nesh. Flasin me zë të ulët. Shkruajnë letra. Rrëzojnë të vërtetën nga tavolinat tona! Do t'ju gjejmë……..
Hijet e kuqe, në mendjen e tij, u trazuan. Ai ndjeu se po i bindej një misioni më të madh se vetja. Çdo fjali që nxirrte nga goja e tij e forconte bindjen se ishte në luftë me armiq të padukshëm dhe se kjo luftë e justifikonte gjithçka. Ai uli duart ngadalë dhe i drejtoi nga turma.
- Mos kini frikë! - thirri. - Frika është arma e tyre. Unë jam këtu për t'ju mbrojtur. Unë jam zëri juaj. Unë jam hija që nuk trembet nga errësira!
Në atë çast, disa duartrokitje të çrregullta u dëgjuan, të pasigurta, por si një provë besnikërie. Arbeni i mori si shenjë fitoreje. Sytë e tij u ndezën edhe më fort. Dhe askush nuk e kuptoi se fjalimi nuk ishte më për turmën, por për hijet që vetëm ai i shihte dhe që tashmë kishin filluar të flisnin në emrin e tij.

- Njerëz të Tiranës! - bërtiti.
Zëri i tij shkulte ajrin.
- Sot fillon epoka e re! Sot errësira jonë bëhet dritë! Sot kaosi bëhet shtet! Vendi është i braktisur! Armiqtë po afrohen! Ju jeni të pambrojtur! Por unë jam këtu për t'ju drejtuar! Unë jam syri që sheh gjithçka! Jam mendja që kupton gjithçka! Jam ai që flet me hijet që ju nuk i shihni!
Nga turma dolën brohorima të çuditshme. Disa njerëz qeshën. Disa u trembën. Disa e morën seriozisht.
Arbeni vazhdoi, i dehur nga zëri i vet.
- Ju e dini se kush jam unë! Unë jam Doktor Arbeni! Shëroj trupa? Po. Por tani do shëroj shoqërinë! Me këto duar…
Ngriti duart lart sikur mbante nën peshë qiellin …
- Kam trajtuar mijëra! Tani… Do trajtoj një popull të tërë! Kam shëruar kudo njerëz me kancer me sëmundje të rënda Tani do të shëroj një popull.
Turma lëvizi e hutuar. Dhelpra i dha shenjë njërit prej shokëve të tij. Ai shpërtheu një kapsollë të madh zjarri në ajër. Një shpërthim i kuq që ndriçoi gjithçka. Arbeni u ndez më shumë.
- Do të rikthejmë rendin! Do rikthejmë fuqinë! Do rikthejmë strukturën! Është koha që Shqipëria të ketë sërish drejtim të hekurt!
- Nuk ka demokraci pa frikë! Nuk ka liri, pa kontroll!
Turma përjetoi një drithmë.
Disa brohoritën. Disa u larguan me frikë. Disa filluan të bindeshin. Unë do t'ju shpëtoj nga çifutët e gjakpirësit e

pesëdhjetë vjetëve. Do t'ju mbroj nga doktrinat fallco të barazisë dhe heronjëve. Ju jeni të varfër e të vjedhur, sepse besuat në sistemin e kalbur kapitalist.

Kapitalizmi është shpikje e bankierëve çifutë. Mjet për të pasuruar ata që janë hijenat e këtij kombi e jo punëtorët që sakrifikojnë gjithë jetën dhe nuk fitojnë asgjë.

Bac Dhelpra buzëqeshi me atë buzëqeshjen e tij të ftohtë, të keqe.

Ai e dinte: Doktor Arbeni po shndërrohej në veglën e tij të përsosur.

Elira e sheh të vërtetën, e fshehur mes turmës. E shikonte burrin që dikur kishte menduar se mund ta shpëtonte. Ai po fliste për rikthim të komunizmit, për liri me kontroll, për frikën si armë që sjell rend dhe qetësi.

Syri i tij i majtë dridhej si tel i tendosur. Ai nuk ishte më Arbeni që ajo kishte njohur. Ai ishte një fantazmë e çmendur në trup njeriu.

Ajo nuk do ta lejonte Burrin e Hijeve të ndizte zjarrin e qytetit.

Ajo do ta ndalte. Edhe nëse duhej të rrezikonte jetën e vet.

Ajo u kthye dhe u zhduk në errësirë, ndërsa mbi podiumin e improvizuar, doktor Arbeni ngrinte duart në ajër si profet i një epoke që askush s'e donte të kthehej.

Tirana ishte kthyer në një qytet të kuq. Flamuj, pankarta, uniforma, madje edhe fytyrat e njerëzve dukeshin sikur ishin larë me të njëjtën ngjyrë. Ishte koha kur ra qeveria e djathtë edhe socialistët (ish komunistët) u rikthyen. Dr.

Arbeni e pa këtë si sinjal hyjnor, si shpallje lufte, si triumf personal.

Ai tashmë ishte nën urdhrat e Bac Dhelprës, ish-sigurimsit që tani kontrollonte çdo cep në SHIK. Dhe Arbeni, me gjithë çmendurinë e tij, u bë altoparlanti i tyre. Nëpër takime të fshehta, në bodrume, në zyre të errëta plot dosje të vjetra, ai fliste me zë të ashpër:

"Pakicat nuk mund të udhëheqin kombet! Pakicat janë dukuri në zhdukje. Kombet e mëdha janë bërë të mëdha se kështu i la Zoti! Kështu është natyra!"

Ata e duartrokisnin. Jo se e besonin, por se u duhej një i çmendur që fliste pa frikë.

Elira – E Burgosura e Padukshme

Në shtëpi, në dhomën gri ku dikur ndizte qirinj për qetësi, Elira ishte bërë hije e vetes. Ajo nuk jetonte më aty. Thjesht ekzistonte. Arbeni e kishte mbyllur brenda, jo me çelësa të dukshëm, por me frikë. Rreth e rrotull kishte vendosur roje - Ca të paguar, ca thjesht frikacakë, njerëz pa fytyrë që i bindeshin kujtdo që mbante paranë dhe pushtetin. Elira mezi ecte nga ankthi. Çdo hap i dukej i huaj, sikur dyshemeja të mos e njihte më. Fryma i bëhej e shkurtër, e copëtuar, si të ishte gjithmonë në prag të një rrëfimi që nuk do të dëgjohej kurrë. Ai i kontrollonte gjithçka: Telefonin, dritat, dritaren, madje edhe heshtjen e saj. Kontrollonte frymën, shikimin, kohën kur mbyllte sytë. Çdo gjë duhej të kalonte përmes dyshimit të tij.

Në një mbrëmje, kur Tirana gëlonte nga zërat e të dehurve

politikë dhe rrugët dridheshin nga fjalime boshe e premtime të kalbura. Ai hyri papritur në dhomë. Pa trokitur. Pa paralajmërim. Sytë i kishte të egër, ishin sytë e një njeriu që nuk fliste më me njerëz, por me fantazmat e veta. Sytë e një njeriu që kishte humbur kufirin mes pushtetit dhe çmendurisë. Ai u afrua ngadalë, si gjykatës dhe si xhelat njëkohësisht.

Elira nuk foli. E dinte se çdo fjalë mund të përdorej kundër saj.

- E di që flet - tha ai më në fund, me një zë të ulët, pothuaj të butë, por më të frikshëm se britma. - Edhe kur hesht, ti flet. Dhe në atë dhomë gri, ku dikur qirinjtë digjeshin për paqe, errësira u bë ligj. Me botë të padukshme, Elira! - tha ai dhe bërtiti. - Pse u fik drita te korridori?

Ajo ngriti kokën ngadalë.

- Nuk e kam fikur unë… Ra rryma, Arben.

Ai qeshi me atë të qeshurën e thyer, të çarë në dysh.

- Jo. Jo! Hija jote e fik! Të kam thënë që hijet janë të lidhura me trurin tënd të djathtë, me emocionet. Kur ti gënjen, drita fiket. E kupton?

Ajo uli sytë. Ai iu afrua, duke tundur telefonin e saj në dorë.

- Pse ka numër të fshirë këtu? Kush të mori? Me kë fole? Kush të shkruan? Pse nuk më thua? - ia përplasi pyetjet si plumba.

- Nuk më ka shkruar askush… - tha ajo me zë të ngjirur. - E fshiva sepse… ishte reklamë.

Ai e shtyu mbrapa, por jo fort. Sa për t'i kujtuar se nuk

kishte më as emër, as zë.
- Gratë janë tradhtare! - bërtiti ai në fytyrë të saj. - Kështu ka qenë gjithmonë! Kështu më thonë hijet! Ato ma konfirmojnë! Ti je pjesë e një plani…
Elirës i prenë gjunjët. Ajo e kuptoi përfundimisht: Arbeni s'kishte kthim mbrapa. Ai po fliste me njerëz që nuk ekzistonin.
Po jepte urdhra që nuk kishin logjikë. Po drejtonte një luftë që vetëm ai e shihte.
Dialogu i Çmendurisë
Ai u ul në mes të dhomës, duke parë tavanin sikur kishte dikë tjetër aty.
- Urdhër 17! - tha me zë komandanti. - Askush s'del nga dera pa lejen time. Ndaloni çdo komunikim me jashtë. Ndaloni valët! Ndaloni frymëmarrjen e tepërt! Elira mund të dërgojë mesazhe me qerpikë!
Pastaj u kthye nga ajo:
- Je duke dërguar sinjale me sytë e tu. Mos i hap shumë. Kur i hap shumë, më tradhton.
Elira s'mundi ta mbante veten.
- Arben… Të lutem… Ndalo. Unë jam vetëm Elira. Nuk jam hije, nuk jam tradhtare…
Ai e priti një sekondë, pastaj pëshpëriti:
- Jo, ti s'je Elira. Ti je kanali. Përmes teje flasin ata… Ata që më duan të keqen.
Në dhomë ra heshtja. Heshtja që e përmbyll kapitullin. Heshtja përpara stuhisë më të madhe. Elira kuptoi se ishte

futur në burg. Jo në burg të shtetit, jo në burg me hekur. Por në burg të padukshëm, të ndërtuar nga çmenduria e një burri që dikur kishte qenë dikushi… Dhe tani ishte humbja e vetvetes.

Urdhrat e Errësirës. Elira ndjeu për herë të parë se diçka brenda saj po çahej. Nuk ishte thjesht frika. Nuk ishte thjesht ankthi. Ishte diçka më e thellë, një çarje e brendshme, sikur trupi dhe mendja e saj nuk po bashkëpunonin më.

Ajo u ul në dysheme, pranë radiatorit të ftohtë, me duart që i dridheshin. Në veshët e saj dëgjoheshin zëra që nuk ishin të sajat. Jo, jo zëra të çmendurisë… Por zërat e rojeve poshtë, të cilët flisnin për të, qeshnin me të. E trajtonin si një objekt…..Tirana jashtë gumëzhinte nga thirrjet e natës së kuqe. Dhe atëherë dera u hap me një krismë. Hynte Arbeni, sikur po vendoste këmbën në skenë për një konferencë të madhe për shtyp.

Sytë i shkëlqenin me një dritë të frikshme, jo dritë mendimi, por dritë çoroditjeje.

- Fillojmë! - tha ai me ton triumfal, ndërsa mbylli derën me çelës. - Më duhet të jap urdhrat e sotëm. Shiko, Elira. Ti do jesh dëshmitare. Kështu do e shohësh se jam patriot… Jam njeri që punon për kombin!

Ai vuri dorën në vesh, sikur po dëgjonte dikë.

- Po, komandant… Ju dëgjoj… - belbëzoi. - Jo, jo, nuk ka rrjedhje informacioni. E kam gruan të izoluar,… është nën kontroll të plotë.

Elira e mbylli fytyrën me duar. Ai e pa.

- Përse u fshehe?! - ulëriti. - Duhet të dëgjosh! Ky komb mbahet në këmbë nga njerëz si unë! Jo nga femra që dridhen si lecka!
Ai vazhdoi, duke ecur nëpër dhomë sikur po komandonte një ushtri të padukshme:
- Urdhër 23: Forcat e kuqe të shpërndahen nëpër blloqe. Të fikni dritat në rrugica, të kontrolloni dyqanet e djathta. Të arrestoni hijet që ecin pa zhurmë. Këto janë agjentë të pakicave!
- Urdhër 24: Të hiqet çdo poster i PD-së nga rrugët. Kombi s'mund të ketë dy zëra. Një zë do, një qendër!
Ai ndaloi papritur dhe pa drejt Elirës.
- Ti… pse po dridhesh? - e pyeti me dyshim. - Mos po i dërgon mesazhe dikujt tani? Nëpërmjet frymëmarrjes? E ke frymën më të shpejtë se zakonisht…
Elira u mbështet pas murit, me fyt të tharë.
- Arben, të lutem… Po më frikëson… - tha ajo me zë që mezi dëgjohej.
Ai u ngrit mbi të, duke i prekur mjekrën me forcë.
- Frika jote më tregon se unë kam të drejtë! - ulëriti ai. — Sigurimi kurrë nuk gabon! Kurrë! Hije të djathta po vijnë nëpër shtëpi, Elira. I ndiej. I dëgjoj natën. Ti i ke ftuar!
Zëri i tij u përplas në muret e dhomës si një aktakuzë pa gjyq. Elira nuk duroi më. Ajo shpërtheu në lot, jo me britma, por me një rrjedhje të heshtur, të dëshpëruar, sikur diçka brenda saj po çahej përfundimisht.
Supet i dridheshin dhe duart i mbulonin fytyrën, si të donte

të fshihej nga sytë e tij dhe nga vetë realiteti.
Për një çast, Arbeni e lëshoi veten, sikur çmenduria e tij të ishte lodhur nga vetja për disa sekonda. Fryma iu thellua, supet iu ulën. U kthye nga ana tjetër dhe u ul rëndë në karrige. Pastaj ndodhi diçka edhe më e frikshme.
Ai filloi të fliste me ajrin. Jo me Elirën. Me një "zë imagjinar" që vetëm ai e dëgjonte.
- Po… po, e di. - murmuriti, duke tundur kokën lehtë. - Jo, jo ende… Duhet provë. Ajo duhet të rrëfejë vetë. Sytë i kishte të fiksuar në boshllëk, sikur dikush po i qëndronte përballë.
Elira e kuptoi se nuk ishte më thjesht viktimë e dyshimit, por dëshmitare e shkatërrimit të një mendjeje.
- Më kupton, apo jo? - vazhdoi ai, me një qetësi të rreme. — Nuk është personale. Është çështje sigurie.
Në atë moment, heshtja u bë më e rëndë se çdo britmë, sepse çmenduria, kur fillon të flasë me veten dhe ta quajë drejtësi, nuk ka më nevojë për armiq të vërtet.
Pastaj Arbeni filloi të flasë me hijet. "Po, shef… E kuptoj… Po, po,… mund ta eliminojmë. Po, po… do i fikim të gjitha dritat. Do t'i mbajmë njerëzit në errësirë. Errësira i bind njerëzit. E bën kombin të qëndrojë. Po, po, do e nis menjëherë."
Pastaj iu drejtua Elirës sërish:
- Të shoh… çdo orë. Çdo minutë. Mos e mendo të më ikësh. Kudo të shkosh, hijet e mia janë të kuqe. Dhe të gjejnë.
Elira nuk foli. Sytë i ishin bërë të turbullt. Ajo e kuptoi se

nëse nuk e ndalonte dikush, ai mund të kthehej në rrezik për gjithë qytetin.
Ose, më keq… për të.
- Divorci i pamundur
"Njeriu nuk lind i lirë; Lirinë e fiton vetëm kur guxon të largohet nga ajo që e shkatërron."
Çdo zinxhir që e mbërthen në terr dhe frikë që e mbyt në heshtje, çdo diktat që e deformon njeriun brenda vetes është diktaturë. Këto janë burgjet e padukshme. E kundëta Liria nuk është dhuratë. Ajo është betejë, udhëtim në errësirën e vetes, ku secili hap është rrezik, secili vendim një akt guximi. Vetëm ai që ka kurajon të prish murin e brendshëm, të sfidojë hijet e veta, mund të ngrejë kokën dhe të thotë: "Jam i lirë."
"Frika është hija që i rri pas njeriut, derisa ai mëson të ecë drejt dritës."
Ajo është shoqëruesja që nuk largohet lehtë, e padukshme dhe e pandalshme. Shumë përpiqen ta shmangin, ta fshijnë, ta mohojnë, por ajo gjithmonë i ndjek. Drita nuk është mungesë frike; Drita është guximi për të ecë pavarësisht saj. Çdo hap drejt së vërtetës, çdo hap drejt dritës, e dobëson hijen, derisa ajo më në fund të zhduket, ose të kthehet në kujtim i largët. Liria dhe drita nuk janë dhuratë; Janë rezultat i përballjes me errësirën brenda vetes dhe përtej saj.
Ai tashmë kishte ikur nga realiteti.
Nuk ishte dr. Arbeni, njeriu që dikur dinte të dëgjonte, të

shëronte, të fliste me qetësi dhe mendje të kthjellët. Por ajo që kishte mbetur prej tij ishte vetëm një hije e deformuar nga sëmundja. Dashuria e tij, që dikur kishte qenë e ngrohtë dhe e përmbajtur, ishte shndërruar në diçka tjetër: Një fiksim i verbër, një forcë e errët që nuk njihte më kufij. Ai tani përbënte rrezik për këdo. Sidomos për të.

Elira e dinte se një ditë ai mund të shërohej. E dinte se diku, thellë brenda tij, ekzistonte ende njeriu që ajo kishte dashur. Por ajo ditë ishte larg, tmerrësisht larg. Dhe deri atëherë, çdo hap i saj ishte në rrezik, çdo frymëmarrje një sfidë për të mbijetuar.

Dashuria e tij për të ishte kthyer në një anakondë që ia merrte frymën ngadalë, ditë pas dite, natë pas nate. Nuk e shtrëngonte menjëherë. E mbante të lidhur, duke e lodhur, duke e mpirë, duke i vjedhur ajrin pa zhurmë. Ai jetonte tashmë në një botë imagjinare, të ndërtuar nga sëmundja e tij — Një realitet paralel ku ajo i përkiste vetëm atij, ku çdo refuzim ishte tradhti dhe çdo largim një komplot.

Elira donte të ikte, por mendimet e së shkuarës e mbanin të lidhur. Kujtimet i ktheheshin pa ftesë: Çdo prekje dhe ledhatim, çdo kompliment i bërë dikur prej tij ishte i vërtetë, ishte i bukur, ishte njerëzor. Ai e kishte dashur me një pastërti që atëherë i dukej e rrallë. Dhe pikërisht kjo e bënte gjithçka edhe më të dhimbshme.

Sepse tani ajo dashuri ishte kthyer në kërcënim.

Jeta e saj ishte në rrezik. Jo nga urrejtja, por nga një dashuri e sëmurë që nuk dinte të ndalej. Dhe ndërsa ecte drejt së

panjohurës, Elira e kuptoi se mbijetesa e saj varej nga një vendim i vetëm: Të shpëtonte veten, edhe nëse kjo do të thoshte të linte pas njeriun që dikur kishte qenë gjithçka.

Një telefonatë që mund të ndryshonte gjithçka

Ajo mori frymë thellë, sikur po zhytej nën ujë për herë të fundit. Gishtat i dridheshin mbi tastierën e telefonit, jo nga të ftohtit, por nga një frikë e grumbulluar prej ditësh, ndoshta prej muajsh. Çdo shkronjë që shkruante i dukej si një hap mbi një urë të lëkundur.

Avokat "Duhet të më ndihmosh. Nuk mund të rri më këtu. Ai do të vijë."

E lexoi mesazhin dy herë përpara se ta dërgonte. Për një çast hezitoi, sikur edhe telefoni ta dëgjonte frymëmarrjen e saj dhe mund ta tradhtonte. Pastaj shtypi "dërgo". Ekrani u errësua dhe zemra i rrahu fort, si të donte t'i shpëtonte kraharorit.

Ndjekja dhe frika e përditshme

Çdo hap jashtë dyerve të shtëpisë i dukej si një kurth i ngritur me kujdes. Ajri i ftohtë i rrëshqiti mbi fytyrë, por nuk e qetësoi. Ajo ecte ngadalë, duke vështruar përreth, me ndjesinë e pandarë se çdo hije mund të ishte ai. Njerëzit kalonin pranë saj, të zhytur në hallet e tyre, pa e ditur se frika mund të ecte kaq pranë, kaq qetë, kaq e padukshme.

Makina e tij, gjithmonë e fshehur diku në sfond, ishte kthyer në një obsesion. Çdo dritare e errët dhe reflektim xhami, çdo motor që ndizej pas shpine i dukej si shenja e rikthimit të tij. Edhe kur nuk e shihte, ajo e ndjente praninë

e tij — Si një hije që nuk largohej kurrë nga drita e saj.
Telefonatat e panjohura ishin më të tmerrshmet. Zilja e telefonit i priste frymën. Edhe kur nuk përgjigjej, heshtja që pasonte ishte po aq kërcënuese. Mesazhet, të shkurtra, të ftohta, me fjalë të zakonshme, mbartnin gjithmonë të njëjtin nënkuptim: Ai po vëzhgonte, po priste, po afrohej.
Ajo e kuptoi se frika nuk ishte më një ndjesi kalimtare, por një mënyrë jetese. Një pritje e pafundme. Dhe ndërsa shtrëngonte telefonin në dorë, duke pritur një përgjigje. E dinte se ajo telefonatë. Ajo e vetmja ishte shpresa e saj e fundit për të dalë nga ky rreth i mbyllur. Çdo mëngjes, sapo dilte jashtë shtëpisë, i dukej sikur dikush po i bllokonte frymën. Ajri, edhe pse i hapur, i rëndonte mbi kraharor si një peshë e padukshme. Hapat e saj ishin të kujdesshëm, të matur, sikur rruga vetë të ishte shndërruar në një skenë rreziku.
Zhurmat e zakonshme të qytetit — Motorët e makinave që kalonin, frenat që kërcisnin, zërat e largët të njerëzve i dukeshin si sinjale vëzhgimi. Çdo automjet që ngadalësonte pranë saj i dukej sikur po e ndiqte. Çdo xham i errët mbante një sy të fshehur. Edhe heshtja, kur pa pritur binte, ishte po aq kërcënuese sa zhurma.
Ajo tashmë po kalonte në një dramë të ngjashme, por më të heshtur, më të padukshme. Jo më skena të hapura, jo përballje direkte, por një terror i brendshëm, i ushqyer nga frika e tij. Ai nuk kishte nevojë të ishte fizikisht pranë për ta shkatërruar. Mjaftonte prania e tij imagjinare, e ngulitur në

mendjen e saj. Elira ndalonte herë pas here, duke bërë sikur kontrollonte telefonin, vetëm për të parë reflektimin e saj në xhamat e dyqaneve. Kthehej papritur, duke kërkuar pas shpine një figurë që nuk shfaqej kurrë, por që ajo e ndiente gjithmonë aty.

Zemra i rrihte fort, jo nga ecja, por nga pritja e përhershme e diçkaje të keqe.

Ajo e kuptonte se frika po e ndryshonte. Po i merrte lirinë, po i vidhte normalitetin, po e kthente çdo mëngjes në një betejë për të dalë nga dera. Dhe megjithatë, ajo dilte, sepse të qëndronte brenda do të thoshte të pranonte robërinë, ndërsa jashtë, mes ankthit dhe zhurmës, ekzistonte ende një fije shprese se një ditë, kjo ndjekje do të merrte fund. Në çastet e qeta, kur mundohej të qetësohej, mendimi për të ishte gjithmonë aty: Ai do të vijë. Ai nuk do të ndalet. Ky terror e ndiqte edhe në ëndrrat e saj. Gjumi nuk ishte strehë, por ishte një vend ku ai mund të vinte gjithmonë, një fantazmë që e shoqëronte. Ajo filloi të mbante shënime të çdo incidenti: mesazhe kërcënuese, telefonata anonime, njerëz që dukeshin të vëmendshëm në rrugë, makina të panjohura që e ndiqnin. Çdo detaj ishte një copëz e një harte të rrezikut që duhej kuptuar për të shpëtuar.

Për herë të parë, ajo ndjeu nevojën për të planifikuar largimin me kujdes. Çdo hap, çdo vend ku do të shkonte duhej të ishte i fshehtë. Nuk ishte më vetëm frikë; Ishte një strategji mbijetese. Në darkë, kur dritat e qytetit u shuan, ajo u ul për të bërë një listë:

Telefonoi avokatin për ndihmë ligjore dhe divorcin.
Duhej të gjejë një vend të sigurt për të fjetur, ku ai nuk mund ta gjente.
Duhej të kontaktojë ambasadën për strehim dhe mbrojtje.
Duhej të mbante gjithçka të fshehtë Duhej të ruhej sidomos nga telefonatat dhe mesazhet, sepse Bac Dhelpra kap çdo informacion në ajër
Ajo e dinte se çdo gabim mund të ishte fatal. Ai nuk ishte thjesht i zemëruar, ai ishte i pushtetshëm, i pasur dhe me mendje të sëmurë.
Çdo ditë që kalonte jashtë kontrollit të saj, frika rritej, por gjithashtu rritej edhe vendosmëria: Ajo nuk do të dorëzohej.
Vendimi për largim dhe strategjia e mbrojtjes
Në mëngjesin e tretë pas daljes nga spitali, ajo kuptoi se frika nuk do të largohej vetë. Ai e përgjonte kudo…. Vëzhguesin nga dritarja e kapi në momentin më të papërshtatshëm. Ai gaboi dhe u afrua shumë. Tashmë dukej qartë Ishte koha për të vepruar. Ajo mori telefonin dhe shkroi një mesazh të qartë për avokatin:"Nuk mund të rri më këtu. Ai do të vijë. Më ndihmo. Kam nevojë për mbrojtje dhe divorc. Kam ikur nga shtëpia te spitali. Jam në një shtëpi tjetër." Mendimi i largimit e mbushte me frikë, por edhe me një lloj fuqie të çuditshme. Çdo gjë duhej të ishte e planifikuar. Çantat u përgatitën në heshtje, duke përfshirë dokumente të rëndësishme, para dhe sende të nevojshme për disa ditë. Çdo gjë tjetër do të mbetej pas. Avokati i dha këshillat e para: Duhej të paraqitej kërkesë për divorc, edhe pse nuk

kishin çertifikatë martese dhe të kërkonte urdhër mbrojtjeje emergjente nga gjykata. Ai e paralajmëroi që agresori kishte pushtet dhe para, kështu që çdo gabim mund të shfrytëzohej.

Ajo vendosi të largohej nga shtëpia menjëherë pas takimit me avokatin. Përgatiti itinerarin e fshehtë, duke zgjedhur rrugë të panjohura, vendet ku nuk mund të monitoroheshin nga ai. Një mik i besueshëm e priti përkohësisht. Në një vend të fshehtë, ku mund të qëndronte pa u gjetur. Por largimi nuk ishte thjesht fizik; Ishte strategjik. Çdo lëvizje, çdo telefonatë, çdo informacion duhej të mbahej sekret. Ajo telefonoi edhe Ambasadën Amerikane në Tiranë, duke shpjeguar situatën. Strehimi, mbrojtja ligjore dhe ndihma emergjente ishin të domosdoshme. Në momentet kur mendonte për të ardhmen, ajo ndjeu një përzierje frike dhe vendosmërie. Nuk ishte më viktimë pasive; Po merrte kontrollin e jetës së saj. Çdo hap i planifikuar çdo rrugë e zgjedhur, e afronte pak nga pak drejt lirisë së saj.

Avokati me ekpin e tij e mori nga shtëpia në mënyrë të fshehtë dhe dërgoi në strehimoren që tha dhe ambasada Amerikane.

Strehimi i përkohshëm dhe mbrojtja

Ajri brenda ndërtesës ku ajo do të strehohej ishte i ngrohtë dhe i qetë, një kontrast i çuditshëm me frikën që mbante në shpirt. Çdo hap i saj ishte i matur. Gjithçka ishte paketuar e mbyllur me kujdes. Strehimi nuk ishte vetëm një vend për të fjetur. Ishte një qendër strategjike ku çdo

hap i agresorit mund të monitorohej dhe neutralizohej. Një grua e moshuar, përgjegjëse për strehimin, e priti me një buzëqeshje të butë, por të vendosur. "Je e sigurt këtu," tha ajo, por sytë e saj tregonin se kuptonte se kjo siguri ishte relative. Nuk kishte vend absolut të sigurt në një botë kur ai kishte pushtet dhe para.

Ajo u ul në një dhomë të vogël, me një tryezë të thjeshtë dhe një dritare të vogël që shikonte një oborr të heshtur. Çdo tingull nga jashtë e bënte të ndiente tensionin, por gjithashtu e mbante të vëmendshme. Telefonoi avokatin përsëri, duke e njoftuar për vendndodhjen e sigurt dhe për planin e përkohshëm.

Personeli i strehimit i dha udhëzime të qarta: Çdo mesazh i panjohur të raportohej menjëherë, çdo hap kur të dalësh jashtë të bëhej me kujdes dhe çdo informacion te brendshëm duhet ruajtur për të mos u shpërndarë jashtë. Ajo kuptoi që mbrojtja nuk vinte vetëm nga muret e forta, por edhe nga disiplinimi i çdo veprimi të saj. Ndërkohë, mendja e saj kthehej te ai. Ai mund të vinte gjithmonë, por tani ajo kishte strategji për të minimizuar rrezikun. Çdo ditë që kalonte në këtë vend ishte një ditë fitore e vogël. Nuk kishte qetësi absolute, por kishte kontroll të pjesshëm mbi fatin e saj. Në mbrëmje, ndërsa dritat e qytetit shuheshin dhe heshtja mbulonte rrugët. Ajo ndjeu një lloj force të re. Frika nuk ishte zhdukur, pra kishte vend për kujdes dhe për forcë denoncimi. Në heshtje, ajo e përqafonte këtë forcë, e dinte që kjo ishte armë më e fuqishme se çdo mur i fortë, apo kamera mbikëqyrjeje.

Çmenduria nuk vjen papritur. Ajo është heshtja e gjatë e dhimbjes që askush nuk e dëgjoi.
"Kur njeriu humb realitetin, ai nuk sheh më njerëz — Sheh skena nga vetja e tij."
Takimi me avokatin
Dhoma e avokatit ishte e vogël, por e ngrohtë. Librat e rreshtuar në raftet e larta i jepnin një ndjesi serioziteti dhe kompetence. Ajo u ul në karrigen përballë tavolinës, duke ndjerë një dridhje të vogël në duar. Avokati shikoi dokumentet që kishte sjellë, pastaj i hapi sytë me një shikim të qetë, por të vendosur. Ai ishte një tip serioz dhe zyrtar gjithmonë vishej me kostum të zi dhe këmishë të bardhë.
Avokati: E kuptoj situatën. Nuk jeni e martuar me letra, por ligji përcakton që mund të kërkoni ndihmë ligjore për ndarje dhe mbrojtje.
- Shpresa është një dritë që nuk shuhet, edhe kur rruga është errësirë e plotë. - tha ajo.
Pastaj vazhdoi: Disa ikin për të shpëtuar trupin; Të tjerë ikin për të shpëtuar shpirtin.
Ajo: Ai… nuk ndalet. Më ndjek, më survejon. Nuk mund të rri më në shtëpi. Kam frikë se do të më,… do të më dëmtojë.
- Po prandaj të largova nga shtëpia, - tha avokati dhe e shikoi drejt në sy. Pastaj duke shikuar nga dera foli: Këtu tek ne je e sigurtë. Mos keni frikë. E kuptoj, sepse kjo nuk është vetëm frikë e zakonshme. Këtu kemi rrezik real për jetën tuaj. Duhet të paraqesim menjëherë një urdhër mbrojtjeje emergjente. Dhe ngriti kokën edhe e shikoi në sy atë.

Ajo se la të mbarojë fjalën dhe ndërpreu e tha: Po avokat ke të drejtë, por s'është rast dosido. Fatëkeqësi për mua që e takova një njeri të tillë. Tani duhet të shpëtoj, por dhe të ruhem sepse ai ka para, pushtet…, dhe ndoshta nuk ka më mend të ndalet. A do të funksionojnë?

- Këto që thoni ju. Të shohim. Unë bësoj në ligj dhe drejtësi. Mbaroi ajo duke psherëtirë thellë dhe një pikë lot i ra mbi qerpik dhe rrëshqiti në faqe. Pastaj foli edhe një fjali .. Jeta duhet marrë si të vjen, - mbaroi ajo.

Avokati E shikoi në sy dhe ngriti zërin: Do të funksionojë, por duhet të jemi të zgjuar. Do ta bëjmë me takt. Ju duhet të jeni e fshehtë për çdo veprim. Do t'ju udhëzoj hap pas hapi. Nuk do të lejojmë që ai të ketë mundësi të përdorë pushtetin e tij kundër jush.

- E di, e di, - tha ajo. - Çfarë duhet të bëj tani? Ku duhet të shkoj? ……Të lutem avokat sigurohuni mirë.

Edhe u ngrit nga karrigia sikur për t'u shpirë. Ajo ishte shumë e bukur elegante dhe e gjatë. Sytë e saj lëshonin magnet dashurie për secilin mashkull, jo vetëm për Arbenin. Ajo gjithmonë vishej me rroba blu, në kombinim me të zeza. Dukej mrekulli pavarësisht pikëllimit që kishte ndër sy. "E vërteta e frikshme është më e shëndetshme se një gënjeshtër e ëmbël që të shkatërron."

"Njerëzit e çmendur i shpikin armiqtë; Njerëzit e urtë i gjejnë tek vetja."

Avokati, pasi e ndoqi bisedën e saj pa folur tha: Së pari, do të qëndroni në këtë vend të sigurt. Kam rregulluar

dokumentet për strehim të përkohshëm. Pastaj, do të fillojmë proçedurat për divorcin dhe urdhrin e mbrojtjes. Çdo mesazh dhe telefonatë e tij, duhet të regjistrohet dhe të mos i përgjigjeni.

Ajo: Dhe… nëse ai më gjen këtu?"

Avokati: Ai nuk do të mund t'ju gjejë. Jo nëse ndiqni planin. Por duhet të jeni e kujdesshme, të gjithë lëvizjet duhet të jenë të kontrolluara.

Ajo: Kam frikë,… por duhet ta bëj. Nuk mund të rri më pasive.

Avokati: Kjo është vendosmëria që ju nevojitet. Çdo hap që do të ndërmarrim është për mbrojtjen tuaj. Do të jeni e sigurt, por duhet të ndiqni rregullat.

Ajo mori frymën thellë, duke ndjerë tensionin dhe frikën, por edhe një lloj force të re që po rritej brenda saj. Ky takim nuk ishte thjesht ligjor. Ishte fillimi i betejës së saj për liri. Reflektim dhe ndërgjegjësim. Ashtu si ishte e veshur me fustan të zi dhe pallto gri.

Ajo u ul pranë dritares së vogël në strehimin e përkohshëm, duke shikuar rrugën bosh jashtë. Dritat e qytetit shuheshin një nga një, por frika nuk largohej. Ajo i kujtoi çdo moment të dhunës, çdo shprehje fjalësh kërcënuese, çdo shikim të ftohtë që e kishte shtrirë në panik.

"Sa shumë kam duruar,…" mendoi ajo. "Sa shumë kam lejuar që frika e tij të më kontrollojë." Por tani ndodhej larg, e fshehur dhe për herë të parë ndjente se kishte mundësi të vendoste vetë për jetën e saj.

Në heshtje, ajo shikonte kudo rrugën, njerëzit, ndërtesat, pastaj pushoi e foli me vete:"Nuk jam më viktimë. Nuk do të lejoj që frika të më shkatërrojë. Do të luftoj. Do të mbijetoj. Nuk mbyllet çdo histori me dashuri. Disa mbyllen me leksione, për humbjen dhe gjetjen e dashurisë së re. Disa me dhembje… Fundet nuk janë dënime — Janë portat nga ku fillon një jetë tjetër."

Një ndjenjë e fuqishme e pushtoi. Nuk ishte vetëm frika që e mbante zgjuar, por edhe vendosmëria që po rritej brenda saj. Çdo ditë që kalonte në këtë vend të fshehtë ishte një ditë fitore e vogël. Ajo po e mësonte të mbante kontroll mbi jetën e saj, mbi trupin dhe mendjen e saj, dhe mbi të ardhmen që kishte të drejtë ta krijonte.

Ajo e kuptoi që liria nuk vinte vetëm nga largimi fizik, por edhe nga fuqia e brendshme për të vendosur. Tani frika nuk ishte më armik i vetëm; Ishte një mjet që e mësonte të qëndronte e kujdesshme, e vëmendshme dhe e fortë.

Dhe ndërsa nata binte dhe heshtja mbulonte qytetin, ajo ndjeu se kishte një shpresë të vogël, por të fortë. Kjo ishte lufta e saj dhe nuk do ta humbte. Ajo natën vonë iku nga vendi i fshehtë i avokatit dhe forca të shumta të policisë e dërguan në strehimore. Ajo shpesh mallkonte atë natë interviste me doktorin në RTSH, por mbrohej me mendimin që ai njeri ishte tjetër i bukur, top model dhe shumë i zoti. Të gjitha femrat do binin në dashuri më të, tha më vete ajo. Si për t'u mbrojtur nga dënimi i vetes… Pastaj ra në heshjte…..Ajo qëndroi para portës së qendrës,

duke ndjerë një dridhje që i kalonte të gjithë trupin. Një ndjenjë frike dhe pasigurie e mbërthente: "A do të jem me të vërtetë e sigurt këtu?" Çdo hap drejt brendësisë dukej si një hap drejt një bote të panjohur, por njëkohësisht një shpëtim i mundshëm. Ajo ishte mësuar që të jepte lajme, të bëntë xhiro në qytet dhe të shkonte atje ku është lajmi. Tani morën fund ëndrrat dhe realiteti po i troket. Ajo ngriti kokën dhe pa një punonjëse që po e shikonte më vëmendje dhe kërshëri. Ajo ishte punonjëse e qendrës.

Një grua me uniformë të thjeshtë, e cila dukej e qetë dhe e vendosur, e priti tek dera.

Gruaja: Mirë se erdhët! Nuk keni pse keni frikë këtu. Jeni e sigurt.

Ajo: Përshendetje zonjë Ajeni! Mirë?

Edhe pa marrë përgjigjen e saj tha: Po… kam frikë… Ai nuk ndalet… Nuk di sa do të mund të jem e sigurt këtu.

Gruaja: Këtu nuk mund të vijë. Askush nuk do ta gjejë. Do t'ju ndihmojmë të qëndroni të fshehtë dhe të sigurt. Nuk jeni vetëm.

Ajo: U kënaq nga fjalimi i gruas e tha: Faleminderit! Nuk e di se çfarë të bëja pa ndihmën tuaj.

Gruaja e shoqëroi në një dhomë të vogël, me drita të buta dhe një atmosferë të qetë. Një tjetër grua, e cila kishte kaluar vetë situata të dhunshme, ishte atje për t'i dhënë mbështetje.

Gruaja tjetër: Kam qenë në vendin tënd. E di se frika të mban zgjuar gjithë natën. Por do të jesh e sigurt këtu. Do të

mësosh të marrësh kontroll mbi jetën tënde përsëri.
Ajo u ul në një karrige, duke ndjerë çdo dridhje të trupit. Çdo fjalë që dëgjonte ishte një qetësim i vogël, por frika nuk largohej krejtësisht. Çdo tingull jashtë dhomës, çdo hap i afërt e bënte të dridhej. Por ndjenja e mbështetjes dhe fakti që nuk ishte më vetëm filloi të formonte një forcë të brendshme. Ajo kishte lexuar vetëm në romane skena të tilla dhe si kishte dhënë rëndësi dikur. Kurrë s'do t'i shkonte mendja që një ditë do e jetë ajo vetë, që do e jetojë Pastaj ajo iu kthye sëmundjës së Arbenit dhe po e imitonte. Qeshi pak, por filloj të mendojë thellë…Si ka mundësi që ka ndodhur vërtet kjo?
Ajo (me vete): Mund të ndjej frikë… Por nuk jam më e vetmuar. Nuk do ta lejoj që të më kontrollojë. Do të luftoj, dhe do të mbijetoj.
Ajo e kuptoi se kjo ishte një hap i madh drejt lirisë së saj, një vend ku mund të fillonte të rindërtonte jetën, edhe pse frika do të qëndronte gjithmonë një hap larg.
Ndërhyrja e Ambasadës Amerikane. Telefoni i saj dridhej në dorë.
Numri i Ambasadës Amerikane në Tiranë që ajo kishte marrë nga avokati shfaqej në ekran. Merri frymën thellë, duke ndjerë frikën që i kalonte çdo qelizë të trupit, por edhe një shpresë të vogël që mund të bënte ndryshimin. Ajo e hapi më në fund telefonin dhe mes pasigurisë dhe frikës dëgjoi zërin tjetër në telefon.
Zëri i konsullit (në telefon): Ambasada Amerikane jam. Përshëndetje! A jeni mirë tani? - tha ai. Të telefonojmë që të

gjëjmë mënyrën si mund t'ju ndihmojmë?
Ai heshti për momentin, pastaj i bëri disa pyetje.
E ajo tha (me zë të dridhur): Jam Elira Dosti gazetare e RTSH. Unë jam në rrezik. Im shoq. Një njeri me pushtet dhe para, më ndjek dhe më kërcënon dhe më dhunon. Kisha nevojë për strehim dhe mbrojtje. Nuk mund të rrija më në shtëpi me të.
Konsulli: E kuptoj situatën dhe seriozitetin e saj. Pa merak zonjë. E kemi marrë seriozisht punën tuaj. Ne kemi mundësi për strehim emergjent dhe mbështetje ligjore. Do të koordinojmë me autoritetet vendase dhe do të sigurojmë që të jeni e mbrojtur. A mund të na jepni vendndodhjen tuaj aktuale?
- Po,- tha ai. - Unë kam një avokat dhe ai më ka ndihmuar shumë. Avokati më solli këtu.
- Shumë mirë, - tha tjetri në telefon. Elira shpjegoi se ku ishte me zë të dridhur dhe gjithë ankth Pastaj tha ajo: "Po… Jam në një qendër për gra të dhunuara. Në periferi të Tiranës. Dua të qëndroj këtu, por frikësohem se ai mund të më gjejë. Po ua nis vendnodhjen tani zoti konsull.
- Epo mirë, - tha ai. - Ne do të marrim masat tona patjetër. Edi që keni frikë nga ai njëri i vështirë, - tha Konsulli. - Kjo është e kuptueshme. Ne do të sigurojmë mbështetje shtesë dhe diskrecion maksimal. Askush nuk do të dijë vendndodhjen tuaj. Do të jeni nën mbrojtje ndërkombëtare dhe çdo kërcënim do të raportohet menjëherë.
Ajo mori frymën thellë, duke ndjerë se tensioni dhe

frika nuk kishin zhdukur, por për herë të parë ndjeu një mbështetje të fortë, një dorë që do të kujdesej për sigurinë e saj.
Në heshtjen e dhomës, ndërsa telefonata përfundoi, ajo i tha vetes:
"Nuk jam më vetëm. Nuk mund të më gjejë. Kam mbrojtje. Por duhet të qëndroj e zgjuar. Historia nuk ka mbaruar dhe unë nuk do të dorëzohem."
Drita e dobët që vinte nga dritarja e dhomës së strehimit i duket si një fillim i ri. Një ditë, ajo do të jetonte pa frikë, por deri atëherë, çdo hap ishte një betejë dhe çdo vendim, një hap drejt lirisë. Ajo u ul pranë tavolinës në strehimin e përkohshëm, me dokumentet e avokatit përpara. Telefoni dridhej në dorë. Një pjesë e saj kishte frikë se çdo hap mund të zbulohej, por pjesa tjetër ndjente vendosmërinë që kishte ndjerë për herë të parë pas shumë javësh. Frikën e saj e ndërpeu avokati nga ana tjetër e telefonit.
Ai tha: "Aloo," dhe foli direkt pa bërë pyetje tjera.
Avokati: Kemi një plan. Do të kërkojmë urdhër mbrojtjeje emergjente dhe do të nisim proçedurat për divorcin, pavarësisht se nuk kishit çertifikatë martese.
- Por kjo nuk mjafton, - tha kjo. - Ai ka pushtet dhe para.
- Pa merak zonjë, - tha avokati. - Jeni e frikësuar. E kuptoj. Çdo lëvizje do të jetë e fshehtë dhe e koordinuar. Dakord për këtë?
Ajo: Po… dua vetëm të jem e sigurt. Nuk mund të rri më pasive.

Avokati: Do të bashkëpunojmë me Ambasadën Amerikane në Tiranë. Ata do të të ofrojnë mbrojtje të menjëhershme dhe strehim të fshehtë. Do të jesh e mbrojtur, por duhet të ndjekësh çdo udhëzim që të japim.
Pas bisedës dhjetë minutëshe, ai mbylli telefonin.
Ajo mori frymën thellë dhe filloi të shkruante çdo detaj të lëvizjeve të mundshme të agresorit, duke krijuar një "hartë të rrezikut". Çdo rrugë dhe hap jashtë duhet të ishte strategjik. Ai njeri ka shumë punëtorë që i paguan dhe shumë spiunë njëkohësisht.
- Do ta kem të vështirë, - tha më vete ajo.
Pastaj u qetësua kur kujtoi që ka ndërhyrë Ambasada. (Asaj iu kujtua biseda ose telefonata me Ambasadën…}..Pastaj … Ishte e qetë, por çdo fjalë që mbante mend kur ai fliste Ia fuste frikën përsëri. Fjalët e doktorit nuk i hiqeshin nga mendja. Ato ia rrisnin tensionin: Por iu kujtuan dhe njëherë fjalët që foli me konsullin amerikan dhe filloi t'i kujtonte përsëri të gjitha. Uli kokën poshtë pastaj e ngriti gjysëm lartësi. E u qetësua nga ato premtime të një supërfuqie si USA. Pastaj ajo citoi fjalët ku fliste ai përfaqësuesi amerikan..
Konsulli: Ne kemi marrë kërkesën tuaj. Ju do të vendoseni në strehim të fshehtë dhe çdo kërcënim i agresorit do të monitorohet. Bashkëpunimi me avokatin tuaj është i domosdoshëm, për çdo hap ligjor. Avokati duhet pyetur. Asgjë mos bëj vetë. Ne jemi në kontakt me të.
Ajo u lehtësua kur kujtoi fjalët. Pastaj tha me vete: "Kam frikë se ai do të më gjejë. Nuk mund të rri më vetëm. Se di

sa e sigurtë jam këtu."
Por kur iu kujtuan fjalët e Konsullit: "Ky është qëllimi ynë. Ju nuk do të jeni vetëm. Do të ketë patrullim diskret, komunikim të sigurt dhe çdo masë do jetë emergjente në dispozicionin tuaj. Do të jeni e mbrojtur."
Pasi rikujtoi edhe disa herë bisedën me konsullin. Pra kur ajo i bëri analizë teksti bisedës…….
Ajo ndjeu një lehtësim të vogël. Frika ruan vreshtin edhe nuk ishte zhdukur, por tani kishte një dorë mbështetëse që e ndihmonte të qëndronte e sigurt.
Takimi i përbashkët: Avokat + Ambasada
Disa ditë më vonë, avokati dhe përfaqësuesi i ambasadës erdhën në qendrën e strehimit afër Qytetit Studenti, për të diskutuar strategjinë. Atmosfera ishte serioze dhe tensioni i ndjekjes ishte i pranishëm në çdo fjali. I pari që mori fjalën dhe hyri direkt në bisedë ishtë avokati. Ai e shikoi drejt në sy Elirën dhe e pyeti: Si ia ka kalur këtu? A ka shqetësime me personelin.

E duke i thënë që këtu ka siguri absolute dhe mos të ketë frikë. Ajo buzëqeshi lehtë. Dukej e shqetësuar, por e vendosur. Pastaj ai shtoi: Ulu në karrige dhe dëgjo zonjë.

Ajo heshti pak dhe u ul në karrigen përballë dhe pa që edhe përfaqësuesi amerikan i cili nxori bllokun dhe po shënonte. Ai filloi bisedën… "Tani flasim për punë tha ai seriozisht. Kemi një plan që funksionon në tre hapa: 1) Urdhër mbrojtjeje, 2) Divorc ligjor, 3) Strehim dhe mbrojtje e koordinuar."

Pastaj foli avokati: Çdo gabim mund të shfrytëzohet nga agresori.

Ai drejtoi shikimin nga amerikani, ose nga përfaqësuesi ambasadës i cili e mori seriozisht çështjen. Ai iu drejtua Elirës me një shikim të rreptë dhe autoritar. Kruajti zërin, rregulloi xhaketën, u ngrit në këmbë e pastaj tha: Zonjë jeni e sigurtë. Marinsat tanë do t'ju mbrojnë. Do të ketë patrulla të fshehta dhe strehim të fshehtë. Secila lëvizje duhet të jetë me koordinim me ne dhe avokatin. Ai nuk do të ketë asnjë mundësi për ndjekje.

Ajo nuk foli por nga frika shtoi: Çfarë ndodh nëse ai… gjen ndonjë gjurmë të vendndodhjes time?

Dhe filloi të qajë nga frika dhe stresi. Ndërkohë fshiu lotët më një letër të bardhë higjienike e u ul në karrige. Ata shikuan njëri -tjetrin dhe folën.

Avokati: Asnjë gjurmë nuk do të ekzistojë. Por duhet t'i respektojmë të gjitha rregullat. Çdo telefonatë dhe mesazh, çdo informacion i ndarë me të tjerët duhet të jetë i kontrolluar.

Elira tundi kokën në shenjë kuptimi dhe zbatim urdhri. Pastaj amerikani e shikoi me dhembshuri e tha: Unë jam përfaqësuesi i Ambasadës. Ju premtoj që do t'ju ndihmojmë kudo. Ne nuk bëjmë shaka. Mund të lëvizni vetëm me ne dhe çdo emergjencë do të menaxhohet. Jeni nën mbrojtje diplomatike.

Ajo u ul dhe mori frymë. Një pjesë e saj ishte e lehtësuar, një pjesë tjetër akoma dridhej nga frika. Por për herë të parë

ndjeu një strategji të plotë. Edhe pa një plan që mund ta shpëtonte jetën e saj.

Largimi i Fshehtë

Përgatitja dhe largimi nga qendra

Ajo u zgjua herët në mëngjes, ndërsa qyteti ishte ende gjumë. Dritat e dobëta të dhomës së strehimit i dhanë një ndjesi paqësore, por trupi saj ishte i tensionuar. Çdo hap duhet të ishte i matur, çdo gjurmë e lëvizjeve të saj të jetë e fshehtë. Ajo tashmë do shpëtonte dhe do ndihej e sigurtë vetëm jashtë Shqipërie. Ndërsa ishte akoma në pizhama, trokiti dera e dhomës. Elira u tremb pak, por zëri i punëtores e qetësoi.

Strehuesja: Jeni gati?

- Pa merak zonjë,- tha ajo pas derës. - Mos u tremb më. Çdo lëvizje do të jetë e planifikuar. Do të shkojmë në një vend tjetër që nuk ka kamera dhe nuk të njeh askush. Bëhu gati për gjysmë ore do vijnë të të marrin. Mos rri kot! Lëri mendimet dhe hamendjet. Tani je nën mbrojtjen tonë. Ke shpëtuar zonjë, - tha ajo. - Për ty po ndërhyn Amerika, O zonja gazetare.

Ajo: Po, po faleminderit! Kam frikë, por nuk mund të rri më pasive. Ai mund të vijë çdo moment.

Strehuesja: Mos u shqetëso. Ne do të jemi me ty në çdo hap të rrugës. Telefoni yt do të jetë i sigurtë nga ndjekja dhe survejimi. Çdo mesazh i panjohur do të fshihet, nuk do lexohet, deri sa të jemi të sigurtë.

Ajo mori frymën thellë, duke ndjerë tensionin që e mbante

zgjuar. Çantat e përgatitura më parë ishin aty: Dokumente ligjore, para, gjëra të domosdoshme për disa ditë. Çdo gjë tjetër mbetej pas.

Lëvizja e fshehtë

U nisën me një makinë të fshehtë, pa shenja dalluese, duke kaluar nëpër rrugë të ngushta e të panjohura. Shoferi ndryshonte drejtimet herë pas here, kthente papritur në rrugica anësore, ndalonte për pak çaste e pastaj vazhdonte sërish, sikur po fshinte gjurmët e një pranie të padukshme. Çdo lëvizje ishte e menduar për të shmangur çdo mundësi survejimi.

Ajo qëndronte e heshtur në sediljen e pasme, me shpinën paksa të përkulur përpara, duke shikuar përreth me sy të hapur dhe të tendosur.

Dritat e rrugës rrëshqisnin mbi xhamin e makinës si hije që vraponin. Çdo zhurmë e vogël - Një frenim i papritur, një motor që ndizej pranë, e ndonjë borí e largët - e bënte të dridhej. Zemra i rrihte fort, por ajo përpiqej të merrte frymë ngadalë, të mos tregonte panikun që po i mbyste gjoksin.

Në mendje, me një qetësi të ngritur dhe të dhimbshme, i tha vetes: “Çdo hap është një test. Por nuk mund të kthehem mbrapa.”

Për disa minuta, heshtja mbizotëroi. Asnjë fjalë nuk u tha. Vetëm zhurma e gomave mbi asfalt dhe rrahjet e zemrës së saj që i dukeshin më të forta se motori i makinës. Pastaj, pa paralajmërim, makina ngadalësoi dhe u ndal në një vend të fshehtë, larg dritave dhe zhurmës së qytetit.

Aty u pritën nga një tjetër person, një burrë me fytyrë të qetë, por sy vigjilentë i cili merrej me strehimin dhe menaxhimin e lëvizjeve. Ai hodhi një vështrim të shpejtë rreth e rrotull, sikur po verifikonte edhe një herë sigurinë e vendit, përpara se të fliste.

- Mirë se erdhët! - tha ai me zë të ulët, por të prerë. - Ky vend është i sigurt për tani. Do të qëndroni këtu derisa të kontrollojmë çdo gjurmë dhe të organizojmë lëvizjen tjetër.

Ajo zbriti nga makina me kujdes. Mori çantat me duar që ende i dridheshin lehtë dhe fshiu djersët e frikës nga balli me shpinën e dorës. Rregulloi flokët, që i kishin rënë mbi sy, si për t'u kapur pas një gjesti të vogël normaliteti, një shenjë se ende ishte ajo vetë.

Pastaj ngriti kokën dhe tha me zë të ulët, por të sinqertë: Faleminderit! Nuk e di çfarë do të bëja pa ndihmën tuaj.

Pa pritur përgjigje, u fut në strehimoren e re. Dera u mbyll pas saj me një tingull të thatë. Për herë të parë pas shumë kohësh, ajo ndjeu një qetësi të brishtë. Jo sepse frika kishte ikur, por sepse, të paktën për atë natë, ajo kishte shpëtuar.

Koordinimi me avokatin dhe Ambasadën

Pasi u vendos, ajo mori një telefonatë nga avokati.

Avokati: Çdo gjë po shkon sipas planit. Urdhri i mbrojtjes është i gatshëm dhe Ambasada është në dijeni të vendndodhjes suaj. Do të ketë patrullim diskret dhe çdo kërcënim do të raportohet menjëherë.

Ajo nuk foli vetëm dëgjoi, por pas kësaj tha: Kam frikë… Nëse dal jashtë derës më duket rrezik.

Avokati: Kjo është normale. Por tani ke një strategji. Nuk je më e vetme. Çdo vendim që merr do të jetë i mbrojtur.
Më pas, telefoni i saj dridhej me një tjetër mesazh nga Ambasada. Ajo e hapi dhe lexoi. Sytë i shndritën dhe më shumë kur lexoi atë që kishte shkruar konsulli: "Jeni nën mbrojtje të plotë. Çdo kërcënim i mundshëm do të menaxhohet. Mos dilni pa koordinuar me ne, ose me avokatin."
Ajo mori frymën thellë dhe ndjeu një lehtësim të vogël. Frika nuk ishte zhdukur, por tani kishte një rrjet mbështetjeje që e mbante të sigurt, ishte një hap drejt lirisë së saj.
Arbeni merr vesh largimin e Elirës
Ai e mori vesh nga burime të afërta: Elira po planifikonte të largohej drejt SHBA-së. Ajo kishte marrë ndihmë nga Ambasada dhe avokati. Zemra i rrihte me një ritëm të çmendur dhe mendja i rrëshqiste mes fiksimeve dhe paranojës.
Arbeni nuk ishte më njeriu i qetë pas terapive. Ai ishte lehtësuar pas një periudhe trajtimi, por jo krejt. Shumë shenja të çmendurisë dhe kontrollit ekstrem vazhdonin të shfaqeshin në veprimet e tij. Ai ndihej i tradhtuar dhe i humbur.
Ai bëri organizimin: të gjithë punëtorët dhe kontaktet e tij në qytet morën urdhra të qarta. Çdo rrugë, çdo lagje, çdo vend ku mund të shkonte Elira duhej survejuar. Ai e ndiqte si anija në dallgë të mëdha, pa kursyer asgjë.
Frika dhe koordinimi i masave emergjente

Në strehimin e fshehtë, Elira mori një telefonatë nga avokati.
Avokati: Ai e ka marrë vesh largimin tuaj. Po organizon gjithçka për t'ju ndaluar. Duhet të qëndroni të fshehtë dhe të mos dilni pa koordinim.
Elira e shqëtesuar dhe me zë të mekur tha: E di… Kam frikë se nuk do të ndalet. Ai mund të bëjë çdo gjë. Dhe vetëm ju dhe shteti Amerikan mund ta ndaloni, se me këta në pushtet ai e ka mirë shumë.
Avokati: Po. Por tani jeni nën mbrojtje të plotë të Ambasadës. Çdo kërcënim i mundshëm do të raportohet menjëherë në polici. Nuk mund të vijë këtu. Mbroheni nga marinsat zonjë. S'bëhet shaka me ta.
Ajo mori frymën thellë, duke ndjerë tensionin të përthithte në çdo atom të trupit, por edhe një ndjenjë lehtësimi i erdhi në trup dhe mendje e uli gotën e ujit mbi tavolinë dhe u kënaq nga mendimi që kishte mbrojtje ligjore dhe diplomatike që e mbante të sigurt.
Njerëzit denoncojnë Arbenin dhe ndërhyrja e policisë
Kur Arbeni u afrua në qytet, disa qytetarë dhe fqinjë që kishin parë sjelljen e tij të dhunshme dhe kërcënuese, kontaktuan menjëherë policinë.
Polici telefonoi avokatin i cili kishtë lënë numër kontakti tek informacioni i policisë dhe tha menjëherë: Kemi marrë informacion se një person po ndjek dhe kërcënon një grua. Ai është Arbeni, i njohur për shkelje dhe dhunë. Është kapur kot më të. Edhe sipas patrullave është dr. Arbeni.
Avokati (në telefon): Dakord na ka dal në plan taman. Kjo

është koha e veprimit. Të ndalohet për një shkelje tjetër. Edhe mos t'i shkojë mendja tek Elira. Le të ndërhyjë policia. Edhe ky veprim do të sigurojë që ai të mos ketë mendjen tek klientja jonë.
- Dakord shef. - tha polici. - Po flas me shefin e krimeve të komisariatit dhe po veprojmë.
Policia e ndaloi Arbenin, duke e larguar nga qyteti dhe duke vendosur masa të menjëherëshme sigurie. Ai rezistoi dhe bërtiti, por nuk kishte rrugëdalje. Atë e dërguan në një komisariat në Elbasan, që të ishte sa më larg Elirës. Nga larg dëgjohej zëri i tij, që depërtonte ajrin me gjatësi një kilometër afër komisariatit.
Arbeni (duke bërtitur): Nuk mund ta lejoj! Do ta ndaloj! Do të vij tek ajo!
Polici: Asnjë hap. Ju jeni nën arrest. Çdo kërcënim që keni bërë ndaj gruas është një krim i rrezikshëm.
Ai heshti por përsëri filloi të bërtiste derisa i tha polici: Nëse vazhdoni kështu do të vijë grupi i gatshëm të merret me ty zotëri. Hesht dhe prit vendimin e prokororit.

Lehtësimi dhe siguria e Elirës
Në strehim, Elira mori lajmin se Arbeni ishte ndaluar dhe se policia kishte marrë masa të rrepta për të parandaluar çdo kontakt.
Elira (në mendje): "Është larg… Por frika nuk ka mbaruar ende. Por tani mund të marr frymë pak më qetë. Nuk jam më e vetme dhe nuk do të lejoj të më kontrollojë."

Ajo përsëri një mori një telefonatë nga Ambasada:
Konsulli: Zonjë përshëndetje! Zotëria është ndaluar. Ju jeni të mbrojtur. Çdo masë emergjente do të jetë në dispozicionin tuaj. Nuk ka më rrezik të menjëhershëm.
Ajo ofshau dhe nxori frymën.
- Shyqyr, - tha ajo më në fund. - Mbase ka Zot edhe për mua.
Një lehtësim i vogël mbushi dhomën, por tensioni i fshehur nuk ishte zhdukur. Elira e dinte se liria e saj ishte e sigurt për momentin, por historia nuk kishte mbaruar ende.
Fluturimi drejt lirisë. Planifikimi i largimit
Në strehimin e fshehtë, Elira u ul pranë avokatit dhe përfaqësuesit të Ambasadës për të finalizuar planin e largimit. Tavolina ishte mbushur me dokumente, bileta të fshehura dhe lista me itinerarë të mundshëm.
Avokati: Ky është plani për largimin drejt SHBA-së. Do të përdorim rrugë të fshehta dhe transport diskret. Askush nuk do të dijë itinerarin tuaj.
Elira: Kam frikë se çdo gabim mund të na zhbëjë gjithë planin.
Përfaqësuesi i Ambasadës: Kjo është normale. Por çdo hap është i kontrolluar. Policia është në dijeni të çdo veprimi të mundshëm të Arbenit. Patrullimi diskret dhe mbrojtja ligjore do të jenë aktivë deri në momentin që hipni në avion.
Elira: Po… Duhet ta bëjmë sa më shpejt. Nuk mund të rri më pasive.
Avokati: Do të ecim hap pas hapi. Çdo lëvizje do të

koordinohet me ne. Ju duhet të ndiqni çdo udhëzim. Edhe marinsat amerikanë do t'ju shoqërojnë nga larg. Askush nuk ka mundësi t'ju marrë. Jeni e mbrojtur sa një president. - dhe qeshi më në fund ai.

Elira qëndronte në zyrën e strehimit, duke mbajtur dokumentet dhe biletat e avionit që do t'i jepnin gjithmonë lirinë. Larg nga këtu. Zemra i rrihte, por diçka brenda saj e shtynte të vepronte.

Elira: Tani nuk mund të hesht më. Ai duhet të ndalet. Nuk mund të lejoj që dikush tjetër të vuajë pasojat e tij.

Mos e lejoni atë njeri të shkaktojë viktima të tjera. Bëjini publike se është i marrë.

Avokati: Ke të drejtë. Do të fillojmë proçedurat penale. Do të thërrasim policinë dhe do të dorëzojmë çdo provë që kemi. Çdo kërcënim dhe ndjekje ndaj një femre është kriminale.

Elira: Po… duhet ta bëjmë. Nuk mund të rrimë më pasivë. Po e denoncoj. Ai është një minë lëvizëse. Edhe mund të bëhet viktimë e tij çdo grua tjetër si unë.

Thirrja e kapitenit të rajonit

Policia e Tiranës u përfshi menjëherë. Një telefonatë e avokatit mjaftoi për të vënë në lëvizje mekanizmin zyrtar. Kapiteni i rajonit u thirr urgjentisht dhe, pas pak, mbërriti në qendrën e strehimit për të marrë personalisht raportin e Elirës. Prania e tij solli një ndjesi serioziteti dhe rendi, sikur për herë të parë frika e saj po merrte formë ligjore. Ai hyri në dhomë me hapa të qetë, por të vendosur. Uniforma

ishte e rregullt, fytyra e përmbajtur, sytë të vëmendshëm. U prezantua shkurt dhe u ul përballë saj, duke nxjerrë bllokun e shënimeve.

- Mirë se ju gjeta! - tha me ton profesional. - Kam dëgjuar për situatën tuaj. Na tregoni çdo detaj që mund të na ndihmojë të veprojmë.

Elira mori frymë thellë. Duart i ishin ftohur, por zëri i doli i qartë. Ishte hera e parë që po fliste jo si viktimë e frikës, por si dëshmitare e së vërtetës. "Ai më ndjek," tha. "Më survejon. Më ka kërcënuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë të tërthortë. Ka pushtet dhe para dhe mendon se kjo e bën të paprekshëm. Por çdo gjë është dokumentuar. Telefonatat, mesazhet, oraret, lëvizjet… çdo shenjë e tij. I kam të gjitha."

Ajo nxori telefonin dhe një dosje të hollë nga çanta. Provat ishin aty, të renditura me kujdes, sikur vetë ajo kishte ndërtuar një mur mbrojtës fletë pas flete.

Kapiteni i hodhi një vështrim të shpejtë materialeve dhe tundi lehtë kokën.

- Shumë mirë, - tha. - Çdo provë do të regjistrohet zyrtarisht dhe do të hapim procedurën penale menjëherë. Pas kallëzimit, ju jeni person i mbrojtur nga ligji. Askush nuk mund t'ju prekë gjatë këtij procesi.

Fjalët e tij nuk ishin premtime boshe; Ishin fjali të rënda, të shkruara në ligj. Për herë të parë pas shumë kohe, Elira ndjeu diçka që i afrohej sigurisë. Ajo buzëqeshi lehtë, një buzëqeshje e thyer, por e sinqertë. Pastaj filloi ta denonconte Arbenin, pa emocione të panevojshme, pa hakmarrje në

zë. Vetëm fakte. Vetëm e vërteta. Dashuria e dikurshme nuk kishte më vend aty; Kishte mbetur vetëm nevoja për drejtësi.

Së bashku me ekipin mbikëqyrës dhe nën shoqërimin e policisë, u nisën drejt komisariatit. Çdo hap drejt ndërtesës zyrtare ishte një hap larg errësirës. Aty, në zyrat e ftohta dhe të ndriçuara me neon, u bë gjithçka ligjore:

Deklaratat, firmat, procesverbalet.

Kur doli prej andej, Elira nuk ishte ende e lirë, por ishte e mbrojtur. Dhe kjo ishte hera e parë që frika nuk e udhëhiqte më rrugën e saj.

Skena në polici

Në stacionin e policisë, Elira u ul përballë një tavoline të madhe metalike, e ftohtë në prekje, ku oficerët e policisë gjyqësore dhe avokati i saj ishin tashmë të pranishëm. Drita e fortë e neonit binte drejt mbi dokumente, duke i bërë shkronjat të duken edhe më të rënda. Në muret përreth, monitorë sigurie shfaqnin pamje nga kamera të fshehta: Lëvizjet e Arbenit, ndalesat e dyshimta, mesazhet kërcënuese, oraret e përsëritura. Çdo detaj i frikës së saj ishte kthyer në provë.

Oficeri i policisë gjyqësore foli me zë të qetë, por të prerë, duke treguar një dosje të trashë përpara saj.

"Çdo veprim i Arbenit është dokumentuar. Regjistrimet audio, pamjet filmike dhe dëshmitë përputhen. Do të nisë procedura penale për ndjekje, kërcënime dhe rrezikim të jetës. Gjykata do të vendosë masën e ndalimit për t'iu afruar juve 100 m larg."

Ai i shtyu dokumentet drejt saj dhe shtoi: Ju lutem, firmoseni këtu — Në çdo faqe. Dhe në fund: Emër, mbiemër dhe firmë.
Elira mori stilolapsin. Dora i dridhej lehtë, jo nga frika e çastit, por nga pesha e gjithçkaje që po mbyllej pas një firme. Ajo ngriti sytë.
- Kam frikë se mund të reagojë, - tha me zë të ulët. - Nuk di nëse do ta kuptojë se ka humbur kontrollin.
Kapiteni i rajonit, i cili qëndronte pak më larg, ndërhyri menjëherë. Zëri i tij ishte i fortë, i sigurt.
- Ky është ligji, - tha. - Ju jeni e mbrojtur. Çdo kërcënim i mëtejshëm do të ndëshkohet. Ne jemi këtu për t'ju mbrojtur dhe proçedura penale do të vazhdojë deri në fund.
Avokati u përkul pak drejt saj, me një ton më të butë, por po aq të vendosur.
"Tani kemi një mbrojtje të plotë ligjore. Ai nuk mund të reagojë kundër jush pa pasoja të rënda penale. Çdo shkelje e urdhrit do të përkeqësojë pozitën e tij."
Kapiteni shtoi, duke e parë drejt në sy: Të gjitha pasojat që ju ka shkaktuar ai njeri do t'i përgjigjet ligjërisht.
Elira uli sytë dhe filloi të firmoste faqet njëra pas tjetrës. Çdo firmë ishte një ndarje, me frikën, me heshtjen, me fajin që kishte mbajtur për vete. Kur mbërriti në faqen e fundit, shkroi emrin dhe mbiemrin me një dorë më të fortë se sa priste.
Kur mbaroi, e la stilolapsin mbi tavolinë dhe mori frymë thellë. Një ndjenjë lehtësimi i përshkoi trupin, e ngadaltë,

por reale. Frika nuk kishte ikur plotësisht, por tani ajo nuk ishte më vetëm.

Lehtësimi dhe vendosmëria

Elira u ul në karrige dhe mori frymën thellë. Për herë të parë ndjeu një ndjesi të fortë sigurie:

Elira (në mendje): Ai nuk mund të më ndjekë më. Ligji është me mua. Por historia nuk ka mbaruar ende. Duhet të qëndroj e zgjuar dhe të mbroj lirinë time. Pa liri s'ka jetë. Jam budallaqe. Është e kotë të besojmë të dashuria më shikim të parë. Të gjitha dashuritë janë gënjeshtra. Ajo tashmë s'do dashurojë më kurrë. Kishte humbur të gjitha ndjesitë e dashurisë. Ajo iku e qetë nën shoqërinë e grupit të gatshëm policorë. Tashmë historia e dashurisë së tyre ishte drejt fundit. Iku shpejt dhe u ndal. Të qëndronte në dhomën e strehimit, duke shikuar dokumentet e mbledhura. Telefonata të panumërta, mesazhe kërcënuese dhe shenja e survejimit ishin regjistruar dhe dokumentuar me kujdes. Zemra i rrihte, por diçka brenda saj e shtynte të vepronte.

Elira: Nuk mund të heshtja më… Ai duhet të ndalej. Nuk mund të lejoja që dikush tjetër të vuajë pasojat e tij.

Avokati: Ke të drejtë. Pas denocimit do të fillojmë proçedurat penale menjëherë. Çdo provë që ke mbledhur do të përdoret kundër tij. Çdo kërcënim dhe ndjekje janë krime të rënda. Ne të gjitha ia dhamë oficerëve gjyqësor, me prova dhe fakte.

Elira: Kam frikë… Nuk e di nëse mund të më bëjë gjë përsëri ai.

Avokati: Tani ishte koha. Ti je një armë kundër tij. Ligji është me ty dhe nuk do të lejosh që ai të ndikojë më në jetën tënde.
Elira mori frymën thellë dhe filloi të organizonte dokumentet sipas kronologjisë: Çdo telefonatë, mesazh dhe incident i regjistruar. Të gjitha provat materiale që kishte për të Ia dorëzoi policisë dhe Ambasadës. Një kopje e mbajti për vete. "Mbase do e botoj një ditë,"- mendoi.
Ndihma e Ambasadës
Koordinimi me Ambasadën Amerikane ishte i vazhdueshëm dhe i strukturuar. Çdo hap, çdo vendndodhje dhe çdo orar i Elirës kalonte përmes një filtri sigurie të dyfishtë. Policia shqiptare dhe përfaqësuesit diplomatikë punonin në heshtje, larg syve të publikut, për të garantuar që asnjë detaj të mos lihej rastësisë. Një përfaqësues i Ambasadës u takua personalisht me Elirën dhe stafin drejtues të policisë. Takimi u zhvillua në një ambient të sigurt, pa zhurmë, por me një seriozitet që e bënte të qartë se situata po trajtohej në nivel të lartë. Çdo skenar i mundshëm u analizua: Lëvizjet, kontaktet, rreziqet, mënyrat e reagimit të menjëhershëm.
Konsulli mori fjalën me një ton të qetë, pothuajse prindëror, sikur donte t'i largonte frikën jo vetëm me fjalë, por me bindje.
- Jeni e mbrojtur, - tha ai. - Çdo kërcënim i mundshëm do të menaxhohet menjëherë. Patrullimi i fshehtë është aktiv dhe çdo lëvizje e tij po monitorohet në kohë reale. Nuk jeni vetëm dhe nuk jeni më e pambrojtur.

Fjalët e tij nuk ishin thjesht ngushëllim. Pas tyre fshihej një mekanizëm i tërë sigurie: Vëzhgim diskret, komunikim i koduar, ndërhyrje e shpejtë në rast rreziku. Elira e ndjeu këtë, jo si presion, por si një mburojë të padukshme që më në fund po ngrihej rreth saj.

Ajo foli ngadalë, me një zë që ende mbante gjurmë frike, por edhe një fill shprese.

- Kam frikë, - tha. - Por për herë të parë ndiej se nuk jam më e vetme. Nuk jam e pambrojtur.

Avokati ndërhyri menjëherë, duke e përforcuar mesazhin me gjuhë ligjore të prerë.

- Tani ke mbrojtje të plotë, - tha ai. - Nuk mund të ketë më ndjekje apo kërcënime pa pasoja të rënda dhe çdo masë e mundshme është e gatshme për t'u zbatuar në çast.

Elira uli sytë për një moment, duke marrë frymë thellë. Frika nuk ishte zhdukur plotësisht - Ajo nuk largohet kaq lehtë - Por tani ajo nuk e sundonte më. Për herë të parë pas shumë kohësh, Elira ndjeu se kishte aleatë, institucione, njerëz që qëndronin përkrah saj jo nga mëshira, por nga drejtësia. Dhe kjo e ndryshoi gjithçka

Reagimi i Arbenit dhe lehtësimi i Elirës

Arbeni u ndalua në komisariat nën masa të menjëhershme sigurie. Fillimisht për shqetësimin dhe kërcënimin e një personi tjetër, por shumë shpejt ndaj tij u vendos edhe ndalimi absolut për çdo kontakt me Elirën. Urdhri ishte i qartë, i prerë dhe i pakthyeshëm. Nga korridoret e komisariatit dëgjoheshin britmat e tij. Zëri i Arbenit, dikur

i qetë dhe racional, tani ishte i çarë nga çmenduria dhe humbja e kontrollit.
"Nuk mund ta lejoj! - bërtiste ai. - Do ta ndaloj me çdo çmim! Ajo më tradhtoi! Ajo qenka e pabesë! Tani që unë rashë brenda… Ajo iku!"
Fjalët i dilnin të copëtuara, pa logjikë, si mendime që përplaseshin me njëra-tjetrën. Ai nuk fliste më me realitetin, por me versionin e tij të deformuar të së vërtetës, një botë ku ai ishte viktimë. Dhe ku Elira po vuante, pavarësisht ligjit, moralit apo pafajsisë së saj.
Një polic iu afrua dhe i foli me zë të prerë, pa asnjë luhatje: Jeni nën arrest. Çdo kërcënim ndaj gruas do të ndiqet penalisht. Nuk ka më rrugëdalje për ju.
Fjalët ranë si një derë e mbyllur përfundimisht. Për herë të parë, Arbeni nuk kishte më kontroll mbi askënd, as mbi të, as mbi situatën, as mbi jetën e tij.
Ndërkohë, Elira ndodhej prej ditësh në strehimore. Ora ecte ngadalë, çdo minutë i dukej i zgjatur. Ajo priste lajme, duke ecur herë pas here nëpër dhomë, duke u ndalur pranë dritares, duke dëgjuar zhurma që tani nuk i frikësonin më si më parë, por ende i mbanin zemrën vigjilente. Kur më në fund mori lajmin, u ul ngadalë. Mori frymë thellë, sikur për herë të parë mushkëritë e saj u mbushën plot. Lotët i dolën pa zhurmë, jo nga dhimbja, por nga lehtësimi.
Në një monolog të heshtur me veten, tha: Do Zoti dhe shpëtova. Ai nuk mund të më ndjekë më. Ligji është me mua. Historia nuk ka mbaruar ende, por unë nuk jam më

viktimë. Do ta mbroj jetën time.
Fjalët nuk ishin thjesht mendime, ishin një betim i brendshëm. Një kufi i vendosur përfundimisht mes së kaluarës dhe asaj që do të vinte.
Çmenduria e Arbenit
Shfaqja e halucinacioneve dhe obsesioneve
Pas ndalimit dhe fillimit të procedurave penale, Arbeni filloi të humbte gjithnjë e më shumë kontaktin me realitetin. Qoftë në dhomën e izolimit në komisariat, qoftë më pas në ambientet e spitalit psikiatrik, sjellja e tij u bë e paqëndrueshme dhe e rrezikshme.
Ai fliste shpesh me një figurë imagjinare që e quante "Qirllin" — një shok i sajuar nga obsesionet e tij, Një zë që e nxitonte, e justifikonte,ushqente me idenë se kishte të drejtë. Debatonte me të, qeshte papritur, pastaj shpërthente në zemërim, sikur po përballej me armiq të padukshëm.
Halucinacionet vizuale u shtuan. Dritat e dhomës i shihte si sy që e vëzhgonin. Hijet në mure shndërroheshin në njerëz që e ndiqnin, në figura që i afroheshin pa zhurmë. Ndonjëherë ngrihej me vrull, duke bërtitur se dikush po vinte për ta marrë.
Mjekët shënonin çdo detaj. Dosja e tij po mbushej jo vetëm me akuza penale, por edhe me prova të qarta të një shkatërrimi mendor të thellë, një çmenduri e ushqyer nga obsesioni, humbja dhe refuzimi i realitetit. Ndërsa Arbeni fundosej gjithnjë e më shumë në errësirën e mendjes së tij, Elira, diku larg, po fillonte ngadalë të ringrihej. Dy rrugë

që dikur ishin kryqëzuar nga dashuria, tani ndaheshin përfundimisht: Njëra drejt shkatërrimit, tjetra drejt mbijetesës dhe jetës. Fliste me veten në mënyrë obsesive, duke shprehur frikë dhe fiksime për Elirën dhe të tjerët. Të gjithë ndalonin dhe nuk flisnin. Vetëm dëgjonin.

Arbeni (duke folur me Qirllin): Ti e di… Ata nuk kuptojnë. Ajo do të kthehet… Duhet ta ndaloj… Ata nuk e lejojnë, por unë do ta bëj.

Qirlli (imagjinar, në mendjen e tij) vazhdonte ta mësonte atë.

"Çfarë po bëjmë? Ajo është larg… Ti po humb çdo kontroll."

Arbeni godiste murin, bërtiste dhe ndjente një presion të jashtëzakonshëm të mendimeve paranojake. Çdo hap i tij dukej sikur e bënte të zhytet më thellë në çmenduri. Ai qante dhe pastaj qeshte. Paranoja e tij tashmë nuk ka më shpëtim.

Shtrime dhe trajtime spitalore

Ai u dërgua në spital për trajtim të menjëhershëm. Mjekët diagnostikuan një psikopati të rëndë, me simptoma paranoje dhe halucinacione. Ata vendosën shtrim të tij të shpejtë dhe receta mjekësore u bënë gati për të stabilizuar gjendjen. Ato u shkruajtën menjëherë nga mjekët psikiatër. Në mënyrë të shpejtë mjekët u mblodhën te dhoma e tij e shtrimit pasi i bënë konsultën përfundimtare.

Doktori: Ai ka humbur kontaktin me realitetin. Ne do të shkruajmë receta për të ulur simptomat obsesive dhe halucinacionet. Çdo trajtim duhet të monitorohet ngushtë.

Infermierja: Ai shpesh sulmon kur nuk kupton realitetin.

Duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mbajmë regjistrime të çdo veprimi.

Arbeni kalonte periudha të gjata të qetësisë të ndërprera nga episode të dhunshme psikologjike. Obsesionet për Elirën dhe për kontrollin e gjithçkaje që kishte humbur, e bënin të pandërgjegjshëm ndaj mjedisit. Ai ishte i sëmurë mendor. Frika për humbjen e lirisë iu kthye në një obsesion psikopatologjik dhe në sulme ndaj të tjerëve. Ai vetëm qante dhe shante këdo që i afrohej. Më pas u diskutua edhe mundësia e takimeve të tij, por vetëm me leje të posaçme, thanë mjekët, sepse kjo do ta përkeqësonte edhe më shumë gjendjen e tij.

Daljet për pak ditë dhe recetat për shërim.

Pas disa ditësh, kishte përmirësim dhe do të lirohej për periudha të shkurtra, sipas protokollit spitalor. Por çdo dalje ishte një shfaqje e paranojës dhe tensionit të brendshëm, ai ndiente se kishte humbur gjithçka dhe i urrente qytetarët që kalonin në rrugë, duke i parë ata si një kërcënim të vazhdueshëm.

Fjalët e tij ishin të ngatërruara, shpesh fliste për Elirën, Qirllin dhe njerëzit që donte të kontrollonte.

Recetat dhe trajtimi mjekësor synonin të stabilizonin gjendjen, duke përfshirë ilaçe për psikozë, qetësues dhe trajtime psikoterapeutike intensive. Në mbledhjen e fundit kishte diçka të përmirësuar, por duhej parë me vëmendje, kishte thënë doktori kryesor që po e ndiqte atë.

Doktori: Recetat po funksionojnë pjesërisht. Ai është

stabil për momentin, por ka nevojë për monitorim të vazhdueshëm.
Ai nuk ishte më agresiv, por shërimi ishte ende larg shpresës. Paranoja e tij fliste me veten dhe me hijet.
Arbeni fliste me hijet, por dhe s'dihej përgjigja. Ai thoshte me zë të lartë: Ata nuk kuptojnë… Askush nuk kupton… Por unë do ta ndjek… , Nuk do ta humb…Do ta marr përsëri.

Kthimi i obsesionit dhe izolimi psikologjik
Obsesioni i tij për Elirën nuk u shua me ndalimin, përkundrazi, u ngulit përjetësisht në mendjen e tij. Kontrolli që dikur ushtronte mbi të tjerët, mbi situatat, mbi vetë jetën, tani ekzistonte vetëm si iluzion në një mendje që po shpërbëhej dita-ditës. Shtrime të tjera të njëpasnjëshme, terapi intensive dhe konsultime të vazhdueshme me neurologë dhe psikologë u ndërmorën për të parandaluar çdo rrezik të mëtejshëm, çdo rikthim të mundshëm të ndjekjes. Por Arbeni kishte humbur tashmë diçka thelbësore: Lidhjen me realitetin.
Ai nuk e kontrollonte më mendimin e vet. Kujtimet, fantazitë dhe haluçinacionet përziheshin pa kufij, duke krijuar një botë të brendshme ku Elira ishte ende aty — Jo si njeri i lirë, por si figurë e përvetësuar, si simbol i pushtetit të humbur. Në atë botë, ai ende besonte se kishte të drejtë, se e vërteta ishte vetëm e tij.
Dialogu me Qirllin imagjinar vazhdonte pa ndërprerje. Qirlli nuk ishte më thjesht një shok i përfytyruar. Ai ishte

pasqyra e copëtuar e vetëdijes së tij, zëri që e sfidonte dhe e mashtronte njëkohësisht.

Përmes këtij dialogu, identiteti i Arbenit shpërbëhej ngadalë, si një pasqyrë e thyer në qindra copa.

Psikopatia dhe paranoia u përforcuan. Çdo shikim i mjekëve i dukej kërcënim. Çdo hap i infermierëve, një kurth. Ata e monitoronin pa pushim — Jo vetëm për sigurinë e të tjerëve, por edhe për të, sepse ai ishte bërë rrezik për vetveten. Një mëngjes, para agimit, ai u humb sërish. U ngrit në mes të dhomës së bardhë dhe filloi të fliste me një njeri që askush tjetër nuk e shihte. Zëri i tij ngrihej e binte, sikur po zhvillonte një gjyq të brendshëm. Ai bërtiste dhe po vetë ia kthente përgjigjet.

- Unë… nuk jam i marrë…- thoshte me zë të lartë, duke shtrënguar kokën me duar. - Ata nuk kuptojnë… Ajo do të kthehet…vetë dhe unë do ta ndaloj… të ikë përsëri? Joo. Mbaje mend këtë.

Qirlli iu përgjigj me një zë të ulët, por therës, që dukej se vinte nga hijet e murit: Është e pamundur… Gjithçka po shpërbëhet.

Arbeni u kthye me vrull, duke parë drejt një qoshe bosh.

- Mos rri aty, - bërtiti. - E di që je aty. Mos u fsheh pas hijes.

Zëri i Qirllit u dëgjua sërish, i qetë, pothuajse i dhembshur: Unë s'jam hije, Arben. Ti je ai që po fshihesh.

Fjalët ranë rëndë. Për një çast, Arbeni heshti. Sytë iu mbushën me konfuzion, sikur realiteti po përpiqej të depërtonte. Por çasti kaloi shpejt. Ai u ul ngadalë në

shtrat, duke murmuritur fjalë të pakuptueshme, ndërsa mjekët shënonin edhe një episod tjetër të humbjes së plotë mendore.

Izolimi i tij nuk ishte më fizik. Ishte psikologjik, i pakthyeshëm. Një burg pa mure, ku mendja ishte xhelati dhe viktima njëkohësisht. Ndërsa Arbeni fundosej në këtë errësirë të brendshme, bota jashtë vazhdonte pa të. Dhe Elira, larg, po ndërtonte një jetë ku emri i tij po shndërrohej ngadalë në një kujtim që nuk kishte më pushtet. Ai tashmë ishte pa arsye, fliste kot…

Arbeni, fantazmës së padukshme: Gënjen! Ti erdhe për të më marrë. Të gjithë vijnë për këtë. Qirilli: Askush s'po të merr asgjë. Ti e ke humbur vetë gjithçka.

Arbeni (duke bërtitur): Hesht! Mos ma thuaj këtë! Lirinë nuk ta jap!

Qirilli (qetë): Liria jote është frika jote. Prandaj më sheh mua.

Arbeni: Ik! Më ler rehat!…Pse nuk ikën?

Qirilli: Sepse jam zëri yt. Dhe nuk mund të ikësh nga vetja.

Arbeni (me zë të dridhur): Atëherë… Pse më urren?

Qirilli: Unë nuk të urrej. Ti e urren botën që nuk të kupton më.

Arbeni hesht. Flet vetëm frymëmarrja e tij.

Doktorët ia caktuan dignozën atij. Ishte e rëndë dhe e pashërueshme. Doktorëve iu erdh keq.

"Ai ishte kolegu tyre. Edhe ishte më i miri, por pati fat shumë të keq,"- thoshin ata përditë mes tyre. Ata shkruajtën

recetën përfundimtare si dhe emrin e sëmundjes që ai kishte:
"Schizoaffective Disorder / Çrregullimi shizoafektiv"
Mbrojtja dhe Arrestimi i Arbenit
Kallëzimi në Policinë Gjyqësore
Përsëri Elira, e mbështetur nga avokati, shkoi në Policinë Gjyqësore të Rajonit për të bërë kallëzimin e dytë kundër Arbenit. Ajo kishte mbledhur prova tjera të panumërta: Mesazhe kërcënuese, regjistrime të telefonatave, dëshmi të fqinjëve dhe dëshmi nga stafi i qendrës së strehimit. Elira thoshte gjithmonë: "Kam frikë…Edhe se ai është i rrezikshëm dhe ka pushtet. Nuk mund të qëndroj më në qytet pa mbrojtje."
Oficeri i Policisë: Çdo gjë do të regjistrohet. Pas kallëzimit tuaj të dytë do të nisin menjëherë procedurat përfundimtare për arrestim.
- Ju do të keni mbrojtje të plotë deri në largim. Keni një fat që s'jeni e martuar ligjërisht më të.- shtoi avokati duke qeshur.
- Pooo, - tha kjo. - Më shpëtoi Zoti. Kisha parandjenja të këqija për Zotin, prandaj s'e bëra. E parandjeva, prandaj jemi drejt fundit. Tashmë unë kam bërë të gjitha dokumentat gati. Mos keni frikë më zonjë."
Avokati hodhi një vështrim të shkurtër në sytë e saj, por ende nuk ishte i sigurt se ai nuk do ta gjente dhe nuk do të vepronte kundër saj, prandaj bëri përsëri kallëzim të dytë në rajonin policor pranë qendrës, sepse donte të ishte

i sigurt për mbrojtjen e Elirës.

"Do të sigurohemi që asnjë hap i yni të mos shkelë ligjin. Dhe mendoj që s'kemi pse presim më - shtoi ai. - Le të ndalohet ai njeri, (ndërsa komçoi xhaketën e tij ngjyrë blu dhe përsëriti). Kjo është koha për të vepruar menjëherë."

Mbështetja e policisë dhe masat mbrojtëse.

Policia e rajonit mori masa të menjëhershme dhe të detajuara për të garantuar mbrojtjen e Elirës. Një patrullë e fshehtë ishte e gatshme për të shoqëruar çdo hap të saj, duke ecur pas saj si një hijë e padukshme. Çdo itinerar, do kalonte përmes një plani të qartë, të sigurt dhe të kontrolluar.

Shtegu i largimit drejt destinacionit të sigurt ishte hartuar me kujdes maksimale: Rrugë alternative, kontroll i mundshëm i zonave të rrezikshme dhe koordinim i vazhdueshëm me qendrën e strehimit. Ai bashkëpunoi ngushtë me policinë për të garantuar mbrojtje diskrete, duke u siguruar që askush të mos e dallonte se ku ndodhej Elira.

Pastaj foli dhe Kapiteni i Rajonit, që i tha qetësisht, por me vendosmëri: Ju nuk do të jeni kurrë e vetme. Çdo kërcënim i mundshëm do të ndiqet menjëherë. Askush nuk mund t'ju afrohet. Ne jemi këtu për t'ju mbrojtur deri në fund.

Elira rrëshqiti duart në tavolinë dhe foli me një zë të përmbajtur, por të plotë me lehtësim: Faleminderit! Më duket e pabesueshme që mund të ndjehem e sigurt pas gjithë kësaj.

Pas kaq ditësh frike, kjo ndjesi ishte e çmuar dhe reale. Për herë të parë, ajo ndjeu se jeta e saj nuk varej më nga hije të

padukshme dhe kërcënime të fshehta.

Arrestimi i Arbenit

Ndërkohë, policia kishte përgatitur me kujdes dosjen penale për Arbenin. Edhe pse ai ishte shtruar në spital psikiatrik, askush nuk kishte iluzion se rasti do të mbyllej aty. Prokurori kishte vendosur që çështja të shkonte në gjykatë. Ligji duhej të vepronte, pavarësisht gjendjes së tij mendore. Arbeni ishte i paparashikueshëm. Një moment i qetë dhe pothuajse i penduar. Momentin tjetër i egër, i kërcënueshëm dhe i pamëshirshëm. Ky ndryshim i menjëhershëm e bënte rrezikshëm jo vetëm për Elirën, por edhe për veten dhe çdo person që e rrethonte.

Mjekët paralajmëruan se kjo ndarje e personalitetit mund të përfundonte në tragjedi, madje edhe me humbjen e jetës së dikujt.

Në një çast, ai fliste me zë të ulët, si i penduar. Më pas shpërthente në britma dhe mallkime: Do ta paguani! Jeni të mjerë! Do t'ju shfaros me hijet e mia të kuqe!

Fjalët e tij nuk ishin thjesht kërcënime. Ishin shenja të një mendjeje që po copëtohej. Komisari nuk mund të humbiste kohë. Ai firmosi vendimin për dërgimin e çështjes në gjykatë, i bindur se vetëm ligji mund ta ndalte Arbenin përpara se errësira e tij të merrte një tjetër jetë.

Konsultat mjekësore

Pas kërkesës për arrestim dhe dërgim në spitalin e burgjeve, u kërkua një konsultë e plotë psikologjike dhe psikiatrike. Mjekët duhej të vlerësonin gjendjen e tij mendore, të

përcaktonin nivelin e rrezikshmërisë dhe të sugjeronin masa për të parandaluar ndjekje ose dhunë të mëtejshme.
Konsultat përfshinin teste intensive, intervista të gjata, dhe vëzhgime të vazhdueshme të sjelljes së tij. Çdo aspekt i tij, nga dialogu me Qirllin imagjinar tek shpërthimet e papritura të zemërimit, ishte i dokumentuar dhe analizuar me kujdes. Qëllimi ishte i qartë: Mbrojtja e shëndetit të tij, por mbi të gjitha, mbrojtja e jetës së Elirës dhe e çdo qytetari tjetër që mund të ishte në kontakt me të. Një koordinim i ngushtë mes policisë, spitalit dhe gjykatës ishte vendosur për të siguruar që çmenduria e tij të mos kthehej në rrezik të drejtpërdrejt.
Të shohim nëse Arbeni duhet të shkojë në gjyq penal apo të trajtohet në spital psikiatrik. Këto vendime duhet t'i miratojë gjykata. Unë do të paraqes realitetin, kishte thënë prokurori.
Mjekët ligjorë erdhën menjëherë në komisariatin numër një. E panë në gjendje të mjeruar dhe duke bërtitur e duke ushtruar forcë. Ai kishte mbaruar përgjithmonë. Ata nuk vonuan dhe shkruajtën në raport ligjor. Diagnozën Paranojë, haluçinacione dhe sjellje obsesive.
Ai shfaqi episode të dhunshme gjatë intervistës me doktorët.
Konsulta përfshinte rekomandimin për shtrim të detyruar në spital, për të parandaluar çdo rrezik për të tjerët.
Psikiatri: Ai ka humbur kontaktin me realitetin. Një trajtim i detyruar psikiatrik është i nevojshëm për të parandaluar

rrezik për të tjerët dhe për të vetën. Ai s'do jetë kurrë më normal.

"Kaq ishte dhe historia e tij," - thanë doktorët me një keqardhje të madhe për ish kolegun e tyre të famshëm.

- Sigurimi në spital është mirë për të dhe për ty, - i tha avokati Elirës.

- Kjo do të sigurojë që ai të mos ketë më mundësi të ndjekë ose kërcënojë kurrë më. - përfundoi ai.

Vendimi për mbrojtje dhe trajtim

Vendimi përfundimtar:

"Elira do të mbrohet nga policia deri në largim drejt destinacionit të sigurt. Jashtë Shqipërie mendoi se në SHBA, - tha avokati, - Ambasada ta bëri vizën zonjë (iu drejtua asaj). Kështu që bëhu gati për të ikur…"

Arbeni do të dërgohet përfundimisht në spital psikiatrik, për trajtim të detyruar, duke e larguar nga qyteti dhe ju garantojmë edhe sigurinë publike.

Proçedura ligjore dhe mjekësore bashkëpunuan për të siguruar një zgjidhje të menjëhershme dhe të sigurt.

Kapiteni i Rajonit: Çdo gjë është nën kontroll. Ju do të keni mbrojtje deri në largim dhe ai nuk mund t'ju afrohet.

Elira: Është e pabesueshme… Ndiej një lehtësim që nuk e kam ndjerë kurrë më parë.

Avokati: Kjo është vetëm fillimi. Liria juaj është e mbrojtur dhe çdo hap tjetër do të jetë nën kujdes ligjor dhe mbrojtje të plotë.

Udhëtimi drejt Lirisë

Përgatitja për largimin

Elira u zgjua herët në mëngjes. Bagazhet ishin të pakta, por çdo send kishte një vend të veçantë: dokumentet, pasaporta dhe disa sende personale që i kujtonin shtëpinë e saj.

Një patrullë policie e fshehtë priste jashtë derës për të siguruar largimin e saj.

Elira (me vete): Është hera e parë që ndjej se nuk jam e vetme… çdo hap që hedh është i mbrojtur. Por frika nuk më lë…

Jam njeri i frikësuar deri në palcë. Me ka terrorizuar shumë keq ai njeri.

Avokati (duke e mbajtur për dore): Çdo gjë është nën kontroll. Patrulla do të shoqërojë çdo hap dhe do të sigurojë që asgjë nuk mund të shkojë keq.

Elira: Kam frikë se ai mund të shfaqet… çdo moment më duket që po më ndjek.

Avokati: Ai nuk mund të afrohet më. Policia dhe Ambasada janë të përgatitur. Ti ke mbrojtje të plotë. Të gjitha opsionet i kemi përgatitur. Rri pa merak zonjë.

Arritja në aeroport dhe tensioni

Aeroporti ishte i mbushur me zhurma të përziera: Hapa të shpejtë, njoftime metalike nga altoparlantët, valixhe që rrëshqisnin mbi dyshemenë e ftohtë. Për Elirën, çdo tingull dukej i zmadhuar, sikur rrihte drejtpërdrejt në mendjen e saj. Trupi i saj ishte aty, por mendja lëvizte mes frikës, kujtimeve dhe një shprese të brishtë për shpëtim. Çdo fytyrë që i afrohej i dukej e dyshimtë. Një burrë që ndaloi pranë sportelit, një grua që hodhi një vështrim të shkurtër,

një pasagjer që foli me zë të ulët në telefon. Të gjithë, për një çast, i ngjanin hijes së tij. Zemra i rrihte fort, pothuajse në dhimbje. Policia e fshehtë ishte e pranishme, por e padukshme për syrin e zakonshëm. Oficerë të shpërndarë në zona strategjike, sy vigjilentë, lëvizje të kontrolluara, komunikim i vazhdueshëm në radio. Asgjë nuk i lihej rastësisë.

Oficeri i Policisë (përmes radios, me zë të ulët dhe të prerë): Zona është e sigurt. Çdo hyrje dhe dalje është nën kontroll. Nuk ka kërcënim të menjëhershëm. Vazhdoni sipas planit.

Elira shtrëngoi fort dorezën e bagazhit. Ai bagazh nuk mbante vetëm rroba — Mbante jetën e saj të re, një fillim të pasigurt, por të domosdoshëm. Ajo u përpoq të përqendrohej te frymëmarrja: Një frymëmarrje e thellë… Edhe një tjetër. Çdo hap drejt portës së imbarkimit ishte një hap larg frikës, larg errësirës që e kishte mbërthyer për kaq kohë.

Elira (me vete, në mendime të copëzuara): Çdo hap më çon më larg… larg tij,… larg gjithë frikës. Por pse zemra më rreh kaq fort? Jam duke fituar lirinë time… Apo po iki nga diçka që më ka shënuar përgjithmonë?

Ajo ndaloi për një çast, sytë iu mbushën me lot. Mendimet u kthyen pas, tek fillimi.

"Unë nuk jam përgjegjëse për atë që i ndodhi… Tek Zoti jam e pastër. Unë e doja atë njeri. Rashë në dashuri me shikim të parë. Nuk kam asnjë pendesë për dashurinë time."

Zëri i saj u drodh, edhe pse fjalët i thoshte vetëm për veten:

"Ai ishte i sëmurë edhe më parë… Nuk ia bëra unë këtë. Nuk e shkatërrova unë. Unë e dua Arbenin e dikurshëm. Atë burrë të bukur, të zgjuar, të zotin. Por ky që ekziston tani… Ky është një njeri tjetër."
Lotët i rrodhën pa zhurmë.
"Duhet të shpëtoj jetën time. Prandaj po iki."
Avokati qëndronte pranë saj, i qetë, i përqendruar, me një ton sigurie që kishte peshë. Avokati: "Rrini e qetë. Edhe pak dhe gjithçka merr fund. Kur të hipim në avion, nuk ka më kthim pas. Çdo kapitull i vjetër mbyllet aty."
Ai e pa drejt në sy, me një seriozitet njerëzor.
"Liria jote fillon tani."
Elira hodhi edhe një vështrim të fundit rreth e rrotull. Asnjë hije. Asnjë kërcënim. Vetëm dritë artificiale, njerëz të panjohur dhe një derë që po hapej drejt së panjohurës.
Ajo mori frymë thellë dhe bëri hapin e fundit drejt portës së imbarkimit. Jo si një grua që po ikën, por si një grua që po shpëton veten.
Në avion dhe reflektimi
Avioni u ngrit në ajër. Elira shikonte nga dritarja, duke parë qytetin e largët që po zvogëlohej. Ndërsa retë i kalonin përpara, një ndjesi çlirimi filloi të mbizotëronte mbi frikën.
"Jam e lirë… Nuk ka më kërcënime… Nuk ka më dhunë… çdo gjë është e sigurt… Por kujtimet nuk largohen lehtë."
Ajo mendonte për Arbenin, ''për policinë që e kishte mbrojtur'' dhe për avokatin që nuk kishte lënë asnjë detaj pa planifikuar. Çdo episod i kaluar ishte një kujtesë e forcës së saj.

Elira: Faleminderit Zotit! Më duket e pabesueshme. Më duket sikur po rilind. Zoti më ndihmoftë!

Arritja në spital dhe shtrimi

Nuk ka çmenduri pa dhimbje. Dhe nuk ka dhimbje pa një histori të fshehtë. E vërteta e mendjes së njeriut është shumë më e thellë se çdo spital ku e fusim haluçinacionet nuk janë gënjeshtra; Janë të vërtetat që njeriu nuk duron dot.

Halucinacionet nuk janë gënjeshtra; Ato janë të vërtetat që njeriu nuk duron dot. Janë shfaqje të fshehta të shpirtit, copa realiteti që truri refuzon, sepse dhimbja e tyre është më e madhe se ajo që mund të përballojmë. Çdo vizion i çuditshëm, çdo zë apo hije që shfaqet para syve tanë është thjesht një pasqyrë e asaj që kemi frikë ta pranojmë.

Arbeni u soll në spitalin psikiatrik me policinë pas arrestimit. Dritat e kaltra të korridoreve dhe zhurma e hapave të infermierëve i dukeshin si një fushë beteje e panjohur.

Arbeni (duke folur me veten dhe Qirllin imagjinar): Ti e di… Ata nuk kuptojnë… çdo hap është nën kontrollin tim… Nuk mund të më ndalojnë!

Infermierja: Ai duket jashtëzakonisht i shqetësuar dhe shpesh shfaq agresivitet të papritur. Duhet të veprojmë ngadalë, të kujdesshëm dhe të monitorojmë çdo lëvizje të tij. Çdo hap i gabuar mund të provokojë një shpërthim, prandaj duhet të jemi pranë, por pa e ngacmuar. Siguria jonë dhe e tij varet nga qetësia dhe vëmendja jonë e vazhduesheme.

Ai u shtrua në një dhomë të izoluar për kontroll të plotë, ku çdo lëvizje ishte e regjistruar.

Halucinacionet dhe obsesionet

Arbeni kishte humbur lidhjen me realitetin. Çdo hap në dhomën e spitalit ishte një betejë me vetveten. Ai filloi të shihte hije që lëviznin pas mureve, fytyra të panjohura që qeshnin në mënyrë kërcënuese, apo që e ndiqnin me sy të fiksuar. Zërat imagjinarë nuk pushonin. Dhe Qirlli, shoku i tij fantazmagorik, ishte gjithmonë aty, duke i folur, duke e sfiduar, duke e ndëshkuar dhe njëkohësisht duke e mashtruar.

Arbeni (me zë të lartë, të çrregulluar): Ata po më tradhtojnë… Ajo është imja… Nuk mund të largohet… Nuk do ta lejoj!

Zëri i Qirllit ndërhynte, i ulët, i qetë, por i pamëshirshëm:

Qirlli (imagjinar): Është e pamundur…Gjithçka po shpërbëhet… Nuk ke më kontroll asgjë…

Fjalët e tij humbnin në zhurmën e dhomës, ndërsa sytë i dridheshin nga frika dhe dëshpërimi. Ai përpiqej të kapte diçka të prekshme në ajër, por nuk ishte asgjë tjetër veçse boshllëk dhe iluzione. Sa herë tentonte të dëmtonte veten, infermierët ndërhynin shpejt, me qetësi, por me vendosmëri, duke e kufizuar pa e traumatizuar më tej.

Ajri i dhomës ishte i ngarkuar me tension dhe ankth. Çdo zhurmë e largët e bëri të dridhej, çdo hap ose trokitje e bënte të besonte se dikush po afrohej për ta ndëshkuar. Infermierët e dinin se vetëm vëmendja e vazhdueshme dhe ndërhyrja e shpejtë mund ta mbronin dhe qetësonin në këtë moment kritik.

Infermierja (duke shtrirë medikamentet në dorë): Duhet të japim medikamentet. Ky episod është shumë i dhunshëm, por i përshkruar qartë nga diagnoza e tij. Stabilizimi është i domosdoshëm.

Diagnostikimi dhe recetat mjekësore

Mjekët kryen një konsultë psikiatrike të thellë. Analizuan historikun e pacientit, episodet e fundit, shenjat e halucinacioneve, obsesioneve dhe çdo anomalie mendore që mund të paraqitej si rrezik për të dhe të tjerët. Rezultatet e vlerësimit klinik: Çrregullim paranojak-obsesiv. Shprehej në frikën e vazhdueshme për rrezik dhe në sjellje të përsëritura kontrolli, duke e bërë çdo lëvizje të tij një ritual të pasigurisë.

Çrregullim delirant, lloji i ndjekjes: Pacienti besonte se ndiqej ose kërcënohej nga të tjerët, pavarësisht realitetit.

Këto dy çrregullime ndërthureshin në mënyrë komplekse, duke e bërë Arbenin jashtëzakonisht të ndjeshëm ndaj çdo stimulueseje të ambientit. Një zhurmë e vogël, një hap në korridor, ose një fjalë e papritur mund të shkaktonte shpërthime të dhunshme ose vetëdëmtim. Për këtë arsye, mjekët vendosën një plan trajtimi të personalizuar, që përfshinte: Medikacion antipsikotik dhe qetësues, për stabilizim të gjendjes emocionale dhe të perceptimit.

Terapinë bisedore të orientuar në realitet, për të forcuar lidhjen e tij me botën reale dhe për të reduktuar halucinacionet. Masa mbrojtëse në ambjentin spitalor, me monitorim të vazhdueshëm dhe praninë e infermierëve të trajnuar për situata emergjente.

Psikiatri (duke ngritur kokën pas shënimeve të recetës): Ai është në një gjendje të avancuar të psikozës. Recetat do të jenë antipsikotike dhe qetësuese, për të stabilizuar gjendjen dhe për të parandaluar çdo rrezik. Çdo episod i ri do të monitorohet në kohë reale dhe nuk do të lejojmë që të dëmtojë veten ose të tjerët.
Infermierët e shikonin me kujdes, të vetëdijshëm se çdo minutë ishte vendimtare. Arbeni ishte zhytur në botën e tij imagjinare ku çdo frymë e ajrit, çdo hije dhe çdo zë mund të kthehej në rrezik për jetën e tij dhe të të tjerëve. Infermierja e cila po monitoronte që në fillim Arbenin u pajtua me thëniet e doktorit psikiatër: "Do të monitorojmë çdo episod dhe do të regjistrojmë reagimet. Ai ka nevojë për shtrim të detyruar. Përgjithmonë." - përfundoi së foluri ajo……
Elira iku dhe divorci nuk u bë, sepse ata kurrë nuk ishin të martuar ligjërisht. Ishte thjesht një çështje fati, apo një rrjedhë ngjarjesh që nuk mund të parashikoje.
"Drejtësia nuk është hakmarrje. Është çlirimi i shpirtit,"- mendoi ajo me një frymëmarrje të rënduar nga zemërimi dhe humbja e dashurisë.
"Ligji nuk mund të mbrojë zemrën tënde nga dhimbja, por të jep mundësinë ta shpëtosh vetveten. Të jep një rrugë që nuk e ke menduar kurrë."

Ajo kuptoi se liria e brendshme dhe paqja e shpirtit nuk vinin nga ndëshkimi i të tjerëve, por nga aftësia për të pranuar dhe për të vepruar me mençuri. Ishte një mësim i dhimbshëm, por i domosdoshëm: Ndonjëherë ligji mund

të jetë mbrojtës, por zemra kërkon veprime të tjera për të gjetur qetësinë.

Arbenin e mori gjumi si rezultat i qetësuesëve të shumtë që i bënë. Ai tashmë ishte në botën imagjinare dhe te inkuzicionit të vet që erdhi si pasojë e goditjeve që i ishin bërë dikur në kokë dhe tru. Fëmijëria e veshtirë është bazë për çregullimet jetësore që vijnë pas kësaj. Ai s'pati kurrë jetë të mirë. Jeta e dënoi në kulmin e bukurisë jetësore të tij.

Renja e hijeve të kuqe

Rënia e Kryeqytetit të Kuq, Dr. Arben Kodra, sipas deklaratës së Kapitenit të Komisariatit, numër një Ditmar Gjergji, ishte arrestuar për dhunë ndaj gruas së tij, Elira Dosti, për nxitje dhune në rrugë dhe për financim të veprimeve që cënojnë rendin dhe për përdhosje të Kushtetutës. Ai është mbajtur disa ditë në komisariat, në dhomë të ngushtë dhe të ftohtë, me dritat që ndriçonin vetëm pjësërisht dhe që shtonin tensionin e situatës.

Pas vizitës së mjekëve ligjorë u shpall se gjendja e tij psikike nuk ishte e mirë dhe nuk plotësonte kriteret për përgjegjësi penale të plotë. Normalisht, ai tashmë ndodhet në Spitalin Psikiatrik Nr. 5 në Tiranë dhe po merr ndihmën mjekësore të nevojshme, nën mbikëqyrje të vazhdueshme.

Shprehja e keqardhjes për situatën ishte i dukshëm: Të gjithë në komisariat e kuptonin që një njeri me përmasa ndërkombëtare, i njohur dhe me ndikim, përjetonte një krizë të tillë. Njëkohësisht, po e ndiqnin penalisht atë. Edhe ata që kishin abuzuar me të dhe e kishin nxitur të kryente veprime antikushtetuese.

Kapiteni: Situata është serioze. Nuk është vetëm çështje ligjore, por edhe psikologjike. Ai nuk mund të lihet pa ndihmë dhe nuk mund të lejojmë askënd të abuzojë me të.
Komisari: Është një njeri me përmasa dhe ndikim. Ne duhet të jemi të kujdesshëm, por drejtësia nuk mund të bëhet selektive.
Gjendja emocionale e Arbenit ishte e tensionuar dhe e paqëndrueshme. Shikimi i tij luhatej midis zemërimit, frikës dhe konfuzionit. Ai i përgjigjej me heshtje ose me zë të ulët kur flitej për ligjin dhe pasojat. Dhoma ku qëndronte ishte e ftohtë, me një ndjesi izolimi, duke pasqyruar gjendjen e tij të brendshme, të mbushur me ankth dhe halucinacione të fshehta.
Infermierët dhe oficerët e mbikëqyrnin nga afër, të vetëdijshëm që çdo reagim i tij mund të ishte i paparashikueshëm. Për këtë arsye, çdo hap i Arbenit ishte i regjistruar, çdo fjalë e tij dëgjohej dhe çdo lëvizje monitorohej me kujdes. Dhoma e pritjes e spitalit ishte e qetë tashmë, por tensioni mbetej në ajër. Infermierët hynë ngadalë, duke u afruar me kujdes te Arbeni. Dritat e zbehta reflektonin mbi fytyrën e tij, duke nxjerrë në pah lodhjen, zemërimin dhe crregullimin e brendshëm.
Infermieri: Dr. Kodra, do të shkoni tani në katin e dytë. Jemi në Spitalin Psikiatrik Nr. 5. Do të jetë një vend i sigurt aty, ku mund të merrni ndihmën e nevojshme.
Arbeni (me zë të ulët, por të dridhur): Ai e kundërshtoi vendimin, por fjalët i dilnin me vështirësi. Duart i shtrënguan

cepin e këmishës së zezë, sikur të kërkonte mbështetje te vetja për të përballuar atë që po ndodhte. Sytë i dridheshin, fytyra e tensionuar tregonte frikë dhe zemërim të përzier, ndërsa mendja e tij përpiqej të kuptonte pasojat e vendimit. Një heshtje e rëndë mbuloi dhomën, ndërsa çdo fjalë e tij dukej si një përpjekje për të kapur një liri që i dukej gjithnjë e më larg. Nuk kam nevojë… Nuk kam nevojë… Ata nuk kuptojnë… Gjithçka është kundër meje…

Kapiteni dhe komisari e shikonin nga jashtë dhomës, të qetë, por me vëmendje të madhe. Ata e dinin që çdo lëvizje e Arbenit mund të ishte e paparashikueshme.

Kapiteni (në zë të ulët për komisarin): Shikoje… është i izoluar në mendimet e veta. Çdo reagim mund të jetë i dhunshëm, por nuk mund ta lëmë pa trajtim.

Komisari: Është e vërtetë… Psikika e tij është në kaos. Ne po bëjmë vetëm atë që duhet për të mbrojtur jetën e tij dhe të të tjerëve.

Arbeni u ngrit ngadalë, me trupin që dridhej dhe sy të shqyer nga ankthi. Infermierët e shoqëruan me kujdes, duke e mbajtur me dorë të sigurt. Ai shikonte gjithçka rreth vetes me paranojë, duke menduar se çdo person që afrohej ishte një kërcënim i fshehtë.

Dhoma e spitalit psikiatrik ishte e gjallë me ngjyra të zbehta, me drita të buta dhe një qetësi të imponuar, që për kontrast me kaosin në mendjen e Arbenit, dukej si një botë e huaj dhe e frikshme. Infermierët e shtruan në krevat, duke i kontrolluar shenjat vitale dhe duke e lidhur butësisht për siguri.

Psikiatri (duke e vëzhguar me kujdes): Dr. Kodra, Këtu do të merrni trajtimin e duhur. Haluçinacionet dhe obsesionet tuaja do të monitorohen dhe do të ketë mbikëqyrje 24-orëshe.
Arbeni (me zë të tronditur): Unë nuk… Nuk mund të jem këtu,… nuk do ta lejoj,… ata nuk e kuptojnë…
Infermierët shpjeguan se çdo ilaç do të jepte efekt gradual dhe se nuk kishte dhunë, por mbikëqyrje dhe trajtim. Ai u shtrua ngadalë, me zemrën që rrihte fort dhe mendimet që luhateshin mes paranojës dhe humbjes së kontrollit.
Kapiteni e shikoi nga dera, duke ndjerë një përzierje shqetësimi dhe qetësie: Është e tmerrshme të shikosh një njeri kaq i fuqishëm dhe i rrezikshëm të dorëzohet përballë çmendurisë së vet.
Dhoma u mbush me një qetësi të imponuar, por për Arbenin ishte vetëm fillimi i një beteje të re: Betejës me mendjen e tij, obsesionet dhe humbjen e kontrollit mbi realitetin.
Psikiatri: Dr. Kodra, po ju vendosim në një trajtim të kontrolluar. Ilaçet do të ndihmojnë të qetësoheni dhe të rikuperoni mendjen.
Arbeni (me zë të dridhur): Nuk dua… Nuk dua të më kontrollojnë… Nuk mund të më ndalojnë…
Infermierët u afruan me kujdes, duke shpjeguar çdo veprim: shtrimin në krevat, kontrollin e shenjave vitale, vendosjen e lidhëseve të sigurisë përkohësisht. Ai i përjetonte ato si prona të lirisë së tij, të cilat po i humbte një nga një.
Brenda mendjes së Arbenit, Qirilli, shoku i tij imagjinar dhe

fiktiv, filloi të fliste. Zëri i tij ishte i qetë, por mbushur me një seriozitet të pazakontë, sikur të njihte çdo mendim të fshehtë të Arbenit. Ai i fliste si një udhërrëfyes i brendshëm, duke e sfiduar dhe ngacmuar njëkohësisht, duke ngritur pyetje që Arbeni nuk guxonte t'i bënte vetes. Çdo fjalë e Qirillit godiste menjëherë emocione të harruara dhe frikë që qëndronin të fshehura në thellësinë e mendjes së tij. Ishte si një dialog me vetveten, por me një forcë të jashtëzakonshme, ku realiteti dhe imagjinata përziheshin në mënyrë të rrezikshme.

"Po të marrin gjithçka, Arben… Por nuk mund të marrin mendjen tënde… Ose jo?"

Ta kanë marrë siç duket situata.

Arbeni (i shtrirë, duke u dridhur): Joo ti nuk di asgjë. Je vetëm një hije në mendjen time. Ti kujton që ekziston, por jo, të kam lindur unë. Dhe mbaje mend. Jooo kurrë … ata nuk mund të më ndalojnë… Nuk,… ,Nuk e kuptojnë… Realitetin tim. - ngriti zërin Arbeni, ndërsa djersë dhe pështyma i ranë poshtë faqeve dhe gojës.

Ai filloi të ndjente halucinacione të vizualizimeve: Njerëz që shfaqeshin në dhomë, zëra të panjohur që e urdhëronin të ndalonte frymëmarrjen, dritat që i dukeshin sikur flinin mbi të. Psikiatri e shikonte nga afër, duke regjistruar çdo reagim për të përshtatur trajtimin.

Psikiatri: Çdo halucinacion është një sinjal për ne. Nuk është realiteti, por mendja e tij po kërkon të shfaqë frikën e fshehur.

- Po, - tha infermjerja,- është e vërtetë doktor.
Ndërsa po bënte përzgjedhjen e ilaçeve për doktorin. Ajo nuk foli më vetëm bëri përzgjedhjen e tyre.
- Dr. Kodra, do të merrni medikamentet gradualisht. Ato nuk janë armë, por një mënyrë për të shpëtuar mendjen tuaj.
Arbeni u përpoq të bënte rezistencë, por trupi i tij ishte i lodhur dhe mendja e tij filloi të dorëzohej me ngadalë. Një heshtje e rëndë mbushi dhomën, ndërsa ai shikonte qetësinë e personelit si diçka të huaj, të frikshme, por të domosdoshme.
Ai po fillonte të kuptonte se kjo nuk ishte një dorëzim; Ishte një hap i parë drejt mbijetesës së vetvetes, edhe pse çdo centimetër i mendjes së tij kundërshtonte realitetin. Dhoma e Spitalit Psikiatrik Nr. 5 ishte e qetë, por Arbeni nuk ndjente qetësi. Secili hap i infermierëve, secili tingull i dritares dhe secili reflektim i dritës mbi mure i dukeshin kërcënime të fshehta. Ai u ul në krevat, me trupin që dridhe, dhe filloi të vizualizonte Zërin e Qirllit, shokut imagjinar që e ndiqte kudo.
Qirlli (në mendjen e Arbenit): Duke u shtrirë këtu, duket sikur i dorëzohesh, sikur çdo gjë rreth teje ka humbur kuptimin dhe çdo mundësi për të vepruar është shuar. Por ndoshta kjo është vetëm një maskë, një iluzion për ata që duan të shohin të dobëtin në ty. Në thelb, mendja ime nuk pushtohet kurrë dhe çdo sekondë e heshtjes është një planifikim i fshehtë. Çdo frymëmarrje dhe lëvizje e vogël,

po mbledh informacion, po gatuan hakmarrjen. Dorëzimi dhe hakmarrja nuk janë dy gjëra të ndara. Ato janë dy fytyra të së njëjtës monedhë dhe unë po i vë bast të dyja njëkohësisht. Ndonjëherë, duket më e lehtë të shfaqesh i pafuqishëm, të jesh një hije që pret momentin e duhur për të goditur. Çdo shtrirje e trupit, çdo heshtje, është një strategji. Dhe strategjia ime është hakmarrja që do të vijë me forcën e padiskutueshme.

Këto ishin shënime të tij në një fletore që iu gjet …Gjëra të sakta, por të prodhuara nga një mendje e sëmurë. Ai uluriti, lëvizte këmbë dhe duar në shenjë proteste…

Pastaj tha Arbeni (duke e përplasur dorën në krevat, zëri i dridhur): Nuk…, nuk mund të dorëzohem… Jo tani, jo këtu. Dorëzimi do të thotë t'u jap të drejtë atyre, t'u jap kënaqësinë që më shohin të thyer. Ata shohin vetëm trupin tim të lodhur, plagët, heshtjen time të gjatë… Por nuk shohin atë që po zien brenda meje. Nuk e kuptojnë. Nuk mund ta kuptojnë. Fuqia ime nuk është në muskuj, as në britmë, as në dhunë të verbër. Ajo është në durimin tim, në mendjen që nuk fle kurrë, në kujtesën që mban shënim çdo padrejtësi, çdo fytyrë. Ata mendojnë se jam shuar, se jam shtrirë përfundimisht. Gabohen rëndë. Unë jam ende këtu. Jam ende duke u mbajtur. Dhe kjo është fuqia ime e vërtetë, të mos dorëzohem edhe kur gjithçka përreth më thotë se fundi ka ardhur.

Infermierët u afruan me kujdes, duke përgatitur medikamentet për të qetësuar haluçinacionet dhe

obsesionet. Ai e ndjente çdo dozë si një sulm ndaj lirisë së tij, por trupin nuk mund ta mronte dot nga ata.
Infermierja: Dr. Kodra, këto ilaçe nuk janë për të të ndaluar, por për të shpëtuar mendjen tënde. Secili hap është për sigurinë tënde dhe të të tjerëve.
Arbeni (me shikim paranojak, duke i ndjekur lëvizjet): Siguria ime… Ata nuk e kuptojnë,… nuk e kuptojnë… Se çfarë dua unë. Dua Elirën dhe kaq.
Pas disa orësh, avokati i Elirës arriti në spital, i shoqëruar nga një përfaqësues i ambasadës amerikane në Tiranë. Të gjithë e shikuan me respekt dhe ndonjëherë me frikë.
Avokati: Arben, ju kujtohet se jeni këtu për trajtim, jo për ndëshkim. Por duhet të kuptoni… Veprimet tuaja ndaj zonjës Dosti nuk mund të mbeten pa pasoja.
Ambasada: Zonja Dosti do të ketë mbrojtje të plotë nga ne. Asnjë hap nuk do të lihet pa monitorim. Edhe asnjë kërcënim nuk do të mbetet pa u ndjekur ligjërisht.
Arbeni i ndjente fjalët si të huaja. Në mendjen e tij, perceptimi i realitetit dhe i fuqisë së tij ishte i turbullt. Ai fliste me Qirllin.
Qirlli: Shiko… Ata nuk mund të të marrin mendjen plotësisht. Por mund të të ndalojnë veprimet…Janë të fuqishëm dhe kudo…
Ai rrëshqiti në krevat, duke i dhënë trupit pak qetësi, por mendja e tij ishte e mbushur me errësirë, obsesione dhe halucinacione. Infermierët regjistronin çdo reagim, duke monitoruar tensionin e gjakut, rrahjet e zemrës dhe lëvizjet e tij.

Psikiatri: Arben, çdo sulm, çdo shikim paranojak, çdo zhurmë që sheh këtu është një pasqyrë e mendjes tënde. Ne nuk mund ta ndryshojmë atë menjëherë, por mund të ndihmojmë që të mos shkatërrosh vetveten dhe të tjerët.

Kapiteni i rajonit (pa avokatin) e shikoi në sy Arbenin: Ky është momenti kur ligji dhe trajtimi i psikikës bashkohen. Nëse nuk do të ishte ndërhyrja jonë, situata mund të kishte qenë shumë më e rrezikshme për të gjithë.

Arbeni qëndroi i heshtur, me sy që shikonin brenda dhe jashtë dhomës, duke ndjerë një luftë të brendshme mes forcës së tij të vjetër dhe dobësisë së re që i impononte realiteti. Ai kuptoi se kjo ishte beteja e parë e madhe për të mbijetuar, jo kundër Elirës, por kundër vetes dhe mendjes së tij.

Pas disa ditësh në Spitalin Psikiatrik Nr. 5, Rutina filloi të vendoste një ritëm të qetë, por i tensionuar. Arbeni u zgjua çdo mëngjes nën shikimin e infermierëve, çdo lëvizje e tij ishte monitoruar dhe efekti i ilaçeve gradualisht filloi të qetësonte trupin dhe mendjen e tij.

Në dhomë hyri psikiatri (duke kontrolluar kartelën): Efekti i ilaçeve po fillon të shfaqet. Rrahjet e zemrës janë më të qeta, halucinacionet pakësohen. Tani mund të fillojmë të flasim për ato që ndodhen në të kaluarën tënde.

Arbeni (i ulur në krevat, i zbehur): Nuk e kuptoj… Ndihem… më qetë… Por gjithçka që kam bërë E bëra të mos me ikte Elira…

Infermierja iu afrua me hapa të lehtë dhe i zgjati një gotë

ujë. Arbeni e mori me duar të dridhura, sikur edhe pesha e vogël e xhamit të ishte tepër e rëndë për të. Gishtat iu rrëshqitën pak, uji u drodh brenda gotës, duke pasqyruar pa dashje trazimin e tij të brendshëm. Piu pak, ngadalë, por shija e ujit nuk i solli lehtësim. Ishte e ftohtë, e pafajshme, dhe pikërisht për këtë e padurueshme.

Çdo objekt rreth tij dukej i qetë, i palëvizshëm, pothuajse indiferent: Shtrati i rregulluar, muret e bardha, drita e zbehtë që binte nga dritarja. Ishte një qetësi e rreme, një qetësi që nuk arrinte të depërtonte në mendjen e tij. Brenda tij, mendimet vërtiteshin pa pushim, të ngulitura si gozhdë. Obsesionet ktheheshin vazhdimisht, duke i përsëritur të njëjtat skena, të njëjtat fjalë, të njëjtat gabime që nuk mund t'i zhbënte më. Pendimi i rëndonte në kraharor, jo si një shpërthim emocional, por si një peshë e vazhdueshme, e heshtur, që nuk i linte vend frymëmarrjes së lirë. Ai e dinte se koha po ecte përpara, se bota jashtë vazhdonte normalisht, por për të, gjithçka kishte mbetur e ngujuar në atë moment të brishtë, ku qetësia e jashtme përplasjet e pamëshirshme me kaosin e mendjes së tij.. Ai tashmë nuk kuptone realen me irealen.

Qirlli (në mendjen e tij, e zbutur nga ilaçet): Tani ke kohë të mendosh, Arben… Të reflektosh, jo të veprosh. Çdo gjë që ke bërë mund të analizohet, të kuptohet… dhe ndoshta të ndreqet.

Arbeni u ul më fort në krevat, duke përjetuar turpin dhe frikën e brendshme: Nuk dua të shkoj mbrapa, por… Nuk

mund të harroj asgjë. Çdo hap i imi…, çdo kërcënim…, çdo fjalë… , të gjitha janë këtu. Në kokën time janë mbledhur ……varg.

Psikiatri: Çdo reflektim është një hap drejt shërimit. Nuk është vonë të kuptosh gabimet, të pranosh përgjegjësinë dhe të fillosh të ndërrosh rrjedhën e jetës.

Arbeni (i ulur, i heshtur): Por si… si mund ta ndaloj këtë kaos në mendjen time? Si mund të kthehem… , te realiteti?

Psikiatri (duke buzëqeshur me qetësi, por me sy që shikojnë përtej sipërfaqes): Me durim, Arben… Nuk është çështje që të zgjohemi një ditë dhe të jemi të gjithë të shëruar, të gjithë të fuqishëm. Çdo ditë ka sfidat e veta, çdo hap i vogël është një fitore që shpesh nuk duket menjëherë. Shiko këtu, – ai tregoi lehtë me gishta drejt tavolinës ku ishin disa objekte të thjeshta – Çdo gjë që duket e zakonshme, çdo objekt i zakonshëm, ka kaluar kohë dhe kujdes për t'u rregulluar, për të qëndruar në vendin e vet. E njëjta gjë ndodh me ty. Nuk do të jesh i plotë nesër, por do të jesh më i fortë se dje. Është një rrugë e ngadaltë, ku nuk ka hapa gjigantë, por secili hap i vogël llogaritet. Nuk ka turp të ndihesh i dobët, nuk ka turp të ndihesh i rraskapitur, sepse të gjitha këto janë pjesë e forcës së të ardhmes. Le të mos harrojmë se fuqia nuk matet nga sa shpejt ecim, por nga guximi për të vazhduar edhe kur rruga duket e pashpresë. Dhe ti e ke këtë guxim, Arben… Edhe kur nuk e ndjen. Ai është aty, duke pritur të shpërthejë.

Dita kalonte ngadalë. Infermierët shikonin çdo gjest të tij

dhe qetësia e dhomës ndikonte në mendjen e tij, duke e bërë Arbenin të ndjente një ndjesi të re: Kontroll mbi mendimet e tij.

Ai nuk ishte i lirë ende, por filloi të kuptonte se fuqia më e madhe nuk ishte të posedonte dikë tjetër, por të zotëronte vetveten.

Një ditë, avokati i Elirës vizitoi spitalin për të diskutuar proçedurat ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e saj. Arbeni e ndjente praninë e tij si një përkujtues të fuqisë ligjore dhe pasojave.

Avokati: Dr. Kodra, ligji nuk ka urrejtje, ka drejtësi. Çdo veprim që keni bërë ka pasoja dhe tani është momenti të pranoni përgjegjësinë.

Arbeni (me zë të heshtur): Po… e kuptoj… Por… nuk është e lehtë të pranosh gjithçka që kam humbur.

Ai uli kokën dhe shikoj poshtë në tokë.

- Dakord jam avokat, - shtoi ai. – Do të paguaj deri në një. Vetëm të mos ikë Elira nga unë.

Në atë moment, Arbeni përjetoi një moment reflektimi të thellë. Mendimet e tij të errëta dhe obsesionet u përplasën me realitetin dhe ligjin, duke i treguar se rruga për shërim dhe kuptim të veprimeve të tij ishte e gjatë, por e mundshme. Arbeni rrinte i shtrirë në krevat, duke parë dritat e buta të dhomës që tundeshin si valët e një deti të qetë... Truri i tij ishte një labirint i errësirës dhe obsesionit. Mendimet e tij luhateshin midis të kaluarës, të tashmes dhe halucinacioneve që përbindeshin në çdo cep të dhomës.

Qirlli (imagjinar, i ulur në krah të tij, i qetë por i kërcënueshëm): Arben… Shikoje mirë çdo hap që bën këtu. Ata e quajnë shërim, por unë e di sa e hollë është vija mes shërimit dhe zhdukjes. Çdo hap është një peshore që lëkundet: Nga njëra anë humbja, nga tjetra shpëtimi. Dhe ti ecën pa e ditur se ku po e vendos këmbën. Ti mendon se po përparon, por ndoshta po harron. Dhe harresa është një lloj humbjeje më e thellë se dhimbja. Ata duan qetësinë tënde, jo të vërtetën tënde. Duan një Arben të rregulluar, të parashikueshëm, jo atë që mban brenda zjarrin.

Por mos u gabo: Shpëtimi nuk vjen gjithmonë si dritë. Ndonjëherë vjen si errësirë që të mëson të shohësh ndryshe. Unë nuk të them se cili hap është i duhuri, sepse edhe unë jam pjesë e dyshimit tënd. Jam frika jote dhe forca jote njëkohësisht.

Zgjidh vetë, Arben… Sepse askush tjetër nuk mund ta bëjë këtë për ty. Çdo hap që bën këtu, sado i vogël të duket, është një akt i pakthyeshëm. Një lëvizje e heshtur që ose të shuan ngadalë, pa zhurmë, pa britma, duke të bërë të harrosh kush ke qenë dhe pse ke luftuar… Ose të rilind, duke të dhënë një formë të re dhimbjeje, por edhe një arsye të re për të vazhduar.

Mos kërko shenja të qarta, sepse këtu nuk ka. Rruga nuk ndizet përpara teje. Ajo hapet vetëm pasi e ke shkelur. Edhe unë, që jam zëri yt më i errët, nuk e di cili hap është i vërtetë. Jam vetëm pasqyra e dyshimit tënd, hija që të shoqëron kur mendon se je vetëm.

Në këtë vend, e vërteta nuk shfaqet si një dritë e pastër që ndriçon gjithçka dhe i jep fund dyshimit. Ajo vjen si një plagë e hapur, e dhimbshme, që nuk kërkon të shërohet menjëherë, por të pranohet. Është një dhimbje që nuk mund ta shmangësh, sepse pikërisht ajo të tregon se ende ndjen, se ende je i gjallë. Shumëkush e ngatërron të vërtetën me qetësinë, por këtu, e vërteta është trazim, është përballje me atë që ke fshehur prej vetes.

Zgjedhja jote nuk do të peshohet nga ajo që do të ndodhë më pas, nga fitimi apo humbja, nga shërimi apo rrënimi. Ajo do të matet vetëm nga guximi për ta bërë, nga forca për të mos qëndruar i ngrirë në frikë. Edhe një hap i gabuar është një akt jete, sepse pasiviteti është vdekja më e butë dhe më e padukshme. Duke zgjedhur, Arben, ti pranon rrezikun, dhimbjen dhe pasigurinë. Pranon që mund të gabosh, por edhe që mund të rilindësh. Dhe pikërisht në këtë akt të brishtë, por të ndershëm, qëndron mbijetesa jote e vërtetë: Jo në përsosmëri, jo në përgjigje të sakta, por në guximin për të thënë "po" jetës, edhe kur ajo të vjen e thyer.

Arbeni (duke i dridhur duart, duke u përpjekur të kontrollojë frymëmarrjen): Çdo gjë… … çdo zë…Të gjithë më ndjekin… Nuk mund të shpëtoj… Ata janë kudo…

Infermierët e shikonin me kujdes, duke regjistruar çdo shenjë të stresit, çdo rrahje të fortë zemre, çdo fjalë të përsëritur në vetvete. Ai filloi të bënte lëvizje të rastësishme, sikur po përpiqej të fshihte diçka, ndërsa syri i tij ndiqte çdo objekt që duket i qetë, por për të ishte shenjë e kërcënimit.

Psikiatri (duke shikuar kartelën): Shikoni… çmimi i kontrollit të humbur është i madh. Ne duhet të jemi të durueshëm dhe të kujdesshëm. Çdo halucinacion është një sinjal që duhet trajtuar me takt.

Arbeni ndjente një terrorizëm të brendshëm: Nuk ishte vetëm frika nga personeli apo ambienti, por edhe nga mendimet dhe obsesionet e tij. Ai fliste me Qirllin, i cili tani po bëhej më i ngulitur dhe i fuqishëm në mendjen e tij.

Qirlli: Shiko… Ata po përpiqen të të ndalojnë… Por nuk mund të të ndalin mendimet. Mendja jote është e lirë,… Edhe në këtë burg të qetësisë.

Ai filloi të vizualizonte hije që lëvizin, figura që fluturonin mbi tavolinën e dhomës dhe zëra që e këshillonin ose e urdhëronin. Infermierët shpjeguan me kujdes.

Infermierja tha: Çdo vizion është i përkohshëm, Dr. Kodra. Mendja juaj po përpiqet të kuptojë, po lufton brenda vetes. Ne jemi këtu për t'ju ndihmuar, jo për t'ju dëmtuar.

Por Arbeni nuk mund të ndalonte aq lehtë. Ai ndihej i rrethuar, i përndjekur dhe i kontrolluar nga secili objekt dhe zë. Ai ndjente një humbje totale të fuqisë, por gjithashtu një humbje të vetëdijshme të brishtësisë tij.

Pastaj foli Psikiatri (duke folur ngadalë, qetësisht): Çdo ditë këtu është një hap drejt qetësisë. Nuk është fundi i botës, por fillimi i një procesi ku do të mësoni të kontrolloni mendimet, të kuptoni obsesionet dhe të rifitoni fuqinë mbi veten tuaj.

Arbeni rrinte i heshtur. Zërat në kokën e tij u ulën pak nga

pak, por hije dhe fantazma të së kaluarës mbetën, duke e bërë çdo moment të spitalit një betejë të brendshme. Ai kuptoi se ky burg i qetë ishte vetëm një arenë e re, ku nuk kishte të tjerë për të kontrolluar, përveç vetes dhe mendjes së tij. Pas disa javësh trajtimi të kontrolluar, stafi i spitalit vendosi t'i japë Arbenit një përmirësim të vogël. Një lehtësim për të lëvizur brenda një zone të caktuar të kompleksit. Ai u ngazëllye menjëherë, por nuk e kuptonte që kjo liri ishte e kufizuar dhe monitorimi i tij ishte i vazhdueshëm. Ai kujtoi që fitoi lirinë.

Arbeni (duke dalë me vrull nga dhoma, me zë të lartë, i çarë nga ankthi) bërtitit: Elira! Ku je ti?!

Zëri i tij përplaset në korridor, kthehet si jehonë dhe i duket i huaj, sikur nuk i përket më.

"Mos u fshih… Të lutem dil ….. Pastaj tha: Mos më lër vetëm në këtë vend të çmendurish!"……

Ai ndalet për një çast, merr frymë me vështirësi, sytë i enden nëpër hapësirën e zbrazët. E di. "Nuk mund të më shpëtojë askush!" - britma i shpërthen nga kraharori, e ashpër, e dëshpëruar. "As mjekët, as fjalët e tyre, as premtimet! Nuk pinë ujë."

Ai e kuptoi që nuk e shpëtonin më. Hapat i bëhen të pasigurt, por vendosmëria i ndizet në fytyrë.

"Unë do të të gjej, Elira!" - thërret përsëri me gjithë zërin e tij. Këtë herë jo vetëm si kërkim, por si betim. "Edhe nëse duhet të përballem me çdo errësirë brenda meje, edhe nëse rruga më shkatërron… Do të të gjej!"

Zëri i tij mbetet pezull në ajër, mes frikës dhe sfidës, si dëshmi se, edhe në çastin më të thyer, Arbeni ende po lëviz, ende po kërkon — Dhe ky kërkim është forma e fundit e shpresës së tij. Ai vazhdonte të fliste me Elirën duke iu drejtuar qiellit, sikur ajo të kishte ikur në parajsë.
Infermierët u përpoqën të ndërhynin, por ai nuk i dëgjonte. Zëri i tij jepej plot paranojë dhe urrejtje, sikur i gjithë spitali ishte një terren ku ajo mund të fshihej.
Infermierja: Dr. Kodra, qetësohuni! Ajo nuk është këtu. Ju jeni në një vend të sigurt, nuk mund të dilni jashtë kësaj zone! U dëgjua zëri i rojeve civile.
Por Arbeni nuk mund të ndalte. Sytë e tij shikonin gjithçka, çdo dritë, dhe zhurmë, si shenjë që mund të shihte Elirën. Ai e kërkonte në çdo drejtim, duke bërtitur emrin e saj, duke përjetuar frikën, zemërimin dhe obsesionin. Të gjitha në një….
Qirlli (imagjinar): Arben… Ata të mashtruan… - Zëri vjen i ulët, i ngadalshëm, si një e vërtetë që nuk do të dëgjohet. Nuk e di ku është. Askush, nuk ta tha të vërtetën, sepse e vërteta ishte shumë e rëndë për t'u mbajtur.
Mos e kërko aty ku ishte dikur, sepse ajo botë nuk ekziston më. Nuk mund të presësh që gjithçka të jetë si përpara, sikur asgjë të mos ketë ndryshuar, sikur plagët të mbyllen vetë dhe koha të kthehet pas. Ajo që humbe nuk kthehet në të njëjtën formë dhe ndoshta as ti nuk je më i njëjti njeri që ishe.
Të mashtruan jo vetëm për vendin ku ndodhet ajo, por

edhe për idenë se shpresa është një kthim. Shpresa nuk është rikthim, Arben. Është përballje. Është të pranosh se ajo që kërkon mund, të mos jetë më aty dhe megjithatë të vazhdosh të ecësh, sepse pritja për një botë të pandryshuar është një tjetër kurth. Nëse vazhdon ta ndjekësh atë iluzion, do të humbasësh edhe atë pak forcë që të ka mbetur. Tani nuk je këtu për të rikthyer të shkuarën. Je këtu për të vendosur nëse ke guximin të jetosh me të vërtetën që ka mbetur.

Arbeni (duke u dridhur, e duke shtrirë duart përpara): Jo… nuk mund ta pranoj… Ajo është këtu… Duhet të jetë… Nuk mund të më shpëtojë…

Infermierët dhe psikiatri e shikuan me kujdes, duke mbajtur një distancë të sigurt, ndërsa emocionet e tij shpërthejnë. Ai nuk e dinte që Elira tashmë ishte në SHBA, e mbrojtur plotësisht nga avokati dhe ambasada, larg çdo rreziku. Pastaj ndërhyn me qetësi dhe hap të ngadaltë. Psikiatri (duke folur qetësisht): Arben, të lutem… Duhet të pranosh realitetin. Ajo nuk është këtu. Çdo hap që bën tani është vetëm për shëndetin tënd dhe për të mos dëmtuar askënd. Por Arbeni nuk mund të ndalte. Ai bënte hapa të shpejtë. Kapi çdo objekt, sikur të ishte një shenjë dhe zëri i tij u bë edhe më i lartë, duke thirrur Elirën me dëshpërim dhe urrejtje të përzier. Infermierët regjistruan çdo veprim dhe çdo fjalë, duke monitoruar tensionin dhe rrahjet e zemrës, dhe duke përgatitur një ndërhyrje të shpejtë nëse situata do të dilte jashtë kontrollit. Ai nuk e dinte që bota e jashtme

tashmë e kishte mbrojtur Elirën. Edhe çdo përpjekje për të arritur tek ajo ishte e dënuar të dështonte.

Arbeni (i ulur për pak në stol, me frymë të rënduar): Po… Nuk mund të kuptoj se ku është. Pse ka ikur ??…Ajo s'e di që nuk mund të jetoj pa të… Nuk mund të jetoj…

Qirlli (i qetë, por i prerë): Arben… Kjo është rruga jote e re. Nuk ka më fuqi jashtëtokësore që të japin kënaqësi. Nuk ka më Elira. S'ke për ta gjetur më. Vetëm ti mund të zgjidhësh çfarë mbetet prej vetes. Ti s'je më si dikur. Tani s'je asgjë.

Ai rrinte i heshtur, duke ndjerë shtypjen e realitetit, por gjithashtu filloi të kuptojë se tensioni, frustrimi dhe urrejtja e tij do të duhej të kanalizoheshin për të përballuar shërimin. Ditët kalonin ngadalë në spital. Arbeni filloi të kuptonte se çdo hap i tij ishte i kufizuar, i monitoruar dhe i mbështetur nga rutina e mjekëve. Ai nuk mund të kërkonte më Elirën me zë të lartë, sepse ishte larg, në SHBA, por mendimi për të nuk e linte të qetë. Një pasdite, pas administrimit të ilaçeve, ai rrinte në dhomë, duke parë dritën që hynte nga dritarja. Qirlli, shoku imagjinar, u ul pranë tij, i heshtur këtë herë.

Qirlli (duke folur ngadalë, i qetë, me një qetësi që shqetëson): Arben… Ndoshta ka ardhur koha të shohësh përtej frikës, jo për ta zhdukur atë, por për ta njohur. Frika jote nuk është armiku yt; Është dëshmia se ke dashur diçka me gjithë qenien tënde. Por kur frika fillon të drejtojë çdo hap. Ajo shndërrohet në burg. Ti ke kërkuar të kontrollosh gjithçka: Njerëzit, kohën, kujtimet, fatin. Ke besuar se po të mbaje fort gjithçka në duar, asgjë nuk do të humbiste.

Por jeta nuk funksionon kështu. Sa më fort të shtrëngosh, aq më shumë rrëshqet. Dhe ajo që rrëshqet më dhimbshëm është ajo që doje dikur. Ajo ide e një bote të drejtë, e një fundi të lumtur. Nuk ekziston më. Të gjithë janë ujqër dhe të pabesë. Doktor Arbeni, mësoje më në fund. Nuk mund të kontrollosh gjithçka. Dhe as nuk mund të kesh gjithçka që doje dikur, sepse ajo 'dikur' nuk ekziston më. Ajo ishte një version i jetës që nuk e dinte ende çmimin e humbjes. Tani je këtu, me duar më të zbrazëta, por me sy që mund të shohin më qartë. Të shohësh përtej frikës nuk do të thotë të dorëzohesh. Do të thotë të pranosh kufijtë e tu, pa u thyer prej tyre, sepse vetëm atëherë, kur pushon së luftuari me atë që nuk mund të ndryshosh, fillon të kuptosh çfarë mund të shpëtosh ende.

Arbeni (duke ulur kokën, me zë të dobët): Po… e di… çdo gjë që kam bërë më ka sjellë këtu…Edhe gjithçka që dua… Nuk është më e imja…

Psikiatri hyri në dhomë përsëri për kontrollin rutinë, dhe vëzhgoi ndryshimin në qëndrimin e tij.

Psikiatri: Po shoh përmirësim, Dr. Kodra. Mendja juaj po fillon të pranojë realitetin. Reflektimi dhe pranimi i humbjes janë hapat e parë drejt qetësisë.

Arbeni (me sy të zbehtë, duke marrë frymë thellë): Ndonjëherë ndihem i lirë… Por frika, zemërimi… Nuk më lënë të qetë.

Psikiatri: Është normale. Çdo ndjenjë është pjesë e procesit. Duhet të pranosh se fuqia më e madhe nuk është të

kontrollosh dikë tjetër, por të zotërosh vetveten.
Arbeni rrinte i heshtur për disa minuta, duke përjetuar përplasjen midis fuqisë së tij të mëparshme dhe dobësisë së tashme. Ai kuptoi se çdo obsesion, çdo haluçionacion dhe çdo sulm i brendshëm ishte një pasqyrë e dobësisë së tij dhe se rruga e shërimit nuk ishte e lehtë.
Qirlli (imagjinar, i qetë, me një ton që nuk gjykon): Ti nuk ke humbur gjithçka, Arben. Humbja të duket totale sepse dhimbja flet më fort se arsyeja, por ende ka diçka që nuk të është marrë: Zgjedhja. Ajo është e vetmja gjë që nuk mund ta humbësh, përveçse nëse e dorëzon vetë. Ke mundësi të ndryshosh rrjedhën e jetës tënde. Jo duke fshirë atë që ka ndodhur, sepse e kaluara nuk fshihet, por duke e pranuar pa e kthyer në helm. Ajo që ke bërë, ajo që nuk ke bërë, gabimet dhe heshtjet e tua. Të gjitha janë pjesë brenda teje, por nuk kanë pse të jenë udhërrëfyesi yt i vetëm.
Të pranosh të kaluarën, do të thotë të mos e përdorësh më si justifikim për të lënduar veten apo të tjerët. Do të thotë të ndalosh ciklin e shkatërrimit që ke trashëguar. Edhe, ndoshta pa e kuptuar, e ke vazhduar të njëtën gjë. Ky nuk është një akt heroik, Arben. Është një akt i heshtur, i përditshëm dhe pikërisht për këtë është i vështirë.
Dhe po, mund të ndërtosh një të ardhme që nuk do të shkatërrojë askënd. Jo një të ardhme perfekte, por një që nuk ushqehet me dhimbjen e të tjerëve. Një të ardhme ku nuk ke nevojë të fitosh mbi askënd për të ekzistuar. Kjo është mundësia jote e fundit dhe më e vërtetë: Jo të shpëtosh botën, por të mos e shkatërrosh më.

Ai e shikoi dritën që hynte nga dritarja dhe për herë të parë ndjeu një ndjesi të çuditshme qetësie dhe reflektimi. Nuk ishte një triumf i madh, por një hap i vogël drejt ndërgjegjësimit dhe pranimit.

Arbeni (me zë të ulët, pothuajse për vete): Ndoshta… fuqia nuk është të zotërosh dikë tjetër,… por të zotërosh vetveten…

Infermierët dhe psikiatri e shikuan me kujdes, duke regjistruar çdo shenjë të reflektimit të tij. Ai rrinte aty, midis humbjes dhe ndërgjegjësimit, duke kuptuar se vetëkontrolli dhe qetësia e brendshme ishin armët e vërteta.

Dita përfundoi dhe Arbeni qëndroi i heshtur, duke menduar për rrugën e gjatë që kishte përpara, duke kuptuar se shpresa dhe reflektimi ishin hapat e parë drejt shpëtimit të vetes. Arbeni rrinte i ulur në krevat te dhoma e spitalit. Gjithçka e qetë përreth tij, por mendja e tij ishte një det i trazuar emocionesh. Papritur, realiteti goditi si një stuhi e papritur: Elira nuk ishte më aty. Ajo ishte larg, në SHBA, e mbrojtur dhe e sigurt. Ai u ngrit, shtriu duart në fytyrë dhe një ndjesi e thellë humbjeje pushtoi çdo qelizë të trupit të tij. Sytë iu mbushën me lot, dhe zëri i tij u bë i dridhur:

Arbeni (me vete, me zë të ulët dhe të thyer): Nuk… nuk e kam… Nuk e kam më… Elira… oh, Elira…

Qirlli (imagjinar, i heshtur në fillim, pastaj i butë): Arben… ky është realiteti. Nuk mund ta kesh më. Tani duhet të përballesh me vetveten.

Ai përjetoi çdo kujtim të së kaluarës me Elirën: Buzëqeshjet

e saj, bisedat e natës, frikërat që ndanin dhe ëndrrat e përbashkëta që nuk do të ndodhnin më. Dhimbja ishte e papërshkrueshme, një përzierje midis pendimit, humbjes dhe vetëdijësimit të gabimeve të tij.

Psikiatri (duke hyrë ngadalë, me zë të qetë): Arben,… lotët nuk janë dobësi. Ata janë pjesë e procesit. Ti po kupton, po ndjen dhe po pranon realitetin. Ky është hapi i parë drejt shërimit.

Arbeni rrinte aty, duke qarë dhe duke u dridhur, ndërsa infermierët e shikonin me kujdes, duke lënë që ai të përjetonte çdo emocion pa ndërhyrë. Ai e ndjente për herë të parë thellësinë e humbjes, por gjithashtu filloi të kuptojë se ky ishte momenti i reflektimit të vërtetë mbi veprimet e tij dhe pasojat që ato kishin sjellë.

Arbeni (duke pëshpëritur për vete, me zë të tronditur, pothuajse i shuar): Çdo gjë,… çdo gjë që kam bërë… Më ka çuar këtu… - Fjalët i dalin me vështirësi, sikur secila të peshojë më shumë se tjetra. - Çdo zgjedhje, edhe ato që i quajta të drejta,… edhe ato që i justifikova si të domosdoshme… Të gjitha më sollën në këtë pikë.

Ai mbyll sytë për një çast, sikur të përpiqet të kthehet pas në kohë.

"Mendova se po ndërtoja diçka…, se po mbroja dikë… Se po luftoja për një kuptim. Por tani shoh vetëm pasojat. Shoh rrugën e mbushur me gjurmë që nuk mund t'i fshij më."

Një heshtje e rëndë i mbush kraharorin.

"Dhe tani… Nuk kam më atë që doja…"

Fjalia mbetet pezull, e papërfunduar, sikur edhe vetë ai të ketë frikë ta shqiptojë. Pastaj vjen e vërteta, e zhveshur nga çdo iluzion: "Nuk e kam më Elirën…"
Emri i saj i rrëshqet nga buzët si një plagë e re.
"Gjithçka që bëra, e bëra duke menduar se në fund ajo do të ishte aty. Se humbjet do të kishin kuptim."
Fryma i thyhet.
"Por pa të… çdo fitore duket bosh. Dhe çdo hap përpara… një dënim."
Ai mbetet i heshtur, jo sepse nuk ka më fjalë, por sepse më në fund po e pranon atë që e ka shmangur më shumë: jo vetëm humbjen e Elirës, por faktin se asgjë nuk e kthen më njeriun që ishte para se ta humbiste.
Qirlli qëndroi pranë tij, i heshtur, duke e lënë të kuptojë: fuqia nuk është të posedosh dikë tjetër, por të zotërosh vetveten dhe të përballosh humbjet.
Arbeni rrinte aty, duke qarë, duke përjetuar dhimbjen dhe pendimin, por gjithashtu duke filluar të kuptojë një të vërtetë të thellë: Vetëm pranimi i realitetit dhe reflektimi mbi gabimet e tij mund t'i japin shans për të shpëtuar mendjen dhe jetën e tij.
Ai kërkonte Elirën me zë të lartë.
Arbeni: Elira! Ku je?! Nuk mund të më shpëtojë askush. Vetëm ti më shpëto! Unë do të të gjej!…..
Infermierja: Dr. Kodra, qetësohuni! Ajo nuk është këtu. Ju jeni në një vend të sigurt!
Ai nuk foli Haluçinacionet dhe obsesionet e tij ishin të

fuqishme. Qirlli, shoku imagjinar, e ndiqte çdo moment
Qirlli: Shiko… Ata po përpiqen të të ndalojnë… Por nuk mund të ndalin mendimet. Mendja jote është e lirë… Edhe në këtë burg të qetë.
Ai nuk e dinte që Elira tashmë ishte larg, mijëra kilometra larg, në SHBA, e mbrojtur nga avokati i saj dhe përfaqësuesit e ambasadës. Çdo informacion që mund të kishte arritur tek ai ishte filtruar, kontrolluar dhe çdo hap i tij ishte tashmë i parashikuar nga një rrjet i padukshëm që ai nuk e kuptonte. Çdo përpjekje për ta gjetur atë, për ta kontaktuar, për ta arritur në një çast të vetëm, ishte e dënuar të dështonte. Ai mund të lëvizte, mund të planifikonte, mund të dridhej dhe të bërtiste, Por çdo strategji e tij ishte thjesht një lëvizje në një lojë ku rregullat nuk i njihte. Ndërsa ai mendonte se po afrohej te ajo, bota tjetër, e fshehtë dhe e qetë, e kishte tashmë mbrojtur nga çdo hap të mundshëm të tij. Ai nuk e dinte, nuk mund ta dinte dhe kjo padyshim e thellonte vetëm dhimbjen e tij: Çdo dëshirë, çdo shpresë, çdo përpjekje, ishte e pafuqishme përballë një realiteti të vendosur dhe të pamëshirshëm.
Në këtë izolim, Arbeni nuk luftonte vetëm kundër kohës dhe distancës, por edhe kundër pafuqisë së tij. Çdo veprim i tij, sado i vendosur dhe i dëshpëruar të dukej, ishte thjesht një reflektim i dëshirës për të rikthyer atë që kishte humbur… Por që tani nuk i përkiste më. Ditë për ditë kalonte mes ilaçeve, monitorimit dhe reflektimit.. Psikiatri dhe infermierët e ndihmonin të përballonte realitetin,

ndërsa Qirlli e udhëzonte drejt ndërgjegjësimit të tij.
Psikiatri: Çdo reflektim është një hap drejt qetësisë. Nuk është vonë të kuptosh gabimet, të pranosh përgjegjësinë dhe të fillosh të ndërrosh rrjedhën e jetës.
Qirlli: Ti nuk ke humbur gjithçka. Ke mundësi të ndryshosh rrjedhën e jetës tënde, të pranosh të kaluarën dhe të ndërtosh një të ardhme që nuk do të shkatërrojë askënd.
Ditët kaluan dhe Arbeni filloi të kuptojë humbjen e Elirës. Ai u ul në krevat, sytë i kishte të mbushur me lot:
Arbeni: Nuk,… nuk e kam…
Fjala i ngec në fyt, sikur trupi të mos e lejojë ta shqiptojë plotësisht. "Nuk e kam më…"
Ai merr frymë me vështirësi, sytë i mbushen me një boshllëk që nuk mbushet me lot. "Elira…" — Emri i saj del si një lutje e vonuar, si një thirrje që nuk ka më ku të shkojë. "Oh, Elira…"
Duart i bien anash, të pafuqishme.
"Gjithçka që isha,… gjith……çka që mendoja se do të bëhesha… Është e lidhur me ty."
Zëri i dridhet, por nuk ngrihet më; Është dorëzim, jo britmë.
"Tani çdo kujtim është një plagë e hapur. Çdo shpresë,… është një gënjeshtër që i thashë vetes për të mbijetuar."
Ai mbyll sytë, sikur errësira t'i duket më e drejtë se drita.
"Nuk të humba vetëm ty, - pëshpëriti ai - Humbi edhe njeriu që isha kur të desha."
Dhe në atë çast, dhimbja nuk kërkon më zgjidhje. Ajo vetëm ekziston, e rëndë, e heshtur, e pakthyeshme, si një e vërtetë

që nuk mund të mohohet më.
Dhimbja e tij ishte e papërshkrueshme, një përzierje midis pendimit, humbjes dhe ndërgjegjësimit të gabimeve të tij. Psikiatri dhe infermierët e lanë të përjetonte çdo emocion pa ndërhyrë, duke i dhënë hapësirë për reflektim të brendshëm.
Psikiatri (duke folur me qetësi dhe ngrohtësi, duke shikuar drejt Arbenit): Lotët nuk janë dobësi, Arben. Shumë njerëz mendojnë se të qash do të thotë të dorëzohesh, të jesh i pafuqishëm, por nuk është kështu. Lotët janë tregues i një force të fshehur, i dëshmisë se po përballesh me atë që të dhemb, jo duke e mohuar, por duke e ndjerë plotësisht. Ata janë pjesë e proçesit, pjesë e rrugës që të çon nga errësira e brendshme drejt një drite që nuk duket menjëherë, por është aty, duke pritur të shfaqet. Kur lejon që dhimbja të dalë jashtë. Ti po kupton, po ndjen dhe po pranon realitetin, edhe atë që është i dhimbshëm, edhe atë që është i pashmangshëm.
Ky është hapi i parë drejt shërimit, hapi i parë për t'u rikthyer tek vetja jote. Nuk është fundi, nuk është zgjidhja e të gjitha problemeve, por është momenti kur fillon të marrësh kontroll mbi brishtësinë tënde, kur fillon të kuptosh se mund të ekzistosh edhe me dhimbjen dhe mund të ecësh përpara pa u shkatërruar nga ajo. Pranoje këtë dhimbje, Arben… Dhe do të shohësh se pas saj mund të lindë një forcë që nuk e ke menduar se ekzistonte brenda teje.

Në dhomën e qetë, Arbeni përjetoi çdo kujtim të së kaluarës me Elirën, duke kuptuar se rruga e shërimit ishte e gjatë, por e mundshme. Për herë të parë, ai ndjeu një ndjesi qetësie dhe reflektimi, një hap të vogël drejt ndërgjegjësimit dhe fuqisë së vetvetes.

Arbeni (duke u ulur i heshtur, me sytë të drejtuar brenda vetes, zëri i ulët, por i vendosur): Ndoshta… fuqia nuk është të zotërosh dikë tjetër… — Fjalët e tij vijnë si një zbërthim i ngadalshëm i mendimeve të gjatë, të ngatërruara dhe të dhimbshme. Gjithmonë kam menduar se fuqia është të kontrollosh njerëz, të drejtosh fatet e tyre, të mbash gjithçka nën dritën tënde. Por çdo kontroll që kam provuar të mbaj… Më ka shkatërruar mua vetë, më ka mbytur më shumë se këdo tjetër.

Ai merr frymë thellë, sikur çdo fjalë të kërkojë hapësirë për të dalë jashtë. Po kuptoj tani… Fuqia nuk është të pushtosh, të detyrosh, apo të marrësh atë që nuk është e jotja. Fuqia është të zotërosh vetveten. Të njohësh frikën, dhimbjen, dëshirat e tua… Edhe të vendosësh se nuk do të lejoj që ato të të drejtojnë.

Është lufta më e vështirë, sepse nuk ka armik jashtë që mund ta fajësosh. Është përballja me vetveten, me gabimet, me dëshirat e humbura, me plagët që mendon se nuk do të shërohen kurrë. Dhe ndoshta… Ndoshta kur arrin këtë, kur arrin të zotërosh vetveten, atëherë kupton se çdo tjetër kontroll është thjesht një iluzion.

Ai hesht për një çast, duke ndjerë peshën e fjalëve të tij

dhe për herë të parë, një lloj qetësie e butë depërton mes trishtimit dhe tensionit të tij.

Ai rrinte aty, duke qarë, duke reflektuar mbi gabimet, pasojat dhe humbjen, ndërsa Qirlli dhe psikiatri funksiononin si udhëzues të brendshëm. Arbeni rrinte i shtrirë në dhomën e spitalit. Veshët e shurdhër dhe shikim i zbrazët. Ai rrinte duke parë dritën që hynte nga dritarja, por pa ndjenja shprese. Ai kishte humbur Elirën, çdo lidhje me botën e jashtme dhe çdo kontroll mbi jetën e tij. Përtej dyerve të spitalit, qyteti vazhdonte i qetë, por për të çdo tingull ishte kërcënim, çdo hije një kujtesë e gabimeve të tij. Qirlli, shoku imagjinar, ishte zhdukur në heshtje, duke lënë Arbenin vetëm me mendimet e tij të errëta.

Arbeni (me vete, me zë të dridhur dhe të ulët): Çdo gjë…, çdo gjë është e humbur…. Nuk ka më Elirë… Nuk ka më fuqi… Nuk ka më shpresë…

Psikiatri hyri në dhomë, me shpresën se do të gjente një shenjë reflektimi, por zëri dhe sytë e Arbenit ishin bosh. Ai nuk mund të përballonte dot dhimbjen, humbjen dhe pendimin e thellë që e kishte shkatërruar nga brenda.

Infermierët e shikuan në heshtje. Për herë të parë, ai nuk bërtiti, nuk kërkoi, nuk luftoi. Ai kishte humbur gjithçka që e lidhte me botën dhe vetveten. Çdo ilaç dhe përpjekje mjekësore dhe çdo përmirësim ishte thjesht një trazim i ri i mendjes së tij të shkatërruar.

Në këtë heshtje të pafund, Arbeni kuptoi një të vërtetë të hidhur: Ai nuk mund të shpëtonte vetveten. Humbja ishte

përjetësisht e thellë. Edhe mendja e tij tashmë ishte një burg i padukshëm, ku asnjë shpresë nuk mund të depërtonte. Ai u shtri, i heshtur, duke ndjerë vetëm boshllëkun dhe errësirën që kishte mbetur brenda. Nuk kishte më Elira, nuk kishte shpresë, nuk kishte të ardhme. Vetëm dhoma dhe zëri i tij i brendshëm i dëshpëruar ishin aty dhe një mendje që nuk mund të shpëtonte.

Doktor Arbeni kishte pësuar humbjen e dytë. Elira iku… Dhe ai u shtrua në spital psikiatrik. Sipas psikiatrit, ai nuk shërohej dot më; Përkundrazi, gjendja i rëndohej me kalimin e viteve.

"Më mirë i vdekur sesa t'i ikë truri," - thonë njerëzit.

Ai ishte mes gjumit dhe ëndrrave jo reale, mes tentativave të pafundme për t'u shëruar. E dyta, infermierja e dobët dhe e heshtur, hyri në dhomë, e përshëndeti dhe i tha:

- Si je sot, zoti doktor?

Arbeni nuk foli dhe as u ngrit nga krevati.

- Jam në botën e ëndrrave, - tha më në fund, duke marrë frymë thellë.

- Jam në botën e brengave… Dhe qaj për dashurinë e humbur…..- Dashuria vjen prapë, - i tha infermierja. - S'ke pse qan. Femrat janë si autobusët: Sa ikën njëra, vjen tjetra. Apo jo, doktor? Edhe ti je shumë i bukur, s'ke pse qan për një femër!

Arbeni mori frymë thellë, ndërsa ilaçi i shkrinte në gjuhë. Pastaj pëshpëriti me një zë që mezi dëgjohej:

Arbeni (duke parë drejt dritares, me zë të ulët dhe i

mbërthyer në heshtje): Zogjtë në kafaz nuk fluturojnë… - tha ai. - Dhe as këndojnë.

Ai heshti për një moment, duke ndjerë boshllëkun përreth. Fjalët nuk ishin thjesht për zogjtë, por për çdo gjë të jetës që mbahet e mbyllur, e ndaluar, e shtrënguar nën rregulla që nuk kuptohen. "Kur fluturojnë, zogjtë e ndajnë gëzimin, me qiellin, me diellin…, me erën. Por kur i mbyll brenda, çdo krah i tyre, çdo tingull i zërit të tyre, prishet. Ndalon të jetosh lirshëm, ndalon të ndjesh."

Ai e shikon kafazin me një dhimbje të fshehur. "Dhe kjo është më e tmerrshmja… Jo vetëm se ata nuk fluturojnë, por sepse harrojnë se kanë pasur krahë. Se kanë pasur këngë. Dhe më e keqja… Ndoshta harrojnë vetë çfarë do të thotë liri."

Fjala e tij mbetet pezull, si një paralajmërim, si një reflektim i fshehur mbi jetën e tij: Çdo kafaz nuk është vetëm hekuri që të mban brenda, por edhe frika që të pengon të ngrihesh. Dhe ndërsa zogjtë heshtin, edhe njeriu mund të harrojë tingullin e vetvetes.

Infermierja ngriti sytë drejt tij, por nuk foli. Në atë dhomë të zbehtë, fjalët e Arbenit tingëlluan si një e vërtetë e hidhur që mbante brenda gjithë jetën e tij të thyer. Mbaroi së foluri dhe i zgjati ilaçin e mëngjesit. Arbeni e pa me sy të hapur, pa shprehje. Nuk tha asnjë fjalë. Vetëm mori ilaçin dhe e piu pa zë. Në kafene dhe në zyrat e spitalit, të gjithë flisnin për të, por askush nuk guxonte t'i fliste.

- Ti do të shërohesh, doktor, - tha infermierja me një

buzëqeshje të lehtë. - Bota lëviz edhe pa Elirën. S'ke pse qan kaq shumë për të more zotëri. Sa të dalësh prej këtu, femrat do të vijnë direkt tek ti, sidomos ti që je si top model!
Arbeni qeshi lehtë, por qeshja iu shua shpejt.
- Zemra nuk i falet dy herë një dashurie, - tha ai, duke shikuar dritaren e mbyllur. - Dashuria e parë është si jeta në parajsë… Moj zonjë.
Infermierja uli sytë, e turpëruar nga fjalët e tij të thella. Në atë dhomë të heshtur, tingulli i zërit të Arbenit i ngjante rrëfimit të një njeriu që e kish humbur botën, por s'e kishte humbur shpirtin.
SEANCA E PARË E TERAPISË
Dhoma e terapisë ishte e bardhë, e thjeshtë, pa orë në mur, pa asnjë objekt që mund ta shpërqendronte mendjen. Vetëm një tavolinë e ulët, dy karrige dhe një dritare e gjatë që nuk hapej kurrë.
Psikiatri, doktor Mal Shkodra, u ul i pari dhe vendosi bllokun e shënimeve pranë vetes.
- Arben… - tha me një zë të qetë. - Kjo është seanca jonë e parë. Nuk je i detyruar të flasësh. Vetëm dëgjo nëse të vjen vështirë.
Arbeni e shikoi me sy të lodhur, të turbullt, si dikush që sapo del nga një stuhi e gjatë brenda mendjes së vet.
- Unë jam i lodhur nga dëgjimi, doktor, - u përgjigj ai ngadalë. - Kam dëgjuar shumë…, brenda vetes. Dua të më heshtin zërat.
Doktor Mali ngriti vetullat lehtë. Çfarë thonë zërat?

Arbeni uli kokën.
- Më thonë të kthehem mbrapa. Më thonë se ajo s'do vijë më. Më thonë se jam gabuar që kam jetuar. Në dhomë ra heshtje. Dritarja u mbush me dritë të zbehtë dimri.
- Zërat që përmend… - tha psikiatri ngadalë. - A kanë fytyrë? A e kujton cilin prej tyre njeh? Arbeni ngriti sytë. Sytë iu mbushën me lot të thatë.
- Po… një fytyrë. E Elirës. Herë më qorton. Herë më lutet. Herë më kërkon të iki pas saj. Doktor Mali shkroi diçka shpejt. - Dhe ti çfarë i përgjigjesh?
Arbeni (duke qeshur hidhur, zëri i dridhur, syte e mbushur me dhimbje): Si t'i përgjigjem dikujt që nuk është më këtu? Pyetja i del nga kraharori si një thirrje e humbur. Qeshi hidhur, jo nga gëzimi, por nga ajo dhimbje që të përpin brenda. "Zemra flet me hijen e saj, doktor… Me atë që mbetet kur personi që doje ka ikur, kur çdo shpresë e vjetër është bërë e pa arritshme."
Ai merr frymë thellë, sikur çdo fjalë të kërkojë hapësirë për të dalë, por nganjëherë bën vetëm zhurmën e dhimbjes që nuk ka emër. "E hijeve nuk u jep dot përgjigje… As nuk mund t'i bindësh, as t'i qetësosh. Mund t'i shikosh vetëm dhe të ndjesh se sa e thyer është bota kur dikush mungon."
Ai ul kokën dhe pëshpëriti përsëri: Ndonjëherë mendoj se kjo heshtje është më e zymtë se vetë mungesa, sepse mungesa të merr atë që ke pasur, por heshtja të tregon se gjithçka tjetër që doje… Ka humbur gjithashtu.
Qeshi përsëri ai hidhur. Si njeri që qesh nga dhimbja dhe

për herë të parë e kupton se disa pyetje nuk kanë përgjigje dhe disa hije nuk zhduken kurrë.
Psikiatri e mbylli bllokun. U ngrit.
- Kjo ishte mjaft për sot. Sot më tregove dhimbjen. Në seancën tjetër do të fillojmë të gjejmë rrugën jashtë saj. Arbeni nuk foli. Vetëm shikoi dritaren. - Zogjtë në kafaz nuk fluturojnë… - pëshpëriti. - Po ndoshta mund të mbijetojnë."
Doktor Mali u afrua te dera.
- Ndryshe nga zogjtë, Arben… Njerëzit mund të hapin vetë kafazin.
Ai doli. Dhoma mbeti e heshtur, ndërsa Arbeni ndjeu për herë të parë një fije të hollë drite brenda vetes.

ËNDËRRA QË ZBULON TË VËRTETËN

Atë natë, pas seancës së parë, Arbeni ra në gjumë të rëndë. Ilaçi i psikiatrisë i kishte zbutur shqisat, por jo shpirtin. Dhe në gjumë, shpirti iu hap si një derë e vjetër që kërcet.
Ai u gjend në një fushë të madhe të bardhë. Nuk kishte pemë, nuk kishte dritë, nuk kishte hije. Vetëm bardhësi… Sikur ishte brenda mendjes së vet, të zbrazët. Në mes të fushës, një kafaz i madh i hekurt. Brenda kafazit, një zog i zi, i heshtur, i ngrirë. Zogu e shikonte drejt e në sy, pa kënduar, pa lëvizur.
-Pse nuk fluturon? - pyeti Arbeni.
Zogu hapi sqepin dhe zëri që doli ishte zëri i Elirës.
- Sepse ti më mbylle këtu, Arben.
Ai u step. Zemra i rrahu fort.

- Jo… Ti ike vetë, Elira. Ti më braktise!
Kafazi u drodh lehtë. Zëri i Elirës u bë më i qartë:
- Jo. Ikja ime ishte pasojë… Jo arsye. Ti më largove me frikën tënde, me dyshimet e tua, me xhelozinë që nuk e pranoje. Ti më mbylle në kafazin tënd të dyshimit… Dhe unë u mbyta aty. Fusha e bardhë u errësua pak nga pak. Qielli u bë gri. Arbeni u afrua te kafazi, duart i dridheshin.
- A ke ardhur të më qortosh?
- Jo, - tha zëri. - Kam ardhur të të tregoj të vërtetën… Që të shpëtoj, sepse nuk je i çmendur, Arben. Ti je fajtor.
Arbeni ra në gjunjë. Lotët i rridhnin.
- A mund të të kthej? - pyeti ai, me zë të thyer, si një degë e thatë nën peshën e dimrit. - A mund të të hap kafazin dhe të të kem prapë?
Zogu i zi nuk lëvizi menjëherë. Pendët i dridheshin lehtë, si të mbartnin mbi vete gjithë peshën e fjalëve që nuk ishin thënë kurrë. Pastaj e uli kokën ngadalë, Jo si shenjë dorëzimi, por si një përkulje para së vërtetës.
- Më hap kafazin, Arben. Jo që të kthehem. Por që të largohesh ti.
Liria për mua s'do të thotë rikthim. Do të thotë që edhe ti të jetosh pa më vrarë çdo ditë brenda vetes. Fjalët ranë mes tyre si një dënim i butë, i pashmangshëm. Arbeni ndjeu diçka të çahej thellë në kraharor, jo zemra, por iluzioni se mund të mbante dikë të gjallë duke e mbyllur.
Ai ngriti duart dhe kapi shufrat e hekurta. Ishin të ftohta. Më të ftohta se korridoret e spitalit ku shpresa zbehej nën

dritat artificiale. Më të ftohta se netët e gjata të vetmisë, kur mendimet i ktheheshin si thika që s'lodhen kurrë. I shtrëngoi fort, sikur hekuri të ishte fajtor për gjithçka dhe me një forcë që nuk e dinte se e kishte, i shtyu për t'i hapur. Kafazi u hap.

Zogu i zi doli ngadalë, pa ngut, si dikush që nuk ikën, por çlirohet. Fluturoi lart dhe ndërsa krahët i prenë ajrin, qielli gri nisi të zbardhej, si një plagë që më në fund merr frymë. Para se të zhdukej, zëri i Elirës u përhap si jehonë, i qetë, i pamëshirshëm dhe i vërtetë:

- E vërteta të shëron…, vetëm nëse e pranon.

Arbeni u zgjua në shtrat, i mbuluar në djersë. Trupi i dridhej jo nga frika, por nga lodhja e pafundme e mendimeve që e kishin torturuar gjithë natën. Zemra i rrihte rëndë, sikur po mësonte për herë të parë një ritëm të ri. Për herë të parë pas shumë muajsh, nuk qau. Lotët nuk shpërthyen. Dhe kjo mungesë dhimbjeje e dukshme kishte një peshë të çuditshme, një qetësi të frikshme, të ngurtë, që nuk i solli lehtësim. Vetëm zbrazëti. Ai ktheu kokën nga dritarja. Agimi po hynte ngadalë, pa premtime, pa patos. Vetëm dritë.

- Unë jam kafazi… - pëshpëriti. - Unë duhet ta hap…

Fjalët ranë mbi mendjen e tij të trazuar si një dritë e ngadaltë, jo ngushëlluese, por e pamëshirshme në qartësinë e saj. Atë çast, ai e kuptoi diçka që kishte refuzuar ta pranonte: E vërteta nuk ishte humbja e Elirës. Nuk ishte distanca, as largësia e pakthyeshme që i kishte ndarë.

E vërteta ishte më thellë. Më e hidhur.
Ishte humbja e vetes dhe fakti se, për të mbajtur dikë, kishte mbyllur shpirtin e tij me shufra hekuri.
Gjithçka tjetër: dhimbja, humbja, frika. Kishte qenë vetëm pasqyrim i asaj që kishte lënë pas brenda vetes. Ai e kuptoi se sa i vogël, sa i kufizuar, sa i mbyllur kishte qenë, duke pritur që dikush tjetër të shpëtonte atë që mund të shpëtonte vetëm vetë.
Një çast heshtjeje mbush dhomën. Fryma e tij ngadalësohet dhe një ndërgjegjësim i butë fillon të depërtojë: Çdo hap, i vogël drejt lirisë nuk ishte për të gjetur dikë tjetër, por për të rimarrë atë pjesë të vetvetes që kishte humbur. Një fillim i heshtur, i thjeshtë,… por i vërtetë.
Elira arrin në SHBA. Pas një viti publikon një artikull të gjatë në gazetën 'Le Monde', ku rrëfen çfarë ka përjetuar.
Titulli:
"Hijet e kryeqytetit të kuq – Tirana…. dr. psikopati Uashington DC – Hapa të rinj në tokën e lirë" Kur aeroplani preku pistën e Aeroportit Ndërkombëtar "Dulles", duart e Elirës dridheshin ende. Nuk ishte dridhje frike, por ndjesi e çlirimit të papritur, e një ajri që nuk ngjan me asnjë tjetër derisa e merr frymë vetë. Qyteti i Uashingtonit shtrihej në horizont si një pikturë e qetë: Monumente të bardha, ndërtesa federale me kolonat e tyre të ftohta. Rrugë të gjera, gjelbërim kudo. Dhe një rend që të dukej pothuaj fiktiv krahasuar me zhurmën e rrëmujshme të Tiranës.
Kur zbriti, dy agjentë të Department of Homeland Security

e prisnin në hyrjen e portës. Njëri mbante dosjen me vulën "State Department – Humanitarian Entry".
Tjetri i buzëqeshi me qetësi:
- Uellcome to the United States, Miss Elira. You are safe nou.
Ajo nuk kishte dëgjuar prej vitesh një fjali që t'i dukej kaq e besueshme.
Vendi ku proçedura është qetësuese, jo kërcënuese
Teksa ecte në korridoret e aeroportit, Elira vërente të gjitha detajet që në Shqipëri do të ishin të pashmangshme: Asnjë zë i ngritur, asnjë sy që e gjurmonte, asnjë nervozizëm te policët e aeroportit. Vetëm profesionalizëm i qetë. Në pikën e kontrollit, një police amerikane me uniformë blu u gjunjëzua paksa për të qenë në nivelin e saj:
- If you feel tired or unell, just tell me. You're under our protection.
Elira firmosi tri dokumente, dha shpjegimet e protokollit, mori vulën e hyrjes humanitare dhe më pas u shoqërua në sallën VIP të pritjes, e cila ishte rezervuar posaçërisht për të.
Pritja nga Departamenti i Shtetit
Në dalje nga aeroporti e priste një makinë e zezë, tip SUV, me targa federale. Brenda, një grua rreth të dyzetave i zgjati dorën:
- Unë jam Catherine Miller, nga Departamenti i Shtetit. Nga sot, je nën programin tonë të mbrojtjes civile. Do të marrësh strehim, ndihmë juridike, psikologjike dhe status

të posaçëm derisa të jesh gati të flasësh publikisht. Makina mori rrugën drejt qendrës së Uashingtonit, duke kaluar pranë Pentagonit, Memorialit të Jeffersonit dhe ndërtesave të bardha që rrezatonin një solemnitet të qetë.

Elira shikonte nga dritarja dhe mendonte: "Ky qytet nuk ka hije. Ka dritë që bie drejt, pa u përkulur."

Shtëpia e re – Një botë e panjohur

Departamenti i Shtetit e vendosi në një shtëpi të siguruar, afër me një ndërtesë të qetë në Georgetoun, një lagje elegante me rrugë të shtruara me kalldrëm dhe shtëpi me tulla të kuqe.

Brenda e priste një tryezë me ushqime, çelësat e hyrjes, një celular i ri amerikan dhe një zarf ku shkruhej: "You are safe. Rest first. Uell talk tomorrou."

Ajo qeshi për herë të parë pas shumë kohësh. Qeshja i doli vetvetiu, e lehtë, e thjeshtë, pa peshë.

Intervista që tronditi Amerikën

Një javë më pas, kur ishte stabilizuar, erdhi telefonata: Zonja Elira, "NBC Njuz" kërkon një intervistë ekskluzive. Emisioni është "Global Frontline Tonight". E drejton gazetari i famshëm Michael Abrams. Jeni gati?

Elira mbylli sytë për një moment. Ishte koha të fliste.

Studioja e NBC në Uashington ishte e ftohtë, profesionale, mbushur me kamera, drita dhe një ekip që e trajtoi me respekt të plotë. Gazetari i dha dorën:

— You don't have to be afraid anymore. Just tell your truth.

Dhe ajo filloi…

Rruga e shpëtimit – dëshmia në televizion

Pjesa më e fortë e intervistës erdhi jo nga tonet e larta, por nga qetësia e rëndë me të cilën ajo nisi të rrëfente momentin vendimtar në Tiranë— Ditën kur e kuptoi se nuk kishte më ku të kthehej dhe se ndihma nuk ishte më një mundësi, por një domosdoshmëri jetike.

Ajo ndaloi për pak çaste, sikur po rimblidhte copëzat e asaj dite, pastaj foli: Më ndiqin kudo, pas pallatesh, përgjonin telefonin. Më kërcënonin. Jo drejtpërdrejt gjithmonë, por mjaftueshëm që ta kuptoja se jeta ime ishte nën vëzhgim. Isha e vetme. Pa mbrojtje. Pa zë.

Ajo tregoi se avokati i saj kishte tentuar të ndërhynte, të hapte dyer ligjore, të kërkonte garanci, por presioni ishte përhapur si një hije edhe mbi të. Edhe ai u vu nën presion. Filloi të tërhiqej, Jo nga frika për veten, por sepse e kuptoi se sistemi kishte vendosur të mos dëgjonte. Policia shqiptare… Ajo ndaloi sërish, duke zgjedhur fjalët. Nuk më mori seriozisht. Ose nuk mundej. Ose nuk donte. Në atë moment, dallimi nuk kishte më rëndësi.

Zëri i saj u bë më i ulët: Atë natë vendosa të shkoj në Ambasadën Amerikane. Ishte vendimi më i vështirë dhe më i qartë i jetës sime.

Ajo përshkroi hyrjen në ambasadë si një kalim nga errësira në një hapësirë ku koha dukej se ndaloi. Hyri me sytë e skuqur nga frika dhe pagjumësia, me trupin që ende dridhej nga ndjekja e padukshme që kishte përjetuar për javë të tëra.

Një marins më pa dhe nuk më bëri pyetje. Më tha vetëm një fjali: "You are safe nou. Sit doun."

Ajo tha se ajo fjali ishte si një çelës që i hapi frymëmarrjen. Ishte hera e parë pas shumë kohësh që trupi i saj e besoi mendjen: Se rreziku kishte pushuar, të paktën për atë çast.

Aty filloi shpëtimi im. Dokumentet u përpunuan brenda pak orësh. Askush nuk më premtoi mrekulli, por gjithçka funksionoi me një qartësi që nuk e kisha përjetuar kurrë më parë. Policia shqiptare nuk më gjeti më. Nuk më kërkoi. Nuk më ndoqi. Unë tashmë isha zhdukur nga rreziku. Ajo tregoi se u nxor nga ambasada me një makinë diplomatike, në heshtje të plotë, nën mbrojtje. Qyteti që dikur e kishte mbajtur peng, mbeti pas xhamit të errët, si një kujtim që nuk kishte më fuqi mbi të. Momenti i fundit para avionit ishte ai që e mbylli rrëfimin me një frikë emocionale:

Teksa po ulesha në ndenjëse, me duart ende të ftohta, një oficere amerikane më pa drejt në sy dhe më tha: "Shiko përpara, jo mbrapa."

Ajo heshti për pak sekonda dhe shtoi: Kjo fjali më ndihmoi të mbijetoj. Jo vetëm atë ditë. Edhe sot. Në studio ra heshtje. Një heshtje jo televizive, por njerëzore. Ajo lloj qetësie që vjen kur askush nuk ka guxim ta thyejë të vërtetën që sapo është thënë.

Michael Abrams u përkul pak përpara, zëri i tij i matur, pa sensacionalizëm: "Kjo është një nga dëshmitë më të forta, më tronditëse dhe më domethënëse që kemi dëgjuar ndonjëherë në këtë program. Një rrëfim që nuk flet vetëm

për një përvojë personale, por që pasqyron dhimbjen, heshtjen dhe të vërtetën e një realiteti më të gjerë. Një realitet që na detyron të reflektojmë thellë si shoqëri."
Dritat e studios vazhdonin të ndriçonin, por diçka kishte ndryshuar. Jo vetëm për të, por për të gjithë ata që po dëgjonin.
Hijet e kryeqytetit të kuq – Tirana Nga Elira …
Tirana nuk fle kurrë plotësisht. Edhe kur dritat shuhen dhe zhurma e ditës tretet në ajrin e rëndë të natës, hijet vazhdojnë të ecin. Janë hijet e një kryeqyteti që ka ndërruar ngjyra, emra dhe maska, por që ende mban mbi vete të kuqen e kujtesës—Një të kuqe që nuk është vetëm ideologji, por gjak, frikë, heshtje dhe bindje e imponuar. Në rrugët e saj të ngushta dhe sheshet e zgjeruara artificialisht, Tirana mbart kontraste të dhimbshme: Kulla që rriten mbi themele të harruara. Fasada moderne që mbulojnë plagë të vjetra, zëra të rinj që flasin lirisht mbi tokë ku dikur fjala ishte krim. Kryeqyteti i kuq nuk është më ai i parullave dhe pankartave, por hija e tij vazhdon të jetojë në mentalitete, në frikën e trashëguar, në indiferencën e mësuar.
Këto janë hijet që nuk shihen në hartat turistike. Hijet e nënave që pritën kot, të intelektualëve që u zhdukën pa varr, të fëmijëve që u rritën duke mësuar të heshtin, më shumë sesa të flasin. Tirana është një qytet që ecën përpara, por që ende kthen kokën pas, sikur të ketë frikë se e shkuara mund ta arrijë sërish.
"Hijet e kryeqytetit të kuq" nuk janë thjesht kujtime.

Ato janë pyetje të hapura: Sa e kemi çliruar veten nga e shkuara? Sa prej saj vazhdon të na drejtojë? Dhe a mund të ndërtohet e ardhmja mbi harresë, pa u përballur më parë me të vërtetën?

Elira Le Monde, botimi special, pas një viti qëndrimi në SHBA

U desh të largohem mijëra kilometra larg Tiranës, për të kuptuar se hijet që më ndiqnin nuk kishin qenë kurrë të mia. Ato ishin hijet e një qyteti të ndërtuar mbi frikë, kontroll, pritje boshe dhe heshtje të trashë – Një heshtje që të mbyllte fytin, por që askush nuk guxonte ta përmendte. Një vit në SHBA m'u duk si një jetë tjetër: Ajri më i lehtë, rrugët më të gjera, njerëzit që flisnin hapur, gazetarët që nuk ngurronin të pyesnin. Në fillim më dhembte ky kontrast. Më dukej sikur trupi im ishte ende i lidhur me telat e padukshëm të qytetit që lashë pas, por pastaj fillova të shkruaja, fillova të flas. Dhe fjalët u bënë dritë.

Ky është rrëfimi im. Jo thjesht historia ime, por historia e një kryeqyteti që di të buzëqeshë vetëm në fasadë, ndërsa në thellësi fsheh plagët e veta më të errëta.

Kryeqyteti që frymon me frikë

Në Tiranë gjithçka duket normale: kafet plot, zëra të qeshur, semaforë që nuk i respekton askush. por nën këtë lëkurë të lëmuar jeton një realitet i fshehur, i cili nuk shkruhet në asnjë raport zyrtar. Frika. Frika që të sheh, të ndjek, të rrotullohet pas shpine. Frika që të bën të kthesh kokën, të ulësh zërin, të përzgjedhësh fjalët. E trashëguar, e përcjellë brez pas brezi si mallkim që nuk shuhet. Në çdo qoshe të

këtij qyteti jetojnë dy Tiranë: ajo e ditës, që rreh me dritat e kafeneve dhe ajo e natës, që rri e fshehur pas dritareve të mbyllura, ku njerëzit flasin me nënkuptime dhe jetojnë me dy realitete: atë që thonë dhe atë që mendojnë.

Rrëfimin që nuk e thashë kurrë me zë

Nuk shkruaj për të larë hesape, por për të treguar atë që më ndodhi jo si viktimë, por si dëshmitare.

Në Tiranë njeriu mund të humbasë brenda një dite. Jo fizikisht, por psikologjikisht. Ti jeton, ecën, shkon në punë, përshëndet, por brenda teje dikush tjetër po tretet dhe askush nuk ta vëren se çfarë ndodh për sa kohë ruan fasadën.

Unë rashë në këtë grackë

Jo sepse nuk e pashë, por sepse besoja se nuk do të më prekte. Mendoja se arsimi, profesioni, përvoja dhe forca ime e brendshme do të më mbronin. Mendoja se të jesh e zonja, e përgatitur dhe e drejtë, mjafton për të qëndruar e lirë. Por kjo nuk mjafton.

Të kesh një profesion, të jesh e arsimuar, të dukesh e forte, këto janë vetëm mburoja të brishta kur përballë ke një sistem që nuk sulmon trupin, por mendjen. Një sistem që nuk të rrëzon me dhunë, por të lodh me presion, të ngulfat me frikë, të mpin me normalizimin e padrejtësisë. Ai nuk të kërkon të bindesh hapur, të mëson të heshtësh ngadalë. Kur sistemi rrethon mendjen tënde, ti ke dy zgjedhje: të heshtësh, ose të ikësh. Të heshtësh do të thotë të pranosh, të bëhesh bashkëfajtore e një realiteti që të gërryen çdo ditë.

Të ikësh do të thotë të humbasësh tokën nën këmbë, por të shpëtosh veten.

Unë ika. Ika jo sepse jam e dobët, por sepse refuzova të bëhesha pjesë e heshtjes. Ika për të mos u mësuar me padrejtësinë, për të mos e quajtur frikën 'normalitet', për të mos ia trashëguar dorëzimin tim atyre që vijnë pas. Ika sepse ndonjëherë largimi nuk është arratisje, por akt i fundit i dinjitetit.

Momenti i fundit para largimit

Mbaj mend aeroportin si dje. Jo zhurmën, jo thirrjet metalike të altoparlantëve, por ndjesinë e ngurtë që më kishte pushtuar trupin, sikur po ecja në një hapësirë pa gravitet. Çdo hap drejt portës si mbarkimit ishte një shkëputje e vogël nga ajo që kisha qenë, nga ajo që kisha menduar se do të isha.

Tirana dukej nga dritarja e avionit si një fëmijë që fle — E qetë, e pafajshme, e shtrirë nën një batanije dritash. Por unë e dija se nën atë qetësi fshihej një qytet që mund të të gëlltiste pa zhurmë, pa lënë gjurmë, pa pasur nevojë për dhunë të dukshme. Një qytet që dinte të heshtte më mirë se të bërtiste.

Ndjeva një therje në kraharor. Nuk ishte mall. As dhimbje e pastër. Ishte një lloj dënimi i butë, i heshtur, që vinte nga brenda: "Nuk e luftove mjaftueshëm."

Zëri ishte imi. Nuk më akuzonte me egërsi, por as nuk më falte. Ishte ai që që mbetet kur çdo justifikim ka rënë dhe njeriu mbetet vetëm me ndërgjegjen e vet. Për një

çast mendova të ktheja kokën, sikur shikimi pas do të më kthente forcën që kisha humbur. Por e dija se aty nuk kishte më asgjë për mua, përveç rrezikut dhe heshtjes së detyruar. Dhe atëherë kuptova diçka tjetër, edhe më të vështirë: Pjesa më e rëndë nuk ishte ikja. Ishte ajo që do të vinte pas. Rrëfimi. Të gjeja fjalët. Të mos lejoja që të tjerët ta tregonin historinë time në vendin tim. Të mos mbetesha vetëm një hije, një emër i humbur në një dosje, një version i shtrembëruar i së vërtetës. Duhej të gjeja zërin tim. Të rimerrja kontrollin mbi jetën time, mbi frikën time. Mbi atë që kisha përjetuar. Dhe këtë nuk munda ta bëja aty, në tokën që më kishte shtypur. Zërin tim e gjeta vetëm pasi pashë Tiranën nga larg.

Kur avioni u ngrit dhe qyteti nisi të zvogëlohej, kur ndërtesat u bënë pika dhe rrugët vija të zbehta, ndjeva për herë të parë peshën reale që më kishte mbajtur të përkulur për kaq kohë. Vetëm kur Tirana u zhduk mes reve, e kuptova sa shumë më kishte rënduar mbi shpinë —Edhe sa e domosdoshme ishte që ta lija pas, jo si arratisje, por si një akt mbijetese. Atë çast, nuk ndjeva fitore. As lehtësim të menjëhershëm. Vetëm një premtim të heshtur ndaj vetes: Që një ditë, kur zëri im të ishte mjaftueshëm i forte. Nuk do të kisha më nevojë të ikja për të qenë e lirë. Çfarë mësova në Amerikë.

Në SHBA kuptova se liria nuk është automatikisht guxim. Liria është terren i hapur; Guximi është të ecësh në të.

Atje askush nuk më pyeti pse zëri im dridhej, pse duart

më kapeshin, pse sytë më shkonin instinktivisht nga pas. Atje askush nuk më gjykoi kur thashë se kisha frikë, as kur thashë se kisha qenë nën presion, as kur tregova se më kishin ndjekur, vëzhguar, frikësuar.

Në vend të gjykimit, mora një gotë ujë dhe një shprehje të qetë:

"Je e sigurt tani. Tregoji të gjitha."

Kështu fillova të shkruaj. Pse po e rrëfej tani? Sepse ka mijëra të tjerë si unë.

Sepse Tirana e ka të vështirë të shohë veten në pasqyrë, sepse frika nuk shuhet nëse nuk nxirret në dritë. Unë e dua Tiranën. E dua siç do dikë që të ka lënduar, por që ende shpreson se mund të ndryshojë. Dhe pikërisht sepse e dua, po e them.

Kryeqyteti ynë nuk është thjesht një vend me ndërtesa të larta dhe ngjyra të ndezura. Është një organizëm që ka nevojë për shërim. Dhe shërimi fillon vetëm kur dikush ka guximin të flasë.

Ky artikull nuk është hakmarrje. Është fillimi i një procesi. Unë po flas.

Jo sepse është e lehtë, por sepse heshtja ka kushtuar shumë. Po flas për ato që u mbytën në frikë, për zërat që u thyen para se të dëgjoheshin, për të vërtetat që u shtynë pafund drejt harresës. Fjala ime nuk është hakmarrje, por kujtesë. Nuk është zhurmë, por dritë.

E ardhmja: dritë mbi hijet.

E ardhmja nuk ndërtohet duke mohuar errësirën, por duke e ndriçuar atë. Çdo fjalë e thënë është një dritare që hapet,

çdo e vërtetë e pranuar është një hap përpara. Hijet nuk zhduken menjëherë, por humbasin fuqinë kur nuk fshihen më.

Unë po flas sepse besoj se fjala ka ende peshë. Se e vërteta – Sado e vonuar – Çliron, dhe se një shoqëri nuk shërohet duke harruar, por duke guxuar të shohë veten në sy. E ardhmja fillon aty ku mbaron frika. Dhe aty, drita nuk është premtim – Është zgjedhje.

Nëse dikush e lexon dhe thotë: "Edhe unë kam përjetuar të njëjtën gjë." - atëherë misioni im ka filluar të japë frytet.

Nuk dua që brezat e ardhshëm të rriten mes dy Tiranave: të ditës dhe të natës. Dua një të vetme: Një qytet që nuk ka frikë nga e vërteta.

Në SHBA gjeta dritë. Tani dua ta dërgoj atë dritë mbrapsht, tek hijet e kryeqytetit të kuq.

Uashington DC – Hapa të rinj në tokën e lirë. Mbaje mend që kur aeroplani preku pistën e Aeroportit Ndërkombëtar "Dulles", duart e mia dridheshin ende. Nuk ishte dridhje frike, por ajo ndjesi e çlirimit të papritur që vjen kur trupi e kupton para mendjes se ka shpëtuar. Një dridhje e lehtë, pothuaj e padukshme, si pasojë e një peshe që më në fund ishte hequr nga shpatullat e mia. Ajri që mora frymë atë çast nuk ngjante me asnjë tjetër. Nuk ishte thjesht ajër, ishte hapësirë. Ishte ndjesia se fjala nuk do të më kthehej kundër, se mendimi nuk do të më dënonte, se heshtja nuk do të ishte më kusht mbijetese. Ishte ajri i një vendi ku njeriu nuk pyetet së pari kujt i përket, por kush është. Teksa rrotat

ndaluan dhe zhurma e motorëve u fashit, kuptova se kisha kaluar një vijë të padukshme. Pas meje mbetën hijet, frika e mësuar dhe kujdesi i tepërt në çdo fjali. Përpara meje ishte e panjohura. E vështirë, ndoshta e vetmuar, por e lirë.

Mbaje mend këtë moment: Liria nuk vjen gjithmonë me britma gëzimi. Ndonjëherë ajo vjen me duar që dridhen, me frymëmarrje të thellë dhe me një qetësi të brendshme që të thotë se, pavarësisht gjithçkaje, ke bërë zgjedhjen e duhur.

Pritja nga Departamenti i Shtetit

Në dalje nga aeroporti e priste një makinë e zezë, tip SUV, me targa federale. Brenda, një grua rreth të dyzetave i zgjati dorën:

- Unë jam Catherine Miller, nga Departamenti i Shtetit. Zëri i saj ishte i qetë, profesional, pa asnjë nevojë për imponim. Ishte ai lloj zëri që nuk premton emocione, por siguri. Nga sot, je nën programin tonë të mbrojtjes civile.

Ajo ndaloi për një çast, sikur t'i linte fjalët të binin në vendin e tyre. Çdo fjali nuk ishte thjesht informacion, por një garanci e matur.

- Do të marrësh strehim të sigurt, ndihmë juridike të specializuar dhe mbështetje psikologjike. Do të kesh një status të posaçëm mbrojtjeje derisa të jesh gati të flasësh publikisht. - Nëse do bëjë, kur ta zgjedhësh vetë këtë hap thuaj.

Nuk kishte kërcënim, as ngut. Vetëm një vijë e qartë midis asaj që kisha qenë deri atëherë dhe asaj që mund të bëhesha.

Ajo nuk po më kërkonte të flisja; Po më jepte kohë. Dhe ndoshta për herë të parë, koha nuk ishte armiku im. Në atë moment kuptova se mbrojtja nuk do të thotë të fshihesh përgjithmonë, por të përgatitesh për të dalë në dritë pa u thyer. Se e vërteta ka nevojë për siguri, jo për sakrifica të verbra. Dhe se fjala, kur mbështetet, mund të bëhet më e fortë se çdo frikë. Mbaj mend kur makina mori rrugën drejt qendrës së Uashingtonit, duke kaluar pranë Pentagonit. Memorialit të Jeffersonit dhe ndërtesave të bardha që rrezatonin një solemnitet të qetë. Unë shikoja nga dritarja dhe mendoja: Ky qytet nuk ka hije. Ka dritë që bie drejt, pa u përkulur."……

You're in a safe place nou. Focus on resting. Ue'll talk Uhen you're ready.

Shtëpia e re

Një botë e panjohur Departamenti i Shtetit e vendosi në një shtëpi të siguruar, në një ndërtesë të qetë në Georgetoun, Një lagje elegante me rrugë të shtruara me kalldrëm dhe shtëpi me tulla të kuqe që ruanin hijeshi të vjetër dhe dinjitet të heshtur. Ishte një qetësi ndryshe nga ajo që ajo njihte—Jo qetësi frike, por qetësi rregulli, ku askush nuk pyeste dhe gjithçka funksiononte pa zhurmë.

Shtëpia ishte e thjeshtë, por i menduar deri në detaj: Mobilje neutrale, dritare të mëdha që sillnin dritë natyrale, perde të rënda që mbylleshin plotësisht kur nata binte mbi qytet. Asgjë pa llogaritje, asgjë e tepërt. Një hapësirë tranziti mes së kaluarës dhe asaj që ende nuk kishte formë. Kur dera

u mbyll pas saj me një klik të butë, ajo ndjeu për herë të parë peshën e vetmisë. Jo vetminë që të zbraz, por atë që të detyron të përballesh me veten. Çdo dhomë ishte një faqe bosh. Çdo hap në dysheme kumbonte si pyetje: Kush jam tani, kur askush nuk më njeh?

Nga dritarja, Georgetoun shtrihej i qetë, pothuaj indiferent ndaj historive që silleshin nga larg. Kalimtarët e rrallë ecnin ngadalë. Qentë të lidhur me zinxhir, dritat e lokaleve ndiznin një ngrohtësi që nuk i përkiste ende. Jeta vazhdonte, pa dijeni për ikjen, frikën dhe guximin që kishin hyrë në atë shtëpi të vogël.

Kjo nuk ishte vetëm shtëpi. Ishte strehë. Një botë e panjohur ku ajo duhej të mësonte të jetonte pa u fshehur, të flinte pa u trembur, të mendonte pa u çensuruar. Dhe shpesh duke ndërruar shtëpi. Edhe ndoshta, për herë të parë pas shumë kohësh, të imagjinonte një të ardhme që nuk niste me frikë, por me mundësi. Brenda e priste një tryezë me ushqime, çelësat e hyrjes, një celular i ri amerikan dhe një zarf ku shkruhej: Atdheu ndodhet aty ku qetesia dhe dashuria bashkohen bashkë. Ajo qeshi për herë të parë pas shumë kohësh. Qeshja i doli vetvetiu, e lehtë, e thjeshtë, pa peshë.

Intervista që tronditi Amerikën

Një javë më pas, kur ishte stabilizuar, erdhi telefonata: "Zonja Elira, NBC Njuz kërkon një intervistë ekskluzive. Emisioni është "Global Frontline Tonight". E drejton gazetari i famshëm Michael Abrams. Jeni gati?"

Elira mbylli sytë për një moment. Jo për t'u fshehur,

por për të mbledhur copëzat e vetes që kishin mbetur të shpërndara mes frikës, kujtesës dhe lodhjes. Në atë çast të shkurtër heshtjeje, kaluan si hije gjithçka që kishte lënë pas: Zërat e mbytur, rrugët e njohura, zgjedhjet e pamundura dhe çmimin e secilës prej tyre. Kur i hapi sërish sytë, frymëmarrja iu qetësua. Nuk kishte më vend për dyshim. Frika nuk ishte zhdukur, por nuk sundonte më. Ajo ishte aty—Si kujtesë e rrezikut, jo si pengesë e së vërtetës.
Ishte koha të fliste.
Jo për të shpëtuar veten, sepse këtë e kishte bërë tashmë. Por për t'u dhënë zë atyre që nuk patën mundësi, për të thyer rrethin e heshtjes që ushqehej me frikë, për të kthyer të vërtetën nga barrë personale në përgjegjësi kolektive.
Në atë moment, fjala nuk ishte më vetëm fjalë. Ishte një akt. Një kufi i vendosur mes së shkuarës dhe së ardhmes. Dhe Elira e dinte: Sapo të fliste, hijet do të humbnin fuqinë e tyre.
Studioja e NBC në Uashington ishte e ftohtë, profesionale, mbushur me kamera, drita dhe një ekip që e trajtoi me respekt të plotë. Gazetari i dha dorën: You don't have to be afraid anymore. Just tell your truth.
Dhe ajo filloi…
Rruga e shpëtimit – Dëshmia në televizion
Pjesa më e fortë e intervistës ishte kur rrëfeu momentin në Tiranë, ditën kur kërkoi ndihmë:— Më ndiqnin. Më kërcënonin. Isha e vetme. Avokati im u përpoq të më ndihmonte, por ai vetë u gjend nën presion. Policia shqiptare

nuk më mori seriozisht – Ose s'mundej, ose s'donte. Atë natë vendosa të shkoj në Ambasadën Amerikane.
Ajo vazhdoi: Hyra brenda, me sytë e skuqur nga frika. Një marins më tha vetëm një fjali: "You are safe nou. Sit doun." Aty filloi shpëtimi im. Dokumentet u përpunuan brenda pak orësh. Policia shqiptare nuk më gjeti më. Më nxorën me një makinë diplomatike drejt aeroportit, nën mbrojtjen e tyre.
Pastaj tregoi momentin e fundit para avionit: Teksa ulesha në ndenjëse, një oficere amerikane më tha: "Shiko përpara, jo mbrapa." Kjo fjali më ndihmoi të mbijetoj. Dhe në fund të intervistës, studioja ra në heshtje.
Michael Abrams tha: Kjo është një nga dëshmitë më të forta që kemi dëgjuar ndonjëherë në këtë program.
Tërmeti diplomatik pas intervistës së Elirës
Intervista në NBC, e transmetuar në "Global Frontline Tonight", nuk ishte thjesht një rrëfim personal. Ajo u shndërrua në një trazim ndërkombëtar, një lëvizje zinxhirore që askush nuk e kishte parashikuar. Brenda pak orëve, emri i Elirës shkonte nga Uashingtoni në Bruksel, nga Nju Jorku në Tiranë.
12 milionë shikime brenda 24 orëve
Platforma streaming e NBC raportoi:
12.3 milionë shikime në 24 orët e para, 300 mijë komente,
#VoiceOf Elira
#Shadou sof Tirana
Për disa ishte tronditëse, për të tjerët frymëzuese, për disa

të tjerë e dhimbshme – Por askush nuk mbeti indiferent.
Kritikët amerikanë e quajtën "dëshmia më tronditëse nga Ballkani pas viteve '90". Reagimi i menjëhershëm i Departamentit të Shtetit. Dy orë pas transmetimit, në faqen zyrtare të Departamentit të Shtetit u publikua një deklaratë e shkurtër, e prerë dhe e ftohtë: "Shtetet e Bashkuara ndjekin me shqetësim çështjen e shtetases shqiptare, Elira D…, E cila ka kërkuar mbrojtje për shkak të presioneve serioze dhe kërcënimeve ndaj jetës së saj. Administrata amerikane po bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë për të garantuar sigurinë e saj dhe për të vlerësuar situatën në terren."
Deklarata u transmetua në CNN, BBC, Reuters, AFP. Brenda natës, çështja u shndërrua në dosje diplomatike.
Komisioni Evropian kërkon hetim urgjent
Brukseli reagoi vetëm pas disa orësh. Një vonesë e matur, tipike për mekanizmat evropianë, ku çdo fjalë peshohet dhe çdo fjali ndërtohet me kujdes, por që në këtë rast nuk kaloi pa u vënë re. Heshtja e parë u lexua si pritje për verifikim. Reagimi që pasoi, si sinjal se çështja kishte kaluar kufirin e një rasti individual.
Në konferencën e përditshme për shtyp të Komisionit Evropian, zëdhënësja doli përpara gazetarëve me një deklaratë të shkurtër, por të drejtpërdrejtë: "Kemi marrë informacion të detajuar mbi rastin e Elirës dhe po kërkojmë menjëherë shpjegime të plota, si dhe një hetim të pavarur nga autoritetet shqiptare. Siguria e qytetarëve

dhe respektimi i të drejtave themelore mbeten një prioritet thelbësor i Bashkimit Evropian."

Toni ishte i ftohtë, institucional, por mes rreshtave lexohej qartë një shqetësim i thellë. Fjala "hetim i pavarur" U theksua më shumë se një here, një formulim që, në gjuhën diplomatike të Brukselit, nënkupton mosbesim ndaj mekanizmave të brendshëm dhe kërkesë për transparencë reale. Gazetarët evropianë nuk e trajtuan rastin si një episod të izoluar. Në analizat dhe komentet që pasuan, ai u krahasua drejtpërdrejt me: Çështjet e përsëritura të mbrojtjes së gazetarëve dhe sinjalizuesve në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Raportet e vazhdueshme mbi korrupsionin institucional dhe ndërhyrjen politike në sistemet e drejtësisë në rajon, dosjet e hapura të monitorimit evropian për Shqipërinë, ku sundimi i ligjit dhe siguria e individit mbeten pika të brishta. Në disa media ndërkombëtare, rasti i Elirës u përmend si "test i besueshmërisë" për autoritetet shqiptare dhe si një provë konkrete se sa larg ishin premtimet nga realiteti në terren.

Burime diplomatike në Bruksel konfirmuan se, përtej deklaratave publike, po shqyrtohej edhe mundësia e ngritjes së një komisioni investigativ ndërkombëtar, një hap i rrallë, por jo i paprecedentë, që zakonisht merret në konsideratë kur ekzistojnë dyshime serioze për dështim sistemik dhe mungesë vullneti institucional për hetim të paanshëm. Mes korridoreve të Komisionit, Çështja nuk flitej më vetëm si

"rasti i Elirës". Ajo po shndërrohej në simbol: Një pasqyrë e tensionit mes aspiratës evropiane dhe realitetit politik në terren. Dhe ndërsa Brukseli kërkonte përgjigje, pyetja që mbetej pezull ishte e thjeshtë, por e rëndë: A do të ishte ky një moment i së vërtetës, apo vetëm një tjetër dosje që do të arkivohej me gjuhë të kujdesshme dhe veprime minimale?

UASHINGTON, QYTETI I DRITËS SË FTOHTË

Uashingtoni e priti Elirën me qetësinë e vet të hekurt, si një qytet që nuk mahnitet kurrë nga askush, por që e shpërblen këdo që i afrohet me NDERSHMËRI. Ajo zbriti nga makina federale në rrugën e qetë të Georgetoun-it, Ku shtëpitë me tulla të kuqe dukeshin si të dalë nga një film britanik. Shtëpia ishte e ngrohtë. S'kishte asnjë ankesë. Ishte e mobiluar me shije amerikane, minimaliste: Një divan i bardhë, një bibliotekë e hapur, një tavolinë. Xhami i madh i dhomës zinte pothuaj të gjithë murin dhe përtej tij, Potomaku rridhte i qetë, duke u shtrirë si një rrip argjendi nën dritën e mbrëmjes. Rrjedha e tij dukej sikur donte të fshinte kujtimet e saj, të lante heshtjen e viteve dhe të mbante premtimin e një fillimi të ri. Por për Elirën, heshtja e lumit nuk shlyente dot të kaluarën. Në tavolinë qëndronte një letër, e shkruar me dorë të qetë dhe të saktë: "Uelcome home, Miss Elira. You are under full protection."

Ajo e mori letrën, e rrudhi ngadalë midis duarve, duke ndjerë peshën e fjalëve. Nuk ishte mosbesim ndaj mbrojtjes, por një provë instinkti, një zakon që nuk shuhet aq shpejt. Siguria nuk ishte vetëm diçka që mund të shkruhej në letër;

Ajo duhej ndjerë, testuar, provuar.
Në mbrëmjen e parë në shtëpi, Elira nuk fjeti. Nuk kishte nevojë për zhurma të jashtme; Mendimet e saj, kujtimet dhe mundësia e ardhshme krijonin një zhurmë të brendshme që mbushte dhomën. Potomaku jashtë rridhte i qetë, por brenda saj, rrjedha e kohës ishte e ngadalshme, e mbushur me frikë, pritje dhe një premtim që duhej fituar me durim: Liria nuk vinte menjëherë, por ndjeshëm, natë pas nate. U rrotullua në shtrat dhe mendja i shkoi tek ai, doktor Arbeni. Ishte dashuruar me të pa kuptuar. Dashuri e qetë, e ndaluar, e brishtë. Ai i ishte dukur gjithmonë i fortë, i mençur, i pazëvendësueshëm. Deri ditën kur bota e tij u shemb. Deri ditën kur paranoja i mori gjithçka.
"Arben… pse?" pëshpëriti ajo, zëri i saj duke u shpërndarë në tavanin e huaj të shtëpisë së re. Fjalët mbetën pezull në ajër, të lehta dhe të brishta, si qenie që nuk dinin ku të uleshin. Çdo cep i dhomës duket se mbante eko të së kaluarës, por nuk kishte asnjë shenjë të tij, asnjë përgjigje që të mund të mbante dhimbjen në vend. Në vend të një zëri të njohur, ajo dëgjoi vetëm zhurmën e avionëve që kalonin mbi qytet. Tingulli i tyre ishte i largët, mekanik dhe indiferent, por për Elirën u duk si një lloj përgjigjeje e ftohtë nga bota, një botë që vazhdonte të ecte, pa marrë parasysh plagët që linin pas. U ul në skajin e dhomës, duart tërësisht bashkuar mbi gjunjë. Çdo frymëmarrje sillte kujtime, çdo hap i kaluar kishte mbetur si hije në çdo mur të shtepisë. Pyeti veten në heshtje: A kishte vërtet ndonjë përgjigje që

mund të zbuste boshllëkun brenda saj? Apo secila pyetje do të mbetej gjithmonë e pashuar, ndërsa qyteti jashtë, me zhurmën e avionëve dhe dritat që shpërndaheshin mbi lumë, vazhdonte të jetonte indiferent ndaj asaj që ajo ndiente?
Heshtja ishte e plotë. Por ndoshta, për herë të parë pas shumë kohësh, ajo kuptoi se disa pyetje nuk kërkojnë përgjigje. Disa janë thjesht dëshira për t'u dëgjuar, për t'u përballur me vetminë dhe për të pranuar se dhimbja mund të ekzistojë edhe në vendet më të sigurta.

Fillimi në televizion – zëri i një gruaje që nuk hesht
Pas dy javësh, Catherine Miller nga Departamenti i Shtetit e shoqëroi në një studio televizive, të vendosur pranë Massachusetts Avenue. Një zonë ku trafiku i dendur dhe sirenat e largëta të qytetit krijonin një ritëm të çuditshëm, pothuaj të hipnotizues. Ndërsa ecte përgjatë korridoreve me dritare të mëdha që hidheshin mbi trotuaret e ngushta. Elira ndjeu një përzierje të nervozizmit dhe kuriozitetit, duke u përpjekur të lexonte shenjat e studiove dhe kabllove që shtriheshin si rrjeta misterioze rreth saj.
Aty, një drejtore programi e priste. Ishte një grua me sy të mprehtë dhe flokë gri, që dukej sikur kishte parë dhe gjykuar më shumë se sa çdo regjistrim televiziv. Kishte shumë përvojë. E shikoi gjatë, me një qetësi të ngurtë, sikur po mat çdo grimcë të shprehjes së saj.
- Ti ke një histori të dhimbshme, - tha ajo.

Pastaj vazhdoi përsëri: Por më shumë se kaq: Ti ke një zë unik. Do të jesh pjesë e emisionit tonë të mëngjesit. Analizë politike, histori personale, çështje ndërkombëtare. E di që mund ta përballosh.

Dhe nuk foli më. Fjala "mund ta përballosh" peshonte mbi supet e Elirës si një sfidë e fshehur. Dhe një ndjenjë e lehtë e frikës përzihesh me eksitim. Ajo ngriti vetullat, duke ndjerë një valë të papritur të fuqisë dhe përgjegjësisë që po i binte mbi supe. Studioja e rrethonte me një qetësi të ftohtë, por në ajrin e saj të tensionuar ndjehej një energji që mund të shndërrohej në diçka të madhe. Diçka që mund të ndryshonte rrjedhën e historisë që ajo ishte gati të tregonte.

- Unë? Analizë politike?

- Po. Sepse ti nuk flet vetëm për veten. Ti flet për një vend të tërë.

Kështu nisi karriera e saj në televizion. Fillimisht me kronika të shkurtra, pastaj me intervista, më pas me debatet e mëdha. Brenda pak muajsh, emri i saj u bë i njohur në Uashington, Nju Jork, Boston. Gazetarët amerikanë e përshkruan si: Zëri që sjell Ballkanin në ekran me sinqeritet brutal", "Analistja që nuk përdor maska", "Fytyra e re e një bote të vjetër"

Në çdo intervistë, ajo fliste për Shqipërinë. Për plagët e saj, për ëndrrat, për vitin e zi 1997.

- Shqipëria ime ka qenë peng i kaosit dhe i bandave, por njerëzit e saj meritojnë më shumë, - thoshte shpesh. - 1997-ta nuk ka mbaruar ende për ne. Sa herë e thoshte këtë fjali,

zemra i dridhej pak, sepse e dinte se Arbeni kishte qenë një nga viktimat e asaj historie të errët. Edhe pse vite më vonë, frika kishte ende rrënjë.

Suksesi që e ndjek, survejimi që nuk pushon

Me suksesin erdhi edhe një rrezik i ri, më i hollë dhe më i padukshëm se çdo kërcënim fizik që kishte përjetuar më parë. Autoritetet amerikane nuk e lanë asnjëherë vetëm.

Prania e tyre ishte gjithmonë e ndjeshme, si një hije që rridhte pas çdo hapi të saj. Përreth shtëpisë, çdo detaj i vogël duhej mbikëqyrur: Ata vendosën kamera të fshehta të ngulitura në cepa të mureve dhe pemëve, duke regjistruar çdo lëvizje; Patrulla civile që kalonin në mënyrë të rregullt, si një rrahje e heshtur e zemrës së qytetit; Kontrolle të përsëritura që kishin për qëllim të testonin, çdo portë, çdo frikë të fshehur. Edhe një makinë që qëndronte gjithmonë e parkuar në rrugicën ngushtë përballë derës, një trup pa fytyrë që vështronte, pa folur, duke mbajtur një kujdes të vazhdueshëm ndaj çdo gjesti apo bisede.

Çdo hap i saj brenda shtëpisë, çdo hap i jashtëm, tingëllonte nën hijen e kësaj survejimi. Qëndronte në dhomën e saj, duke ndjerë presionin e padukshëm të syve të panjohur që nuk pushonin kurrë, duke kuptuar se liria e saj e re ishte e mbushur me kufizime të fshehta. Një sukses që shkëlqente në dritë të jashtme, por që kishte sjellë me vete një rrjet mbikëqyrjeje të ngushtë, të pandërprerë dhe të frikshëm. Catherine e shikoi gjatë, me atë qetësinë e dikujt që ka parë shumë situata të ndërlikuara, pastaj foli hapur: Nuk kemi

ende konkluzione për çështjen tënde. Duhet kujdes. Dikush nga Shqipëria të kërkon. Ende.

Fjala "ende" ra mbi Elirën si një plumb i ngadaltë, duke e shtyrë të ndjejë rëndësinë e rrezikut që e rrethonte, por buzëqeshja e saj ishte e hidhur, e mbushur me ironi dhe një nuancë të thellë rezistence.

- Jeta ime qenka kthyer në film spiunazhi, - tha ajo.

Zëri i saj i thyer vetëm pakë ndante nga një grimcë humori të zi. Catherine u afrua pak më pranë, duke i vendosur një dorë mbi shpatullën e saj me një ngrohtësi që nuk fshihej dot pas protokolleve.

- Do të kalojë, - tha ajo me një qetësi të palëkundur. - Për momentin, duhet të qëndrosh nën mbrojtje.

Elira ndjeu një ndjesi të çuditshme: Siguria dhe kufizimi ishin të lidhura ngushtë, si dy fytyra të së njëjtës monedhë. Çdo hap, çdo frymëmarrje, tani do të shikohej nga sy të panjohur; Çdo lëvizje do të regjistrohej, çdo fjali do të dëgjohej. Por nën atë peshë, një pjesë e saj ndjeu një lloj forcë të re. Një vetëdije se mund të përballonte gjithçka, edhe kur jeta e saj kishte marrë rrjedhën e një romani spiunazhi.

Ajo e pranonte, por në thellësi kishte frikë. Jo për veten. Për kujtimet. Për Arbenin.

Dashuria që nuk vdes edhe kur shkatërrohet

Sa herë shoqëria amerikane e çonte me taksi drejt studios televizive, mendja i shkonte tek ditët kur Arbeni ishte ende i qetë. Ende mjek. Ende ai burrë i mençur që i jepte siguri.

Që i fliste me zë të butë. Që i lexonte libra dhe i shpjegonte botën me një logjikë të rrallë. Pastaj, sëmundja i hyri brenda si një tym i zi, duke u përhapur ngadalë në çdo cep të shpirtit të tij. Frika. Paranoja.

Një ndjesi e padukshme, por e pashmangshme, që e mbërthente dhe nuk e linte të marrë frymë. Një natë në në ëndërr, kur Elira hyri në dhomën e tij në spitalin psikiatrik, Drita e zbehtë e llambës e përplasur mbi muret sterile krijonte hijet e tyre të gjata dhe të çuditshme. Ai e shikoi me sytë e humbur dhe me një zë të dridhur i tha:

- Zogjtë në kafaz nuk fluturojnë dhe nuk këndojnë më, Elira. As unë nuk mundem. Largohu. Shpëto veten.

Fjalët e tij ishin si thikë që i këputi frymëmarrjen. Ajo u largua nga dhoma, me sytë të mbushur me lot dhe zemrën e shkatërruar. Lotët rridhnin pa pushim, por nuk kishte mundësi tjetër. Dhe iku. Sepse ai kishte të drejtë; Shpëtimi i tij ishte i pamundur. Dhe ajo nuk mund të mbante mbi supe barrën e dhimbjes së tij. Ajo që pa ishte vetëm ëndërr. Ai nuk shpëtohet më……Ëndrrat me të do jenë të përjetëshme…….Tani, në mbrëmjet e qeta të Uashingtonit, kur shikonte qytetin e ndriçuar nga dritarja e madhe e dhomës së saj. Ajo ndiente praninë e tij si një hije të butë, një kujtim që nuk largohej kurrë, edhe pse ai nuk ishte më aty. Dritat e qytetit dukeshin si yje të ngrirë, duke pasqyruar një humbje që nuk mund ta harronte.

- Arben, pse nuk pata forcë të të shpëtoja? - pëshpëriste ajo në heshtje, duke u lutur për një përgjigje që nuk vinte,

ndërsa një trishtim i thellë dhe i heshtur mbushte ajrin e dhomës.

Por e dinte se dashuria nuk mjafton për t'u ndeshur me çmendjen. As me sistemin. As me frikën.

Jeta e re dhe hije të vjetra

Në ekran, ajo ishte një grua e fortë, e bukur, e qartë. Fjalët i rreshtoheshin pa u dridhur, zëri i saj kishte peshë dhe siguri, ndërsa opinioni e dëgjonte me vëmendje. Publiku e donte, sepse Elira dinte të fliste me gjuhën e drejtësisë, të dhimbjes së përmbajtur dhe të shpresës së matur.

Por natën…Natën, kur dritat e qytetit shuheshin një nga një dhe zhurma e botës mbetej pas xhamave të mbyllur, Elira ishte veç një grua. Një grua që kishte humbur njeriun që donte dhe që, çdo mbrëmje, përpiqej të rindërtonte veten mbi një boshllëk që nuk mbyllej. Një grua që jetonte mes kujtimesh dhe heshtjesh. Duke mësuar, ngadalë, si të ndizte një jetë të re në një botë të huaj, ku asgjë nuk e njihte emrin e saj të vërtetë. Ajo dinte të fliste për Shqipërinë. Dinte historinë e saj, plagët, padrejtësitë dhe shpresat e pambaruara. Dinte të artikulonte dhimbjen kolektive me fjalë të zgjedhura. Por nuk dinte si të fliste për veten.

Mëngjesi në Uashington sapo kishte lindur. I butë, gri dhe i qetë, si një qytet që zgjohej ngadalë, pa ngut e pa zhurmë, sikur të kishte frikë ta prishte vetë qetësinë e tij. Elira qëndronte pranë dritares së madhe të shtëpisë së saj në Uashington pasi ia ndërruan disa herë. Një lagje e heshtur me pemë të larta, rrugë të shtruara me kujdes dhe shtëpi

koloniale që dukeshin sikur i përkisnin një kohe tjetër. Qielli varej ulët mbi qytet dhe era përplasej lehtë me gjethet e thuprave, duke krijuar një murmurimë të vazhdueshme, thuajse ngushëlluese. Shtëpitë ku banonte i ishin vënë në dispozicion nga Departamenti i Shtetit. Kjo qe. Një shtëpi moderne, me mobilim minimal, shumë dritë dhe pak ngjyra. Asgjë e tepërt, asgjë personale. Një hapësirë e pastër, e rregullt, me atë ndjesinë e qetësisë amerikane që nuk të mbyste, por të rrotullohej përreth, si mjegull e hollë, duke të kujtuar se ishe mysafire.

Elira përgatiti një filxhan kafeje. Zhurma e lehtë e makinës së kafesë ishte e vetmja gjë që theu heshtjen e mëngjesit. Edhe pse larg vendit të saj, ky zakon nuk kishte ndryshuar. Kafeja ishte ura e fundit me veten e dikurshme. U ul pranë tavolinës së drurit të bardhë dhe ngrohu duart te filxhani, duke vështruar avullin që ngrihej ngadalë, sikur të mbante brenda mendimet e saj.

Për një çast, gjithçka ishte e palëvizshme. Pastaj…

Trokitje në derë. Një trokitje e lehtë, e përmbajtur, profesionale. Elira ngriti sytë, sikur të ishte thirrur nga një realitet tjetër.

- Elira, jeni zgjuar?"

Ishte zëri i oficeres së sigurisë, Samantha Roach. Zëri i saj ishte i qartë, i qetë, pa emocion. Një zë që nuk pyeste, por konstatonte. Elira mori frymë thellë, la filxhanin mbi tavolinë dhe u ngrit. Ajo e dinte se dita kishte filluar dhe bashkë me të, edhe roli që duhej të luante. Samanta ishte tepër

korrekte në punë. Ajo ishte një grua afërsisht 40-vjeçare, me sy blu të akullt dhe një buzëqeshje profesionale që nuk e humbte kurrë.

- Po, jam zgjuar, - tha Elira duke hapur derën.

Samantha hyri brenda me një tablet në dorë.

- Sot keni takimin në televizion. Duhet të jemi në lëvizje pas gjysmë ore. NBC kërkoi një segment të dytë për ju. Artikullit tuaj në Le Monde është shikuar me shumë interes.

Elira buzëqeshi lehtë. Një buzëqeshje e hollë dhe e rezervuar, por sytë e saj mbetën të trishtë, të ngarkuar me një lodhje që vetëm koha mund të zbusë.

- E di, - tha ajo, me zërin e saj të qetë, por i mbushur me një grimë shqetësimi. - Shpresoj të mos kthehet në një cirk mediatik. Unë thjesht tregova atë që pashë.

Samantha e vështroi për një moment të gjatë, me një butësi të pazakontë, që rrallë e shfaqte në fytyrë. Sy të qetë, që dukeshin si të kuptonin më shumë se sa mund të thuhej me fjalë.

- Ju po bëni gjënë e duhur, - tha ajo me një zë të ngrohtë, por të vendosur. - Dhe kjo kërkon guxim. Nuk është e lehtë të qëndrosh e vërtetë kur e gjithë bota duket se do ta përkthejë historinë tënde sipas rregullave të veta.

Elira e ndjeu atë çast si një lehtësim të vogël, si një dritë e butë në mes të një terri të brendshëm. Një miratim i heshtur, por i fuqishëm, që i jepte forcë të vazhdonte të rrëfente të vërtetën, pavarësisht frikës dhe pasojave.

Rrugët e Uashingtonit

Makina qarkullonte ngadalë nëpër rrugët e lagjeve elegante. Elira i shihte me vëmendje: Trotuaret e pastra, pemët e gjata, biçiklistët me helmeta të bardha, qentë e shëtitur si pjesëtarë familjeje. Pastaj qyteti hapte papritur horizontin: Ndërtesat e bardha federale, kupola e Kapitolit. E shndritshme në dritën e mëngjesit, monumenti i Uashingtonit që ngrihej për së mbari si një thikë e bardhë drejt qiellit.

"Zogjtë në kafaz nuk fluturojnë,… dhe as këndojnë."

Dhe fytyra e tij ishte tretur në një errësirë që s'kishte ngjyrë

- Sa herë e shoh këtë qytet, më duket si një film, - tha Elira, duke i hedhur një vështrim panoramik dritave që ndriçonin Uashingtonin në mbrëmje. Pallatet, rrugicat e gjata dhe dritat e makinave dukeshin si skena të një kinemaje të ndritshme, por të largët.

Samantha qeshi lehtë, një tingull i ngrohtë që përplasej me heshtjen e natës.

- Ndonjëherë edhe ne që jetojmë këtu, ndihemi sikur ecim në një set filmik, - tha ajo, duke i dhënë një buzëqeshje të qetë dhe të sigurt. Por zemra e Elirës nuk ishte aty. Sytë e saj qëndronin mbi xhamin e madh, duke reflektuar dritat e qytetit, por mendja i rrinte tek dikush tjetër. Tek Arbeni. Tek kujtimet që nuk mund t'i largonte, tek dhimbja që ende e mbante të lidhur me të.

Për një çast mbylli sytë. Një valë kujtimesh e përplasën si erëra të papritura. E pa Arbenin në atë dhomën e vogël të spitalit psikiatrik, ku dritat e zbehta të llambave krijonin hije të gjata mbi muret sterile. Sytë e tij të lodhur, të mbushur

me një trishtim të thellë dhe të paqartë. E shikonin atë me një kombinim dëshpërimi dhe dashurie të heshtur. Fjalët e fundit që i tha në ëndërr. Ende i jepnin zë në kujtesën e saj: Kur hapi sytë përsëri, qyteti i Uashingtonit dukej po aq i bukur dhe i ndriçuar, por zemra e saj ishte e ndarë midis dritave që i shihte dhe hijes së tij që nuk mund ta harronte. E dinte që e kishte dashur. Jo me zjarrin e një vajze të re, por me thellësinë e një gruaje që për herë të parë gjeti te dikush një botë tjetër: Më të mençur, më të dhembshur, më të trishtuar.

Por dashuria e saj ishte thyer. Prerë si një degë e thatë.

Televizioni – Dita e Punës

Studio e televizionit ishte e ftohtë dhe plot drita. Kameramanët lëviznin me shpejtësi, producentët flisnin në kufje, ndërsa gazetarja e famshme e NBC-së, Megan Price, iu afrua me buzëqeshje të sigurt.

- Elira, jemi gati? Segmenti juaj i parë pati 12 milionë shikime. Jeni bërë lajm kombëtar.

Ajo uli kokën, sikur të ishte zëne ne turp. Pastaj tha: "Nuk kam dashur kurrë të bëhem lajm." Megan e pa drejt e në sy: "Po ju jeni zëri që mungonte."

Intervista nisi. Dritat u ndezën. Por në çastin që filluan pyetjet, Elira nuk ndjeu më as dritën, as kamerën, as sytë e miliona njerëzve që po e ndiqnin. Ajo thjesht foli. Foli për Tiranën. Për ngjarjet atje.

Për natën kur gjithçka u kthye në ferr.

Për policinë. Për arratisjen. Për ambasadën amerikane.

Për Arbenin
Dhe e gjitha doli si një rrëfim i fortë, i qetë, i saktë, si një kirurgji emocionale.
Momentet pas intervistës
Kur intervista mbaroi, Samantha i vendosi dorën në shpatull.
- Sot ndryshuat diçka. Ndoshta shumë.
- Ndoshta, - tha Elira e lodhur.
Aty u afrua një teknik dritash. Një djalë i ri, rreth të njëzetave, me flokë të errët të pakrritur dhe sy të zgjuar që reflektonin një ngrohtësi të papritur. Veshja e tij ishte e thjeshtë: Një xhaketë të lehtë të zezë dhe pantallona të errëta, por që nuk mund të fshihnin emocionin në çdo gjest të tij të kujdesshëm.
- Jam nga Tirana, - tha ai me zë të ulët, pothuaj të dridhur nga emocionet. - Dua t'ju falënderoj. Për herë të parë dikush po flet për ne siç duhet. Fjalët e tij prekën diçka të brendshme tek Elira. Një ndjenjë e ngrohtë dhe e papritur e mirënjohjes i përshkoi shpirtin. Zemra e saj, e lodhur nga dhimbja dhe tensioni i ditëve të fundit, Ndjeu një lehtësim të vogël.
- Falëminderit, - i tha ajo, duke i hedhur një vështrim të qetë dhe të ndjerë. - Jam thjesht një njeri. Një njeri që nuk duroi dot më.
Djali qeshi lehtë, si një tingull i pafajshëm dhe i ngrohtë që ndërpriste heshtjen e ambientit të zhurmshëm të studios. Për një çast, të dy ndjenë lidhjen e heshtur të njerëzve që

ndajnë të njëjtën dhimbje dhe të njëjtën ndjesi të pafuqisë përballë padrejtësive. Jashtë, dritat e qytetit reflektonin mbi xhamin e madh, ndërsa brenda, një moment i vogël mirësie dhe kuptimi njerëzor i dha Elirës një frymëmarrje të re, një kujtesë se edhe në mes të turbulencës, njerëzit mund të gjejnë njëri-tjetrin.

Shtëpia në mbrëmje

Mbrëmja ra e qetë mbi Uashington, me dritat e qytetit që ndiznin rrugët ngadalë, si yje artificialë të shpërndarë në një qiell të heshtur. Jashtë, shi i butë, i rrallë, rrëshqiste mbi xhamin e madh të dritares, duke krijuar një muzikë të lehtë dhe monotone që ngjiste në zemër një ndjesi melankolie.

Elira ndezi një qiri pranë dritares. Flaka e tij dridhej lehtë, duke shpërndarë hijet mbi kolltukun blu ku ajo u ul. Një mall i papritur e kaploi, i fortë dhe i dhembshëm, duke i përzier kujtimet e dhimbshme me nostalgjinë për një jetë që nuk mund ta kishte më. Me duart që i dridheshin pak, ajo mori një bllok shënimesh dhe filloi të shkruante, duke lënë që fjalët të rridhnin si një rrëmujë e brendshme: "Unë jam këtu. Por zemra ime ka mbetur atje, në një qytet të kuq, mes hijesh dhe zhurmash. Dua të jetoj,… Por me kujtimet nuk di ç'të bëj."

Sytë iu mbushën me lot, duke reflektuar flakën e qiririt dhe dritat e qytetit. Ajo ndjeu një dhimbje të ëmbël që ngjiste në shpirt, një kombinim të humbjes dhe shpresës. Dhe atë natë, për herë të parë që prej kohësh, Elira u zhyt në gjumë duke ndjerë se po jetonte një jetë të re. Por në heshtjen e

dhomës dhe në ritmin e shiut mbi xham. Ajo e dinte se një pjesë e saj. Ajo më e ndjeshmja. Ajo që ishte gjithmonë e lidhur me kujtimet dhe dashurinë e humbur - Do të mbetej përgjithmonë me Arbenin.

QYTETI I RI

Uashingtoni atë mëngjes dukej i pastër si një fletë e bardhë e sapoçelur. Qielli gri, me vija të zbehta blu, ngjante si një perde që lëvizte ngadalë mbi ndërtesat federale me kupola, mbi rrugët e gjera dhe trotuaret, ku vrapuesit e mëngjesit kalonin me hapa ritmikë.

Elira doli në ballkon me një filxhan çaji të ngrohtë. Flokët e saj të gjatë, ngjyrë gështenjë të errët, i valëviteshin lehtë në erën e freskët të mëngjesit. Kishte veshur një pulovër të hollë gri dhe pantallona të zeza, një thjeshtësi elegante, natyrale. Në fytyrë kishte një qetësi të brishtë, por sytë i rrinin të lodhur, ende të mësuar me hije.

Poshtë, rruga e qetë e lagjes ku ajo jetonte gumëzhinte butë: një makinë policie që kalonte ngadalë për patrullën ditore, një grua që shëtiste qenin, një postier që vendoste me kujdes zarfe në kutitë metalike. Ajo kishte nisur t'i njihte fytyrat e banorëve, por ende nuk ndihej pjesë e kësaj bote.

ZYRAT E TELEVIZIONIT

Në redaksinë e televizionit ku punonte si autore e segmentit "Stories of Freedom". Të gjithëve u kishte bërë përshtypje, shpejtësia dhe saktësia me të cilën ajo shkroi artikujt e parë.

Ishte diçka më shumë se thjesht profesionalizëm; Artikujt e saj kishin një jetë të brendshme, një sens të fshehtë të perceptimit që tërhiqte vëmendjen, duke i bërë njerëzit të ndiheshin sikur po shikonin botën përmes syve të dikujt, që kishte parë më shumë se të tjerët. Një ditë, ndërsa shikonte me kujdes draftet e fundit të segmentit, producentja e saj, Laura Grant, një grua e shkurtër, me flokë të shkurtër të thinjur dhe sy të mprehtë, që dukeshin si teleskop i mendimeve, - iu afrua. Zëri i saj ishte i qetë, por plot siguri:
- Elira, ti ke një zë që mungonte në media. E ndjen këtë?
Elira ngriti kokën nga laptopi, sytë i ndriçonin paksa nga dielli që depërtonte nëpër dritaren e madhe të redaksisë. Ishte një pyetje që kërkonte më shumë se një përgjigje sipërfaqësore.
- Ndoshta… - u përgjigj ajo, duke rrëshqitur gishtat mbi tastierë me kujdes. Ose ndoshta thjesht jam dikush që ka parë gjëra që nuk duhej t'i shihte.
Laura buzëqeshi, një buzëqeshje të vogël, të matur, që dukej sikur maste peshën e çdo fjalë që do thoshte.
- Këtu, - tha ajo duke lëvizur një copë letre të papërfunduar në tryezë - Të gjithë kemi parë diçka. Por jo të gjithë kemi guximin ta tregojmë. Ti e ke.
Redaksia gumëzhinte me zhurmën e monitorëve, grafika që ndryshonin ngjyrë, lajme që shfaqeshin në ekranet anësore, njoftime që mbërrinin pa pushim. Por Elira shpesh ndalej për një moment, duke shikuar nga dritarja e madhe. Avenytë nën diellin e mëngjesit shkëlqenin sikur ishin bërë

prej xhami, flamujt amerikanë valëviteshin pa u lodhur nga era dhe turistët fotografoheshin pranë monumenteve, duke kapur çaste që nuk do të kthehesin kurrë. Ishte një botë që dukej e qetë, por Elira e dinte se pas këtij qetësimi fshihej një ritëm tjetër, më i fuqishëm dhe më i rrezikshëm. Sepse jeta e saj nuk ishte vetëm punë e qetë, lajme dhe artikuj të bukur. Ajo përballej çdo ditë me kujtime, me histori që mund të thyheshin ose të shuheshin dhe me njerëz që nuk donin të dëgjonin të vërtetën. Çdo artikull, çdo segment, ishte një përpjekje për të treguar atë që shumica nuk kishte guximin ta shihte, dhe për këtë arsye, ndonjëherë ajo ndjente peshën e vetmisë mes zhurmës së redaksisë dhe shkëlqimit të qytetit që zgjohej jashtë.

SURVEJIMI

Oficerët e sigurisë amerikane e ndiqnin kudo. Në fillim, kjo e bezdiste; çdo hap, çdo frymëmarrje, dukej sikur i kontrollohej nga sy të padukshëm. Nuk ndihej e lirë. Por me kalimin e kohës, u mësua të jetonte me këtë prani të pandërprerë, të kuptonte se ishte pjesë e një rregulli të heshtur që ruante jetën e saj.

Në hyrje të ndërtesës së televizionit, gjithmonë qëndronte një burrë i gjatë, me syze të errëta që reflektonin dritën e mëngjesit, dhe një tablet të zi të kapur ngushtë në dorë. Ai e përshëndeste gjithmonë me të njëjtin ton të qetë, të prerë:

- Good morning, Miss K.!

- Good morning! - i përgjigjej ajo gjithmonë, me një

buzëqeshje të lehtë, e cila ruante distancën dhe respektin.
Ajo nuk e mori kurrë vesh emrin e tij të vërtetë. Por e ndiente fuqimisht se ai dhe të tjerët si ai kishin një detyrë të fshehtë dhe të rëndësishme: ta mbanin gjallë. Çfarë frikërash, kërcënimesh apo rrezikesh fshiheshin pas tyre, Elira nuk e pyeste. Ishte një mister i padukshëm që mbante një pjesë të sigurisë së saj. Edhe ajo e pranonte këtë heshtje si një pjesë të jetës së re që po përpiqej të ndërtonte.
Dhe kështu, ndërsa qyteti po ambjentohej ngadalë përditë. Ajo mësoi të ecë midis dritave të studiove dhe hijes së mbrojtësve të padukshëm, duke e ndjerë fuqinë dhe rrezikun njëkohësisht, të dy të lidhur në mënyrë të pandashme me jetën e saj.

JETESA NË UASHINGTON

Ajo kthehej çdo natë në shtëpinë e saj. Shtëpia nuk ishte e re por ishte shtëpia e ëndrrave, si për çdo njeri që merrte banesë. Së pari ajo ishte e ndritshme, e heshtur, me një bibliotekë të vogël, me një verandë që kishte daljen drejt një lulishteje të gjelbër. Por për Elirën, ajo ishte vetëm një vend kalimtar. Mbrëmjeve, ndizte një llambë të vogël pranë dritares dhe lexonte libra amerikanë nga Heminguay te Joan Didion, nga Toni Morrison, te gazetat e vjetra të "Uashington Post". Shpesh ndante mendimet me veten, në ato çaste të heshtura kur zhurma e redaksisë shuhej për disa sekonda dhe qyteti dukej sikur merrte frymë bashkë me të.

"Dikur mendova se do jetoja në një qytet të vogël në Shqipëri… Një shtëpi e thjeshtë, rrugë që i njihja me sy mbyllur, fytyra që më përshëndesnin me emër. Jeta do të ishte e kufizuar, por e njohur, e parashikueshme."
Tani ishte këtu, në zemër të Uashingtonit, mes ndërtesave madhështore, dritave që nuk shuheshin kurrë dhe një gjuhe që ende i tingëllonte si një provë e përditshme. Një qytet që të jepte gjithçka, por që të kërkonte edhe më shumë në këmbim.
"Po kush jam unë këtu?" — pyeste veten. Një gazetare mes qindra të tjerave? Një emigrante që flet për lirinë, ndërsa ende mëson si të jetojë me të? Apo një zë i huaj që kërkon vend në një kor të zhurmshëm e të pamëshirshëm? Ndonjëherë i dukej sikur jetonte mes dy botësh: Njëra që e kishte formuar dhe tjetra që po e ndryshonte pa e pyetur.
Shqipëria i vinte në mendje si një kujtim i ngrohtë, por i dhimbshëm, ndërsa Uashingtoni si një sfidë e përhershme, e ftohtë dhe e ndritshme njëkohësisht. Ajo e kuptonte se nuk ishte më ajo vajza që kishte ëndërruar thjesht një jetë të qetë. Por ende nuk ishte plotësisht gruaja që kërkonte të bëhej. Dhe pikërisht në këtë hapësirë të paqartë mes së shkuarës dhe së tashmes, mes asaj që kishte humbur dhe asaj që po ndërtonte, Elira vazhdonte të ecte, duke kërkuar përgjigjen e pyetjes që i kthehej gjithmonë: Kush jam unë, këtu dhe tani?

SEKUENCA E UASHINGTONIT

Një ditë me shi, ndërsa ecte drejt stacionit të metrosë Union Station, një burrë me kapuç iu afrua pa tërhequr vëmendje.

- Jeni ju? Elira?

Ajo habitet, por ruajti qetësinë.

- Po, - tha ajo.

Burrit i dridhej zëri, por foli:

- Ju kam ndjekur në NBC… Artikulli juaj më hapi sytë. Edhe unë kam ardhur nga Ballkani. Ne duhet të flasim… Një ditë, kur të jeni gati.

Kaq foli dhe iku si një shi me rrebesh..

Ai u zhduk mes turmës.

Trupi i Elirës u drodh. Samantha, që ecte disa metra më larg, u kthye menjëherë.

- Çfarë ndodhi? Kush ishte?

- Nuk e di… - tha Elira. - Thjesht dikush që më njohu.

Por fytyra e Samatës u tendos. Ajo e përfshiu me vështrim profesional.

- Do të rrisim masat e sigurisë. Kaq.

SUKSESI I PAQTË

Shpesh ndante mendimet vetëm me veten, në ato çaste kur zhurma përreth zbehej dhe ajo mbetej përballë heshtjes së brendshme. Ishin momente të shkurtra, por të mjaftueshme për ta kthyer mendjen pas.

"Dikur mendova se do jetoja në një qytet të vogël në Shqipëri… - i thoshte vetes. - Një jetë e thjeshtë, rrugë

të ngushta që i njihja me sy mbyllur, njerëz që më përshëndesnin me emër, ditë që rridhnin pa ngut."
Ishte një ëndërr modeste, por e qartë, një siguri e vogël në një botë të pasigurt. Tani kjo jetë është këtu, në zemër të Uashingtonit, mes ndërtesave që ngriheshin si monumente pushteti. Mes dritave që nuk shuheshin kurrë dhe ritmit të pandalshëm të një qyteti që nuk të linte kohë të ndaleshe. Një vend që të jepte mundësi, por që të kërkonte vazhdimisht të provoje veten.
"Po kush jam unë këtu?"
Pyetja i kthehej pa pushim, herë si një dyshim i qetë, herë si një thirrje e brendshme. Ndonjëherë ndihej thjesht një gazetare mes shumë të tjerave, e humbur në një redaksi të madhe. Herë të tjera, një emigrante që fliste për lirinë. Ndërsa ende po mësonte të jetonte me këtë jetë. Dhe kishte momente kur ndiente se ishte një zë i huaj, që përpiqej të gjente vend në një kor të fortë e të pamëshirshëm. Jetonte mes dy botësh: Njëra e kishte formuar, tjetra po e ndryshonte pa e pyetur. Shqipëria i shfaqej si një kujtim i ngrohtë, por i mbushur me plagë, ndërsa Uashingtoni si një sfidë e ndritshme dhe e ftohtë njëkohësisht.
Asnjëra nuk e mbante plotësisht, por të dyja e thërrisnin.
Ajo e kuptonte se nuk ishte më ajo vajza që ëndërronte vetëm qetësi. Por ende nuk ishte gruaja që kërkonte të bëhej. Dhe pikërisht në këtë hapësirë të paqartë mes së shkuarës dhe së tashmes, mes humbjes dhe ndërtimit. Elira vazhdonte të ecte, duke kërkuar jo vetëm vendin e saj në

botë, por edhe emrin e vërtetë të vetvetes. Të mësonte të përgjigjej të gjitha ëndrrave zhgënjimeve. Por mes tyre… Edhe kërcënimeve.,…Dhe ja. Si ka mundësi të ndodhë tani? Papritur, një email i shkurtër shfaqej në ekran: Zërat nga e shkuara nuk i iknin kurrë nga veshi, si një jehonë e largët mallkimi…

"Mos fol më për Shqipërinë. E dimë ku jeton."

Fjalët ishin të ftohta dhe kërcënuese, të shkruara me një saktësi që nuk linte vend për dyshime. Një ndjesi trishtimi dhe tensioni pushtoi ajrin.

Samantha mori telefonin dhe e shikoi emailin disa sekonda, me një fytyrë të qetë por të vendosur, duke matur peshën e mesazhit.

- Nga sot, nuk lëviz më vetëm, - tha ajo me zë të qetë, por çdo fjalë kishte peshën e vendimit të prerë.

Elira e ndjeu një dridhje të lehtë në shpirt, një përzierje frike dhe lehtësimi. Nuk ishte më e vetme në këtë rrjet kërcënimesh dhe mbikëqyrjeje. Por kërcënimi ishte ende aty, i fshehur, i pranishëm dhe ndjenja e pasigurisë mbeti e rëndë mbi supe.

MOMENTI I QETË

Atë mbrëmje, Elira u ul në verandë, larg zhurmës së ditës që ende pulsonte në qytet. Ajri ishte i freskët, me atë qetësi të rrallë që Uashingtoni ofron vetëm pas mesnate, kur dritat mbeten ndezur, por njerëzit tërhiqen në hijet e tyre. Një filxhan çaji i ngrohtë i qëndronte pranë, por ajo mezi e

preku; Mendimet i rridhnin më shpejt se duart.
Uashingtoni shkëlqente në largësi. Silueta e Katedrales së Shën Gjonit ngrihej madhështore në errësirë, ndërtesat e Georgetoun-it ndrinin me një hijeshi të qetë, ndërsa dritat e Potomac-ut lëviznin ngadalë, si yje të vegjël që kishin rënë mbi ujë. Qyteti dukej i bukur dhe i paarritshëm njëkohësisht, sikur po e vështronte nga larg, pa e gjykuar.
Ajo u mbështet pas karriges, ndjeu drurin e ftohtë në shpinë dhe mbylli sytë. Për herë të parë pas shumë kohësh, mendja nuk i rendte drejt frikës, as drejt së shkuarës që e ndiqte si hije. I lejoi vetes. Vetëm frymëmarrjen, ritmin e qetë të natës dhe dritat që pulsonin përtej syve të mbyllur. "Këtu fillon jeta ime e dytë," tha me vete, pa zë, por me një bindje që nuk e kishte ndier kurrë më parë. Nuk ishte një premtim i madh, as një deklaratë heroike. Ishte një pranim i thjeshtë, i sinqertë, i pjekur nga humbjet dhe rrugët e gjata.
"Dhe këtë herë… Nuk do të kem frikë."
Fjalët u shkrinë në ajrin e natës, pa dëshmitarë, por me peshë. Elira e dinte se frika nuk zhdukej kurrë plotësisht; Ajo vetëm mësonte të mos sundonte më jetën. Dhe ndërsa qëndronte aty, mes dritave të qytetit dhe heshtjes së brendshme, ajo ndjeu diçka të rrallë: Jo lumturi të zhurmshme, por paqe. Një paqe e brishtë, por e vërtetë, e mjaftueshme për të vazhduar përpara.

FAMA E SAJ NË SHBA

Fama nuk erdhi si një dallgë e vetme. Erdhi si një stuhi e

heshtur, që fillimisht nisi me një cicërimë gazetash, pastaj me një intervistë në mëngjes, pastaj me analizat në mbrëmje, derisa papritur u bë realitet: Emri i Elirës përmendej në gjithë vendin. Në çdo studio televizive. Në çdo portal. Në çdo podcast serioz politik. Ajo u bë simbol i guximit të grave emigrante, një zë që denonconte dhunën shtetërore dhe njëkohësisht një figurë që shkaktonte debat të fortë. Çdo paraqitje e saj ishte një sfidë dhe një mesazh i qartë.

Studio "Good Morning America"

Dritat e studios në Nju- York ishin kaq të shndritshme sa për një çast Elira ndjeu se po i humbiste fryma. Reflektimi i tyre mbi skenë i jepte gjithçkaje një shkëlqim të ftohtë, pothuaj të papërballueshëm. Publiku filloi të duartrokasë sapo ajo hyri dhe ajo u ndal për një sekondë, duke u përpjekur të përtypte emocionin e papritur. Nuk ishte mësuar me këtë lloj mbështetjeje publike. Gazetari kryesor, Richard Hall, një burrë me flokë të thinjur dhe energji të qëndrueshme televizive, iu afrua me një buzëqeshje të ngrohtë. Kostumi i tij gri i përshtatej qetësisë profesionale, por sytë e tij kishin atë kuriozitetin tipik të dikujt që ka parë shumë histori të mëdha.

Elira hyri në studio e veshur me një kostum të thjeshtë, por elegant: Një këmishë të bardhë me mëngë të gjata, të qepura me kujdes dhe pantallona të errëta të drejta që i dhanë një linjë të pastër dhe serioze trupit. Çorapet e zeza dhe këpucët me taka të ulëta e bënë të ndihej e sigurt dhe e qëndrueshme në çdo hap. Flokët i kishte të kapur në një

bisht të lirshëm pas kokës, disa fije të lirshme i binin mbi fytyrë, duke i dhënë një butësi dhe natyrshmëri pamjes. Sytë e saj, të thellë dhe pak të lodhur, reflektuan dritat e forta të studios dhe emocionin e momentit. Ndërsa ecte drejt skenës, kostumi i thjeshtë e bënte të dukej serioze dhe e vendosur, por buzëqeshja e saj e lehtë dhe lëvizjet e kujdesshme i jepnin një ngrohtësi të ndjerë publikut. Çdo detaj i veshjes tregonte përzgjedhje të qëllimshme: Të shfaqej e respektueshme, por edhe e afërt dhe e prekshme. Kur u ndal para mikrofonave dhe publikut, dritat reflektuan mbi xhamin e syzeve të Richard Hall-it dhe mbi flokët e saj, duke e bërë atë të dukej si një figurë e qetë, por e fuqishme, gati të rrëfejë historinë e saj dhe të kapë zemrat e shikuesve.
- Zonja E., Amerika po flet shumë për ju, - tha ai, duke i dhënë dorën dhe duke e përshëndetur. Dorën e saj e përshkoi një ndjesi ngrohtësie dhe serioziteti; Ishte një përzierje respekti dhe kurioziteti.
- Nuk e di nëse e meritoj gjithë këtë vëmendje, - iu përgjigj Elira me një buzëqeshje të lehtë, por sy të ndritshëm.
Richard Hall buzëqeshi, një buzëqeshje që e shoqëronte me një përkëdhelje të lehtë supi, duke e bërë të ndjehej më e qetë në mes të dritave të forta të skenës.
- Nuk është çështje merite, Zonja E., - tha ai, duke e parë me admirim. - Është guximi juaj që ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Njerëzit duan të dëgjojnë historinë tuaj, jo thjesht lajmet e zakonshme. Elira bëri një frymëmarrje të thellë dhe hodhi një shikim mbi publikun që duartrokiste. Një ndjesi

e çuditshme ngjalli në trupin e saj: Frikë, lumturi dhe një përgjegjësi e papritur, për të përfaqësuar jo vetëm veten, por edhe ata që nuk mund të flisnin.

- Atëherë, - tha ajo duke u përqendruar tek mikrofonat, - Do të bëj atë që mundem, sepse zëri i secilit prej nesh ka rëndësi.

Publiku shpërtheu në duartrokitje. Richard Hall e shikoi për një çast, duke e vlerësuar seriozitetin dhe qetësinë që ajo kishte mbajtur në çdo fjalë. Dhe pastaj ia ktheu buzëqeshjen e ngrohtë, të sigurt. Me një dritë të fshehtë vendosmërie në sy.

Publiku heshti për një çast, ndërsa kamerat përqendroheshin tek fytyra e saj. Richard vazhdoi, duke shtuar një ton më të ngrohtë:

- Nuk e them këtë kot. Ju keni treguar historinë tuaj me guxim,… dhe njerëzit dëgjojnë. Çfarë ndjenje keni duke qëndruar këtu tani?

Elira mori frymë thellë dhe u përgjigj:

- Është e çuditshme,… Njëkohësisht frikë dhe liri. Publiku më sheh këtu të qetë, por historia ime,… është më e madhe se kjo studio.

Richard buzëqeshi dhe hodhi një shikim tek kamerat:

- Tani, zonja E., Çfarë shpresoni të arrini duke treguar këtë histori?

Elira iu afrua mikrofonit dhe tha me vendosmëri: Shpresoj që njerëzit të kuptojnë se çdo zë ka rëndësi. Nuk jam vetëm për veten time… Jam për të gjithë ata që nuk mund të flasin.

Publiku shpërtheu përsëri në duartrokitje. Një ndjesi e ngrohtë mbushi zemrën e Elirës. Për një moment, frika u zbeh, duke u zëvendësuar nga fuqia e një mesazhi të thjeshtë, por të fuqishëm: Të folurit për të vërtetën nuk është kurrë e kotë.

- Ju keni rrëfyer një histori që shumë njerëz nuk do të kishin guximin ta tregonin. Dhe keni ndezur një diskutim që askush nuk e prekte më parë. - tha Riçardi dhe sytë i uli për tokë për të pritur një pikloti që i doli papritur.

Elira preku flokët me një lëvizje të lehtë, pothuaj instinktive, sikur të kërkonte një pikë ekuilibri përpara se të fliste. Fytyra e saj mbante atë bukuri të ftohtë ballkanike që u bënte menjëherë përshtypje amerikanëve: Tipare të qarta e të skalitura, sy të mëdhenj që dukeshin sikur mbanin brenda histori të pathëna. Dhe një lloj trishtimi magnetik që nuk kërkonte vëmendje, por e tërhiqte atë pa zhurmë. Dritat e studios i ndriçonin fytyrën pa mëshirë, Por ajo nuk u shmang. Zëri i saj doli i qetë, i prerë, pa asnjë dridhje: Mendoj se e vërteta nuk duhet të ketë frikë.

Për një çast pati heshtje. Pastaj fjalët u shkrinë në duartrokitje. Jo ato të zakonshmet, të sjellshme, por një reagim i sinqertë, i menjëhershëm, që tregonte se diçka kishte prekur publikun. Prodhuesit e emisionit e shihnin me sy të shkëlqyer, duke shkëmbyer shikime të shpejta mes tyre: Ky ishte ai momenti i rrallë që televizioni kërkon, një fjali e thënë në kohën e duhur, nga njeriu i duhur.

Portretizimi në media

Pas emisionit, jehona e fjalëve të saj u përhap më shpejt sesa Elira e kishte imagjinuar. Gazeta "Nju York Times" botoi një artikull të gjatë, të shoqëruar me një fotografi të saj në profil, me titullin:

"Elira K. — Zëri i ri i ndërgjegjes ballkanike në SHBA."

Artikulli e përshkruante si një gazetare që sillte me vete peshën e historisë dhe plagëve të një rajoni të trazuar, por edhe qartësinë morale të dikujt që nuk kërkon sensacion, por kuptim. Theksohej mënyra e saj e të folurit, matur dhe e drejtpërdrejtë, si dhe aftësia për ta kthyer përvojën personale në një rrëfim universal.

"The Atlantic" shkoi edhe më tej, duke e quajtur: "Një zë i qetë që sfidon narrativat e mëdha të pushtetit."

Në pak javë, Emri i Elirës nisi të përmendej jo vetëm në redaksi, por edhe në panele diskutimi, konferenca dhe debate publike. Për publikun, ajo po bëhej një figurë e re morale. Për median, një histori e fortë. Për Elirën vetë, gjithçka po ndodhte shumë shpejt. Dhe ajo e ndiente se pas këtij vlerësimi fshihej edhe një rrezik i heshtur: Sa më i lartë zëri, aq më e madhe hija që e ndjek.

"Tronditja më e papritur mediatike e vitit." Kështu e quajtën analistët amerikanë, me atë gjuhën e ftohtë statistikore që fsheh tronditje reale. Brenda pak javësh, emri i saj u kthye në titull, titulli në markë. Dhe marka në mall publik të jep shumë para dhe famë. Në okërrat e Amazon Books nisën të shfaqeshin libra me tituj sensacionalë: "Kush është Elira?", "Rrëfimi që ndryshoi Uashingtonin", "Guximi i një gruaje nga Shqipëria"

Autorë që nuk e kishin takuar kurrë, botues që nuk dinin asgjë për jetën e saj, analistë që lexonin vetëm fragmente të shkëputura. Të gjithë shkruanin për të, sikur ta njihnin më mirë se vetë ajo. Historia e saj po zhvishej nga konteksti, po copëtohej dhe po riformulohej sipas nevojave të tregut.
Ndërkohë, tabloidët nuk u interesuan për të vërtetën. Ata u ushqyen me sipërfaqen: Çfarë vishte Elira, me kë fliste në korridoret e studios? Ku rrinte pas emisionit? Pse jetonte vetëm, pse nuk buzëqeshte gjithmonë.
Çdo hap në rrugë u fotografua si provë. Kështu, fama tregoi dy fytyrat e saj: njëra fisnike, që e ngrinte zërin e së vërtetës; tjetra helmuese, që kërkonte të shkatërronte njeriun pas figurës.
Presioni i ri
Një mbrëmje, ndërsa po kthehej nga puna, telefoni i ra në heshtjen e lodhur të rrugës. Ishte Laura, producentja.
- Është koha të flasim seriozisht.
- Për çfarë? - pyeti Elira, edhe pse e ndiente peshën që po vinte.
- Ti tani je figurë publike. Duhet të kesh kujdes me çdo gjë që thua. Me çdo gjë që poston, me çdo hap që hedh. Do kesh kundërshtarë. Do kesh njerëz që s'të duan. Fama në SHBA është një bishë.
Elira u ndal pranë murit të ftohtë të korridorit të shtepisë së saj. Dritat e zbehta i ranë mbi fytyrë, sikur të ishin projektorë të padukshëm.
- E di… Por unë nuk jam artiste. Unë jam gazetare.
Zëri i saj ishte i qetë, por i lodhur. Në anën tjetër të linjës

pati një pauzë të shkurtër. Pastaj Laura foli, prerë:
- S'më intereson çfarë je. Tani je simbol.
"Fjala "simbol" iu ngulit në kraharor si një peshë e rëndë. Simbolet nuk qajnë. Simbolet nuk lodhen. Simbolet nuk lejohen të gabojnë. Dhe për herë të parë, Elira e kuptoi se rreziku më i madh nuk ishte armiku që e sulmonte hapur, por fama që e zhveshte nga e drejta për të qenë thjesht njeri. Në heshtjen e korridorit, ajo ndjeu frikën të rritet. Jo për jetën e saj, por për të vërtetën që rrezikonte të humbiste mes duartrokitjeve.

Përballja me publikun

Në një event të madh në Georgetoun University, salla u mbush deri në fund. Studentë, profesorë, gazetarë dhe aktivistë kishin zënë çdo vend, madje edhe korridoret anësore. Në ajër ndihej një pritje e ngarkuar. Ajo ndjesi kolektive që lind kur publiku pret jo thjesht një fjalim, por një figurë. Kur Elira hyri në sallë, turma u ngrit në këmbë. Duartrokitjet shpërthyen pa paralajmërim, duke u përplasur në muret e larta të auditorit. Për një çast, ajo ndaloi. Ndjeu një rrymë të ftohtë në stomak, si një paralajmërim i heshtur se asgjë nuk ishte më private. U buzëqeshi lehtë dhe iu drejtua podiumit, duke e mbajtur trupin drejt, sikur qetësia e saj të ishte një mburojë e padukshme. Foli qartë, pa retorikë të tepruar, duke prekur tema që studentët i dëgjonin zakonisht në teori, por rrallë nga dikush që i kishte jetuar. Salla dëgjonte në heshtje, e përqendruar, sikur çdo fjalë të kishte peshë.

Pas eventit, ndërsa njerëzit shpërndaheshin ngadalë. Një vajzë e re iu afrua. Kishte një bllok shënimesh në dorë dhe një kureshtje të sinqertë në sy.
- Ju a e shijoni famën? - e pyeti ajo. - Apo ju rëndon?
Elira u mendua për një moment. Vështrimi i saj rrëshqiti mbi sallën tashmë gjysmë bosh, mbi karriget e rreshtuara që pak më parë kishin qenë plot zëra.
- Në fillim, fama, - tha ajo. - Të tërheq si dritat e një qyteti të madh… Por më pas të verbon. Vajza qeshi lehtë, me një lloj respekti të pavetëdijshëm.
- Shpresoj që mos t'ju verbojë shumë.
Elira buzëqeshi, por nuk u përgjigj, sepse e dinte se verbimi nuk ndodh gjithmonë papritur; Shpesh vjen ngadalë, në emër të duartrokitjeve.
Fytyra e famës
Në shtëpi, në dhomën e saj të qetë, Elira rrinte shpesh vetëm. Larg auditorëve, kamerave dhe zhurmës së vazhdueshme të vëmendjes publike. Ajo kthehej sërish në atë që ishte në thelb: një grua me mendime të pashprehura, me pyetje që nuk gjenin lehtë përgjigje. Heshtja e kësaj dhome nuk ishte bosh, ajo mbante peshën e ditës, fjalët e thëna dhe ato që kishin mbetur pezull.
Dritat e buta të një qiriri të ndezur krijonin hije të gjata mbi librat e radhitur në raftet prej druri. Tituj të filozofisë, historisë, letërsisë. Libra që dikur i kishte lexuar me etje, tani i shfletonte pa u ndalur. Aroma e dyllit mbushte ajrin me një ndjenjë përkohësie, sikur çdo gjë ishte e destinuar të

digjej ngadalë e të zhdukej, ashtu si flaka e qiririt.
Ajo kthente faqet, por fjalët i rrëshqisnin pa u kapur. Mendja i kthehej vazhdimisht te një pyetje që nuk po gjente përgjigje. Një pyetje që e shoqëronte gjithnjë e më shpesh: "A ishte fama një mjet për të thënë të vërtetën, apo një perde e re që e mbulonte atë?"
Në atë heshtje, Elira e kuptonte se publiku shihte vetëm një pjesë të saj. Figurën e sigurt që flet pa u dridhur, zërin e qartë që sfidon, gruan që duket se nuk heziton kurrë. Ishte një imazh i ndërtuar nga dritat, titujt dhe duartrokitjet. Por pas kësaj fytyre publike fshihej një tjetër, më e brishtë, që ende kërkonte ekuilibër mes dritës dhe errësirës, mes nevojës për të folur dhe dëshirës për të heshtur. Ajo e dinte se fama nuk të godet gjithmonë me zhurmë. Shpesh ajo të lodh ngadalë, të zhvesh nga intimiteti dhe të mëson të jetosh me vështrime të padukshme. Dhe pikërisht aty, në këtë vetmi të qetë, larg syve të botës, Elira ndiente peshën e vërtetë të famës: Jo në duartrokitje, jo në artikujt e gazetave, por në heshtje. Në momentet kur askush nuk e shihte dhe ajo duhej të përballej vetëm me veten.
"Kush jam unë tani?"
Në Uashington, ajo ishte njëkohësisht edhe figura politike edhe emigrantja e guximshme edhe gazetare edhe simbol i të drejtave të njeriut si edhe gruaja misterioze ballkanike me një të shkuar të errët. Fama e rrethonte si një rreth zjarri, duke hedhur dritë dhe hijë njëkohësisht mbi çdo hap që hidhte, çdo koment në media, çdo titull sensacional e bënte

të ndihej sikur po luante në një skenë ku nuk mund të tërhiqej, por ku duhej të performonte vazhdimisht.
Por ndonjëherë, ajo vetëm donte qetësi. Vetëm një mëngjes normal, pa kamera që e ndiqnin çdo lëvizje, pa patrulla policie, pa intervista, pa njerëz që e matnin dhe e gjykonin. Vetëm ajo, një filxhan kafeje dhe heshtja që ngjallte siguri. Dritaret e shtëpisë së saj ndriçoheshin nga dielli i lehtë i mëngjesit. Edhe ajri i ftohtë i janarit mbante aromën e kafeve të pjekura. Për disa minuta, bota mund të prishej ose të shpëtonte dhe ajo thjesht ishte vetvetja. Dhe pastaj erdhën ofertat.
Një ditë, Samantha i dorëzoi një zarf të trashë, i cili dukej si një premtim që mund të ndryshonte gjithçka.
"Nga Penguin Random House,"- tha ajo, me një buzëqeshje të ngrohtë që nuk mund të fshihte emocionin.
Elira e hapi me kujdes. Ishte një ofertë për një libër autobiografik. Zemra i rrihte pak më shpejt. Gishti i saj preku letrën me kujdes, sikur të ishte e brishtë. Mendja i shkoi menjëherë tek pyetjet që gjithmonë e shoqëronin: A jam gati të rrëfej gjithçka? A do të më kuptojnë? A do të më gjykojnë? Çdo kujtim, dhimbje e fshehur dhe moment i lumtur apo i hidhur që kishte kaluar u rreshtua brenda saj si figura të ndriçuara nga një reflektor i padukshëm.
Të nesërmen erdhi një ofertë tjetër, për një dokumentar. Ajo e vuri dorën mbi gojë dhe për një çast u ndje e vogël para madhështisë së mundësive. Ishte një hap drejt të panjohurës: Nëse e bënte këtë, do të humbiste pjesën e saj

private, por ndoshta do të ndihmonte dikë tjetër, dikë që nuk kishte zë. Mendimet i rrëshqitën brenda si valë të forta: "A do të mund të kontrolloj narrativën time? A do të më kuptojnë shikuesit?"

Dita e tretë solli një ofertë nga një kompani prodhimi nga Los Angeles: Historia e saj do të bëhej film. Elira u ul në karrigen e zbehtë të studios dhe heshtja u bë e rëndë, pothuajse e padurueshme. Laura, asistente dhe shoqe e saj e besueshme, i tha me zë të qetë, por të prerë:

"Ky është momenti kur gjithçka ndryshon. Nëse e bën këtë, jeta jote nuk do të jetë më private. Çfarëdo gjë që ke mbajtur për vete, tani do të jetë për të gjithë. Çfarëdo gjë që ke fshehur, do të shihet, do të dëgjohet, do të diskutohet."

Elira e ndjeu peshën e fjalëve të Lauras iu dukën si një valë që e mbulonte atë dhe bregun e detit. Një pjesë e saj dëshironte të rrinte larg, të ruante heshtjen dhe qetësinë e mëngjesit të thjeshtë. Por një tjetër pjesë e saj ndjeu një zjarr të brendshëm: Mundësinë për të treguar të vërtetën e saj, për të bërë që zëri i saj të arrinte më shumë njerëz. Për të dhënë shpresë atyre që nuk kishin guxim. Për herë të parë, ajo e pyeti veten me një zë të qetë, por vendimtar: "Kush jam unë tani? A jam thjesht një simbol, apo mund të jem vetvetja edhe mes dritës dhe hijes që fama i hedh mbi mua?"

Heshtja mbeti përgjigjja e saj për disa çaste, por ajo e dinte: Zgjedhjet e mëdha nuk lënë hapësirë për dyshime të gjata. Vetëm veprimet tregojnë kush je.

"Nëse do, mund të bëhesh e pasur brenda vitit."
Elira u ul në kolltukun e saj blu dhe mbajti zarfin ngadalë në duar. Një heshtje mbushte dhomën, ndërsa mendimet përplasnin njëra-tjetrën. "Para dy vitesh, as që do ta imagjinoja këtë. Tani gjithë Amerika po flet për mua… Po unë çfarë dua vërtet? Pasuri? Famë? Apo qetësi? E di që historia ime ka rëndësi, por,… sa do të kushtojë kjo te pjesa ime private?"
Mbylli zarfin ngadalë, duke e ndjerë peshën e vendimit. Një pjesë e saj ishte e gatshme të tregonte gjithçka, të shpëtonte të tjerët përmes historisë së saj, por një pjesë tjetër donte të ruante heshtjen, vetminë e çmuar që ende i jepte forcë dhe qetësi.
"Nuk është thjesht një libër, - i tha vetes ajo me një zë të heshtur, - Është e gjithë jeta ime që mund të shndërrohet në spektakël. A mund ta përballoj? Ajo e humbi pak dhe për një moment, dhoma e qetë dhe drita e qiririt u bënë një bastion i vogël paqeje, ku mund të dëgjonte vetëm frymëmarrjen e vet, duke menduar për çdo hap që do të vinte. Do ishte vendimtar për të dhe karrierën e saj."
"Po nëse nuk dua të jem e pasur? Po nëse dua thjesht të jetoj?"
Laura qeshi.
"Atëherë ke ardhur në vendin e gabuar. Amerika nuk të lë të jesh 'vetëm'."
Trazimi brenda saj
Një natë, teksa po kthehej në shtëpi, shiu binte me rrëmbim,

duke përplasur ujë mbi trotuar dhe duke krijuar rrëke që gumëzhinin nën këmbët e saj. Elira nuk ecte shpejt, ecte me kapuçin e palltos tërhequr mbi kokë. Ajo ecte ngadalë duke hyrë thellë në mendime, sepse ndiente se diçka e brendshme po ndryshonte. Nuk ishte më thjesht e panjohura që kishte ardhur nga Shqipëria. Ishte dikush tjetër, një version i saj që tani shikohej dhe vlerësohej, dikush që e peshonte, e gjykonte, e adhuronte, dikush që nuk ishte më i lirë.

"Fama është si një det i madh, - mendoi ajo, - me një dridhje të lehtë në trup. Të ngre, të mahnit… Por mund të të mbyt po aq shpejt."

Dhe pastaj… thirrja

Një mbrëmje e ftohtë dimri, ndërsa po pinte çajin në verandë, Elira ishte mbështjellë me një shall të hollë dhe vështronte dritat e qytetit që dridheshin në errësirë. Ajri ishte i mprehtë, pothuaj therës dhe heshtja kishte një peshë të pazakontë. Pikërisht atëherë, telefoni i saj cingëroi.

Një numër i panjohur

Zemra iu shtrëngua lehtë. Ajo e mori aparatin me dorë të dridhura dhe u përpoq të mbante zërin të qetë ndërsa u përgjigj: "Po?"

Nga ana tjetër e linjës erdhi një zë i ftohtë, i prerë, zyrtar. Një zë që nuk linte hapësirë për keqkuptime: "Flet Departamenti i Shtetit."

Elira ndjeu një shtrëngim të menjëhershëm në stomak. Për një çast, mendimet iu shpërndanë pa rend.

"Po… - tha ajo më në fund, me një ton që tradhtonte lehtë tensionin.

"Zonja Miller… {Elira}, - vazhdoi zëri, duke përdorur pseudonimin e saj, - Kemi nevojë të takohemi menjëherë. Ka informacion që duhet të diskutohet personalisht. Nuk ka kohë për vonesa."

Fjalët ranë njëra pas tjetrës, të thata, pa shpjegime, pa ngushëllim. Linja mbeti e hapur për një çast të shkurtër, pastaj u mbyll. Elira mbeti e heshtur. Çaji ishte ftohur në filxhan, por ajo nuk e vuri re. Mendimi i parë ishte frika. Një instinkt i thellë për vetëmbrojtje, një ndjenjë se diçka po lëvizte përtej kontrollit të saj. Në kokë i kaluan skena të shpejta: Artikujt, fjalimet, vëmendja e tepërt, hijet që fama sjell pas vetes.

Por pothuaj menjëherë, frika u përplas me diçka tjetër. Një ndjenjë përgjegjësie, e rëndë dhe e qartë, u ngrit brenda saj. Ajo e dinte se kishte ardhur deri këtu pikërisht, sepse nuk kishte heshtur. Dhe tani, heshtja nuk ishte më një mundësi. Ajo mori frymë thellë, u ngrit nga karrigia dhe hodhi një vështrim të fundit mbi qytetin që shkëlqente i ftohtë përpara saj. Dritat nuk dukeshin më si yje, ato tani ngjanin si sy që vëzhgonin. Elira e kuptoi se kjo thirrje nuk ishte thjesht një takim. Ishte një prag. Dhe sapo e kishte kaluar. Çfarëdo që është, nuk mund ta lë pas. Kjo është jeta ime tani…

- Ku duhet të vij? - pyeti ajo, duke përtypur një frymëmarrje të thellë, përpjekje për të ruajtur qetësinë.

- Personeli i sigurisë së Departamentit, - tha, - brenda një ore.

- Merr vetëm sendet personale. Mbaje kokën të qetë, zonja Miller, - tha ai..

Kur mbylli telefonin, Elira u ul në karrigen e verandës, duke ndjerë peshën e çastit. Shiu i rrëmbyeshëm binte ende jashtë, por tani pikat e shiut dukeshin të ngadalësuara, sikur koha e kishte marrë frymë. Zemra i rrihte fort, por vendosmëria po lindte brenda saj. Ky është momenti kur jeta ime nuk është më vetëm imeja. Çfarëdo që të ndodhë, nuk ka kthim pas. Ajo ngriti kapuçin mbi kokë dhe pa u menduar gjatë, nisi të ecte përsëri në rrugët e lagura, drejt një të panjohure që do t'i ndryshonte gjithçka.

"Kemi marrë informacione se jeni bërë objekt interesimi nga një grup i huaj. Duhet të merren masa të reja sigurie. Fama juaj po sjell rrezik."

Elira ngriti kokën drejt qiellit të natës. Fama…i ishte bërë fat. Dhe burg. S'ka vend për shqetësim i thanë aty, por detyra jonë është të informojmë dhe të ruajmë nga gjitha gjërat e mundshme që mund të ndodhin ty……

HYRJA E GAZETARIT AMERIKAN

Uashingtoni po përvëlohej nga një vapë korriku, kur Elira e pa për herë të parë. Ishte pas një paneli mbi të drejtat e njeriut në një sallë të madhe universitare në Capitol Hill. Ajo sapo kishte përfunduar të fliste, me tonin e saj të qartë, të prerë, pa lëvizur shumë duart, kur turma u ngrit në këmbë për ta duartrokitur.

Mes atyre fytyrave që lëviznin si dallgë ngjyrash, një

burrë i gjatë, i veshur me një këmishë blu të lehtë dhe me një dosje nën sqetull, iu afrua me hapa të ngadalshëm, të kujdesshëm.
Flokët i kishte pak të çrregullt, në sytë blu i shndriste një përzierje kurioziteti dhe respekti profesional.
- Elira D., Apo jo?
Ajo u kthye, pak e lodhur nga reflektorët dhe duartrokitjet.
- Po, - tha butë. - Si mund t'ju ndihmoj?
Ai zgjati dorën.
- Unë jam Michael Turner. Gazetar hetimor. 'Uashington Herald'.
- Ju kam lexuar," - tha ajo, duke ia shtrënguar dorën me kujdes. - Dhe unë ju kam ndjekur për javë të tëra. Artikujt tuaj… janë një thesar. Keni ndikuar këtu më shumë se shumë njerëz që jetojnë gjithë jetën në këtë qytet.
Ajo uli sytë pak me modesti.
- Nuk kam bërë gjë të veçantë. Vetëm kam thënë të vërtetën.
- E vërteta është e rrallë, - tha ai me një buzëqeshje të lehtë.
- Dhe ju e bëni të duket e bukur.
Elira ngriti sytë. Për një çast, ajo ndjeu një lloj të ngrohti në gjoks — Jo ndjenja, por kujtim. Kujtimin e dikujt që dikur e kishte parë po ashtu, me sytë e një njeriu që e vlerësonte sinqerisht.
Arbeni…Emri i tij i vinte papritur ndërmend, pa paralajmërim, si një valë e fortë që përplasej mbi brigjet e mendjes dhe tërhiqej vetëm për t'u kthyer sërish. Elira përpiqej ta shkundte atë mendim menjëherë, sikur i

digjte lëkurën nga brenda, por sa herë e largonte, aq më këmbëngulës rikthehej. Ishte bërë si një hije që nuk largohet kurrë plotësisht, si një tingull i largët që vazhdon të dëgjohet edhe kur gjithçka tjetër hesht.

"Pse nuk mund ta harroj?"- mendoi ajo, duke u përpjekur të mbante frymën të qetë, të mos e linte gjoksin t'i shtrëngohej. Ka kaluar kaq shumë kohë, ka ndodhur kaq shumë… Dhe megjithatë, çdo kujtim i tij mbetej i gjallë, i freskët, pothuaj i dhimbshëm në qartësinë e vet, sikur koha të mos kishte kaluar fare. Në mendjen e saj u shfaqën sytë e tij të lodhur, por ende të ngrohtë. Fjala e fundit që i kishte thënë në dhomën e spitalit, e thënë me zë të ulët, thuajse si një lutje. Ai tashmë ishte një ëndërr që e mundonte kudo. Po atë pasdite zhurma e shiut që binte jashtë dritares, ishte monotone dhe e rëndë e bënte këtë të humbur në kujtime dhe të pafuqishme. Të gjitha këto përziheshin me ndjenjat e saj të pafajshme dhe të dhimbshme, duke krijuar një kujtim që nuk kishte formë, por kishte peshë.

"Nuk mund ta lë pas", i tha vetes me zë të ulët, thuajse duke iu frikësuar tingullit të fjalëve. Një dridhje e lehtë i përshkoi trupin. "Nuk mund ta harroj… Sepse një pjesë e imja mbeti atje."

Edhe kur përpiqej të përqendrohej te puna, te fama, te njerëzit që e shikonin me admirim dhe pritshmëri. Emri i tij e ndiqte kudo, si një hije e padukshme që ecte paralel me të. Ishte një kujtesë e dhimbshme se, edhe në mes të suksesit dhe dritës publike. Disa plagë nuk mbyllen kurrë.

Ato vetëm mësohen të mbahen. Prandaj iu bë qejfi nga komplimenti i gazetarit amerikan, por kaq……
Elira u afrua pranë dritares dhe vështroi dritën e zbehur që hynte nga jashtë, duke u përzier me hijet e mbrëmjes. Mori frymë thellë, sikur të kërkonte forcë në ajër. Tani e dinte me siguri: Mund të ecte përpara, mund të ndërtonte një jetë të re, mund të fliste me zë të fortë për botën… Por Arbeni do të ishte gjithmonë një pjesë e saj e pandashme, e pashlyeshme, një zjarr i heshtur që do të digjej përgjithmonë në kujtesën e saj.

NYJA E PARË

Ndërsa turma dilte nga salla, Michael e ndoqi Elirën në korridorin e gjatë të veshur me dritë të bardhë.
- Do të dëshiroja të bisedonim më gjatë. Dua të bëj një profil të plotë për ju. Jo thjesht intervistë… , por tregim. Njerëzit duan të dinë kush jeni.
- Nuk jam gati, - tha ajo me një zë paksa të ulët. Ai u ndal.
- Kushdo tjetër në këtë vend do të ishte i lumtur të kishte qasjen e një gazetarë si unë. Ju jeni e vetmja që s'më thoni 'Po'. Kjo më bën më shumë kureshtar.
Ajo qeshi lehtë, një qeshje pothuaj fëmijërore.
- Unë nuk jam 'kushdo tjetër'.
- E di.- Ai u afrua pak më shumë.- Dhe pikërisht për këtë dua të të njoh.
Në atë moment, Samantha u shfaq nga kthesa e korridorit, si një stuhi e heshtur sigurie.

- Koha për të ikur, - tha ajo me ton profesional, por sytë i flisnin "Kush është ky?"
Michael ngriti duart në shenjë paqeje.
- S'ka problem. Do të flasim.
Ai iku ngadalë, pa e kthyer kokën.
Elira e vështroi ndërsa largohej, por ajo nuk e ndiqte më gjatë me sy.
Në zemër i rëndonte një ëndërr e thyer.

NJOHJA QË NUK BËHET DASHURI

Ditët që pasuan, Michael nisi t'i shkruante email-e, jo invazive, gjithmonë të respektueshme:
"Dua të kuptoj mendimin tuaj mbi tranzicionet politike."
"Si e përjetuat muajin tuaj të parë në SHBA?"
"A do të pranonit një kafe profesionale?"
Elira i përgjigjej shkurt, me korrektësi, pa i lënë hapësirë afërsie.
Për shembull: "Falëminderit, por jam shumë e zënë."
"Ndoshta një ditë."
Një mbrëmje, Laura i tha:
- Duket që ai është i interesuar për ty.
Elira uli duart mbi tastierë.
- Ai është gazetar i mirë.
- Nuk pyeta për punën e tij, - tha Laura duke qeshur me sy. - Ai të pëlqen.
- Jo. Nuk është kështu.
Laura e vështroi me një qetësi të mprehtë.

- Atëherë dikush tjetër është në zemrën tënde.
Elira nuk foli. Nuk deshi. Por sytë e saj u mjegulluan paksa, si mjegulla e Potomac-ut mbi urat e vjetra të Georgetoun-it.

ZEMRA QË NUK SHËROHET

Një mëngjes të ftohtë vjeshte, ndërsa po ecte te Rock Creek Park, erërat e buta të pyllit i prekën fytyrën dhe ajo ndali hapin.
Në mes të gjelbërimit, me dritat e diellit që binin si pika të arta në tokë, ajo mendoi: "Sido që të bëj, zemra ime ka mbetur në Shqipëri. Në një jetë që nuk kthehet më."
Ajo u ul në një stol druri dhe mbylli sytë. Një lot i vetëm, i pathyeshëm, iu rrëshqit në faqe, por nuk ra kurrë. Vetëm ndezi një pikë therëse në zemrën e saj, një kujtesë që nuk donte të shuhej. Michael iu afrua nga larg, duke mbajtur dy filxhanë me kafe në duar. Drita e zbehtë e mbrëmjes i hidhte hije mbi fytyrën e tij.
- Mendova se mund të të gjeja këtu. Mund t'i sjell këto pa pritur, - tha ai me një buzëqeshje të lehtë.
Elira ngriti sytë. Nuk ishte e befasuar. Ai po mësonte ritmin e saj, mënyrën se si ajo e ndiente botën rreth vetes.
- Falëminderit! - tha ajo duke marrë kafenë. Nuk e preku me buzët e saj, vetëm e mori me dorën e saj që dridhej paksa.
Michael u ul pranë, por jo shumë afër, duke respektuar hapësirën e saj.
- Pse nuk më le të afrohem? – pyeti ai.
Zëri i tij i qetë, por edhe i mbushur më ankth, ishte i

drejtpërdrejtë., me një mënyrë të prerë, pa shtrembërime, si të gjithë amerikanët e tjerë.
Elira uli kokën dhe pa duart e saj të mbledhura.
- Sepse nuk dua, - tha ajo, me zë të ulët.
- Ka dikë tjetër? - vazhdoi ai, duke shikuar çdo shprehje në fytyrën e saj.
Ajo heshti gjatë, shumë gjatë. Fletët e pemëve lëviznin lehtë nga era, si duar të padukshme që e shtynin të thoshte të vërtetën që kishte mbajtur brenda.
Më në fund, me një frymëmarrje të thellë dhe një dhimbje të fshehur, ajo tha:
- Po.
Michael mori frymë thellë, ndjeu peshën e fjalës, dhe e shikoi seriozisht:
- Dhe ai është…?
Elira rrëshqiti sytë drejt rrugës së lagur dhe heshti përsëri, duke ndjerë se çdo përgjigje do të ndryshonte gjithçka midis tyre.
- Nuk ka rëndësi, - tha Elira me një zë që dridhej pak nga brenda, jo nga jashtë.
- Nuk është këtu. Ishte pjesë e një jete që nuk kthehet më, por zemra nuk ndryshon kur jeta ndryshon.
Michael uli sytë dhe ftoi një buzëqeshje të hidhur.
- Atëherë unë jam njeriu i gabuar,… në vendin e gabuar… Në kohën e gabuar.
- Jo, - tha Elira. - Je njeri i mirë. Por unë nuk jam e lirë.
Michael u ngrit, e piu kafenë me një gllënjkë të gjatë dhe tha:

- Atëherë do të të respektoj. Dhe do të jem këtu,… si gazetar dhe si mik.
Ai iku ngadalë, duke mos shikuar pas, i mbushur me ndjenjën e dështimit. Nuk foli më.
Ditët kaluan shpejt. Edhe miqësia u forcua, por vetëm miqësi……..
Elira mbeti ulur mes pemëve, ndërsa era përkëdhelte flokët e saj dhe Uashingtoni përreth gumëzhinte si një botë e madhe, e bukur dhe e vetmuar. Mbrëmja kishte rënë butë mbi Uashington. Qyteti kishte një dritë të vetën, Një shkëlqim borxhli ndaj historisë, por me ambicie të një metropoli modern. Pranë lumin Potomac, dritat e urës shkëlqenin në ujë, ndërsa era sillte aromë gjetheve të vjeshtës së vonë. Ata u bënë shokë bashkë.
Elira ecte përkrah Michael-it, kolegut të saj të ri në stacionin televiziv CNN – Uashington National Njuz. Ai ishte ai lloj gazetari amerikan që dukej sikur lindi me mikrofon në dorë: Serioz, i përqendruar, i thjeshtë në komunikim. Qëndrimi i tij i qetë dhe profesional. E ndihmonte Elirën të ndihej më pak e ekspozuar.
- Elira, mos harro, kjo është thjesht një dalje publike rutinë,
- i tha ai me buzëqeshje të qetë.
- Unë e di, - u përgjigj ajo, - Por ky qytet më duket ende i madh, i gjerë… Sikur më vështron. Michael qeshi lehtë.
- Uashington-i është si kamerat tona. Të sheh gjithmonë, por nuk të gjykon. Studioja e CNN ishte e mbushur plot me njerëz.

Kjo ishte hera e parë që Elira do të shfaqej publikisht si autore e segmentit investigativ për Shqipërinë, tranzicionin e saj të dhunshëm dhe vitin e zi 1997. Ndërsa kamerat përgatiteshin, Michael u afrua me një bllok shënimesh në dorë.

- Pra, në intervistë, unë hap debatin dhe ti shpjegon çështjet që ke publikuar te «Le Monde».

- Dakord, - tha ajo, ndërsa përtypte nervozizmin.

Drita kryesore i ra mbi fytyrë. Nuk e kishte harruar kurrë ndjesinë e dritës së fortë. E vetmja dritë që e kishte ndjekur në Shqipëri ishte ajo e makinave që e ndiqnin netëve. Kur segmenti përfundoi, Michael e përshëndeti para kamerave.

- Ishte kënaqësi të punoja me një gazetare kaq të zonjën dhe kaq të guximshme, - tha ai publikisht.

Kaq mjaftoi.

Dhe interneti shpërtheu.

Fotografi të tyre krah për krah, thjesht kolegë, u bënë virale. “Elira & Michael”, “Dynamic Duo”, “Nju Voice from the Balkans”. Ajo nuk ishte mësuar me këtë lloj famë amerikane.

E frikësonte. Jo fama në vetvete, por interpretimet.

Në mbrëmje po kthehej në shtëpinë e saj komode në lagjen e saj. Rrugët e qytetit ishin të qeta, pothuaj të zhytyra në errësirë dhe dritat e shtëpive një nga një shuheshin ngadalë, duke lënë një heshtje të lehtë mbi asfalt. Çdo tingull i këmbëve mbi kalldrëm, i përkiste një bote që dukej si e largët dhe e brishtë. Elira ndjeu atë thikë të zakonshme

të kujtesës, atë ndjesi të dhimbshme dhe të ëmbël që shfaqej kur shikoje dritat e qytetit dhe kuptoje se bukuria e Uashington-it, Lumturia e qetë, rrugët e gjata dhe shtëpitë e ndriçuara, megjithëse reale dhe të arritshme, ishin larg. Shumë larg krahasuar me ç'kishte lënë pas, Me ata që kishte dashur, me kujtimet që nuk e lanë të qetë asnjëherë.

Kur mbërriti në shtëpinë e saj, ndjeu peshën e heshtjes. Ndezi laptopin. Dritat e tastierës i ndriçonin fytyrën në mënyrë të ftohtë dhe të përqendruar. Gazetat online shkruanin për të, për suksesin e saj, për mënyrën se si po ndryshonte perceptimin për Ballkanin. Titujt nuk ishin thjesht emra, ishin vulat e njohjes që i jepnin rëndësi punës së saj:

"Nëna e dëshmisë së re nga Ballkani."

"Zëri që tronditi Evropën."

"Elira, gruaja që i tregoi botës hijet e Tiranës."

Ajo buzëqeshi për një çast, një buzëqeshje të hollë, të matur. Por ajo buzëqeshje iu venit shpejt kur pa një fjalë të vogël në email-in e fundit: Arbeni.

Emri i tij shkëlqeu në ekran, i vetëm, pa shoqërim. Ai nuk kishte dërguar asnjë mesazh të ri, asnjë email. Asgjë nuk kishte ndryshuar. Ishin të gjitha të vjetrat, Një arkiv i heshtur që vazhdonte të gërryente brenda saj. Vetëm emri i tij, i mbetur i pandryshuar në kujtesën e kompjuterit dhe më thellë, në kujtimet që nuk shuhen kurrë, që nuk mund t'i fshish me asnjë klikim. Michael ishte koleg. I respektuar, i qëndrueshëm, një figurë profesionale që ofronte stabilitet

dhe siguri. Por krahas Michael-it, mendimi për Arbenin ishte si një flakë që nuk shuhej; Një kujtim i zjarrtë, i papërmbajtshëm dhe i dhimbshëm. Ishte ai që e kishte lënë të kuptonte se disa njerëz, disa lidhje, nuk mund të fshihen, pavarësisht distancës, suksesit apo njohjes publike.

Elira mbylli sytë për një çast dhe mori frymë thellë. Drita e laptopit qëndronte mbi fytyrën e saj si një pendë që ndriçonte gjysmën e së tashmes dhe gjysmën e së shkuarës. Ajo e dinte se, përkundër suksesit, përfitimeve dhe dritave të Uashingtonit, një pjesë e saj do të mbetej gjithmonë aty ku kishte lënë një copë zemre, aty ku ndjenja për Arbenin mbetej e paprekur, e pa ndryshuar, e zjarrtë si dikur. Por zemra e saj? E mbyllur, e ngurtë, e pathyeshme në një pikë të vetme:

Dr. Arbeni, ai që e kishte dashur, ai që e kishte humbur, ai që ishte zhytur në errësirën e vet. Nuk kishte vend për tjetërkënd.

Të nesërmen, në stacionin televiziv, Michael i troket në derën e zyrës.

- Elira, kanë ardhur ftesa nga tri emisione të mëdha. Dhe… CNN do të bëjë një dokumentar me ty.

Ajo uli sytë.

- Michael, unë… Nuk kam ardhur këtu për famë.

Ai u ul para saj.

- E di. Por tani ti je bërë simbol. Dhe njerëzit duhet të të dëgjojnë. Mendoje si një mënyrë për të mbrojtur ata që nuk mundën të flisnin.

Ajo e pa gjatë.
Vërtet ai nuk kërkonte asgjë.
Asgjë përveç profesionalizmit dhe të vërtetës.
- Në rregull, - tha më në fund.
- Por më jep një garanci.
- Cilën? - pyeti ai.
- Që askush të mos keq interpretojë këtë partneritet.
Michael u shtang, pastaj qeshi.
- Elira, unë jam i martuar me punën time. Dhe ti…, më duket se e ke zemrën diku tjetër.
Ajo u kthye nga dritarja ku shihej obelisku i Uashingtonit Monument që prekte qiellin.
- Po, Michael. Zemra ime nuk është këtu.
Ai e kuptoi menjëherë dhe s'pyeti më.
Në largësinë e qetë të Uashington-it, në xhamin e zyrës moderne, u pasqyrua fytyra e saj e lodhur, e bukur në mënyrë të trishtë, e fortë dhe e brishtë njëkohësisht. Të gjitha bashkë. Amerika i dha famë. Mediat i dhanë zë. Publiku i dha respekt. Por dashuria…Dashuria kishte mbetur e ngrirë në një dhomë të errët, diku në Shqipëri, ku Arbeni luftonte me demonët e mendjes. Dhe askush nuk mund ta zëvendësonte atë vend. As fama. As Amerika. As Michael.

VIZITA NË DEPARTAMENTIN E SHTETI

Mëngjesi në Uashington kishte një dritë të ftohtë, thuajse metalike. Qielli ishte ngjyrë gri e argjendtë, një ngjyrë që

dukej e prerë posaçërisht për ndërtesat zyrtare dhe rrugët e gjera të kryeqytetit amerikan.

Elira qëndronte në trotuarin përballë hyrjes së Departamentit të Shtetit, ndërsa agjenti i sigurimit të saj amerikan, një burrë i heshtur me sy të zinj mbrojtës, ruante hapësirën rreth saj. Jashtë gjithçka ecte ngadalë. Brenda saj, gjithçka po shembej. Ajo mbajti frymën për disa sekonda.

- Jam gati, - tha më në fund.

- Po, zonja Elira. Më ndiqni, - u përgjigj agjenti.

Hyrja e Departamentit të Shtetit ishte madhështore në mënyrën e vet të heshtur. Korridoret e gjera me mure prej guri të hapur ngjanin si labirint diplomatik ku vendoseshin fatet e kombeve të vogla e të mëdha.

Në sallën e pritjes, dy flamuj qëndronin paralel: Ai Amerikan dhe ai i NATO-s. Elira i pa për një çast. Ndjeu një pulsim nervoz. Një kujtesë të asaj dite kur kishte hyrë me vrap në ambasadën amerikane në Tiranë. Këtu gjithçka ishte zyrtare, por ajo mbante ende plagën e frikës.

Michael i afrohet dhe i pëshpërit:

- Sot të gjithë duan të të dëgjojnë, Elira. Mos u shqetëso.

Ajo u thirr përsëri në Departamentin e Shtetit. Por këtë herë, ajo nuk kishte asnjë ide pse. Një ndjesi e çuditshme ankthi iu përhap ngadalë në trup, si një rrufe që ngadalë afron. U ndje e shqetësuar dhe po shikonte rrotull hapsirën e ndërtesës: "Çfarë kanë zbuluar? A kam bërë diçka gabim? A po ndodh diçka që nuk e kuptoj?"

Kur u ul në dhomën e pritjes të madhe dhe të ftohtë, ku dritat

e neonit shndrisnin mbi pllakat e bardha, Ajo ndjeu se në çdo hap të saj ishte vëzhguar. Karriget prej metali kërcitnin dhe shurdhonin çdo tingull të këmbëve të punonjëseve që ecnin nëpër korridor. Edhe ajri i thatë i zyrës mbante erën e kafesë dhe dokumenteve të gërricte fytin, të keqësonte frymëmarrjen.

Ajo mendoi se çfarë mund të ishte. Ishte shqetësuese, por edhe intrigante. Për arsyen që e kishin thirrur në atë mënyrë të shpejtë. Mbase është një informacion i ri për rastin… Ndoshta diçka që lidhet me Arbenin… Ose me njerëzit që e kanë ndjekur gjithë këtë kohë…

Një oficere e ftohtë i afrohet, i jep një biletë me emrin e zyrës ku duhet të shkojë. Elira merr frymë thellë dhe ngre kokën. Zemra i rrihte fort, por hapësira e heshtur dhe qetësia e dhomës e bënë të ndihej akoma më e tensionuar.

"Ky nuk është thjesht një takim… - mendoi ajo. - Çfarëdo që të ndodhë aty, nuk do të jetë e lehtë…"

Pa e ditur ende se çfarë e priste brenda, Ajo nisi të ecte drejt dhomës së zyrtarit. Ndjeu çdo hap si një paralajmërim të fshehtë: Se jeta e saj nuk do të ishte më kurrë normale dhe çdo vendim i saj tani do të kishte pasoja që ajo nuk mund t'i parashikonte.

Ajo qeshi lehtë, një e qeshur e shpejtë që u shua po aq shpejt sa lindi.

"Jam më mirë, kur nuk më shohin shumë sy…" – mendoi edhe pse tani duket e pamundur, sepse vështrimet e shumta e rëndonin, i kërkonin të ishte dikush tjetër. Ndërsa

ajo donte vetëm të mbetej vetvetja, larg gjykimeve dhe pritshmërive. Ata u futën në një sallë të gjatë, të ndriçuar nga drita të buta. Në krye të tryezës ishte Zëvendës sekretarja për Çështjet Globale, një grua rreth të pesëdhjetave, me një vështrim të mprehtë dhe të vendosur.

- Mirë se erdhe në Departamentin e Shtetit, zonja Elira! - tha ajo duke i shtrirë dorën. - E dimë historinë tuaj, e dimë rrezikun që keni kaluar dhe e dimë se zëri juaj ka ndikuar në opinionin botëror.

Elira uli kokën me respekt.

- Jam këtu vetëm për të treguar të vërtetën.

Gruaja e pa drejt e në sy.

- Pikërisht për këtë jemi këtu.

Dosjet u hapën mbi tavolinë. Një hartë e Shqipërisë u shfaq në ekranin e projektorit. Pamje nga dokumentari i NBC-së, kronikat e saj investigative, artikulli i "Le Monde", protestat në Tiranë, deklaratat e Komisionit Evropian.

Zyrtarja flet me ton serioz:

- Artikulli juaj ekspozoi një kapitull të errët të tranzicionit shqiptar. Pasojat e 1997-s, dhuna, rrjetet e krimit… Janë ende plagë të hapura. Kemi parë reagime të mëdha nga Europa. Tani ne po vlerësojmë opsionin e një hetimi ndërkombëtar. Pjesë e tij do të jesh edhe ti, duke na ndihnmuar.

Zemra e Elirës i rrahu fort, por thellë. U qëtesua.

- Nëse më lejoni… - tha ajo me zërin pak të dridhur, - dua që Shqipëria të shihet si vend i shpresës. Nuk dua ta shkatërroj imazhin e atdheut tim. Dua që ai të pastrohet nga e keqja.

Zyrtarja ndaloi për një moment dhe pastaj buzëqeshi butë.
- Pikërisht kjo të bën të besueshme dhe e rëndësishme.
Pas takimit formal, ata lanë sallën dhe ecën drejt një korridori që kishte dritare të mëdha. Nga aty shihej obelisku i Uashington Monument, i ngritur si një shtyllë drite mbi qytet. Michael e vështroi për një çast.
- Të shkojnë këto ambiente, Elira. Je e natyrshme mes tyre…
- Mos e tepro, - qeshi ajo me zë të ulët. - Unë vij nga një lagje e Tiranës, Michael. Kaq thjesht.
- Po ti ke një histori që nuk e ka askush tjetër, - shtoi ai. - Dhe e di që s'ke ardhur këtu për famë. Por fama po të ndjek vetë.
Ajo ndaloi pranë dritares.
Rrezet e diellit pasdite ranë mbi fytyrën e saj dhe shkëlqyen në sytë e saj të lagur. I dha dorën shefes se departamentit dhe iku … Ndërsa po dilnin nga ndërtesa e departamentit të shtetit, ajo i tha bashkëshoqëruesit të vet:
- Michael… Ndonjëherë dua të kthehem. Të shoh mamin, shtëpinë time, të eci në rrugët ku jam rritur. Por… Pastaj më kujtohet gjithçka që kalova. Dhe më kujtohet Arbeni.
Michael nuk foli. Nuk duhej.
- Nuk kam forcë për t'u kthyer ende, - vazhdoi ajo. - Kam frikë se nëse kthehem… Do të shembet gjithçka që kam ndërtuar.
- Atëherë prit. Prit derisa zemra të të thotë se është koha. Ne jemi këtu. Ti nuk je vetëm këtu, Elira.
Ajo e pa gjatë dhe kuptoi se ai fliste si koleg, si mik. Vetëm

kaq. Dhe kjo e qetësoi.
Në dalje të ndërtesës, era e Uashington-it i përplasi flokët mbi fytyrë. Agjenti i sigurimit u afrua menjëherë.
- Makina është gati, zonja Elira.
Ajo u kthye dhe hodhi edhe një herë sytë tek ndërtesa e madhe dhe serioze e Departamentit të Shtetit.
"Sot filloi një kapitull i ri", mendoi, por zemra ime… ende nuk e ka mbyllur atë të vjetrin."
Dhe, ndërsa makina u largua ngadalë mes rrugëve të qeta të kryeqytetit, Elira mbylli sytë, duke ndier peshën e dy botëve:
Botën e famës, dhe botën e plagës që nuk shërohej dot.

LIBRI AUTOBIOGRAFIK DHE LETRA E ARBENIT

Dritat e Uashingtonit binin butë mbi xhamin e madh të dhomës së saj të punës. Jashtë, bora e lehtë e janarit kishte nisur të krijonte një shtresë gri të argjendtë mbi çatitë elegante të lagjes Cleveland Park. Brenda, në tavolinën e bardhë prej druri, laptopi i Elirës ndriçonte faqen e parë të dokumentit të ri, të cilin ajo e kishte titulluar ''Hijet e kryeqytetit të kuq''. Ajo e lexoi titullin disa herë. Nuk ishte thjesht një libër. Ishte kthimi i saj i parë në të shkuarën, por tani me një distancë të ftohtë, klinike. Michael e kishte inkurajuar prej muajsh ta shkruante, ndërsa botuesit amerikanë i kishin dërguar oferta të çmendura.
Por ajo nuk e bënte për famë. E bënte për shërim. Elira mbylli sytë për një çast dhe preku tastierën. Fjala e parë,

pastaj e dyta,… dhe fjalët nisën të rridhnin, si lumi që çan akullin.

"Kam jetuar mes dy botëve: Një Shqipërie që më tronditi dhe një Amerike që më strehoi. Por asnjëra prej tyre nuk më shëroi plotësisht."

Frymëmarrja e saj u ngatërrua, si gjithmonë sa herë i afrohej atij kapitulli të errët të jetës.

Arbeni

I dashuri i saj i vetëm.

Burri që e kishte çuar në qiell dhe pastaj në fund të ferrit, jo nga ligësia, por nga sëmundja. Ai që ishte kthyer, pa dashje, në një rrezik për jetën e saj, edhe pse kurrë nuk do ta donte këtë. Ai që kishte humbur arsyen, ndërsa ajo ishte larguar, duke lënë pas një copë zemre të përhumbur.

Elira shkroi për të me një kujdes që dukej pothuaj dhimbshëm, sikur çdo fjalë ishte një përpjekje për të shpëtuar vetveten, po aq sa për të shpëtuar kujtimin e tij. "Arbeni ishte dashuria e jetës sime. Por dashuria ndonjëherë nuk mjafton për të shpëtuar një shpirt që po fundoset," shkroi ajo, duke ndjerë secilën gërmë si një rënie të vogël të zemrës.

Fjalët rridhnin mbi ekran dhe lotët i ranë pa dashje mbi tastierë, duke bërë që disa të shuheshin me shkëlqim të butë në dritën e dobët të dhomës. Çdo tingull i heshtur i dhomës u mbush me një peshë të padukshme dhimbjeje dhe ajo ndjeu një boshllëk të thellë brenda vetes, si një echo e kujtimeve që nuk donin të hiqnin dorë. Atë çast, telefoni

bëri një tingull të mprehtë, duke e nxjerrë papritur nga mendimet e saj të thella.

"You have a neu email." Fjalët u dukën sikur u shfaqën me zë, duke e paralizuar për një çast. Zemra i rrihte me ritëm të çrregullt dhe ajo nuk mund të parashikonte nëse mesazhi do të sillte ngushëllim apo dhimbje të re. Shkundi lehtë kokën, fshiu lotët me dorën e djathtë dhe mori frymë thellë, duke u përpjekur të qetësohej.

Mes qindra email-eve, një tërhiqte vëmendjen e saj ishte pa titull. Vetëm një adresë e panjohur, e çuditshme. Një ndjesi e çuditshme i përshkoi stomakun: Një miks trishtimi, kurioziteti dhe frike. Zemra iu drodh. Klikoi. Mesazhi ishte i shkurtër. Shumë i shkurtër. Vetëm një skedar i bashkëngjitur: "Letër.pdf."

Ajo hezitoi disa sekonda. Çdo frymëmarrje i dukej e rëndë, si një pritje për diçka që mund të ndryshonte gjithçka. Pastaj e hapi. Në ekran u shfaq një letër e shkruar me dorë. Një shkrim që ajo njihte menjëherë, si gjurmë të shpirtit të tij. Shkronjat e tij kishin atë ritëm të njohur, të papërsëritshëm, që bënte çdo fjalë të dukej si një hapje e hapësirës së brendshme të tij.

Dhe emri i parë që lexoi ishte:

"Elira ime"

Ajo vuri dorën mbi gojë, gati të thërriste, por heshti, i ndjeu gjithë trupin të dridhej, një kombinim i gëzimit dhe dhimbjes që i përplasnin brenda zemrës. Letra vazhdonte: Elira…Një fjalë e thjeshtë, një fillim që e mbante premtimin

e së shkuarës, por edhe një shqetësim të padukshëm për atë që mund të vinte më pas. Një thirrje që nuk ishte thjesht emër, por një vegim i kujtimeve, i ndjenjave të papërmbajtura dhe një mundësie të re, të paparashikuar.
"Po të shkruaj nga vendi ku ti më le dhe ku unë e meritoj të jem derisa të shërohem, ose të mbetem përgjithmonë këtu. Nuk e di nëse kam të drejtë të të shkruaj. Nuk e di nëse do të ma falësh ndonjëherë atë që ua bëra të dyve.
E di vetëm një gjë:
Unë nuk jam më ai që isha.
Mjekët thonë se kam bërë përparime. Por përparimi im nuk të kthen ty tek unë.
E lexova emrin tënd në gazeta.
Të pashë në intervistën tënde në NBC.
Të pashë të buzëqeshje. Ishte një buzëqeshje e lodhur, Elira.
E imja.
E di që nuk të takoj më.
E di që nuk të meritoj më.
E di që zemra jote ka plagë që i shkaktova unë, por dua vetëm të dish…Unë jam krenar për ty. Ti e çove të vërtetën përpara botës.
Ajo të vërtetë që unë s'e mbroja dot as veten time.
Nëse ky është mesazhi i fundit që dërgoj, dua ta dish:
Të kam dashur. Të dua ende dhe nuk ka ditë që nuk më mungon.
Arbeni"
Elira e la telefonin të binte mbi tavolinë. Tingulli i goditjes

i theu heshtjen e dhomës. Koka i ra mbi duar, dhe për herë të parë, lotët nuk mundi t'i ndalonte më. Ajo e ndjeu çdo pikë loti si një dridhje që shkatërronte mbrojtjet që kishte ngritur rreth vetes.

- Oh, Arben… - pëshpëriti, zëri i saj u shua mes fishkëllimës së ngrohtë të kaldajës dhe zhurmës së dobët të kondicionerit që po ngrohte në qoshe. Ishte si të hapej një plagë që sapo ishte mbuluar, por që kurrë nuk ishte shëruar vërtet. Dhimbja ishte e njohur dhe e huaj njëkohësisht, një kombinim i mungesës së tij dhe kujtimeve që s'kishin pushim. Frymëmarrja i bëhej e vështirë dhe çdo goditje e zemrës sillte me vete kujtimin e të gjitha asaj që kishte humbur, por edhe atë që ende donte të mbante gjallë.

Ajo qëndroi aty, e mbërthyer nga një heshtje e rëndë, ndërsa dhoma përreth saj dukej tërësisht e braktisur. Vetëm tingulli i akrepave të orëve të saj dhe fishkëllima e kaldajës mbushnin hapësirën, duke bërë çdo kujtim më të gjallë, e mungesën e tij më të thellë. Ndërkohë u dëgjua një trokitje e butë në derë. Michael futi kokën brenda.

- Elira… je mirë? - Ajo fshiu shpejt fytyrën. - Po… vetëm po shkruaj.

Ai e pa për një sekondë të gjatë, pastaj tha:

- Ne do të shkojmë në Capitol Hill nesër. Do të flasësh para komisionit për çështjet e sigurisë. Bota po të dëgjon, Elira.

Ajo e uli shikimin.

- Po, bota më dëgjon…

- Po ti kë? - e ndërpreu ai butë.

Ajo u kthye ngadalë nga kompjuteri, ku letra e Arbenit ende ndriçonte në ekran. Një dritë e zbehtë që dukshëm nuk dëshironte të shuhej. Ishte sikur çdo germë që kishte shkruar ai të ishte ende gjallë, duke e kapur për zemre dhe duke i sjellë kujtime që nuk e lejonin të qetësohej.
- Disa zëra nuk i shuan dot as Amerika, Michael… - tha ajo, me zërin e saj të ulët duke u tretur mes hapësirës së heshtur. Ishte një thirrje për të kuptuar, por edhe një konfesion i dhimbshëm që s'kishte ku tjetër të shkonte.
Michael qëndroi për një çast i ngrirë, duke e vështruar pa fjalë. Pas pak, ai doli në heshtje, pa bërtitur, pa kundërshtuar, si një figurë e qetë në mes të një stuhie që vetëm ajo e ndjente. Dhoma mbeti e qetë, por ajri dukej i rëndë, i mbushur me mungesë dhe me kujtime që nuk shuheshin dot.
Ajo rrinte aty, duke u përpjekur të përtypte secilën fjalë, çdo ndjesi të mbetur në gjurmët e Arbenit dhe duke kuptuar se disa plagë nuk shërohen kurrë, pavarësisht largësisë apo heshtjes. Elira e mbylli laptopin ngadalë, si të mbyllte një kapitull që nuk donte ta hapte vërtet, por nuk mund ta mbyllte as përgjithmonë.
Letra qëndroi aty, si një flakë e vogël që nuk fiket kurrë.
Dhe ajo e dinte: dashuritë e mëdha nuk vdesin. Ato thjesht mbeten të ngrira, duke pritur… një ditë.

DIPLOMATI SHQIPTAR

Mbrëmja kishte rënë mbi Uashington dhe rrugët rreth Massachusetts Avenue ishin kthyer në shtigje të heshtura,

ku vetëm dritat e ambasadave shndrisnin si ishuj të vegjël diplomatikë. Elira ecte me hap të matur, e shoqëruar nga dy agjentë të sigurisë amerikane, ndërsa zemra i rrihte pa qetësi.

Michael i kishte thënë atë mëngjes:

- Ambasada shqiptare ka kërkuar të të takojë. Kanë dërguar një diplomat të lartë nga Tirana posaçërisht për ty. Kjo e kishte bërë Elirën të ndiejë një therje të fortë frike në stomak. Shqipëria… e ndillte, por edhe e trembte. Në hollin e brendshëm të ndërtesës së ambasadës, aromë kafeje dhe tapeti të ri duket sikur i përshëndeti në mënyrën më të çuditshme të mundshme, aty gjeti një përzierje shtëpie dhe ankthi, sepse iu kujtua Tirana dhe ato që hoqi atje.

Në fund të korridorit, një burrë shtatmesatar, rreth të pesëdhjetave, me flokë të thinjur dhe sy të lodhur, po priste në këmbë.

- Zonja Elira, - tha ai duke u përkulur lehtë. - Jam Ambasador Mentor Kodra, i dërguar nga Tirana për çështjen tuaj. Ai i shtriu dorën me një respekt të ftohtë diplomatësh. Elira u afrua.

- Faleminderit që erdhët! Nuk prisja që Shqipëria… Të më kërkonte.

- Shqipëria është e ndarë, zonja Elira, — tha ai qetë. - Disa ju konsiderojnë tradhtare, disa ju konsiderojnë shpëtimtare. Në të dyja rastet… Ju nuk mund të injoroheni.

Ai e ftoi të ulej në një sallon të vogël, të ngrohtë, me perde të renda të kuqe dhe një tryezë të ulët druri mes tyre. Agjentët amerikanë qëndruan te dera. Ambasadori nuk humbi

kohë— Në Tiranë, pas intervistës suaj në NBC dhe artikullit në "Le Monde", ka nisur një stuhi politike. Disa kërkojnë reformë të thellë, disa duan të mbyllin çështjen. Por qeveria ka frikë se ju do të vazhdoni publikimet. Prandaj jam këtu. Elira ngriti vetullat, vështrimi i saj i qartë sfidoi heshtjen që pasoi.

- Po unë nuk jam këtu për politikë.

Ai e pa drejt, sikur donte të depërtonte përtej mburojës së saj.

- Çfarë doni, atëherë?

Pyetja që ajo kishte mbajtur brenda për muaj të tërë shpërtheu më në fund:

- Dua…, dua që Dr. Arbeni të rehabilitohet. Dua që shteti shqiptar të tregojë kujdes për të. Dua që mjekët më të mirë të angazhohen. Dua që emri i tij të mos përdhoset. Ai nuk është kriminel. Ai është i sëmurë.

Ambasadori u step. Mbylli sytë për një moment, sikur të përgatiste fjalët e vështira që duhej të thoshte. Tingulli i heshtjes u zgjat mes tyre, çdo sekondë duke rënduar mbi dhomë.

- Dr. Arbeni është një rast i ndërlikuar, - tha ai më në fund.

- Dosja e tij është voluminoze. Ka shumë faktorë… Shumë ndikime. Shumë sy mbi të.

- Ai është njeri, - ia ktheu Elira me tone të ulëta por të forta, çdo fjalë ishte si një gur mbi tryezë. * Ai ishte i sëmurë. Doni apo- jo, është viktimë e një shoqërie shqiptare që nuk e trajton shëndetin mendor siç duhet. Dhe unë jam gjallë

falë tij. Ai më mbrojti,… përpara se të humbiste mendjen.
Ambasadori heshti gjatë. Sytë e tij shfletonin mendimet e brendshme, duke u përpjekur të peshojnë rrugën më të sigurt, më të pranueshme për qeverinë dhe politikën. Pas disa çastesh, foli me zë të ngurtë:
- Zonja Elira, kërkesa juaj nuk është e thjeshtë. Rehabilitimi i tij kërkon një vendim politik. Dhe në Shqipëri,… çdo vendim është një luftë.
Elira e ndjeu peshën e fjalëve, por nuk u tërhoq. Zemra i rrihte fort, jo nga frika, por nga vendosmëria. Ajo e dinte që kjo nuk ishte thjesht një betejë për një individ, ishte një betejë për drejtësi, për dinjitet, dhe për të treguar se edhe ata që sëmuren nuk duhet të harrohen, nuk duhet të përdhosen.
- Nëse nuk guxoni të luftoni për të… - tha ajo, dhe heshtja që pasoi ishte më e fortë se çdo kërcënim - Atëherë kush do ta bëjë? Atëherë luftoni, - tha ajo butë, por me një vendosmëri që e drodhi ajrin.
Ai e vështroi gjatë, pastaj modifikoi tonin.
- Ka diçka që duhet ta dini. Dr. Arbeni ka filluar të stabilizohet. Mjekët në Tiranë raportojnë përmirësime të vogla, por të qëndrueshme. Ai ju ka kërkuar ju.
Zemra e Elirës pushoi për sekonda.
- Më ka… kërkuar mua?
- Po. Dhe letra që morët… - Ambasadori uli zërin. - Ka kaluar në disa duar, përpara se t'ju mbërrinte. Nuk e dërgoi vetëm ai. Dikush në staf e ka lejuar të dalë jashtë sistemit.

Elira ngriti kokën.
- Pse?
Ambasadori në vend të përgjigjes tha:
- Sepse ka njerëz në Shqipëri që duan të shohin drejtësi. Edhe kur politika i lidh duart.
Pastaj ai u përkul përpara, e me shikim serioz foli:
- Elira… Nëse ju, publikisht, kërkoni rehabilitimin e tij, kjo do të ndikojë shumë. Askush nuk mund të ju kundërshtojë. Ju jeni fytyra ndërkombëtare e këtij rasti. Zëri juaj do të ketë peshë.
Ajo e shikoi në sy, e shqetësuar, e lënduar, por e qartë në vendim.
- Atëherë unë do ta bëj.
- Jeni e sigurt?
- Po. E kam borxh. - tha ajo me zë të qetë, por të vendosur.
- Kujtdo që të kem dashur ndonjëherë, i jam borxhli të vërtetës.
Fjalët ranë në heshtje, por mbushën dhomën me një peshë të padukshme. Nuk ishte thjesht një premtim; Ishte një betim i brendshëm, një përgjegjësi që nuk mund ta shmangte më, edhe pse e dinte se rruga përpara nuk do të ishte e lehtë. Ambasadori u ngrit në këmbë, i gjatë dhe i rreshtuar si një figurë e paprekshme. Sytë e tij dukej se gërmonin çdo mendim të fshehur pas fjalëve të saj. Një heshtje e rëndë mbushi dhomën, ndërsa çdo sekondë dukej se përshpejtohej, duke ndjerë rrahjet e zemrës së tyre si një alarm të padukshëm.

- Atëherë përgatituni. - tha ai, zëri i tij i fortë duke lëvizur si një valë e ftohtë. - Shqipëria do të tronditet sërish.

Ajo e kuptoi menjëherë se ky nuk ishte vetëm një paralajmërim politik, por një parathënie e fatit të saj dhe e atyre që donte. Një detyrë që mbante mbi supe, një stuhí që po afrohej, dhe një e vërtetë që nuk mund të shtyhej më. Dhoma, për një çast, u duk e ngushtë, pothuajse e pamjaftueshme për të gjithë tensionin që mbushte ajrin — Një tension i krijuar nga çdo frymëmarrje e saj, nga çdo fjalë e thënë me përkujdesje nga ambasadori. Çdo heshtje pasonte një tingull të padukshëm që dukej se rëndonte mbi supet e të pranishmëve. Në dalje, Michael e priti, me sy që përpiqeshin të lexonin në fytyrën e saj çdo ndjenjë të fshehur.

- Si shkoi?

Elira shikoi qiellin e natës, ku hëna varej e plogët mbi kupolat e ambasadave.

- Tani fillon stuhia e vërtetë, - tha ajo.

- Dhe ti? Je gati?

Ajo mbylli sytë, kujtoi fytyrën e Arbenit në vitet e bukura, buzëqeshjen e tij të pastër, premtimin që i kishte bërë dikur: "Të dua deri në fund."

- Unë jam gati për të, - tha me një zë të qetë. Dhe Uashingtoni, i ftohtë dhe i gjerë, dukej sikur i njihte fjalët e saj. E pranoi ndihmën që ajo po i jep doktorit.

SHQIPËRIA REAGON

Kur lajmi u transmetua globalisht: "Gazetarja shqiptare Elira kërkon publikisht rehabilitimin e Dr. Arbenit, ish-mjekut të njohur, i cili u përball me probleme të rënda mendore pas tragjedisë së 1997-s," Një valë tronditjeje mbuloi Shqipërinë.

Tirana, qyteti që Elira e kishte lënë, nuk dukej më e njëjtë për askënd. Ndërtesat e qeverisë, të ndriçuara nga dielli i pasditeve të janarit, dukeshin më të rënda, më të vjetra, si të mbingarkuara nga kujtesa kolektive. Në sallën e shtypit, gazetarë dhe kameramanë u grumbulluan me mikrofonë dhe aparate, duke e bërë presionin e parë mbi qeverinë. Zyra e Kryeministrit, ndërkohë, ishte e mbushur me tension.

Një këshilltar politik i qetësoi kolegët.

- A keni parë lajmin? Elira e Uashingtonit kërkon rehabilitimin e Arbenit!

- Po, - tha kryeministri me fytyrë të ngrysur. - Ai rast ka qenë i ndjeshëm për vite. Tani… po del në nivel ndërkombëtar.

- Kjo do të krijojë presion të madh mbi institucionet tona, - shtoi një tjetër. - Jo vetëm opinionin publik, por edhe Komisionin Evropian dhe Departamentin e Shtetit janë interesuar.

Kryeministri rrëshqiti dorën mbi tryezë.

- Duhet të veprojmë me kujdes. Nuk mund ta injorojmë. Por as nuk mund ta shohim këtë si shenjë dobësie.

Reagimi i medieve shqiptare ishte menjëherë i ndarë.

Në një studio televizive, gazetari i njohur i RTSH-së diskutonte:
- Ky është një rast që do të shënojë historinë e medias shqiptare. Elira kërkon që Dr. Arbeni. Një figurë shumë e diskutuar, të rehabilitohet. A duhet ta bëjë shteti këtë hap?
Një eksperte e shëndetit mendor shtoi:
- Nuk bëhet fjalë vetëm për politikë. Është një çështje humane. Ai ishte viktimë e kushteve dhe ngjarjeve të 1997-ës.
Ndërsa disa politikanë deklaruan se kërkesa e saj ishte provokative. Pjesa tjetër e opinionit publik filloi të shkruante në rrjete sociale:
"Elira ka të drejtë!"
"Dr. Arbeni meriton shërim dhe respekt."
"Është koha për drejtësi humane, jo politike."
Një mbështetje masive nisi të krijohej në internet, duke bërë presion mbi qeverinë shqiptare dhe institucionet. Ndërsa lajmi përhapej, Elira qëndronte në shtëpinë e saj në Uashington. Dritat e qytetit ndriçonin fytyrën e saj të lodhur, të bukur, por të tensionuar. Ajo mbante në dorë laptopin dhe shikonte faqen e mediave shqiptare. Fjalët dhe komentet ishin të shumta, të ndryshme, por ajo i njihte të gjitha. Zemra e saj rrihte fort, jo për famën, por për shpresën se Arbeni mund të shpëtohej.
- Michael… - tha ajo duke u kthyer ngadalë nga ai, me një frymëmarrje të thellë që i dridhej në krahëror. - Shqipëria ka reaguar. Zërat janë ngritur, institucionet janë vënë në

lëvizje. Nuk do të jetë e lehtë… As për ty, as për mua.
Për një çast, heshtja u shtri mes tyre si një mur i padukshëm. Michael e vështroi me qetësi, me atë qetësi që nuk vinte nga mungesa e frikës, por nga pranimi i saj. Sytë i qëndronin të palëkundur, sikur tashmë e kishte bërë paqe me pasojat.
- Por është e drejtë, - tha më në fund, me një zë të ulët, por të vendosur. - Ti po bën atë që askush tjetër nuk guxoi ta bëjë. Dhe ndonjëherë, e vërteta kërkon më shumë se kurajë… Kërkon sakrificë.
Ai u afrua një hap më pranë, jo për ta bindur, por për ta mbështetur.
- Historia nuk ndryshohet nga ata që heshtin, - shtoi. - Ajo shkruhet nga ata që pranojnë të paguajnë çmimin.
Elira mbylli sytë dhe i shpërtheu një mendim:
"Nëse kjo nuk e shpëton, asgjë nuk do të shpëtojë zemrën time."
Në këtë mënyrë, presioni publik dhe ndërkombëtar filloi të ndikojë mbi qeverinë shqiptare. Pas disa ditësh, ministria e shëndetësisë njoftoi formimin e një komisioni për rehabilitimin e Dr. Arbenit, duke hapur rrugën për një vendim që mund të shpëtonte një jetë dhe të mbyllte plagën e së kaluarës.

JETA NË UASHINGTON DHE ZEMRA TEK ARBENI

Uashingtoni ishte kthyer në shtëpinë e saj të re. Rrugët e gjera me drurë të mbuluar me borë, dritat e monumenteve që ndriçonin natën, u bë vendi ku Elira ecte çdo mëngjes

për të shkuar në punë në stacionin televiziv CNN. Ajo ishte tashmë pjesë e ekipit kryesor, një figurë e njohur, respektuar dhe e kërkuar nga gazetarët për opinione mbi Ballkanin.
Por, megjithë famën dhe suksesin, zemra e saj rrihte gjithmonë në një vend tjetër: Dr. Arbeni.
Në studio, Ajo fliste me qetësi dhe siguri para kamerave. Publiku amerikan e donte. Ishte folësja e bukur nga Shqipëria, që rrëfente për demokracinë, tranzicionin, bandat dhe errësirat e vitit 1997. Çdo fjali e saj ishte e matur, e fortë, e bindshme.
- Ju jeni e njohur tani, - i tha Michael një ditë në punë. - Shumë amerikanë ju ndjekin.
- Po, - u përgjigj ajo me një buzëqeshje të lehtë. - Por ata nuk ndjekin historinë time të vërtetë.
- Dhe cila është ajo? - pyeti ai, me kuriozitet.
Elira heshti. Sytë e saj u humbën drejt dritares, ku lumi Potomac shkëlqente si argjend.
- Zemra ime është larg, - tha thjesht. - Diku në Shqipëri.
Michael e kuptoi menjëherë. Nuk pyeti më. Jeta në shtepinë e saj moderne dhe të rehatshëm dukej e qetë. Lagjja e saj ishte një botë e sigurt, plot kafene dhe librari të vogla, me erë të pastër dhe shëtitje të gjata. Por çdo natë, pasi dritat u shuan dhe qyteti ra në heshtje, Elira mbyllej në dhomë, hapte laptopin dhe ndiente mungesën e Arbenit. Kujtimet e tij, buzëqeshjet, fjala e ngrohtë rridhnin brenda saj si një lumë i pakthyeshëm. Ajo shkruante rreshta të reja për librin autobiografik, për çdo ndodhi të dhimbshme dhe për çdo

ditë që kishte kaluar larg tij. Por letra e fundit e... Arbenit, e mbajtur në një kuti të vogël mbi tavolinë, ishte gjithmonë aty: Një kujtesë e dhimbshme dhe e ëmbël njëkohësisht. Shumë kolegë amerikanë vinin për kafe ose drekë. Ata e shikonin Elirën si model. Por askush nuk mund të zëvendësonte hapësirën që Arbeni kishte lënë në zemrën e saj.

Nuk kishte romancë të re. Nuk kishte ngacmime. Vetëm kujtimi i tij dhe mendimi se ndoshta një ditë ai mund të ishte stabil dhe i lirë i liruar nga tmerri i shëndetit të tij mendor, se dhe mund të bashkoheshin ,…

- Ndonjëherë mendoj se nuk do të jem kurrë e lumtur plotësisht, - tha ajo një mëngjes në zyrë me Michaelin, ndërsa shikonte rrugët e qytetit nga dritarja.

- Dhe pse? - pyeti ai.

- Sepse zemra ime nuk ka ndryshuar vend. Nuk mund të gjej qetësi këtu… Kur ai nuk e ka ende.

Michael u hesht, duke e kuptuar. Nuk kishte asgjë për të thënë. Vetëm heshtja e madhështishme e Uashingtonit, lumi që rridhte i qetë, dritat që shkëlqenin mbi monumente… Edhe zemra e Elirës që mbetej e lidhur tek një kujtim, tek një dashuri që nuk mund ta harronte.

Jeta vazhdoi. Ajo mbante intervista, botonte artikuj, punonte për segmentet e saj. Uashington-i ishte mikpritës dhe i madh. Por çdo moment e përplaste fytyrën e Arbenit në mendje: Të qeshurat e tij, shikimin, frymën që ndante me të gjatë ditëve të vështira.

- Dikur do të vijë koha… - pëshpëriti një natë, duke parë hënën mbi rrugët e qeta. Dhe atëherë do ta gjej qetësinë e vërtetë.
Deri atëherë, fama, suksesi dhe dritat e Uashington-it ishin vetëm hije të largëta të një jete që ajo ende nuk e ndiente plotësisht të vetën. Zemra i përkiste vetëm Arbenit. Dhe kjo nuk ndryshonte asgjë.

LAJME NGA SHQIPËRIA

Pasditja në Uashington kishte rënë qetë mbi rrugët e qytetit. Dritat e monumenteve të famshme ndriçonin si pika të çuditshme mbi një tapet gri. Elira ulur pranë dritares së madhe të apartamentit të saj, me një gotë çaji të ngrohtë, ndjente një qetësi të brendshme që vinte e ndërthurur me pritje dhe ankth.
Papritmas, telefoni i saj bëri tingullin e njohur. Një email nga Ambasada Shqiptare në Uashington. Zemra i rrihte fort. Ajo e hap pa hezitim. Subjekti: Përditësim mbi dr. Arbenin Dërgues: Ambasada e Shqipërisë. Ajo filloi të lexonte: Zonja Elira,
Komisioni për rehabilitimin e Dr. Arbenit ka raportuar përparime të qëndrueshme. Ai është nën mbikëqyrje mjekësore të specializuar dhe tashmë ka filluar të tregojë shenja stabiliteti.
Mjekët konfirmojnë se ai mund të fillojë proçesin e rikthimit gradual në jetën publike dhe të marrë pjesë në konsultime për pacientë të tjerë me probleme të ngjashme.

Sapo të jeni gati, mund të koordinoni një vizitë të sigurt për ta takuar.
Me respekt,
Ambasada e Shqipërisë Elira u ngrit ngadalë, të dridhurat i kaluan trupin. Lotët i ranë natyrshëm mbi faqet e saj. Ishte lajmi që kishte pritur me muaj. Ai ishte gjallë dhe kishte filluar të shërohej. Çdo frymëmarrje e tij, edhe pse ende e rënduar, ishte një dëshmi se rreziku kishte filluar të tërhiqej. Drita e zbehtë e dhomës binte mbi fytyrën e tij, ku lodhja dhe dhimbja bashkëjetonin me një shenjë të qartë jete.
- Michael… - e thirri ajo, duke hedhur një hap drejt tij. Zëri i saj ishte i ulët, i dridhur, i mbushur njëkohësisht me frikë të mbetur dhe me lehtësimin e atij çasti të rrallë kur shpresa nuk është më vetëm një dëshirë. Ai u kthye menjëherë, i shqetësuar, sikur ta kishte ndjerë dridhjen e saj përpara se ta dëgjonte. Sytë iu ngulën tek ajo, të vëmendshëm, kërkues.
- Çfarë ndodhi? - pyeti, me një ton që përpiqej të ishte i qetë, por që nuk e fshihte ankthin.
- Ai… po përmirësohet, - tha ajo, me sytë plot lot. - Ai… mund të bëhët të takohet përsëri. Michael… Mund të shkoj ta takoj.
Ai heshti për disa sekonda, duke matur fjalët. Pastaj tha:
- Është e rrezikshme, por gjithashtu e drejtë. Nëse mendon se duhet, unë do të të ndihmoj të organizosh gjithçka.
Elira mori frymë thellë. Të gjitha frikërat, kujtimet e dhimbshme dhe dashuria e papërmbajtur për Arbenin shpërthyen brenda saj si një stuhi e heshtur.

- Nuk mund të qëndroj më këtu duke ditur se ai… po lufton vetëm, - tha ajo me vendosmëri.
- Ai duhet të shohë se nuk e kam harruar. Nuk mund të pranoj që të gjithë këta muaj të kalojnë pa e parë fytyrën time.
Një plan filloi të formësohej në mendjen e saj. Ajo do të udhëtonte fshehurazi, duke shmangur vëmendjen e mediave dhe presionin e paparashikueshëm të politikës. Michael do të ndihmonte me sigurinë dhe koordinimin. Ajo nuk dëshironte lajme, vetëm një takim privat, një takimi ku zemrat e tyre mund të shihnin njëri-tjetrin pa pengesa.
- Do të shkoj, - përsëriti ajo, duke e shtrënguar laptopin pranë gjoksit. - Nuk mund të pres më.
Michael e pa gjatë. Nuk kishte nevojë për fjalë. Ai e kuptoi gjithçka.
Jeta në Uashington do të vazhdonte: Punë, intervista, librin e saj që po shkruante, fama që e ndiqte kudo. Por tani, një detyrë më e rëndësishme e thirri: Të ishte pranë tij. Dhe ndërsa dritat e qytetit ndriçonin mbi rrugët e heshtura, Elira përjetoi një përzierje emocionesh: frikë, shpresë, dashuri dhe vendosmëri. Zemra e saj kishte vetëm një destinacion: Shqipëria dhe Dr. Arbeni.
Dashuria e humbur nuk zhduket kurrë. Ajo veç zhvendoset brenda nesh si një dhomë e mbyllur, ku ende merr frymë kujtimi i dikujt që s'është më pranë. Njerëzit thonë se koha shëron, por koha nuk shëron asgjë. Ajo vetëm na mëson si ta mbajmë dhimbjen pa u rrëzuar. Dashuria e vërtetë nuk

vdes. Ajo rri pezull sipër nesh si një re që nuk bie kurrë shi, por nuk largohet asnjëherë. Ne vazhdojmë të jetojmë, të qeshim, të punojmë, por thellë brenda vetes mbajmë një dritë që i përket dikujt tjetër, një dritë që nuk fiket edhe kur shpirti lodhet. Dashuria e Elirës për Arbenin ishte pikërisht ajo dritë, një zjarr i heshtur që nuk kërkoi kurrë shpërblim. E humbur në këtë botë, por e gjallë në brendësi të saj. Ndoshta ky është fati i të gjithë dashurive të mëdha. Ato nuk mbarojnë, ato thjesht jetojnë në një vend ku s'mund të preken, por mund të ndihen. Dashuria e humbur është prova se zemra jonë ka ditur të dojë me gjithë forcën e saj, edhe kur jeta na detyron të ecim vetëm.

Rënia e kryeqytetit të kuq

Ishte javë që policia merrte ankesa nga lagje të ndryshme: Njerëz të maskuar, hije që shfaqeshin natën, makina që lëviznin pa targa, silueta që fshiheshin nëpër hyrje pallatesh. Fillimisht asnjë nuk i mori seriozisht — Shqipëria kishte parë shumë çudi. Por ankesat u bënë aq të shumta sa u desh ndërhyrja e një oficeri me përvojë.

Kapiten Ardit Hoxha, burrë i qetë dhe i ftohtë në vendimmarrje, mori dosjen në dorë. Ai ngriti sytë nga raportet e turnit të natës dhe tha:

- Këtu ka diçka më shumë se thjesht vandalizëm. Më sillni listën e kamerave të zonës dhe verifikoni çdo raport të orëve të vona. Të nesërmen në mëngjes, ai kishte tashmë një skemë të qartë: Të gjitha incidentet ndodhnin pranë vendeve ku kishte kaluar Elira — Rruga drejt punës, kafeneja ku pinte

kafen e mëngjesit, dyqanet ku blinte ushqime, qendra ku takonte njerëz të mediave.
- Nuk është rastësi, - pëshpëriti Arditi, duke parë me imtësi hartën.
Shënimet çonin në një emër që nuk e priste: Dr. Arben… Shtëpia e Arbenit ishte e heshtur, e errët, sikur kishte vite që askush s'kishte jetuar aty. Policia hyri me proçedurë standarde. Arditi hapi dritaret. Një erë e rëndë, e stërlodhur u përhap në dhomë.
- Zoti kapiten… - thirri një polic nga dhoma e pasme. - Duhet të vini ta shihni këtë.Në mur ishte një panel i madh, krejtësisht i mbuluar me fotografi të Elirës. Disa ishin të shkrepura nga larg, disa nga fare afër, disa të përpunuara me shënime të kuqe. Një polic tjetër solli një kuti të madhe kartoni.
- Dosje të plotë, kapiten. Data, orare, vendndodhje… Ka ndjekur çdo hap të saj. Arditi mori një nga fletrat. Ishte një hartë e Tiranës, me rrugë të shënuara me laps të kuq, segmente të rrethuar, pika të zeza për lokalet dhe vendet ku Elira kishte qëndruar.
Ai uli kokën ngadalë, sikur i rëndoi diçka në gjoks.
- Ky njeri… - tha me zë të ulët.
- Po, kapiten… - tha polici. - Ishte i fiksuar.
Pastaj gjetën edhe diçka tjetër.
Një truprojë e spitalit psikiatrik doli para Arditit në korridorin e errët të shtëpisë dhe i tha:
- Kapiten… Arbeni ka jetuar me muaj në pavionin e

izolimit. Qante ditë e natë. Fliste me veten… Fliste për Elirën. Mbante në dorë fotografinë e saj edhe kur merrte mjekimet. S'e hoqi kurrë nga zemra, as kur s'ishte më i kthjellët. - Arditi mori frymë thellë. - Pra, e donte me të vërtetë,… por ishte i sëmurë rëndë.

Truproja pohoi me kokë.

- Dashuri e pamatur, kapiten. S'mund ta kontrollonte.

Arditi lëvizi ngadalë ndër këto prova, me dilemë të thellë: Ishte kriminel apo viktimë? Të gjitha provat e akuzonin… Por gjithçka në atë shtëpi tregonte se nuk ishte i vetëdijshëm për veprimet e tij

Gjurmët e "Hijeve të Kuqe"

Era e mëngjesit i përplasi lehtë perdet e zyrës së Kapiten Ardit Hoxhës. Ai qëndronte përballë tavolinës së mbushur me dosje, ndërsa drita e zbehtë e dimrit binte mbi hartën e qytetit. Rrathët e kuq, të vizatuar nga Arbeni në atë mur të çmendurie, tani dukeshin edhe më shqetësues: Ato përputheshin me incidente reale.

- Zoti kapiten, - tha një oficer i ri, duke mbajtur një tablet në dorë, - Kemi analizuar kamerat pranë lagjes "Ali Demi". E njëjta siluetë është parë disa herë. Po e krahasuam me pamjet e natës së kaluar në "Bllok".

- A përputhen? - pyeti Arditi pa e ngritur kokën.- Po, kapiten. E njëjta ecje, e njëjta mënyrë lëvizjeje.

Arditi preu shkurt:

- Janë njerëzit e "Bac Dhelprës", - tha ai me zë të ulët, por të prerë, sikur çdo fjalë të ishte peshuar me kujdes. - Arbeni

nuk ka punuar vetëm. Ai ishte thjesht një vegël, një hallkë e vogël në një zinxhir shumë më të gjatë. Një heshtje e rëndë ra në zyrë. Ajri u trash, sikur muret vetë po dëgjonin. Oficerët u panë mes tyre, shkëmbyen shikime të shpejta, të ngarkuara me dyshim dhe shqetësim. Askush nuk foli për disa sekonda, por të gjithë e kuptuan se çfarë nënkuptonte emri që sapo ishte përmendur.

- Çfarë ka të re për të? - e theu heshtjen Arditi, duke u mbështetur lehtë mbi tavolinë. - Për Bacin.

Një nga shefat e sektorit të inteligjencës u përkul përpara. Hapi ngadalë një dosje plastike, dhe tingulli i letrave që u ndanë nga njëra-tjetra u dëgjua qartë në qetësinë e dhomës. Brenda saj kishte raporte, fotografi dhe shënime të shpejta, të mbledhura prej muajsh.

- Kemi lëvizje, - tha ai më në fund, duke ngritur sytë nga dosja. - Jo shumë të dukshme, por të mjaftueshme për të kuptuar se Bac Dhelpra nuk është zhdukur. Përkundrazi… Ai po përgatitet.për të ikur, besoj në azil..diku.

- Ka dalë nga Shqipëria në mënyrë të paligjshme. Me dokumente false. Ka hyrë në Turqi dhe ka kërkuar azil politik. Shteti turk po e shqyrton kërkesën.

Arditi fërkoi mjekrën.

- Normalisht. Kriminelët bëhen engjëj sa kalojnë kufirin. Më vonë atë ditë, Arditi u kthye te shtëpia e Arbenit. Dera ende ishte e hapur, ashtu si e kishin lënë ekspertët. Qetësi e frikshme. Aroma e lagështisë dhe e ilaçeve të spitalit dukej sikur ishte ngulitur në ajër. Në tavolinën e kuzhinës

gjeti një fletore, të grisur përgjysmë. Përmbante fjali të çakorduara, të shkruara me dorë dridhur: “Elira nuk duhet të ketë frikë…”“Elira është e bukur… e pastër… Mos më harroni… Unë e dua…”“Mos e prekni…,. mos e dëmtoni…”Arbenit i dridhej mendja. Por edhe zemra.

Arditi e mbylli fletoren me kujdes. Nuk mund ta mohonte: Arbeni kishte qenë i sëmurë, i vetmuar, i braktisur nga bota, i mbytur në një dashuri që e kalonte logjikën. Në spitalin psikiatrik, një infermier i moshuar e priti në korridor.

- Doktori ishte njeri i mirë, kapiten, - tha ai me zë të ulët. - Shpesh qante. Fliste me Elirën sikur ajo të ishte aty pranë. I lutej të kthehej. Në gjumë thirrrte emrin e saj. Ishte i humbur fare.

- A foli ndonjëherë për “hijet”? - pyeti Arditi. - Po, shumë herë. Thoshte: “Nuk jam vetëm unë… Janë edhe të tjerë… Do ta dëmtojnë… Do t’i afrohen Elirës…” Por askush nuk e mori seriozisht. Ishte gjendje e rënduar. Arditi uli kokën. Ai tani e kuptonte: Arbeni kishte paralajmëruar, por askush nuk e kishte dëgjuar. Në mbrëmje, Arditi u kthye në komisariat. Zyrat ishin ende të zëna, policët lëviznin me dokumente nëpër duar. Ai thirri mbledhje urgjente.

- Zonja dhe zotërinj, - filloi ai, - Rasti nuk është më thjesht çmenduri e një njeriu të dashuruar. Kemi një rrjet. Një organizatë të vërtetë. Arbeni ishte vetëm maja e akullnajës. Të tjerët janë aktivë dhe të rrezikshëm. Të njohur si “Hijet e Kuqe”. Një oficer ngriti dorën, me një hezitim të lehtë në zë.

- Kapiten, çfarë nënkuptohet me "hije të kuqe"?
Arditi aktivizoi projektorin. Në ekran u shfaq një fotografi e zbehur e Bac Dhelprës, e nxjerrë nga arkivat e vjetra operative.
- Ky njeri, - tha ai me ton të prerë, - ishte truri i shumë operacioneve të fshehta që kanë goditur Shqipërinë vitet e fundit. Vepronte në prapaskenë, i lidhur me një rrjet të errët që kontrollonte informacionin, manipulonte individë dhe nxiste kaos politik.
Ai ndaloi për një çast, sikur po peshonte fjalët.
- Arbeni ka qenë pjesë e këtij programi… Jo me vullnetin e tij. I pavetëdijshëm, i manipuluar, i sëmurë. Një mjet ishte, jo autori.
Heshtje totale. Pastaj Arditi shtoi:
- Ne nuk e dënojmë një të çmendur. Por do të kapim ata që e çuan drejt çmendurisë. Kjo ishte vetëm fillesa. Lajmi që trondit dy qytete. Vendimi për të hapur hetim të gjerë mbi "Hijet e Kuqe" u përhap me shpejtësi brenda strukturave të sigurisë. Por përtej zyrave të errëta dhe dosjeve sekrete, diçka tjetër po ndodhte paralelisht. Në distancë të largët, në një qytet krejt tjetër, një grua e quajtur Elira nisi të merrte informacionet e para.
Në rezidencën e saj në Uashington, ajo po përgatiste emisionin e radhës për televizionin amerikan. Kishte mësuar të fliste qartë, me gjuhë të saktë, me një elegancë që nuk e kishte humbur kurrë, edhe pasi jeta i kishte përmbysur gjithçka. Dera e saj trokiti lehtë.

- Miss Elira? - tha një zë i butë. Ishte një nga oficerët e sigurimit amerikan, i dërguar nga Departamenti i Shtetit.
- Po, hyni, - tha ajo, duke ulur lapsin mbi tavolinë.
Oficeri i paraqiti një zarf.
- Kemi marrë një komunikim nga Tirana. Hetimet për sigurinë tuaj personale janë rihapur. Autoritetet shqiptare po bashkëpunojnë me ne. Duket se rasti nuk ishte aq i thjeshtë sa u mendua fillimisht.
Elira ndjeu si iu zbeh fytyra.
- Është,… Për Arbenin? - pyeti ajo me zë të dridhur.
Oficeri nuk foli menjëherë. Dëshirojmë që ju të informoheni zyrtarisht. Ju jeni e sigurt këtu, por duhet të qëndroni e vëmendshme. Ajo u ul ngadalë në kolltukun pranë dritares. Jashtë, qielli i Uashingtonit po turbullohej, duke marrë një ngjyrë gri të rëndë. Ajo e pa me sy të humbur, sikur kërkonte midis reve diellin e Tiranës.
- Pse po hapet tani ky hetim? - pyeti ajo.
- Sepse dikush në Shqipëri ka gjetur diçka shumë të madhe, - u përgjigj oficeri. - Kapiten Ardit Hoxha ka zbuluar prova për një rrjet të tërë njerëzish që ju kanë survejuar… Dhe një prej tyre ka qenë Arbeni.
Ajo uli kokën. Zëri i saj ishte veç një pëshpërimë:
- Ai nuk bëri asgjë për të më lënduar… Ai ishte… i humbur ishte i çmendur tërësisht.
Oficeri e pa me keqardhje.
- E dimë, zonjë. Departamenti ka marrë raportet. Arbeni ishte i manipuluar, i sëmurë, një njeri që nuk mund të

kontrollonte veten. Pa merak zonjë. Po vijojnë hetimet…
Ndërkohë, në Tiranë. Kapiten Ardit Hoxha thërriti ekipin në sallën operative.
Në mes të tavolinës ishte një projektor, ku shfaqeshin pamje të reja të dyshimtëve. Hije që lëviznin natën. Burra me kapuç. Një makinë e zezë pa targa, e kapur në disa zona të ndryshme.
- Sot fillojmë operacionin "Këmba e Kuqe", - tha ai. - Qëllimi: Të zbulojmë çdo person që ka qenë në kontakt me rrjetin e "Bac Dhelprës". Do të kontrollojmë komunikime, lëvizje, financime të dyshimta. Këto nuk janë lojëra. Jemi përballë një strukture që ka jetuar në hijet e shtetit për shumë vite.
Një nga detektivët, një grua me përvojë të gjatë në hetime, tha:
- Kam parë dosjen e Arbenit. Ai nuk ka qenë organizator. Ka qenë i përdorur, i sëmurë, i dashuruar deri në çmenduri. Këta njerëz e kanë shfrytëzuar. Kemi prova që ai është ndjekur psikologjikisht. Futur në skema që nuk i kuptonte dot.
Arditi miratoi me kokë.
- Pikërisht për këtë, ne nuk do ta ndjekim ligjërisht. Arbeni është viktimë. Ai mban në shpirt Elirën… Dhe ka jetuar nën diktatin e njerëzve shumë më të errët se ai.
Një oficer i ri pyeti:
- Po Bac Dhelpra? - Arditi e shikoi fort, me një ashpërsi të qetë, por të ftohtë.
- Ai është koka e gjithë kësaj. Ai dogji Shqipërinë, shkatërroi

jetë, krijoi kaos. Tani fshihet në Turqi. Por hapat e tij do t'i gjejmë një për një.
Mbi tryezë ra një heshtje e rëndë. Të gjithë e dinin: Po hynin në një luftë të fshehtë, kundër diçkaje që nuk dukej në dritë. Në fund të ditës, Arditi doli nga zyra. Qielli i Tiranës kishte marrë ngjyrë vjollcë në rrëzë të kodrave. Ai ndezi një cigare dhe mendoi:
- Elira… do të marrë drejtësinë e vet. Ne do ia vërtetojmë.
Dhe Arbeni do të pastrohet nga faji. Kjo histori duhet të mbarojë njëherë e mirë. Era fryu lehtë, si një parathënie e stuhisë që po afrohej. Sepse hija e kuqe, ashtu si çdo e keqe që rri në errësirë, sapo kishte nisur të ndjehej e kërcënuar. Hije të kuqe mbi shpirtin e një njeriu të pafajshëm.
Policia nisi hetimet vetëm pasi qytetarët filluan të ankoheshin për njerëz të maskuar, që lëviznin natën si fantazma nëpër lagje, pa zë dhe pa gjurmë. Njerëzit thoshin se ndiheshin të ndjekur, se sy që nuk i shihnin i ndiqnin nga pas. Por askush nuk e dinte se, çdo lëvizje dhe hije ishte ndërtuar nga një rrjet i errët që e kishte përdorur Arbenin, një njeri i pafajshëm që donte vetëm Elirën.Kapiten Ardit Hoxha. Një oficer i heshtur, me përvojë të gjatë në krimet e organizuara dhe me urrejtje personale për rrjetet e fshehta që shkatërrojnë jetë, mori përsipër çështjen. Ai ishte i pari që kuptoi se gjurmët nuk ishin të rastësishme. Pas çdo ankese, pas çdo raporti, ai shihte një skemë, një logjikë që vetëm mendjet e sëmura të shërbimeve të vjetra mund ta krijonin.

Kur hynë në shtëpinë e Arbenit përsëri, heshtja ishte e rëndë si një zili e vdekur. Kapiteni dhe dy efektivët e tij ndalën frymën për një çast. Dhoma dukej si një altar i dhimbjes, një vend ku shpirti i një njeriu ishte copëtuar ngadalë. Në mure gjetën dosje, fotografi të Elirës, harta të lëvizjeve të saj, data, orare, itinerare që dikush ia kishte futur në mendje. Një mur i tërë ishte i mbuluar me shënime të kuqe. Jo shënime të një njeriu të çmendur, por të një njeriu të drejtuar nga dikush tjetër. Me dorë të huaj. Me frikë të futur në shpirt.
Në një qoshe të dhomës, gjetën edhe rrobat e tij, të palara, të hedhura, dhe një fotografi të Elirës të futur në xhep. Si të ishte një zemër e dytë. Si të ishte oksigjeni i fundit i jetës së tij.
Arbeni, tashmë në spitalin psikiatrik, vetëm qante çdo ditë dhe fliste me Elirën. E thërriste. E lutej. E kërkonte si fëmija që kërkon nënën. Ai nuk e kuptonte dot pse jeta e tij ishte shkatërruar. Ai nuk e kuptonte se e kish përdorur. Bac Dhelpra, ish-agjenti i SHIK-ut që kishte djegur Shqipërinë me intrigat e tij, ishte arratisur në Turqi dhe kishte kërkuar azil politik, duke lënë pas një rrjet hijesh që ndiqte çdo hap të një vajze të pafajshme. Arbeni nuk ishte as fajtor, as kriminel. Ai ishte viktimë. Një gur shahu i hedhur në mes të një loje që nuk e kuptonte. Dashuria e tij e sinqertë u kthye në mjet presioni. Dosjet e gjetura në shtëpi ishin të rënda. Kishte raporte të falsifikuara, dokumente të sajuara, analiza të rreme. Kishte prova që e fajësonin Arbenin, por paradoksalisht, edhe prova që e shfajësonin.

Ardit Hoxha e kuptoi menjëherë:
Ky njeri nuk ishte autor, ky njeri ishte pre' e një makinerie të errët.– "Ky është i përdorur. I shkatërruar. I sëmurë nga ajo që i bënë," – tha kapiteni me një zë të ulët, duke mos e hequr sytë nga fotografia e Elirës që Arbeni mbante në dorë sa herë flinte.
Në spital, Arbeni fliste me zë të ulët, sikur Elira të ishte ulur te këmbët e shtratit. "Elira… Mos më lër,… s'kam tjetër,… Më ke mbetur vetëm ti… Jam lodhur… Po më vrasin ngadalë…" Infermierët thoshin se netëve ai përpiqej të ngrihej, sikur të donte të ikte drejt Tiranës, drejt saj, drejt një ëndrre që s'i kish mbetur më.
Ndërkohë, kapiten Ardit Hoxha vazhdonte ndjekjen e "hijeve të kuqe".
Të gjithë rrjedhat të çonin tek një emër: Bac Dhelpra.
Njeriu që kishte hedhur në erë institucione, njerëz, jetë, që kishte përdorur Arbenin si mburojë dhe pastaj ishte zhdukur.
Dhe ndonëse policia gjeti shumë foto të Elirës në shtëpinë e Arbenit, shumë shënime, shumë material të dyshimtë. Ata e kuptuan se ai nuk mund të përgjigjej para ligjit. Jo sepse nuk ishte fajtor, por sepse ishte thyer. Ishte shkatërruar. Ishte bërë hije e vetes. Ai jetonte vetëm me dhimbjen dhe me dashurinë e pamatë për Elirën. Dhe kjo dashuri e kishte mbajtur gjallë, por edhe e kishte çuar drejt humnerës.
Dhoma e errët e spitalit psikiatrik
Arbeni rrinte i mbledhur pranë dritares së vogël me

kangjella. Drita e mëngjesit depërtonte si një vijë e hollë që i priste fytyrën më dysh. Ishte dobësuar. Sytë i kishin humbur shkëlqimin e dikurshëm, ndërsa duart nuk pushonin së dridhuri. Fletoret e tij ishin të shpërndara në dysheme. Të gjitha mbushur me një emër që i digjte shpirtin: Elira.
Mjekja e shërbimit, dr. Ana Marku, hyri qetë në dhomë.
- Arben… Pive ilaçet sot? - pyeti ajo me një ton të ulët.
Ai e shikoi si një fëmijë i humbur.
- Doktoreshë… A ka ardhur? Ajo më tha se do të vinte… Elira s'mund të më lerë. E di që s'mund të më lërë…
Zëri i dridhej. Kishte ditë që përsëriste të njëjtën fjali, por sot dukej sikur peshonte më shumë. Dr. Ana u ul pranë tij. - Arben, Elira nuk është këtu… Por bota jashtë po lëviz. Po hetohen shumë gjëra. Gjithçka do të dalë në dritë. Ti ke qenë viktimë,… jo fajtor.
Arbeni ngriti kokën. Në sytë e tij u ndez për një çast një shkëndijë dhimbjeje të kthjellët.
- E di… ai më detyroi. Ai… Bac Dhelpra… Më tha se Elira ishte në rrezik. Unë doja vetëm ta mbroja…- E di, - tha mjekja butë. - dhe këtë po e kupton edhe policia.
Zbulimi që tronditi Kapiten Ardit Hoxhën
Në zyrën e tij në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, kapiten Ardit Hoxha kishte mbledhur një tufë dosjesh mbi tavolinë. Kishte punuar tri netë pa gjumë. Shifrat, emrat, fotografitë, ecnin para syve të tij si hije.
Një oficer i ri trokiti.
- Zotëri kapiten… Jemi gati me analizën e kompjuterit të

Arbenit.
- Hyr! - i tha kapiteni.
Ai hapi derën. Më hap të ngadaltë iu afrua tavolinës së kapitenit. Oficeri vuri një USB mbi tavolinë dhe tha:
- Kemi gjetur prova shumë të qarta se disa skedarë nuk janë krijuar prej tij. Janë futur nga jashtë. Me gjasë… nga një shërbim informacioni. Gjurmët çojnë në një qendër operative në Izmir, Turqi, aty ku dyshohet se është arratisur Bac Dhelpra.
Arditi u ngrit në këmbë menjëherë.
- Pra, dikush ia ka ngarkuar gjithë rrjetin e survejimit si faj? Dhe ky ka qenë vetëm një mjek i thyer nga dashuria?
- Po, kapiten. Të gjitha tregojnë se Arbeni është përdorur.
Arditi mbylli sytë. Fryma e rëndë i dilte si një psherëtimë e lodhur.
- Shqipëria jonë është coptuar dhe fëlliqur nga njerëz të tillë. Habi, pra shokë, - tha ai. - Kaq shumë rrugaçë kemi prodhuar ne si komb… Ne s'e ndalojmë dot kurrë këtë lojën e tyre të errët. Një njeri i pafajshëm u shkatërrua vetëm se dashuronte gabimisht… Kjo është dhimbja, jo vetëm imja e krejtëve.
Shtëpia e Arbenit – Dhoma e sekreteve
Mbajmë mend kur policia hyri në shtëpinë e Arbenit, mbetën të shtangur. Muret ishin të mbuluara me foto të Elirës. Jo si të një maniaku, por si të një njeriu që kërkonte shpresë. Çdo imazh kishte shënime: "E qeshura më shpëton", "Rruga drejt jetës", "Drita ime".

Pastaj, në kënd të dhomës, gjetën një dosje të madhe të zezë me stemën e një agjencie që nuk ekzistonte në asnjë regjistër zyrtar. Brenda saj, dokumente të falsifikuara. Urdhra për survejim. Harta lëvizjesh - Të gjitha të nënshkruara me një pseudonim: BDH. Bac Dhelpra.

Arditi i goditi me grusht tavolinën dhe tha: E shfrytëzoi. E shtyu drejt çmendurisë. Ky njeri nuk ka faj,… ky është viktimë.

Oficeri i tij i vjetër, Iliri, foli me zë të dridhur: Më kujton disa raste të vjetra të sigurimit të shtetit, shef. Mjetet janë ndërruar, por metoda është e njëjtë. Gjuetia e njerëzve të brishtë është njësoj.

Arditi uli kokën.

- Kjo botë… nuk ndryshon kurrë, - tha ai.

Netët e errëta të Arbenit në spital

Mjekët thonin se Arbeni flinte pak. Çdo natë ai ngrihej, mbante foton e Elirës mbi gjoks dhe fliste me të me zë të ulët:

- Më fal…, të lutem, më fal… Unë doja vetëm të të mbroja… Ata më thanë… Ata më mashtruan… Elira…

Disa herë mjekët e gjenin duke qarë ngadalë, pa zë, me fytyrën mbuluar me duar. Dhimbja e tij nuk ishte e një të çmenduri.

Ishte dhimbja e një njeriu që kishte dashur shumë dhe ishte thyer.

- Eja,… eja dhe më thuaj që s'jam vetëm… - pëshpëriste ai.

Pastaj qetësohej, sikur Elira ishte aty, duke e prekur në shpatulla.

"Dashuri e pamundur". Shkroi një infermiere në raport. "Ai nuk ka frikë nga ne. Ka frikë nga boshllëku që i ka mbetur brenda."

Ndjekja e hijes – Arratisja e Bac Dhelpra-s

Informacionet e Interpolit erdhën të shpejta: Bac Dhelpra kishte kaluar kufirin drejt Turqisë, tri ditë para se rrjeti i tij të zbulohej. Kishte kërkuar azil politik, duke pretenduar se Shqipëria e përndiqte padrejtësisht. Mediat turke e paraqitën si "disident". Realiteti ishte i kundërt.

Arditi, në zyrën e tij, tha me zë të prerë:

- Ky rast është armiqësi ndaj shtetit tonë. Por mbi të gjitha… Ky njeri shkatërroi jetën e një doktori. Dhe kërkon t'ia hedhë paq, duke u shtirë si opozitar.

Iliri pyeti: Çfarë bëjmë për Arbenin?

Arditi uli sytë.

- E çlirojmë. E rehabilitojmë. Ky njeri ka vuajtur më shumë se të gjithë ne bashkë. Është gjynah që një përsonalitet i tillë të masakrohet nga një kriminel.

Shfajësimi i tij

Raporti final i policisë ishte i qartë:

"Arben Kodra nuk ka kryer asnjë vepër penale. Ka qenë i përdorur nga agjentura e jashtme dhe në gjendje të rëndë psikologjike pranë kohës kur është implikuar. Ndodhet jashtë çdo përgjegjësie ligjore."

Arditi e lexoi me zë të dridhur.

- I kemi borxh jetën këtij njeriu… - tha ai. - Vetmia e Arbenit dhe fotografia e fundit e Elirës. Era e athët e ilaçeve ndihej

fort në dhomën nr. 27 të spitalit psikiatrik. Arbeni rrinte ulur pranë krevatit të hekurt, me shpinën pak të përkulur, si një pemë që kishte duruar shumë stuhi. Gjithçka tek ai mbante vulën e lodhjes: Flokët e gjatë, sytë e nxirë nga pagjumësia, duart e dridhura.

Por në mes të kësaj shkretëtire të brendshme, ai mbante në duar fotografinë e Elirës. E shikonte sikur ajo të ishte një copë qielli e marrë me vete. Ai buzëqeshte ngadalë.

"Elira… - pëshpëriste. - Ti je e vetmja dritë në këtë vend. Të ndjej afër,… shumë afër… Edhe pse të humba… Edhe pse më morën gjithçka…"

Ai e vendosi foton mbi zemër, e mbajti aty, sikur dëshironte të thithte jetën prej saj.

"Ata më thanë që je në rrezik. Më gënjyen. Më përdorën. Më çmendën. Por zemra ime… Ajo nuk u shit. Ajo nuk u prish. Ajo mbeti e jotja."

Mbylli sytë. Në errësirë, ai e shihte përsëri Elirën: Duke qeshur, duke folur, duke e thirrur me emër. Dashuria e tij nuk ishte fantazi e sëmurë.

Ishte plagë e vërtetë.

Bac Dhelpra – arratisja, ferri dhe frika

Në një hotel të pistë në periferi të Izmirit, Bac Dhelpra rrinte duke lëvizur nervozisht nga dritarja te dera. Fytyra i ishte dobësuar, sytë i vigjilonin çdo hije që kalonte jashtë. Telefonin e kishte hedhur disa herë. Kishte nisur aq shumë mesazhe të koduara, saqë edhe vetë kishte filluar të harronte te kush i dërgonte.

- Më tradhtuan… të gjithë… - pëshpëriste.

- Arbeni do duhej të ishte zhdukur. Jo të dilte i pafajshëm… Ai freskonte ballin me duar të ftohta. E kuptonte: Shqipëria s'do ta linte të qetë. As Amerika.
Dhe ajo që e trembte më shumë…dr Arbeni dinte gjithçka.
"Po më ndjekin… - tha duke ecur sa andej-këtej. - Por unë… jam dhelpra. Jam mësuar me gjahun. Jam mësuar me tym e gjak."
Ai mori një dosje të zezë - Kopjen e asaj që i kishte lënë tek Arbeni. E hapi. Fotografitë e Elirës. Shënimet e tij. Plani për ta përdorur Arbenin.
Si mburojë. Dhe aty kishte lënë, një foto te Arbenit duke qarë, duke mbajtur foton e Elirës mbi gjoks.
Bac Dhelpra qeshi me ftohtësi.
"Mjek i gjorë… - tha. - Nuk të vret dot sa duhet dashuria? Po s'të mbaroj unë punë, si do të mbarojë bota, kur s'e bëra unë, si do ta bëjnë pashkollësat…
Qeshi …Por pastaj, qeshja iu ngri.
Në ekranin e televizorit të vjetër u shfaq një lajm:
"Policia shqiptare shpall të pafajshëm mjekun Arben Kodra. Akuzat janë manipuluar. Dyshohet për shërbime të huaja të infiltruara."
Baci ngriti volumin.
Spikeri vazhdoi: "Kapiten Ardit Hoxha deklaron se do të kërkohet ekstradimi i personit të njohur me nofkën 'Bac Dhelpra'."
Fytyra e tij u zverdh.
"Jo…- jo… Nuk mund të ketë mbaruar kaq shpejt…"

Ai e mbylli dosjen me vrull dhe u ul në dysheme.
Për herë të parë, u duk sikur kishte frikë të vërtetë.
Arbeni – zemër që nuk heq dorë
Natën vonë, në spital, Arbeni u zgjua nga ëndrra e një zëri të njohur.
Elira. I dukej sikur ajo i fliste nga dritarja, E ulur në stol jashtë. Ajo fliste me butësi, si një aromë që vinte nga deti:
"Mos u frikëso, Arben. Unë nuk të kam harruar."
Ai u ngrit i tronditur.
"A… je këtu? Elira… Mos më lër. Unë nuk doja të të humbisja. Jo. Jo ty. Jo dritën time."
Mjekët e dëgjuan që fliste me tone të qeta, asnjë çmenduri, asnjë britmë. Vetëm dashuri e pastër, e përzier me dhimbjen e një njeriu që s'e gjen kurrë rrugën drejt personit që do. Infermierja Mirela e shikoi nga dera dhe pëshpëriti: "Ky njeri nuk është i sëmurë. Ky njeri… është i plagosur nga jeta."
Arbeni, ndërkohë, puthi fotografinë e Elirës dhe e mbajti në duar si një stoli të shtrenjtë..
"Elira… "
Zëri i tij ishte i ulët, i lodhur, por i mbushur me një qartësi të re. "Dashuria ime nuk më ka lënë kurrë. Ajo më mbajti gjallë, edhe kur gjithçka tjetër po shembej."
Ai mori frymë thellë, sikur po mblidhte forcën për të nxjerrë fjalët që i kishin mbetur peng në shpirt.
"Ndërsa ai tmerri… Ai njeri,… dhelpra - zëri iu drodh për një çast. - Ai që më shtyu në rrugë të gabuar, që më errësoi

mendjen dhe ma vodhi paqen… Do të paguajë. Jo nga dora ime. Unë… Nuk e kam më atë barrë……Do ta gjejë nga Zoti dhe shteti do ta gjejnë……"
Ai hapi sytë dhe e pa drejt, me një shikim ku nuk kishte më urrejtje, por dorëzim. "Zoti e ka në dorë ai do hakmerret - shtoi qetë. - Dhe kjo më mjafton."
Pastaj i mbylli sytë ngadalë. Frymëmarrja iu rregullua, tensioni iu largua nga fytyra dhe, për herë të parë pas shumë netësh të gjata e të mbushura me ankth. Ai ra në një gjumë të qetë, sikur më në fund kishte gjetur paqen që i kishte munguar.
Në Shqipëri – Frika e elitave. Kur lajmi për pafajësinë e Arbenit u përhap, në qarqet politike shpërtheu paniku. Zyrat u mbyllën me nxitim. Telefonat ranë pa pushim dhe mbledhjet e improvizuara u kthyen në skena nervozizmi dhe frike.
- Të mos hapet çështja! - bërtiti një zyrtar i lartë në një mbledhje të mbyllur, duke goditur tavolinën me grusht. - Mos dalin prapë emrat tanë nëpër Turqi… Gjëra të vjetra, dosje që duhet të kishin vdekur! Një heshtje e rëndë pasoi, derisa dikush guxoi të fliste:
- Po Baci? Çfarë do të bëjmë me të?
Zyrtari u përkul përpara, me një buzëqeshje të ftohtë.
— Ai le të bëjë ç'të dojë, mjafton të mos kthehet më këtu. Lëreni të hajë bar në Turqi. Sa më larg, aq më mirë. Por përtej këtij paniku të mbyllur pas dyerve të blinduara, në rrugë po ndodhte diçka tjetër. Njerëzit e thjeshtë nisën të

flisnin ndryshe, me zë të ulët, por me ndjeshmëri.
- E gjora Elirë… - dëgjohej në një kafene lagjeje.
- Po ky Arbeni? - shtonte dikush tjetër. - E çuan në çmenduri.
- Na ra turpi, - thoshte një burrë i moshuar duke tundur kokën.
- Këta s'dinë më të ruajnë as njerëzit më të mirë që kemi, - përfundonte pohimin një grua nga fundi i lokalit.
Në kafene, në autobusë, në rrugë dhe në radhë dyqanesh, emrat e tyre qarkullonin nga goja në gojë. Nuk ishin më thashetheme, por një lloj ndërgjegjeje që po zgjohej ngadalë. Dhe për herë të parë pas shumë kohësh, e vërteta po flitej jo nga pushteti, por nga njerëzit.
Në fund të fundit, në këtë vend, dashuria e dikujt shpesh përfundonte në dramë. Kapiten Ardit Hoxha ecte ngadalë në korridorin e spitalit psikiatrik, duke ndjerë çdo hap të tij të rëndë, sikur po e shoqëronte një njeri të brishtë drejt dritës pas shumë errësirash. Një infermiere e re e çoi pranë dhomës nr. 27, dhe trokiti lehtë.
- Ai është më i qetë sot, kapiten… - tha ajo. - Ka folur për Elirën… dhe për atë që i ka ndodhur. Arditi përkul kokën dhe mori frymë thellë. Nuk e donte uniformën që të tregonte autoritetin e policit. Këtë takim donte ta bënte si njeri, si dikush që ka parë shumë dhimbje dhe ka vendosur të bëjë drejtësi.
Infermierja hapi derën dhe hyri në dhomë.
Arbeni rrinte ulur pranë dritares. Një batanije e zbehtë mbulonte supet e tij, por duart e dridhura mbanin fort

fotografinë e Elirës. Ai e shikonte me kujdes, sikur të ishte një pjesë e shpirtit të tij, Një oksigjen që nuk mund ta humbiste.

Kur dëgjoi hapa në korridor, ngriti kokën me frikë, por shikimi i kapitenit qetësoi një pjesë të trazimit të tij.

- Ardit…? - pyeti ai me zë të dobët dhe të dridhur. - Je ti…?

- Po, Arben. Unë jam, - tha Arditi, duke u ulur ngadalë pranë krevatit. - Erdha të të shoh dhe të të them të vërtetën.

Arbeni e shikoi gjatë, heshtja mbante një peshë të madhe.

Pastaj foli, i hutuar:

- Më thanë… Se ajo ishte në rrezik. Më thanë të bëja gjithçka… Por unë… Unë vetëm e doja…, vetëm doja ta mbroja…

Ai e mbajti fort fotografinë. Lotët i rridhnin ngadalë, pa zë. Arditi vendosi dorën mbi supin e tij.

- Arben… Nuk je fajtor. Ata të përdorën, të manipuluan, të shtynë drejt çmendurisë. Ti deshe vetëm të mbroje atë që doje. Sytë e Arbenit u mbushën me një shkëndijë shprese.

- E… e di ajo? A do të më falë…? - pyeti, me një dridhje të lehtë në zë.

- E di, - tha Arditi, me zë të ngrohtë. - Ka kërkuar publikisht rehabilitimin tënd. Ka folur për pafajësinë tënde dhe dashurinë tënde. Nuk ka për të të urryer. Arbeni e mbuloi fytyrën me duar. Trupi i tij dridhej i butë. E dashura e tij ishte larg, por zemra e tij nuk ndalej së dashuruari. - Vetëm mos i sillni asaj dhimbje më… - pëshpëriti ai. - Ajo nuk e meriton…

Arditi buzëqeshi lehtë dhe i ra lehtë te shpatullat e tij.

- Nuk do ta lëndosh. Dhe një ditë, kur të jesh gati, do të mund të komunikosh me të. Do të jesh i drejtë me të dhe i lirë, me fol për dashurinë që ke për të, Arben.
Arbeni e mbajti foton mbi zemër dhe mbylli sytë. Për herë të parë në shumë javë, ndjeu pak qetësi. Në atë dhomë të bardhë, mes ilaçeve dhe korridoreve të zbehta. Një burrë i thyer po rikthehej në jetën e tij, i mbrojtur nga dashuria dhe kujdesi i një njeriu të drejtë.

Arratisja dhe Ndjekja e Bac Dhelpra-s. Turqia: Hije që nuk shuhen
Tre muaj më parë, Bac Dhelpra kishte kaluar kufirin drejt Turqisë. Një hotel i vogël në periferi të Izmirit i shërbente si strehë e përkoshshme. Ai ecte nervoz nga dhoma në dhomë, ngadalë, duke vështruar çdo dritare dhe çdo derë. Çdo hije që kalonte jashtë i dukej kërcënim, çdo zë. Ai strukej pas murit. Tani hija ishte ai... Frika dhe paranoja po e bënin atë si Arbenin……
- Nuk mund të më kapin… Nuk mund… - pëshpëriste me vete. - Po e di Arbenin… Atij mjeku… I shkatërrova jetën, por nuk do shpëtojë kështu. Ai s'bëhet më. Nuk mund të më dënoncojë. Si quhet në gjuhën teknike. Nuk mund të dëshmojë. Ai s'është normal. Nuk quhet dëshmia e tij. Nuk kam frikë,… Nuk kam frikë! - fliste më vete vazhdimisht ai.. E zëri i dridhur mbushte dhomën ku qëndronte.
Por frika nuk ishte më vetëm një ndjenjë e largët. Kur ndezi televizorin për të marrë lajmet e botës, ekranin pushtuan

fotot e Arbenit. Të qeshur dhe të pafajshëm. Raporti i policisë shqiptare ishte i prerë dhe i qartë: "Arben Kodra është i pafajshëm. Akuzat janë manipuluar. Shërbimet e huaja e përdorën." Baci ngriti shikimin, fytyra e tij ndriçoi nga zemërimi dhe frika. Ai e kuptoi menjëherë: Loja kishte mbaruar për të, të paktën për momentin.

Ndjekja nga Shqipëria në Tiranë. Kapiten Ardit Hoxha nuk pushonte. Çdo informacion, çdo fotografi dhe çdo gjurmë e Bac-it ishte përpunuar. Ai kishte kontaktuar autoritetet turke dhe Interpol-in. Një rrjet i heshtur u ngrit për të ndjekur lëvizjet e tij.

- Ai nuk do mund të fshihet, - tha Arditi duke parë hartat e Izmirit dhe udhët e mundshme. - Asnjë port, asnjë hotel nuk është i sigurt për të.

Oficeri Iliri shtoi:

- Po Arbeni? Ai është i sigurt tani, shef?

- Po, — tha Arditi. — por dashuria e tij për Elirën është më e fortë se çdo kërcënim. Ky njeri ka vuajtur shumë dhe ne duhet të sigurohemi që asgjë më të mos e godasë.më

Arbeni dhe fotografia e Elirës

Ndërkohë, në spital, Arbeni e mbante fotografinë e Elirës mbi gjoks, duke përsëritur me zë të ulët:

- Ti je drita ime… Edhe kur gjithçka tjetër më ka braktisur. Edhe kur errësira më ka mbyll rrugët dhe heshtja më rëndon mbi shpinë si faj që s'e kam bërë kurrë. Ti do të jesh drita ime gjithmonë, pavarësisht që nuk kam kryer asgjë të keqe. Gabimi im i vetëm ishte besimi. Më përdorën, më

shtynë drejt humnerës, më lanë të mbaj peshën e mëkateve të tyre.

Por unë… unë mbeta këtu, i zhveshur nga çdo mbrojtje. Vetëm me të vërtetën time dhe me dashurinë për ty. Sepse edhe kur më mohuan emrin, edhe kur më thyen dinjitetin, ndjenja për ty nuk u shua. Ajo mbijetoi si një dritë e vogël në fund të shpirtit, e palëkundur, kokëfortë.

Të dua jo si njeri i papërgjegjshëm, por si dëshmi se ende jam njeri. Të dua sepse tek ti gjej atë që bota ma mohoi: Drejtësinë, qetësinë, dhe arsyen për të mos u shndërruar në atë që ata donin të bëhesha. Nëse kam mbetur gjallë, është sepse ti je drita ime. Edhe kur gjithçka tjetër më braktisi, ti mbete te unë.

Infermierët e shikonin me habi dhe respekt. Ky nuk ishte njeri i çmendur, por një njeri i plagosur nga dashuria dhe tradhtia.

- Do të jetoj, - pëshpëriste ai. - Për veten. Për Elirën. Vetëm për të…

Mbylli sytë dhe i lejoi lotët të rridhnin, të pastrehë dhe të qetë. Fotografia e saj ishte e vetmja gjë që mund të qetësonte zemrën e tij.

Lidhja e padukshme

Pavarësisht largësisë që i ndante dhe mureve të ftohta që e bënin heshtjen edhe më të rëndë, lidhja e tyre mbeti e palëkundur. Nuk kishte nevojë për fjalë të zëshme, as për premtime të shkruara me dorë që mund të humbnin rrugës. Mjaftonte një mesazh i heshtur, një lutje e fshehtë

që ngrihej në errësirë, dhe një foto e vogël, e mbështetur mbi gjoks, që rrihte në të njëjtin ritëm me zemrën e tij. Ajo foto nuk ishte thjesht një kujtim; Ishte dëshmi se shpresa ende jetonte.

Çdo natë, Arbeni e shtrëngonte atë imazh si të ishte një mburojë kundër dëshpërimit. Në atë copë letre ishte Elira. Jo vetëm fytyra e saj, por premtimi se e vërteta nuk mund të burgosej përgjithmonë. Larg, në një tjetër hapësirë. Ajo e ndiente praninë e tij pa pasur nevojë ta shihte. Një ndjenjë e pashpjegueshme i thoshte se ai nuk ishte thyer, se dashuria e tyre kishte marrë formën e durimit. Zoti, nga ana tjetër, ishte shtylla e padukshme që e mbante këtë lidhje në këmbë. Ai ishte mburoja mes Arbenit dhe padrejtësisë. Zëri i qetë që i rikujtonte se pafajësia e tij nuk ishte thjesht një bindje personale, por një e vërtetë e dëshmuar. Me fjalë të thjeshta dhe me praninë e tij të palëkundur. Zoti e ndihmonte Arbenin të kuptonte se gjithçka që po duronte kishte një fund dhe se drita nuk ishte fikur.

Në këtë trekëndësh heshtjeje, besimi dhe dashurie, asgjë nuk u këput. Sepse kishte lidhje që nuk shiheshin, nuk prekeshin, por ishin më të forta se çdo prangë. Dhe ajo lidhje, e padukshme për botën, ishte arsyeja pse ata vazhdonin të merrnin frymë, të prisnin dhe të besonin se e vërteta dhe dashuria, herët a vonë, do të triumfonin.

Letra e Arbenit:

“Elira ime e dashur,

Çdo ditë pa ty është një copë qielli që ka humbur dritën. Çdo natë pa ty është një erë e ftohtë që më përplas fytyrën me kujtime të hidhura. Nuk ka ditë që nuk mendoj për buzëqeshjen tënde, për zërin tënd që më qetësonte dhe për mënyrën si e ndjeja praninë tënde edhe kur nuk ishe aty.
Më kanë përdorur, më kanë gënjyer, dhe të gjithë ata që më rrethuan më shtynë në një hije të errët ku unë humba vetveten. Por zemra ime, zemra ime gjithmonë ishte e jotja. Ajo nuk ka harruar kurrë dashurinë tënde dhe as nuk do ta harroj.
Të kam dashur dhe të dua ende, më shumë se çdo gjë në këtë botë. Edhe pse jam i thyer nga jeta, edhe pse kam humbur shumë, një gjë nuk mund të më marrin kurrë: Dashurinë për ty.
Kur kjo letër të arrijë tek ti, shpresoj që të dish se çdo veprim im i gabuar vinte nga dëshira për të të mbrojtur, jo për të të lënduar. Do të jetoj çdo ditë për të qenë dikush që ti mund të jesh krenare, për të.
Dhe së bashku për ndërtuar një jetë ku ti nuk do të kesh frikë, ku dashuria jonë nuk do të shkatërrohet nga njerëz të errët.
Të lutem, besoje zemrën time. Ajo nuk gënjen.
Gjithmonë i yti,
Arbeni"
Kur infermjerja e dorëzoi mesazhin për t'u dërguar tek Elira në Uashington. Arbeni u ul pranë dritares dhe e shikoi qiellin. Yjet dukeshin të largët, por për herë të parë ai ndjeu

një shpresë të butë që mbante dritën e dashurisë së tyre gjallë.— Tani,… tani ajo do të dijë, — pëshpëriste për vete. — Tani ajo do të dijë që zemra ime është gjithmonë e saj. Dhe kështu, mesazhi u nis drejt Uashingtonit, ndërkohë që Arbeni mbante fotografinë e saj mbi gjoks, duke e ndjerë praninë e saj, edhe në errësirën e natës së spitalit.

Uashingtoni që nuk fle

Elira zgjohej çdo mëngjes para agimit, në atë çast të brishtë kur nata ende nuk ishte dorëzuar plotësisht dhe qyteti mbante frymën pezull. Rrugët e Uashingtonit shtriheshin të heshtura, të lagura nga drita e zbehtë e llambave dhe vetëm ndonjë taksi e vetmuar prishte qetësinë me zhurmën e gomave mbi asfalt. Nga kafeteritë që sapo hapeshin vinte aroma e fortë e kafesë, një erë që i dukej si thirrje për t'u zgjuar jo vetëm trupi, por edhe mendja.

Qyteti nuk ndalej kurrë. Ai s'pyeste për dhimbjen e individëve. Ai jetonte për historinë e madhe, për monumentet, për pushtetin dhe kujtesën kolektive. Elira e dinte këtë. Me filxhanin e kafesë së zezë në dorë. Ajo qëndronte pranë dritares dhe shikonte rrjedhën e qetë të Potomakut. Uji ecte pa u kthyer pas, ndërsa mendja e saj bënte të kundërtën:

Fluturonte larg, drejt vendlindjes, atje ku fati kishte ndryshuar gjithçka pa kërkuar leje.

Çdo ditë ajo udhëtonte me metro dhe autobus, duke mësuar jo vetëm rrugët, por edhe kodet e pashkruara të qytetit. Çdo shenjë, çdo monument, çdo tabelë ishte një copëz e

një gjeografie të re që duhej pushtuar me durim. Njerëzit e shikonin si gazetare të suksesshme, me fytyrën e njohur në ekranet televizive, si një grua që kishte arritur gjithçka. Por askush nuk shihte boshllëkun që ajo mbante brenda vetes, të mbushur me kujtime, me emra që nuk shqiptoheshin më dhe me ëndrra që kishin mbetur pezull.

Në studio, zëri i saj ishte i qartë dhe i sigurt. Ajo fliste për politikë, për drejtësi, për vendime që ndryshonin fatet e kombeve. Kamerat e donin, redaktorët i besonin. Por pas çdo fjale të matur, pas çdo analize të ftohtë, mendja e saj ikte diku tjetër. Kthehej gjithmonë te Arbeni — Te mjeku që kishte parë gjithçka, që kishte besuar te njeriu dhe që ishte thyer prej tij. Kthehej te dhimbjet që nuk shëroheshin me ilaçe dhe te një dashuri që kishte mbetur e gjallë vetëm në heshtje.

Uashingtoni nuk flinte kurrë. As Elira.

Qyteti i huaj dhe gjuha e heshtjes

Uashingtoni ishte një qytet që fliste shumë, por rrallë tregonte shpirtin. Elira e kishte kuptuar këtë që në muajt e parë të qëndrimit të saj. Njerëzit ecnin shpejt, me sytë ngulur në telefonë, Me axhenda të mbushura dhe fytyra të disiplinuara, sikur çdo buzëqeshje të ishte një kontratë e nënshkruar paraprakisht.

Askush nuk pyeste se kush ishe në të vërtetë. Rëndësi kishte vetëm çfarë përfaqësoje në atë çast: Një titull, një funksion, një kartë identiteti institucionale. Ajo e kishte mësuar këtë gjuhë të pashkruar—Gjuhën e heshtjes.

"Mos pyet shumë, —i thoshte vetes çdo mëngjes para se të dilte nga shtëpia."
"Mos trego shumë," përsëriste zëri i brendshëm, teksa lidhte këpucët.
Në fillim i ishte dukur e ftohtë kjo mënyrë jetese. Pastaj, pa e kuptuar, kishte filluar ta pranonte. Të ecte me hapin e qytetit. Të mos ndalej gjatë te ndjenjat. Të mos i linte mendimet të shkonin shumë larg. Në metro, mes zhurmës së frenave dhe njoftimeve metalike. Ajo vështronte fytyrat rreth saj. Të gjithë dukeshin të zënë, të rëndësishëm, por thellë-thellë, të vetmuar.
"A jam edhe unë kështu? A jam bërë pjesë e kësaj qetësie të zhurmshme?"
Askush nuk përgjigjej. Mbrëmjeve, kur Uashingtoni mbetej zgjuar me dritat e tij zyrtare dhe heshtjen diplomatike, Elira ndiente se mendimet i flisnin më fort se njerëzit. Aty ku fjalët mungonin, kujtimet fillonin të trokisnin.
"Mos u dobëso, - i thoshte vetes. - Këtu dobësia nuk ka vend."
Por në heshtjen e dhomës, larg zhurmës së qytetit. Ajo e dinte se njeriu nuk mund të ecë gjithmonë pa u ndalur. Dhe Uashingtoni, me gjithë disiplinën e tij, nuk mund t'ia fshihte këtë të vërtetë.
Çdo mëngjes, teksa zbriste shkallët e metrosë, dëgjonte zhurmën metalike të trenave dhe zërat e përzier në dhjetëra gjuhë. Aty ndiente vërtet se ishte larg shtëpisë. Shqipja i vinte në mendje si një jehonë e largët, si një këngë e vjetër

që vetëm ajo e njihte. Herë pas here, ndonjë fjalë e huaj i dukej e ftohtë, e dobët, sikur nuk mund të mbante peshën e dhimbjeve që ajo kishte sjellë me vete. Në redaksi, Elira ishte e përpiktë, profesionale, pothuajse e ftohtë. Kolegët e respektonin për disiplinën dhe guximin investigativ. Ajo nuk fliste shumë për veten. Kur e pyesnin nga vinte, buzëqeshte lehtë dhe përgjigjej shkurt, sikur e shkuara të ishte një dosje e mbyllur mirë në sirtar. Por në mbrëmje, kur kthehej në shtëpinë e saj të ëmbël, heshtja e mureve ia kthente gjithçka mbrapsht.

Dhoma ishte e thjeshtë: Një shtrat, një tavolinë pune, libra të shpërndarë dhe disa dokumente të vjetra që ajo nuk i kishte hedhur kurrë. Ato ishin dëshmi të një jete tjetër, të një beteje që nuk kishte përfunduar. Aty, në atë hapësirë të ngrohtë të shtepisë, Elira hiqte maskën e gazetareve televizive dhe mbetej vetëm grua, vetëm njeri.

Shpesh ulej pranë dritares dhe shikonte dritat e qytetit. I dukej sikur secila dritë mbante një histori, por asnjë nuk i përkiste asaj. Mendja i shkonte sërish te Arbeni. Pyeste veten se ku ishte, nëse kishte ndonjë ditë të mirë, nëse ende e mbante mend zërin e saj. Pyetje pa përgjigje, që i mbante gjallë vetëm sepse nuk guxonte t'i shuhej plotësisht shpresa.

Në ekran, ajo ishte simbol i suksesit. Në realitet, ishte një grua që kishte mësuar të jetonte me mungesën. Uashingtoni i kishte dhënë karrierë, por i kishte marrë ngrohtësinë. Elira, mes monumenteve dhe ligjeve, po kuptonte se ekzistonte

një vetmi më e thellë se ajo e vendlindjes: Vetmia e njeriut që ia ka dalë, por ka humbur atë që kishte më shumë rëndësi. Ajo mbylli dritën dhe u shtri. Qyteti vazhdonte të gumëzhinte jashtë. Brenda saj, fillonte nata tjetër, ajo ku kujtimet flisnin më fort se çdo lajm.

Qyteti i ri dhe jeta e huaj

Në çdo shesh ku ndalonte, Elira ndiente menjëherë kontrastin mes Uashingtonit dhe vendlindjes së saj. Hapësirat ishin të gjera, të rregulluara, monumentet ngriheshin madhështore, por të ftohta, si kujtime pa ndjenja. Gurët dhe mermeri ruanin historinë e një perandorie moderne, por nuk flisnin për njerëzit e thjeshtë. Ajo e ndiente se këtu gjithçka ishte e saktë, por paksa e largët, sikur qyteti të ishte ndërtuar më shumë për t'u admiruar sesa për t'u jetuar.

Njerëzit lëviznin me nxitim, të zhytur në ritmin e tyre, secili me një qëllim të qartë. Elira vërente fytyrat, gjestet, heshtjet. Me kalimin e kohës, ajo kishte mësuar të lexonte jo vetëm hartat e rrugëve, por edhe shenjat e njerëzve: Kush fliste me sinqeritet, kush luante lojën e pushtetit, kush e mbulonte frikën pas buzëqeshjeve të stërvitura. Ky ishte një qytet ku maskat ndryshonin shpejt, por rrallë binin.

Shpesh ndalej në ndonjë park apo kafene dhe hapte bllokun e saj të shënimeve. Shkruante pa u menduar gjatë, si për të mos lejuar që mendimet t'i iknin. Çdo fjali, çdo vëzhgim ishte pjesë e një hetimi më të madh — Jo vetëm profesional, por thellësisht personal. Ajo kërkonte të kuptonte botën përreth, por në të vërtetë po kërkonte të kuptonte veten,

vendin e saj në këtë qytet që e kishte pranuar, por ende nuk e kishte përqafuar.

Mbrëmjeve mbyllej në shtëpinë e saj, ku librat dhe dokumentet e vjetra që kishte sjellë nga Shqipëria ishin si relike të një jete tjetër. Ato ishin dëshmi të një qyteti që ende jetonte brenda saj, me zhurmat, rrëmujën dhe dhimbjet e veta. Kur i prekte ato fletë, ndiente sikur prekte të shkuarën, sikur të rikthente për pak çaste atë që kishte humbur. Ajo takonte njerëz të ndryshëm: Kolegë të rinj plot ambicie, politikanë që flisnin me fjali të matura, gazetarë të huaj që e shikonin me kureshtje. Disa e admironin për guximin dhe këmbënguljen, të tjerë e nënvlerësonin, duke e parë si një zë që vinte nga një vend i vogël. Elira i pranonte të gjitha me qetësi. Ajo kishte mësuar se suksesi nuk e mbush boshllëkun e brendshëm. Ai vetëm e mbulon përkohësisht, si një dritë e fortë që fsheh hijet, por nuk i zhduk. Dhe kur mbetej vetëm, larg kamerave dhe zhurmës, ajo e kuptonte se jeta e huaj nuk ishte thjesht një vend i ri. Ishte një gjendje shpirtërore, ku njeriu mëson të ecë përpara, duke mbajtur brenda vetes gjithçka që nuk mund ta lërë pas.

Arbeni, njeriu i mbetur në kohë

Arbeni jetonte në një kohë që nuk ecte më përpara. Ditët i ngjanin njëra-tjetrës, të sheshta, pa kufij të qartë mes mëngjesit dhe mbrëmjes. Pas tre vitesh në spital, pas tre vitesh mure, drita artificiale dhe zërash të përmbajtur, ai kishte mësuar të mos i besonte orës. Koha për të nuk matej më me minuta, por me dhimbje dhe qetësi të rreme.

Rehabilitimi e kishte kthyer pothuajse në mjekun e dikurshëm. Duart i dridheshin më pak, mendja ishte më e kthjellët, por shpirti mbetej i lodhur. Kishte ditë kur e ndiente veten të fortë, të aftë të rikthehej dhe kishte ditë të tjera kur gjithçka i dukej e kotë. Kujtimet vinin pa paralajmërim, si goditje të papritura dhe e rrëzonin sërish në heshtje.

Ai e dinte se fati e kishte thyer. Jo vetëm sëmundja, por edhe padrejtësia, frika, braktisja. Kishte qenë mjek i respektuar, emër i njohur, njeri që besonte te shkenca dhe te njeriu. Pastaj gjithçka ishte përmbysur. Institucioni që duhej të shëronte, e kishte shkatërruar. Spitali ishte kthyer në burg dhe ai në të burgosur të padukshëm.

Netëve, kur korridoret qetësoheshin dhe dritat zbeheshin, Arbeni mbyllte sytë dhe e shihte Elirën. Në ëndrra ajo vinte e qetë, me sytë e njëjtë, me zërin që nuk e kishte harruar kurrë. Aty ai ndiente se ishte ende njeri, ende i dashur. Ajo i fliste pa pyetje, pa dhembshuri të tepruar, thjesht si dikur.

- Ende jam këtu, - i thoshte ajo në ëndërr.

- Edhe unë, - përgjigjej ai, edhe pse e dinte se nuk ishte e vërtetë.

Zgjimi ishte gjithmonë i vështirë. Dhoma e bardhë, shtrati i ngushtë, zhurmat e largëta e kthenin në realitet. Ai shtrëngonte duart dhe përpiqej të mbante mend ëndrrën, sikur ajo të ishte e vetmja gjë që i përkiste ende. Diku larg, në një qytet tjetër, Elira jetonte jetën e saj të re. Arbeni nuk e dinte si dukej ajo tani, por e ndiente se ende ekzistonte.

Dhe kjo ndjenjë, e brishtë dhe e dhimbshme, ishte ajo që e mbante gjallë.
Ai ishte njeriu i mbetur në kohë, por dashuria nuk njihte kohë. Ajo vazhdonte të jetonte vetëm në ëndërr - Dhe ndoshta kjo ishte forma e saj më e pastër. Ëndrra e përbashkët.
Nata i bashkonte atëherë kur dita i mbante larg. Elira nuk e kuptonte gjithmonë se kur fillonte ëndrra dhe kur mbaronte realiteti. Disa netë, lodhja e rëndë e rrëzonte në gjumë pa menduar, por kishte netë të tjera kur trupi flinte dhe mendja mbetej zgjuar, duke e kërkuar Arbenin në errësirë.
Në ëndërr, gjithçka ishte më e qetë. Nuk kishte qytete të huaja, nuk kishte spitale, as kamera e as lajme. Ishin vetëm ata të dy, në një hapësirë pa emër, pa kohë. Elira e shihte Arbenin si dikur: I qetë, i rregullt, me sytë që i flisnin më shumë se fjalët. Zemra i dridhej çdo herë që ai afrohej.
- Mendova se më kishe harruar, - i tha ajo një natë, me një zë që i dridhej lehtë. - Nuk harrohet ajo që të ka mbajtur gjallë, - u përgjigj Arbeni. Ata ecnin krah për krah, pa prekur njëri-tjetrin, sikur një vijë e padukshme i ndante. Elira ndiente dëshirën të shtrinte dorën, por diçka e ndalonte. Ajo e dinte se nëse e prekte, ëndrra do të prishej.
- Pse vetëm këtu? - e pyeti ajo. - Pse vetëm në gjumë?
Arbeni uli sytë.
- Sepse këtu nuk na gjykon askush. Këtu nuk ka diagnoza, as vendime. Vetëm ne. Në atë botë të heshtur, fjalët e tyre

rridhnin ngadalë, si ujë i qetë. Ata flisnin për gjërat që nuk kishin thënë kurrë: Për frikën, për fajin, për dashurinë që kishte mbetur e pazgjidhur. Elira i tregonte për jetën e saj në Uashington, për suksesin që nuk e bënte të lumtur. Arbeni i fliste për netët e gjata, për ditët kur e ndiente veten të padukshëm.

- Unë të kam dashur gjithmonë, - tha ai më në fund. - Edhe kur nuk isha më vetvetja.

Elira ndjeu se sytë po i mbusheshin me lot. - Edhe unë. Por dashuria jonë ka mbetur në mes, si një fjali e papërfunduar. Në çastin kur ajo guxoi ta shikonte drejt në sy, drita u zbeh. Gjithçka filloi të shpërndahej. Ajo ndjeu se po zgjohej.

Elira u ngrit në shtrat, me zemrën që i rrihte fort. Dhoma ishte e errët, qyteti jashtë gumëzhinte lehtë. Ajo e dinte se Arbeni ishte larg, ndoshta duke u zgjuar edhe ai nga e njëjta ëndërr. Dy njerëz, dy qytete, një dashuri që jetonte vetëm aty ku realiteti nuk arrinte.

Ëndrra ishte strehë. Por edhe plagë. Ata nuk u bënë kurrë çift në jetë, por çdo natë bashkoheshin në një botë ku fati nuk kishte pushtet. Ishin dy zemra që u njohën shumë herët dhe u humbën shumë shpejt; Jeta ua mori realitetin, por nuk ua fshiu ndjenjën. Dashuria e humbur është ajo që nuk u jetua kurrë, por që vazhdon të të zgjojë çdo mëngjes më e fortë se realiteti.

Spitali si plagë dhe simbol

Spitali nuk ishte më vend shërimi. Ishte plagë e hapur, e lënë qëllimisht të mos mbyllej. Muret e tij mbanin ende

erën e dezinfektantit të vjetër, por pas kësaj arome fshihej kalbëzimi i një sistemi të tërë. Dritaret e thyer, korridoret e zbehta dhe pajisjet e ndryshkura flisnin më shumë se çdo raport zyrtar. Aty ku dikur hyhej për të shpëtuar jetë, tani hyhej me frikë — Ose nuk hyhej fare. Pasi ekipi i doktor Mentorit u largua, gjithçka mori tatëpjetën. Modernizimi mbeti në letër, planet u harruan, fondet u zhdukën. Spitali u kthye sërish në një godinë publike pa shpirt, ku përgjegjësia ishte gjithmonë e paqartë dhe faji nuk kishte emër. Askush nuk mbante llogari. Askush nuk dënohej. Vetëm pacientët paguanin çmimin.

Infermierët punonin me rroga të vonuara, mjekët më të aftë u larguan ose u detyruan të heshtnin. Ata që mbetën, mësuan të mbijetonin. Jo të shëronin — Të mbijetonin. Çdo ditë ishte një kompromis i ri me ndërgjegjen. Çdo korridor ishte një kujtesë se sistemi nuk kishte dështuar rastësisht, por me metodë.

Arbeni ishte një nga ata që e pagoi më shtrenjtë. Ai nuk u thye vetëm nga sëmundja, por nga institucioni që duhej ta mbronte. Spitali e gëlltiti, e izoloi, e harroi. Dhe kur doli prej tij, nuk ishte më i njëjti njeri. Ai ishte dëshmi e gjallë se si pushteti, kur mbetet pa kontroll, mund të shkatërrojë jo vetëm ndërtesa, por edhe mendje, karriera dhe dashuri. Elira, nga larg, e ndiqte këtë histori si gazetare, por edhe si njeri i përfshirë. Çdo dokument që lexonte, çdo dëshmi që mblidhte, i dukej si një plagë tjetër që hapej. Ajo e kuptoi se spitali ishte vetëm një rast; Simboli i vërtetë ishte shteti që

kishte braktisur qytetarët e vet. Një shtet ku institucionet publike ishin kthyer në prona private, ku shëndeti dhe drejtësia ishin mall tregu. Historia nuk ishte më vetëm personale. Ajo ishte shndërruar në aktakuzë. Elira e dinte se po hynte në territor të rrezikshëm. Të prekësh spitalin do të thoshte të prekësh interesa, emra, pushtet. Por heshtja ishte bashkëfajësi dhe ajo nuk mund të heshtte më. Spitali mbeti aty, një godinë e heshtur, por me zë të fortë për ata që dinin ta dëgjonin. Ishte plagë e një vendi që nuk ishte shëruar kurrë nga e shkuara dhe simbol i një të tashmeje që vazhdonte të prodhonte dhimbje.

Dhe diku, mes dokumenteve dhe ëndrrave, mes dashurisë së humbur dhe të vërtetës së zbuluar, historia mori një kthesë pa kthim.

Hijet e kuqe dhe azili i Bac Dhelprës

Hijet e kuqe nuk u zhdukën me dënimet. Ato thjesht ndryshuan formë. Disa u ulën në heshtje, disa u shpërndanë nëpër zyra të tjera, disa u fshehën pas ligjeve të reja që mbanin po të njëjtën frymë të vjetër. Sistemi i kishte mësuar mirë këto lëvizje: Të mbijetonte duke u dukur se po ndryshonte.

Në opinionin publik u fol për drejtësi, për pastrim, për kapitull të ri. Në realitet, vetëm maja e ajsbergut ishte prekur. Dosjet më të rënda mbetën të mbyllura, emrat më të fuqishëm u përmendën pa u thirrur kurrë. Hijet vazhdonin të ekzistonin, të padukshme, por aktive.

Arratisja e Bac Dhelprës ishte prova më e qartë. Ai nuk iku

nga frika e dënimit, por nga bindja se drejtësia po afrohej shumë pranë. Ikja e tij ishte e organizuar, e menduar me kohë. Një natë pa zhurmë, pa drita, pa fjalë. Ai me një valixhe të vogël, me dokumente të rregulluara, krejt papritur rruga iu hap drejt Turqisë.

Atje, ai u paraqit si viktimë. Si i përndjekur politik. Dosja e tij ishte e ndërtuar me kujdes: Rrëfime të përzgjedhura, fakte të shtrembëruara, heshtje të studiuara. Dhe sistemi i azilit, i verbër ndaj nuancave morale, e pranoi historinë e tij. Bac Dhelpra fitoi statusin që i siguronte mbijetesën, por jo qetësinë. Në Turqi, jeta e tij ishte e re vetëm në dukje. Çdo mëngjes zgjohej me një ndjesi ankthi, çdo zhurmë i dukej si hap pas shpine. Ai e dinte se nuk kishte shpëtuar — Kishte vetëm ikur. Kujtesa ishte ndëshkimi i tij më i rëndë. Netëve, hijet e kuqe që i kishte përdorur i shfaqeshin si fantazma që nuk e linin të flinte.

Elira e kuptoi se historia e Bac Dhelprës ishte më shumë se një arratisje individuale. Ishte modeli i një epoke: Ata që dëmtonin sistemin iknin dhe quheshin viktima; Ata që e kundërshtonin, mbeteshin aty. Ajo e trajtoi këtë temë me kujdes, pa emra të drejtpërdrejtë, por me fakte që flisnin vetë. Reportazhi i saj u bë pasqyrë e një realiteti të dhimbshëm.

Arbeni, kur dëgjoi për azilin, buzëqeshi hidhur.

- Dhelpra gjithmonë gjen strofull, - tha me zë të ulët. Por në sytë e tij nuk kishte as triumf, as mllef. Vetëm lodhje. Hijet e kuqe vazhdonin të jetonin, ndoshta më të qeta, ndoshta më

të kujdesshme. Por ajo që kishin shkatërruar nuk rikthehej më: Besimi. Dhe pa besim, çdo institucion ishte vetëm një ndërtesë bosh, si spitali që vazhdonte të rrënohej, ditë pas dite.

Historia që tregova unë, po i afrohet fundit. Jo me fitore të mëdha, por me të vërteta të hidhura. Dhe ndoshta ky ishte fundi më i ndershëm që mund të kishte.

Uashingtoni vazhdonte të zgjohej herët. Elira ecte çdo mëngjes në të njëjtat rrugë, mes ndërtesave të larta dhe monumenteve që nuk plakeshin kurrë. Jeta e saj ishte e rregullt, e mbushur me kronika, me lajme, me zëra që kërkonin të dëgjoheshin. Ajo kishte arritur gjithçka që dikur i dukej e pamundur. Emri i saj njihej, fjala e saj kishte peshë, por kishte fitore që nuk sillnin paqe.

Në studio, ajo fliste me siguri. Në mbrëmje, heshte. Në dritaren e shtëpisë së saj, dritat e qytetit shndërroheshin në yje të ftohtë. Atëherë mendja i shkonte te Arbeni. Jo si dikur, me ankth dhe pyetje, por me një qetësi të dhimbshme, si një plagë që nuk dhemb më, por nuk shërohet kurrë.

Arbeni jetonte në heshtje. Nuk kërkonte më përgjigje. Ditët i kalonin të ngadalta, me libra të vjetër dhe shëtitje të shkurtra. Njerëzit e njihnin pak dhe ai nuk përpiqej të shpjegonte veten. Kishte mësuar të jetonte me humbjen, ta mbante brenda pa e nxjerrë jashtë. Heshtja ishte mënyra e tij për të mbijetuar. Ndonjëherë, natën, ai e shihte Elirën në ëndërr. Ajo ishte gjithmonë e qetë, e pandryshuar, sikur koha nuk e prekte dot. Ata nuk flisnin shumë. Nuk kishte

më pyetje. Vetëm praninë. Një afërsi që nuk kërkonte shpjegim. Edhe Elira, në netët e saj të gjata, e ndiente të njëjtën gjë. Një ëndërr e përsëritur, e butë, ku Arbeni ishte ai që kishte qenë gjithmonë. Aty nuk kishte spitale, as ikje, as dënime. Vetëm dy njerëz që kishin dashur njëri-tjetrin në mënyrën e vetme që u ishte lejuar.

Ata nuk u bënë kurrë çift në jetë. Fati e kishte ndarë rrugën e tyre në dy kontinente, në dy heshtje të ndryshme. Por dashuria e tyre nuk u shua. Ajo mbeti aty ku realiteti nuk kishte pushtet, në ëndërr.

Dhe ndoshta kjo ishte forma e fundit e shpëtimit: Të pranosh se disa dashuri nuk janë për t'u jetuar, por për t'u mbajtur gjallë, në heshtje, deri në fund.

Baci dhe pasojat e shkeljes së ligjit

Baci, ish-kryetar i SHIK-ut, kishte qenë gjithmonë një njeri që dinte të manipulonte situatat. Ai kishte përdorur pushtetin për interesa personale, duke dëmtuar lëvizjen e demokratëve, duke cenuar të vërtetën dhe duke krijuar frikë mes qytetarëve. Për vite me radhë, ndikimi i tij kishte shkatërruar karriera, kishte mbyllur mundësi, dhe kishte krijuar një sistem ku fajtorët mbeteshin të paprekshëm. Kur drejtësia filloi të afrohej, Baci e kuptoi se loja kishte mbaruar. Nuk ishte vetëm humbja e pushtetit; Ishte paralajmërimi se çdo veprim që kishte bërë kishte pasoja. Ai organizoi largimin e tij me kujdes, natën, pa lajmëruar askënd. Turqia u bë strehë e tij e re. Atje kërkoi dhe fitoi azil politik, duke u prezantuar si i përndjekur, viktimë e një sistemi të padrejtë.

Por jeta në Turqi nuk ishte shpëtim i plotë. Çdo hap që bënte i kujtonte dëmet që kishte shkaktuar. Ai e dinte se shumë njerëz, shumë ide dhe shumë kauza ishin thyer nga veprimet e tij. Partia e demokratëve që kishin dashur të gjithë, mbeti në opozitë. Gjithçka kishte lënduar rëndë, ky njeri, imazhi i tij. Njëkohësisht i fuqishëm dhe i frikshëm, tani mbetej vetëm si një figurë e padukshme, që fshihej pas dokumenteve dhe ligjeve të azilit.

Në rrugët e Stambollit, mes turmave dhe dritave, ai ecte pa gjurmë. Askush nuk e njihte. Ishte i lirë, por i izoluar. Nuk kishte aleatë, nuk kishte pushtet të sigurt. Azili e shpëtoi nga dënimi, por jo nga ndërgjegjja. Çdo natë, kur heshtja e qytetit mbulonte rrugët, kujtesa e atyre që kishte dëmtuar i kthente të gjitha veprimet në gjurmë të pashlyeshme.

Dhe ndërsa Baci jetonte në një tokë tjetër, historia që kishte krijuar mbetej pas tij: Plagë në spital, dëmtime në lëvizjen demokratike, hije të kuqe që nuk kishin ikur plotësisht. Ai kishte fituar mbijetesën, por jo shpëtimin. Dhe ndoshta ky ishte dënimi më i madh: Liria e tij ishte e thjeshtë, por pesha e të shkuarës e shoqëronte në çdo hap. Baci, ish-kryetar i SHIK-ut, nuk ishte thjesht një emër që u harrua me azilin. Ai ishte simboli i një sistemi që kishte shkatërruar shpresën e njerëzve. Për vite me radhë, veprimet e tij kishin frikësuar, manipulimin dhe spiunazhin e kishin bërë normë dhe demokracia që duhej të rritej, ishte shkatërruar në rrënjë. Çdo vendim i tij kishte bërë që njerëzit të lëviznin me kujdes, duke frikësuar iniciativën e re, duke lënë pas dhimbje që

nuk shëroheshin. Kur drejtësia filloi të afrohej, Baci kuptoi se nuk kishte më mbrojtje. Ai nuk priti që ndëshkimi ta gjente. Organizoi ikjen e tij me përpikmëri, duke lënë pas gjithçka: Emrin, pushtetin, shtratin e njohur të zyrës. Turqia u bë azili i tij i ri dhe dokumentet që tregonin se ishte i përndjekur politik ishin mjeti që i siguronte lirinë e jashtme. Por liria e brendshme mbetej e munguar. Kujtesa e atyre që kishte dëmtuar dhe tërë plagët që kishte krijuar e ndoqën kudo.

Spitali, që dikur kishte qenë vend i shërimit, tani ishte një godinë e gjysmë-gërmadhë, simbol i shkatërrimit që kishte nisur me veprimet e hijve të kuqe. Arbeni, i cili kishte vuajtur brenda mureve të tij, ndjente se çdo hap i Bacit në azil ishte një goditje e re për të gjithë ata që kishin besuar te sistemi. Dëmi i bërë ndaj lëvizjes demokratike nuk mund të shërohej, edhe pse drejtësia kishte bërë një hap përpara.

Elira, nga larg, mbante shënime. Çdo reportazh për azilin e Bac Dhelprës ishte një provë se të gjitha veprimet, sado të fshehura, lënë gjurmë. Ajo e kuptoi se histori të tilla nuk përfundonin thjesht me ikjen e fajtorit. Pasojat mbeten, plagët e shoqërisë nuk shërohen vetëm nga ligjet dhe demokracia e dëmtuar kërkon më shumë se dënime individuale. Baci jetonte tani në një qytet tjetër, por gjithçka që kishte krijuar e ndiqte. Ishte i lirë nga dënimi, por jo nga kujtesa e kolektivitetit që kishte plagosur. Rrugët e Stambollit, ndonëse të gjera dhe të zhurmshme, ishin për të njëlloj si korridoret e spitalit: Të ngushta, të mbushura me

fantazma të së kaluarës, të rrethuar nga hijet që nuk mund t'i shmangte.
Ndërsa Arbeni dhe Elira vazhdonin jetën e tyre në qytete të ndryshme, rrjedha e pasojave nga veprimet e Bacit lidhte të gjithë ata. Ai ishte larg, por prezenca e tij ishte gjithmonë këtu: Në heshtjen e spitalit, në ngurrimin e drejtësisë, në zemrat e atyre që kishin besuar dhe vuajtën.
Kështu, historia e Bac Dhelprës, e hijve të kuqe dhe e azilit u bë një paralajmërim: Liria mund të fitohet me dokumente dhe pasaporta, por përgjegjësia dhe ndërgjegjja nuk mund të ikin kurrë. Dhe ata që mbajnë pushtet duhet ta dinë se çdo veprim, çdo dëmtim, mbetet i gjallë në gjurmët që lënë pas.
Spitali mbeti gjysmë gërmadhë. Planet për modernizim, për pajisje të reja, për staf të trajnuar, gjithçka u harrua si një ëndërr e shuar. Qyteti vazhdonte të ecte përpara, por plagët e tij brenda, ato të njerëzve që kishin kaluar aty, mbeteshin të hapura. Muret e bardha nuk shëronin më, ato thjesht mbajnë erën e kujtimeve të vjetra, të dhimbshme dhe të heshtura.
Publiku e kishte harruar historinë që spitali kishte mbartur. Dokumentet, dosjet dhe raportet që tregonin për korrupsionin, shkeljet dhe dhimbjet, u lanë në arkiva të fshehta. Vetëm disa emra mbetën në kujtesën e pak njerëzve: Arbeni, Elira dhe ata që kishin mbijetuar tërë këtë rrëmujë. Ndërtesa, simbol i një sistemi të dështuar, ishte kthyer në një vend ku asgjë nuk ndryshonte, ku gjithçka

vidhej pa kontroll dhe ku jeta vazhdonte për të tjerët, pa dhimbjet e së kaluarës.

Për shumë qytetarë, spitali nuk ishte më se një ndërtesë tjetër në horizont, një pjesë e qytetit që askush nuk i kushtonte vëmendje. Por për ata që kishin parë, ndjerë dhe përjetuar çdo plagë të tij. Ai mbetej një kujtesë e gjallë: një vend ku jeta dhe vdekja, padrejtësia dhe guximi, dashuria dhe humbja ishin përplasur pa kompromis.

Muret e tij të çara flisnin për ata që kishin luftuar për drejtësi dhe për ata që kishin ikur në heshtje. Çdo dhomë, çdo korridor, mbante ende jehonën e të qarave dhe të dhëmbjeve, si një simfoni e heshtur që askush nuk dëgjonte. Dhe megjithatë, ndërtesa qëndronte, si një kujtesë se historia nuk mund të fshihet plotësisht. Edhe kur modernizimi dhe pushteti zgjedhin të harrojnë.

Ata që kishin mbijetuar, si Arbeni dhe Elira, e mbajnë këtë kujtesë brenda tyre. Çdo hap, çdo vend që vizitonin, i rikthente tek plagët e së kaluarës. Por aty ku spitali nuk mund të shëronte më, zemrat e tyre kishin gjetur mënyra të tjera për t'u përballur: Me kujtime, me heshtje, me ëndrrat që nuk mund të shuheshin. Dhe kështu, ndërsa qyteti vazhdonte të rritej dhe ndërtesat e reja të ngriheshin mbi rrënoja. Spitali mbeti një simbol i dhimbjes së harruar, një plagë që nuk do të shërohej kurrë, por njëkohësisht një kujtesë forcës së atyre që kishin guximin të përballeshin me të

Ëndrra e pakapshme – Uashington, natë. Elira qëndron

pranë dritares së shtëpisë së saj. Telefonin e mban të fikur, por mendja e saj është me Arbenin.

Elira (në heshtje dhe shpesh duke folur me vete): Arben… çfarë do të ishte nëse mund të ishim bashkë? Në një botë ku nuk ka spitale, ikje, hije të kuqe…

Një moment heshtjeje. Në të njëjtën kohë, në qytetin tjetër, Arbeni uli kokën mbi një libër të vjetër dhe buzëqesh hidhur.

Arbeni (me vete): Elira… Gjithçka që nuk patëm, gjithçka që na ndau… Ee gjej vetëm te ëndrrat.

Natën, në ëndrrën e tyre të përbashkët, ata takohen. Nuk ka nevojë për fjalë të gjata, heshtja është duke folur me sy.

Elira: Arben Je i gjallë… Këtu, tek unë.

Arbeni: Po… Këtu nuk ka as spital, as hijë të kuqe, as dhimbje që të ndajnë. Vetëm ne.

Elira: Dhe mëngjesi… Gjithmonë na kthen në botën tonë të ndryshme.

Arbeni (duke e mbajtur dorën e saj): Distancat nuk mund të na ndajnë kur ëndërrojmë së bashku. Ëndrrat janë vendi ku gjithçka është e mundur.

Elira: Por a mjafton vetëm ëndrra, Arben? A është e mjaftueshme të duam dikë vetëm në heshtje?

Arbeni: Ndonjëherë, po. Nëse e mbajmë të pastër, e pa kompromet uar nga koha, nga dhimbja, apo padrejtësia… Atëherë dashuria jonë mbetet e përjetshme.

Ata qeshin lehtë, një buzëqeshje që mban mallin dhe lumturinë e munguar. Pastaj nata shkon drejt fundit.

Elira: Do të shohim një ditë… Ndoshta jo në këtë botë. Por këtu, në ëndrrën tonë, ne gjithmonë do jemi bashkë.
Arbeni: Gjithmonë, Elira,… gjithmonë.
Dritat e qyteteve ndizen, duke shënuar kthimin në realitet. Elira kthehet tek dritarja e shtëpisë së saj, Arbeni ul kokën mbi librin e tij. Të dy ndiejnë të njëjtin boshllëk, por edhe një qetësi të çuditshme: Dashuria e tyre nuk mund të shuhej kurrë.

Uashington, natë.
Elira qëndron pranë dritares. Dritat e qytetit shtrihen poshtë saj si një det i ftohtë neonesh, rrugët janë pothuajse të zbrazëta, pa zë, pa ritëm. Xhami i ftohtë i prek ballin, ndërsa ajo flet me vete, por zëri i saj është një thirrje e heshtur drejt Arbenit.
Elira (në heshtje): Arben…, sa shumë më mungon ajo që kurrë nuk patëm. Çdo ditë këtu është një hap drejt suksesit, por zemra,… zemra mbetet gjithmonë bosh.
Në një qytet tjetër, larg dhe i mbyllur në vetminë e tij, Arbeni rri zgjuar. Ai mbante kokën ulur mbi një libër të vjetër e ku faqet e verdha nuk i lexonte më. Mendja i kthehet pa pushim spitalit, korridoreve të tij të ftohta dhe hijeve të kuqe që nuk u larguan kurrë prej tij. Ato nuk janë më thjesht kujtime. Janë shenja të ngulitura thellë në ndërgjegje, njolla që koha nuk i shpërlan dot. Në heshtje, ai flet me vete, sikur t'i drejtohej shpirtit të saj.
Arbeni (me vete): Elira… çdo plagë që kam parë aty brenda

je ti. Çdo hije e kuqe më kujton ty. Vetëm në ëndrra kam gjetur paqe.

Dhe pikërisht aty, në atë hapësirë ku dhimbja nuk kishte pushtet, ata u takuan. Në ëndrrën e tyre të përbashkët, shfaqej një rrugicë e qetë, pa zhurmë, pa kalimtarë, pa dritare që shikonin. Qyteti nuk ekzistonte më. Ishte fshirë si një kujtim i panevojshëm.

Elira iu afrua dhe i kapi dorën, sikur të donte të bindte veten se ai ishte i vërtetë.

Elira: Je i gjallë.,… këtu, tek unë.

Arbeni: Po… këtu nuk ka as spital, as hije të kuqe, as dhimbje. Vetëm ne. Vetëm kjo heshtje që flet më shumë se çdo fjalë.

Ata ecën ngadalë përgjatë rrugicës, ndërsa koha dukej e ngrirë, si të kishte harruar të vazhdonte rrjedhën e saj. Çdo hap ishte një çlirim i vogël, çdo frymëmarrje një premtim i heshtur.

Elira: Dhe mëngjesi gjithmonë na kthen në botët tona të ndryshme… Ndonjëherë më duket se kjo është e pamundur.

Arbeni: Distancat nuk kanë pushtet këtu. Nuk ka kohë që mund të na ndajë. Ëndrrat janë vendi ku gjithçka mund të ndodhë.

Elira u ndal dhe e shikoi me një trishtim të butë, si një pyetje që kishte kohë që kërkonte përgjigje.

Elira: Por a mjafton vetëm ëndrra? A është e mjaftueshme të duam dikë vetëm në heshtje?

Arbeni e shikoi drejt në sy, pa frikë, pa dyshim.

Arbeni: Është më shumë se mjaftueshëm, sepse këtu dashuria jonë është e pastër—E pa kompromet uar nga dhimbja, nga koha, apo nga padrejtësia. Këtu, ne nuk jemi plagë, por shërim.
Elira heshti për një çast, pastaj buzëqeshi lehtë, si dikush që e di se agimi po afrohet.
Elira: Nëse kjo është e vetmja mënyrë për të qenë bashkë. Atëherë le të mos zgjohemi kurrë krejtësisht. Le të jetojmë mes dy botëve, derisa realiteti të na gjejë më të fortë.
Ata vazhduan të ecin, dorë për dore, ndërsa rrugica humbiste ngadalë në dritë—Një dritë që paralajmëronte zgjimin, por që nuk mund ta shkatërronte atë që kishin ndërtuar në heshtje.
"Mendoj se kjo është mënyra e vetme për të ruajtur atë që kemi pasur… Nuk mund të rikthehet realiteti, por kjo… Kjo është e përjetshme. "Ëndrrat''
Një heshtje e ngadaltë mbush ajrin. Ata ndihen pranë njëri-tjetrit, edhe pse e dinë se mëngjesi do t'i ndajë sërish.
Arbeni: Elira… Edhe pse nuk mund të jemi bashkë në këtë botë, çdo natë do të të takoj këtu. Nuk ka asnjë forcë që mund ta marrë këtë nga ne.
Elira: Poo Gjithmonë, Arben… Gjithmonë. Do jemi bashkë. Një.. buzëqeshje e heshtur dhe e dhimbshme përfshin eterin. Ata ecin së bashku në errësirë, duke folur pa fjalë, duke ndjerë, çdo kujtim, çdo plagë të shënuar në shpirtin e tyre. Në netët e tjera, ëndrra ndryshon paksa, por gjithmonë ata gjejnë njëri-tjetrin në të njëjtin vend, duke folur për gjithçka

që nuk mundën të thonë në realitet:
Elira: Kam frikë se do të harrohet gjithçka që ndodhi… Spitali, dhimbjet, çdo luftë për të drejtën.…….
Arbeni: Harresa mund të marrë gjithçka jashtë, por jo këtu. Këtu kemi kujtesën tonë, këtu jemi të lirë. Çdo plagë që kemi mbajtur, çdo humbje, çdo fitore – Janë tonat vetëm në këtë vend.
Elira: Dhe dashuria jonë… Nuk do të shuhet kurrë.
Arbeni: Asnjëherë….
Ata qëndrojnë në heshtje, duke shikuar qiellin e errët. Dritat e qyteteve të largëta shkëlqejnë si yje të heshtur, duke mbajtur gjurmët e ëndrrës së tyre.
Elira (duke buzëqeshur): Ndoshta kjo është mënyra më e mirë për të mbajtur të gjallë atë që nuk mundi të jetojë në realitet.
Arbeni: "Një vend mes ëndrrës dhe realitetit… Aty ku ne jemi gjithmonë bashkë."
Dhe kështu, ndërsa nata vazhdon dhe qytetet zhyten në heshtje, Elira dhe Arbeni gjejnë paqe në një dashuri që nuk mund të preket nga koha, pushteti, apo harresa. Vetëm ëndrrat mbajnë gjallë atë çka nuk mund të jetojë në realitet.
Elira (duke folur me vete): Çdo gjë këtu duket e përkryer… Por brenda meje, gjithçka është bosh. Çfarë do të kishte ndodhur po të ishim bashkë, Arben? Po të mos kishte spital, hijet e kuqe, pushteti që gjithçka e shkatërronte?
Në qytetin tjetër, Arbeni ul kokën mbi librat e tij të vjetër, duke ndjerë të njëjtin mall.

Arbeni (me vete): Elira… çdo hap që kam bërë pas atyre ditëve. Më je kujtuar ti në gjithë heshtjen që kam mbajtur ke qenë gjithmonë brenda ti, gjithçka më rikthen tek ti. Vetëm tek ëndrrat me ty e gjej paqen…….

Në botën e ëndrrave, ne ecim përgjatë një rrugice të qetë. Ajri është i ngrohtë, qyteti i tyre është i heshtur, pa muret e bardha të spitalit dhe as hijet e kuqe që ndjekin gjithçka. Çdo ëndërr e shikoj me ty.

Në fund të fundit, ne ishim ëndrra, nuk ishim realitet. Të paktën aty i kemi takimet e lira. S'na ndjek njeri. S'kemi hije, as sigurimsa. Asgjë nuk na ndalon të jemi bashkë. Të jetojmë në këtë ëndërr të përnatshme.

"Është e pabesueshme… Të jesh këtu me ty, pa asgjë që na ndan."

Arbeni: Askush nuk mund të na ndajë këtu. Kjo është bota jonë, Elira. Vetëm ne dhe heshtja që flet më shumë se çdo fjalë.

Elira: Dhe mëngjesi gjithmonë na kthen në realitet. Distancat, qytetet, bota reale.

Lind, pas ndarjes sonë së përnatëshme. Sa keq që lind dita…

Arbeni (duke buzëqeshur lehtë): Këtë nuk mund ta ndalojë asgjë. Edhe në botën e realitetit, ne jemi të lidhur… Edhe në heshtje, edhe në kujtime.

Ne jemi pranë një lumi të imagjinuar, ku dritat e qytetit reflektojnë mbi ujin e qetë……Ne jemi në parajsën e ëndrrave që s'u bënë realitet kurrë.

Elira: Kam frikë se një ditë gjithçka do të harrohet. Spitali,

dhimbjet, lufta për drejtësi…E çdo hap i vështirë që kemi bërë së bashku, sikur të mos ketë ekzistuar kurrë.
Arbeni: Harresa mund të marrë gjithçka nga jashtë, Elira — Emra, data, mure. Por jo këtë.
(ai prek gjoksin, zemrën.)
"Në këtë vend të ëndrrave që mbajmë brenda nesh, çdo plagë, çdo humbje, çdo fitore është e jona. Ato nuk zhduken; Thjesht shndërrohen në kujtesë që na mban gjallë."
Ata ecin dorë për dorë. Në imazhin që krijon ëndrra, heshtja e natës i mbështjell ngadalë, si një mburojë e padukshme, ku dhimbja pushon së bërtituri dhe shpresa mëson të marrë frymë. Elira: Dhe dashuria jonë… Nuk do të shuhet kurrë?.
Ajo do të jetë në parajsën e ëndrrave të parealizuara.
Arbeni: "Asnjëherë nuk do harrohemi, Elira. Edhe kur gjithçka tjetër të venitet. Dashuria jonë do të mbetet dritë. Asnjëherë nuk do të zhduket…
Natë vonë, ëndrra që zgjasin.
Një qetësi e thellë mbush ajrin. Ata ndihen të sigurt në këtë vend, të lirë nga çdo shqetësim. Të mbrojtur nga çdo lloj dhimbjeje fizike ose politike.
Elira: Më duket e pabesueshme… Se si një ëndërr mund të jetë më reale se çdo realitet që kemi jetuar.
Arbeni: Sepse kjo është e vetmja gjë që nuk mund të preket nga koha, nga pushteti, nga dhimbja… Një vend mes ëndrrës dhe realitetit, ku ne jemi gjithmonë bashkë.
Dritat e qyteteve të largëta shkëlqejnë si yje të heshtur, duke mbajtur gjurmët e dashurisë së tyre. Çdo natë ata takohen

atje, çdo natë e ruajnë atë që nuk mundi të jetojë në realitet. Elira (duke shikuar nga dritarja në Uashington): "Edhe pse bota jashtë vazhdon të jetojë në kaosin e pamundësive, këtu në botën ëndrrave… Gjithçka është e mundur. Këtu dashuria jonë nuk mund të shuhet."kurrë''……

Dënimi i hijes së kuqe dhe Bac Dhelpra

Arbeni u ul ngadalë mbi librin e hapur, sikur faqet të ishin një strehë e përkohshme. Mbylli sytë dhe frymëmarrja iu qetësua. Zëri i tij u shua në heshtje, por fjalët mbetën pezull në ajër:

Arbeni (me vete): Gjithmonë… gjithmonë do të jemi bashkë. Në heshtje, në dritë, në ëndrrën tonë.

Por mendja nuk i bindej qetësisë. Kujtime të tjera u kthyen— Më të rënda, më të errëta. Dënimi i hijes së kuqe, që kishte lënë pas plagë të hapura dhe ikja e Bac Dhelprës në Turqi. Një arratisje që nuk ishte kurrë shpëtim.

Arbeni: Bac Dhelpra… iku. U largua nga drejtësia, por jo nga dhimbja që la pas. Ai u bë i keq për ata që lëvizën për të drejtën, për demokratët e vërtetë e për shumë njerëz të pafajshëm. Mendoi se kufijtë do ta shpëtonin. Por ai nuk mundi të ikë nga kujtimet e mia.

Ajo hije e kuqe nuk ishte më vetëm simbol i dhunës; Ishte plagë kolektive. Dhe Elira, edhe pse larg, e ndiente peshën e saj.

Dhimbja që kaloj mbetet si një dënim. Ajo shfaqet ëndrrat e saj. Elira përditë zgjohej me një ndjesi boshllëku që nuk dinte ta emërtonte. Prandaj Arbeni e kuptoi se ajo që e

rëndonte nuk ishte vetëm dhimbja e tij—Ishte dhimbja e të gjithëve, e atyre që u lënduan pa zë dhe u lanë pas në harresë.
Elira: Çdo natë e ndiej atë boshllëk. Nuk është vetëm për ne…, është për të gjithë ata që u lënduan, që u harruan.
Arbeni: Po. Dhe asgjë nuk e shëron plotësisht. Realiteti i ka shpallur të humbur. Vetëm ëndrrat arrijnë t'i mbajnë gjallë, si kujtim, si dëshmi, si shpresë.
Ata takohen sërish në ëndrrën e përbashkët. Një rrugicë e qetë shtrihet para tyre, e mbështjellë nga natyra dhe heshtja. Qyteti nuk ekziston më. Nuk ka zhurmë, nuk ka pushtet, nuk ka frikë.
Elira: Dua të di… A është e mjaftueshme dashuria vetëm në ëndërr?
Arbeni: Po. Në këtë botë, ajo është e pastër, e paprekur. Këtu nuk ka gabime, nuk ka humbje, nuk ka pushtet.
Elira: Është e pabesueshme… Si një ëndërr mund të jetë më reale se çdo realitet që kemi jetuar.
Arbeni: Sepse kjo është e vetmja gjë që koha dhe dhimbja nuk e prekin. Një vend mes ëndrrës dhe realitetit—Ku ne jemi gjithmonë bashkë.
Momente intime në ëndërr
Natë. Rrugicat e heshtura krijojnë një botë vetëm për ta. Dritat e largëta derdhen mbi ujërat e qeta të lumit, si kujtime që nuk duan të shuhen. Ajri është i ngrohtë, i ngopur me aromën e kohëve të humbura.
Elira i kap dorën Arbenit. Gishtat e tyre ndërthuren pa

frikë, sikur asgjë tjetër të mos ekzistonte.
Elira: Je këtu… Dhe gjithçka më duket si dikur. Këtu nuk ka plagë. Asnjë dhimbje nuk na ndan.
Arbeni buzëqesh lehtë, me një qetësi që nuk e njeh në botën reale.
Arbeni: Po… vetëm ne, Elira. Kjo është e vetmja botë ku jemi të lirë. Nuk ka spitale, nuk ka pushtet, nuk ka hije të kuqe.
Ecën ngadalë përgjatë rrugicës së ngushtë. Duart e lidhura, shikimet e thella flasin më shumë se çdo fjalë.
Elira: Më mungon çdo ditë që nuk ishim bashkë… çdo çast që humbëm.
Arbeni ndalet për një çast, e shikon drejt e në sy.
Arbeni: Por këtu nuk ka humbje. Të gjithë të humburit gjenden këtu, tek ne. Çdo buzëqeshje, çdo prekje është e përjetshme. Nuk ka asgjë të rreme mes nesh. Jemi vërtet të dashuruar…, përgjithmonë.
Ata ndalojnë pranë një ure të vogël. Poshtë tyre, uji pasqyron dritën e natës. Arbeni e tërheq Elirën më afër.
Arbeni: Shiko… çdo natë mund të kthehemi këtu. Nuk ka realitet që mund të na ndajë."
Elira mbështet ballin te kraharori i tij.
Elira: Këtu mund të të prek. Të ndiej në gjithçka që realiteti na e mohon.
Ata heshtin. Një buzëqeshje e vogël. Një prekje e lehtë e gishtave me mall dhe dashuri të pashuar i kthen në realitet.
Elira: Edhe pse mëngjesi na kthen në botët tona të

ndryshme… Këtu jemi gjithmonë bashkë.
Arbeni: Gjithmonë, Elira. Këtu dashuria jonë është e paprekshme.
Këtu është bota jonë e parekur, përgjithmonë bashkë…..
Nata shtrihet e qetë mbi qytetin e ëndrrës. Ata ecin dorë për dore, duke ruajtur çdo çast—Sepse realiteti mund t'i zgjojë, por nuk mund t'ua marrë atë që kanë ndërtuar në heshtje.
Arbeni: Këtu nuk ka kufij. Nuk ka spital, nuk ka hijë të kuqe, nuk ka asgjë që mund të na ndajë.
Ata ecin mbi urën e vogël, por ura nuk është më prej guri. Ajo rri pezull mbi lumin e qetë si një vijë drite, ndërsa uji poshtë nuk rrjedh — Ai kujton. Dritat nuk vijnë nga llambat e qytetit, por nga vetë ajri, sikur nata të ndriçohej nga frymëmarrja e tyre. Çdo hap nuk i çon përpara, por më thellë.
Elira: Dua t'i ndiej të gjitha… Jo si trup, por si kujtesë. Çdo buzëqeshje që s'u tha kurrë, çdo shikim që mbeti pezull, çdo frymë që realiteti na e mohoi."
Arbeni nuk flet menjëherë. Zëri i tij vjen si nga një largësi e brendshme.
Arbeni: Sepse kjo nuk është më botë reale. Është hapësira mes dy mendimeve. Këtu ndjenjat nuk lëndohen. Ato vetëm ekzistojnë.
Ata ndalojnë përballë njëri-tjetrit. Sytë e tyre nuk pasqyrojnë fytyrën, por dritën. Një prekje gishtash mjafton për të hapur një rrymë të padukshme mes tyre. Ndoshta vetëm dashuritë që kapërcejnë njeriun arrijnë këtë rrezatim. Jo

sepse janë të mbinatyrshme, por sepse janë të çliruara nga frika e humbjes. Elira ngre sytë lart. Qielli nuk ka yje; Ka kujtime që pulsojnë ngadalë.

Elira: Kjo Është më reale se jeta… Si mundet që në ëndërr të ndiejmë më shumë se në realitet?

Arbeni buzëqesh, por buzëqeshja e tij nuk është më në fytyrë. Është në zë.

Arbeni: Sepse realiteti kërkon prova. Ëndrra kërkon vetëm besim. Këtu nuk ka gabime, Elira. Nuk ka humbje. Vetëm vazhdim.

Rrugicat përreth nuk janë rrugë. Janë kujtime që nuk u jetuan kurrë, por që ende kërkojnë trup. Drita i ndjek butësisht, sikur vetë ëndrra të mos donte t'i linte të iknin.

Elira: Gjithçka që nuk patëm, na u mor para se ta jetonim.

Arbeni ndalet. Koha ndalet bashkë me të.

Arbeni: Asgjë nuk u mor. Ajo që është e vërtetë nuk humbet. Thjesht zhvendoset. Dhe ne u zhvendosëm këtu.

Ata ecin më tej, ose ndoshta qëndrojnë. Në këtë vend, ecja dhe qëndrimi janë e njëjta gjë.

Ëndrra mbyllet ngadalë rreth tyre, jo si fund, por si premtim. Të gjitha gëzimet tona, dashurinë tonë na i morën të pashpirtët, të pamoralët.

Hijet e kuqe komuniste, por ne jemi bashkë. Kemi qenë kurdoherë bashkë. Këtu nuk ka asgjë të humbur. Çdo plagë që kemi mbajtur, çdo dhimbje,… është jona. E ruajtur këtu, në heshtje dhe dritë.

Ata ndalojnë pranë një liqeni të vogël të ëndrrës. Reflektimi

i dritave mbi ujin e qetë i bën të ndjejnë një përjetësi.
Elira: Shiko… çdo gjë është e qetë, çdo gjë është e mundur. Përse realiteti duhet të jetë gjithmonë kaq i dhimbshëm?
Arbeni: Sepse këtu, në këtë vend mes ëndrrës dhe realitetit. Ne gjejmë gjithçka që bota reale na mohon. Dashurinë tonë, pa kufij, pa dhimbje.
Elira: Dhe kjo është e vetmja mënyrë për ta mbajtur të gjallë dashurinë tonë… Të paprekur dhe të përjetshme.
Ata prekin njëri-tjetrin butësisht, çdo prekje është si një fjalë pa zë që thotë gjithçka. Ata ecin dorë për dorë përgjatë rrugëve të ëndrrës, duke folur dhe heshtur në të njëjtën kohë. Çdo shikim është i thellë, çdo buzëqeshje e ngrohtë. Toka nuk është më vend dashurie, por lufte mes krijesave të njëjta. Ajo është agresive dhe vrasëse. Si në mëngjes ku gjithçka rikthehet në realitet. Por këtu ne jemi të paprekshëm.
"Sa mirë që jemi në botën ireale Ku këta vampirë s'mund të na kafshojnë. Ne jemi në botën tonë të dashurisë së përjetëshme. Gjithmonë do të gjejmë njëri-tjetrin. Këtu nuk ka spital, nuk ka hijë të kuqe, nuk ka dhimbje… Vetëm ne."…
Ata rrinë të përqafuar në ëndërr, në një realitet tjetër tredimensional dhe në një heshtje të gjatë që mbush natën. Aty ata ndjejnë një qetësi që nuk e kanë ndjerë kurrë jashtë ëndrrës.
Elira: Ëndrra jonë është më e fortë se çdo realitet. Këtu dashuria jonë nuk mund të shuhet … Gjithmonë drita vjen pas errësirës. Është realitet fizik. Ne do ta presim atë realitet

…. Këtu në këtë qytet …Në Uashington, qyteti i dashurisë do ta quajmë.

Ata ecin përgjatë një urë të vogël druri mbi lumin e qetë. Dritat reflektojnë mbi fytyrat e tyre, dhe heshtja e natës i bën çdo prekje të duket e përjetshme.

Elira (duke e kapur dorën e Arbenit më fort}

Jo si prekje, por si mendim që i pushtoi vetëdijen. Një afërsi e heshtur, që nuk kërkonte trup për të qenë reale.

Elira (me zë të ulët, sikur t'ia thoshte vetes): Të ndiej… jo vetëm në trup, por si mungesë që më mbush. Çdo buzëqeshje që s'e dhamë kurrë, çdo frymë që e ndalëm në gjysmë… Gjithçka që realiteti na e ndaloi, këtu më pushton.

Arbeni nuk u afrua menjëherë. Qëndroi aty, në distancën më të rrezikshme. Atë distancë ku dëshira fillon të mendojë.

Arbeni: "Këtu nuk ka gabime, sepse këtu nuk ka frikë. Vetëm vetëdije. Vetëm ne, ashtu siç nuk guxuam të ishim. Çdo gjë që nuk e jetuam, e ndiejmë.

Ata ndaluan pranë lumit si gjithmonë. Uji ishte i qetë, por jo i vdekur. Si një mendje që fsheh trazira nën sipërfaqe. Reflektimi i dritës dridhej lehtë, si një mendim i ndaluar që nuk largohet.

Elira: Është e çuditshme… kjo ndjesi. Nuk më prek askund, por jam e mbushur kudo.

Arbeni e shikoi, Jo si burrë që e dëshironte, por si njeri që e njeh thellë tjetrin.

Arbeni: Kjo është erotika që nuk konsumohet. Ndjenja që rritet, sepse nuk shteret. Dashuria jonë këtu nuk shkon

drejt shpërthimit. Ajo shkon drejt thellësisë.
Ata ecën ngadalë, dorë për dorë, por gishtat i tij nuk shtrënguan. Ishte një prekje e përmbajtur, pothuajse mendore. Frymëmarrjet u sinkronizuan pa u vënë re.
Elira: Më mungon ajo që nuk ndodhi kurrë… Jo si akt, por si mundësi. Ajo që mendja ime e ndërtoi natë pas nate.
Arbeni ndaloi. Nuk e pa menjëherë. Heshti. Pastaj foli me qetësi që digjte.
-Këtu nuk ka humbje. Çdo dëshirë e ndalur është ende gjallë. Ne nuk e kemi humbur—Ne e kemi ruajtur afrimitetin të paprekur.
Elira ngriti sytë drejt qiellit. Ndjeu se po i hiqej pesha e trupit, sikur të ishte bërë vetëm ndjenjë.
Elira: Ëndrra jonë nuk kërkon trup për të qenë e vërtetë… Ajo më njeh më mirë se çdo prekje.
Arbeni u afrua vetëm aq sa mendimet e tyre u përzien.
Arbeni: Këtu jemi të lirë sepse nuk kemi nevojë të provojmë asgjë. Këtu jeta bëhet e përjetshme.
Ata qëndruan ashtu, shumë pranë, pa u prekur më shumë, sepse ajo që po ndodhte nuk ishte trupore. Ishte një lidhje që digjte pa u djegur. Ata ndalojnë për një çast, duke qëndruar pranë njëri-tjetrit. Prekja e dorës, shikimi i thellë, dhe buzëqeshjet e heshtura janë të mjaftueshme për të thënë gjithçka.
Elira: Edhe pse mëngjesi na kthen në realitet… Këtu jemi të paprekshëm.
Arbeni: Gjithmonë, Elira. Këtu dashuria jonë nuk mund të

shuhet. Asnjë distancë, asnjë pushtet, asnjë kohë nuk mund ta ndryshojë.

Natën e fundit, ata ecin dorë për dorë përgjatë rrugëve të ëndrrës, duke ndjerë ritmin e zemrave të tyre, Duke folur pa fjalë, ku çdo shikim dhe prekje thotë më shumë se çdo dialog.

Elira: Këtu gjetëm çdo gjë që humbëm jashtë… Dashurinë e vërtetë e gjetëm në këtë vend të ëndrrës.

Arbeni: Kjo është bota jonë… E vetmja që nuk mund të preket nga realiteti. Gjithmonë do të jemi bashkë. Ata bën kryq dhe iu drejtuan qiellit, që ai ta bëjë realitet këtë dashuri, por dashuritë e mëdha nuk jetojnë në tokë. Ato janë gjithmonë në ajër dhe në kozmosin e përjetshëm të pastërtisë njerëzore.

Ata u bashkuan vetëm në ëndërr. Aty në ëndrrën e përjetëshme Arbeni gjendej në një hapësirë që i ngjante një korridori pa fund. Drita ishte e zbehtë, e përthithur nga mure që dikur kishin qenë të bardha. Aty ende ndihej fryma e spitalit, jo si vend, por si kujtesë. Njolla të padukshme dhimbjeje, hijet e kuqe që nuk ishin zhdukur as kur sytë mbylleshin.

Ai qëndroi i palëvizur, i mbërthyer nga ajo ndjesi që kthehet vetëm kur njeriu përballet me atë që nuk u shërua kurrë.

Arbeni (me vete): Gjithçka ishte e mbushur me plagë. Jo vetëm trupat, edhe muret i mbanin mend. Ai Baci iku, por ajo që la pas vazhdon të jetojë. Spitali nuk ishte thjesht një vend. Ishte prova se dhimbja mund të mbetet, sepse

vazhdon e njëjta padrejtësi. Në atë çast, prania e Elirës u ndje para se të shihej. Ajo u shfaq pranë tij, e qetë, sikur errësira të ishte hapur vetëm për të. Drita e natës i ndriçonte fytyrën me një butësi që nuk ekzistonte në kujtime.

"Arben… Ajo që pamë atje na lëndoi. Por këtu… Ndiej sikur plagët nuk na përkasin më."

Ai e pa, me një ndjesi çlirimi dhe peshe njëkohësisht.

Arbeni: Këtu nuk ka mure që mbajnë dhimbje. Nuk janë hijet që ndjekin. Jemi vetëm ne… Edhe pse brenda meje, kujtimet ende marrin frymë.

Ata nisën në udhëtim, ngadalë përgjatë një rrugice të qetë. Uji i lumit të ëndrrës reflektonte dritat e largëta, duke krijuar një qetësi që nuk kërkonte fjalë. Një erë e lehtë i shoqëronte, si një frymë që i mbante zgjuar. Elira i kapi dorën, jo fort, por mjaftueshëm për ta ndjerë.

Elira: Çdo hap këtu ka më shumë peshë se gjithë ditët që kaluam të ndarë. Këtu, koha nuk na ikën.

Arbeni u ndal. E pa drejt në sy, sikur donte ta mbante atë çast përgjithmonë.

Arbeni: Gjithçka që pamë, çdo plagë, çdo padrejtësi… Këtu e humb forcën e vet. Nuk zhduket, por nuk na sundon më. Ajo që mbetet është kjo: Ne të dy bashkë.

Ata vazhduan të ecin në heshtje, të mbajtur nga një ëndërr që, për herë të parë, i çlironte nga hija e kuqe. U ndalën pranë një liqeni të qetë. Prekja e duarve ishte e heshtur, por fliste më shumë se çdo fjalë.

Elira: Është e pabesueshme… Si mundet që një ëndërr të

jetë më reale se çdo realitet?
Arbeni buzëqeshi lehtë. Një buzëqeshje që nuk vinte nga gëzimi i zakonshëm, por nga një qetësi e fituar me mund. Sytë i qëndruan mbi Elirën sikur po e shihte për herë të parë, pa barrën e kujtimeve që rëndojnë, pa frikën e asaj që mund të humbej.
Arbeni: Këtu, çdo shikim, çdo prekje është përjetim i pastër. Nuk ka nevojë për mbrojtje, as për justifikime. Gabimet që na kanë ndjekur nuk kanë pushtet mbi ne. Dhimbja ekziston diku larg, si një jehonë që nuk arrin dot këtu.
Ai ndaloi për një çast, sikur po dëgjonte heshtjen.
-Vetëm këtu e kuptoj se sa shumë na ka mashtruar realiteti. Na mësoi të dyshojmë, të frikësohemi, të mbajmë distancë. Por këtu, distanca nuk ekziston. Jemi vetëm ne, të çliruar nga koha, nga faji, nga gjithçka që na ndau.
Zëri i tij u zbut edhe më shumë.
-Dhe për herë të parë, nuk kam frikë nga ajo që do të vijë, sepse çfarë do që të ndodhë më pas, ky çast është i vërtetë. Dhe kjo mjafton.
Reflektime të brendshme
Ata qëndrojnë pranë një urë të vogël mbi lumin e ëndrrës, heshtja e natës përhap një qetësi të thellë.
Elira: Dhe spitali… çdo dhomë, çdo pacient, çdo dokument… Gjithçka që pamë aty, është pjesë e kujtimeve tona, por këtu nuk mund të na prekë.
Arbeni: Po. Kujtimet janë të gjalla, hijet e kuqe janë të pranishme në mendjen time… Por këtu ne gjejmë qetësi. Çdo prekje e buzëqeshje, çdo shikim,… na mbush me forcë

dhe dashuri.
Ata afrohen më shumë dhe shikimi i thellë bëhet një dialog pa fjalë. Një buzëqeshje e heshtur, një prekje e lehtë e gishtave, ndjenja e pranisë absolute.
Elira: Këtu dashuria jonë nuk mund të shuhet as nga koha, as nga dhimbja, as nga realiteti.
Arbeni: Elira. Në këtë vend mes ëndrrës dhe realitetit, ne jemi të lirë, të paprekshëm."
Momentet intime përfundimtare – nata e ëndrrës
Ata qëndruan ballë për ballë. Drita e ëndrrës u zbeh pak, sikur po u jepte kohë vetëm për fjalët e fundit.
Elira (me zë të ulët): Kur të zgjohemi… A do të thotë kjo se po ndahemi?
Arbeni e shikoi gjatë. Nuk kishte trishtim në sytë e tij, vetëm një qartësi e qetë.
Arbeni: Jo. Do të thotë vetëm se po kthehemi secili në vendin e vet. Ndarja është kur harron. Ne nuk harrojmë.
Elira buzëqeshi lehtë, me një buzëqeshje që mbante lotin brenda.
Elira: Atëherë pse dhemb kaq shumë?
Arbeni: Sepse dashuria që dhemb nuk është e gabuar. Është e vërtetë. Gjërat që janë të cekëta nuk lëndojnë kurrë.
Ajo uli kokën për një çast.
Elira: Në realitet nuk ditëm të jetonim bashkë.
Arbeni iu afrua edhe më.
Arbeni: Sepse realiteti kërkon forca që ne nuk i kishim. Por ëndrra kërkon vetëm guximin për të ndjerë.

Ai e preku lehtë dorën e saj.Arbeni (butë): Këtu nuk jemi të ndarë. Këtu jemi ashtu siç kemi qenë gjithmonë, pa frikë.
Elira ngriti sytë.
Elira: Atëherë le të mos i premtojmë asgjë ditës.
Arbeni: Jo. Le t'i lëmë ëndrrës gjithçka.
Ata u përqafuan. Jo me ngut, jo për t'u larguar më, por për t'u njohur për herë të fundit në atë formë. Trupat u qetësuan, frymëmarrjet u bashkuan dhe ëndrra i mbajti si një hapësirë që nuk kërkon shpjegim. Në atë përqafim nuk kishte frikë nga zgjimi. Vetëm një e vërtetë që u tha pa zë, mes dy zemrave që rrihnin njësoj:
Dashuria nuk matet me sa qëndron, por sa thellë mbetet edhe kur zgjohemi. Nuk ka ndarje mes dy njerëzve që vërtet e duan njëri-tjetrin.
Ajo që ne quajmë ndarje është vetëm koha. Dhe koha nuk është armik, por provë. Nuk është njeriu ai që ndan, as rruga, as rrethanat.
Është Zoti që vendos hapësirën dhe ëndrra që i mban bashkë.
Sepse dashuria e vërtetë nuk jeton vetëm në trup, as vetëm gjatë ditëve.
Ajo jeton përtej orëve, përtej distancave, përtej asaj që shohim.
Ajo ecën në heshtje, pushon në kujtesë dhe ringjallet në ëndërr.
Dhe nëse një ditë dy shpirtra kthehen sërish pranë njëri-tjetrit,

Nuk është rastësi, nuk është fat, as gabim i kohës.
Është dëshmi se ajo dashuri nuk i përkiste vetëm kësaj bote,
Por një universi më të gjerë, ku ndarja nuk ekziston,
Dhe bashkimi nuk ka nevojë për arsye.
Sepse ajo që është dashuri e vërtet, nuk ndahet kurrë. Ajo vetëm ndryshon formë, derisa të gjejë sërish vendin e vet.
Elira qante vazhdimisht për historinë dhe fatin e vet. Ajo shkroi një poezi dhimbjeje që e botuan shumë gazeta përndimore.
Të gjallë u ndamë, e jetojmë ende me këtë urrejtje.
Si re që lundron drejt portës së qiellit të zi.
Tashmë as pulëbardhat s'fluturojnë mbi dete,
Veç korbat sjellin ndonjë një lajm të ri.

Netët, si në varre, peshë i shtuan
ndarjes sonë të vrarë,
nën një qiell të errët, të pafund dhe të gjerë.
Pas nesh mbeti një brengë e tharë,
Edhe detet ujin e fundit avulluan
Kudo u përhap shkretira mbi rërë.
E për t'u mbjellur nuk mbeti më farë
Poezinë ia dërgoi së bashku me letrën e mallit për të dhe dashurinë e munguar

Letra e fundit……

Letër për Dr. Arben Kodra
Spitali Civil "Nënë Tereza", Tiranë
Uashingtonit, 10 shkurt 1998

I nderuar Dr. Arben Kodra,

Në pamundësi të takohemi dhe të jemi si më parë, po ju shkruaj nga larg. Hijet e kuqe nuk na lanë. Të morën nga unë, të tjetërsuan dhe të bënë të humbasësh arsyen në një botë ku elitat ushqehen me njeriun dhe e quajnë këtë politikë. Ne nuk u ndamë nga mungesa e dashurisë, por nga forca që sundojnë dhe zbrazin gjithçka. Dashuritë tona jetojnë vetëm si kujtime, si ëndrra që nuk u lejua të shfaqen në dritën e realitetit. Po ta shkruaj këtë letër jo për të rikthyer, por për të dëshmuar: Se dashuria jonë ishte e vërtetë, edhe kur bota e kthente njeriun në hijë, edhe kur gjithçka që vlente u shkatërrua, edhe kur gjithçka u bë e lejueshme dhe asgjë nuk mbeti e vlefshme.
Në këtë botë të poshtër, të pabesë, pa gjak dhe cinike, njerëzit shkojnë çdo ditë në punë si të programuar. Nuk kanë familje, nuk kanë prejardhje, nuk kanë rrënjë. Nuk duan t'ia dinë për njëri-tjetrin. Ata nuk jetojnë, funksionojnë. Janë vetëm hije që enden në hapësirën e tokës, trupa pa shpirt, prani pa kuptim.
Ata nuk e dinë çfarë është dashuria mes dy njerëzve, mes dy intelektualëve, mes dy qenieve që kërkojnë njëri-tjetrin. Jo për interes, por për kuptim. Ata njohin vetëm paranë dhe

famën. Nuk e kanë problem vdekjen e tjetrit. I papuni, i pastrehi, i shtypuri në regjime totalitare nuk ekziston për ta. Aty ku vdekja është dënimi më i madh. Ajo jepet pa zhurmë, pa gjyq, pa ndërgjegje.

Njerëzit janë larguar nga Krijuesi, ose ndoshta Krijuesi është larguar prej tyre. Nuk ka më rëndësi. Ata vazhdojnë të enden në hapësirën e dhimbjes, ku fiton më i forti, ku i ligu bëhet strehë, ku e keqja nuk fshihet më, por sundon hapur. E keqja nuk është devijim — Është sistem. Është eksperiment. Është norma…….

Në këtë botë, dashuritë jetojnë vetëm në ëndrra. Realiteti i refuzon. Divorci është kudo i pranishëm. Ftohtësia është ligj. Shpërbërja është model. Kudo ka fëmijë jetimë që bien në duart e të pashpirtëve, të atyre që e quajnë veten njerëz, por sillen si ujqër. Dashuria është vetëm një vegim, një dritë që shuhet para se të lindë.

Kjo është një botë masonësh të pashpirt, ku morali është mall i vjetër, ku shpirti është i shitur dhe njeriu ha njeriun. Një botë ku realiteti nuk ia vlen të jetohet, sepse e vërteta është vrarë prej kohësh.

Në fund, nuk mbeti as pyetje. Pyetjet u bënë të panevojshme, sepse përgjigjja ishte boshllëku. Kjo botë nuk u shkatërrua nga luftërat, por nga indiferenca. Njeriu nuk u vra. U fshi. Zoti heshti. Ose njeriu pushoi së dëgjuari. Heshtja ishte e njëjtë.

Dashuria nuk u tradhtua. U harrua. Mirë dhe keq u shkrinë në një indiferencë të ftohtë, ku gjithçka lejohet dhe asgjë

nuk ka vlerë. Vdekja nuk është ndëshkim. Është pushim. Jeta nuk është dhuratë. Është vonesë.

Dhe atëherë u shfaq një dritë. Jo për të shpëtuar. Jo për të gjykuar. Por për të zbuluar zbrazëtinë. Një dritë pa ngrohtësi, pa mëshirë, pa premtim. Hijet u tretën në të. Jo si shpirtra, por si gabime.

Nuk pati ferr. Nuk pati parajsë. Nuk pati ringjallje. Vetëm kthim në asgjë. Sepse e vërteta e fundit është kjo:

Kuptimi nuk humbi. Ai kurrë nuk ka ekzistuar. Dhe kështu, hijet vazhdojnë të ecin.

Pa zë. Pa fytyrë. Pa shpresë. Dhe ndoshta kjo është prova e fundit se gjithçka ka marrë fund. Ose se kurrë nuk ka filluar.

Kjo letër është fakt dhe simbol: Për ne, për dashurinë tonë dhe për të gjitha dashuritë e humbura të kësaj bote. Në fund, hijet vazhdojnë të ecin, pa zë, pa fytyrë, pa shpresë. Por ndoshta, vetëm ndoshta, këto fjalë do të mbeten si dritë në zbrazëtinë ku njeriu u bë i tepërt.

Dhe edhe dashuria jonë u bë hijë. Një kujtim i pashpirt që nuk ndryshon dot realitetin.

Me respekt dhe përjetësi, Elira Dosti Uashington Dc

Fund
Janar 2026

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Buçpapaj, Flamur
Hijet e kryeqytetit të kuq, psikopati : roman / Flamur Buçpapaj ; red. Mujë Buçpapaj. - Tiranë : Nacional, 2026.
... f. ; ... cm.
ISBN 9789928396846
1.Letërsia shqipe 2.Romane

821.18 -31